



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Prrenjas**

**RAPORTI**

**(Auditimin Financiar dhe i Përputhshmërisë)**

**BASHKIA PRRENJAS**

**Tiranë, 2024**

<b>PËRMBAJTJA</b>		<b>Faqe</b>
<b>I.</b>	<b>PËRMLLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	3-7
1	Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit	3-4
2	Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-6
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	6-7
<b>II.</b>	<b>HYRJA</b>	7-13
1	Objektivat dhe qëllimi	8-8
2	Identifikimi i çështjes	8-8
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9-9
4	Përgjegjësitë e audituesve	9-9
5	Kriteret e Vlerësimit	7-10
6	Standartet e auditimit	10-10
7	Metodat e auditimit	11-12
8	Dokumentimi i auditimit	12-13
<b>III.</b>	<b>PËRSHKRIMI AUDITIMIT</b>	13-123
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	13-13
2.	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit	13-123
2.1	Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin	13-15
2.1.1	Mbi auditimin e brendshëm	15-18
2.2	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit për vitin 2023	18-37
2.3	Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2023	37-48
2.4	Mbi planifikimin dhe zbatimin e procedurave të prokurimit publik	49-100
2.5	Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit	100-108
2.6	Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)	108-116
2.7	Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme	116-122
2.8	Të ndryshme të dala gjatë auditimit	122-122
<b>IV.</b>	<b>REKOMANDIME</b>	122-139
<b>V.</b>	<b>ANEKSE</b>	139-149

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Bashkia e Prrenjasit është njësi vendore institucion i pavaruar, ku pas ndarjes së re territoriale është një bashkim mes qytetit dhe tre ish-komunave në afërsitë të tij, pra në total ka 4 njësi administrative si vijon: njësia administrative Prrenjas (qyteti), njësitë administrative Qukës, Rrajcë, Stravaj.

**Misioni** i Bashkisë Prrenjas është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

**Synimi kryesor** është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

**Buxheti i Bashkisë Prrenjas** si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavaruar, nga transfertat e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transfertat specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

### b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditimi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisë të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Prrenjas si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

### c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, përperiudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Prrenjas. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.
- mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit public.
- mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.
- mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit, Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).
- mbi zbatimin i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

### d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme

verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

**e. Nga shqyrtimi i evidencave**, rezultoi se institucioni për periudhën nënauditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 35 gjetje dhe ka dhënë 38 rekomandime, nga ku masa organizative me 26 gjetje dhe 28 rekomandime, 1 gjetje-rekomandime për eliminimin e efekteve negative dhe 8 gjetje dhe 9 rekomandime në vlerën 120,231,937 lekë në fushën e të ardhurave.

**f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.** Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

- **Procedurat e prokurimit publik** për punë publike, mallra dhe shërbime:

Nga auditimi i **16** procedura prokurimi të zhvilluara në Bashkinë Prrenjas për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023, me fond limit 115,754 mijë lekë pa TVSh, u konstatuan parregullsi në përzgjedhjen e procedurës së auditimit, kritere jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DT, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, si më poshtë:

- Në **14** procedura nga 16 të audituara, me vlerë totale të fondit limit 110,038 mijë lekë pa TVSh ose 96% e fondit të procedurave të audituara, u konstatua se janë aplikuar kritere të paargumentuara dhe specifikime teknike të pa argumentuara, jo në lidhje të ngushtë me tipologjinë e procedurës që zhvillohet, e cila ndikon drejtpërdrejt në pjesëmarrjen e OE në procedurë për rritjen e konkurrencës, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të mesëm, si dhe ndikojnë indirekt në eliminimin e OE me oferta më të leverdishme dhe pengojnë në zbatimin e kontratës.

- Në **7** procedura nga 16 të audituara, me vlerë totale të fondit limit 72,284 mijë lekë pa TVSh, ose 63% e fondit të procedurave të audituara u konstatua se, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Prrenjas dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike në Bashkinë Prrenjas, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tyre u konstatuan mangësi dhe mosplotësim i kriterëve të vendosura në DT.

- Në procedurat me vlerë të vogël, u konstatua copëzim fondi dhe vlera e këtyre procedurave e tejkalonte shumë tavan prej 1 milion lekë, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi, ndërkohë që kishin funksion të ngjashëm dhe duhet të grupoheshin duke u prokuruar në një procedurë të vetme.

Gjithashtu në **3** procedura të llojit blerje e vogël u konstatua se vlerësimi i ofertave nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator.

- **Procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit**

- Në **2 (dy) raste**, projekti ndërtimor nuk është i plotë, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore

- Në **5 (pesë) raste**, Bashkia Prrenjas nuk është respektuar lartësia maksimale e kateve të pasaportave të njëjësive strukturore.

- Në **4 (katër) raste** ka mungesë të dokumentacionit teknik për leje ndërtimi që shoqërohen me prishje të objektit ekzistues dhe shtesa kati.

- Në **1 (një) rast**, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), Bashkia Prrenjas, nuk kanë kryer detyrat e tyre funksionale në lidhje me inspektimin e objekteve përpara dhe gjatë ndërtimit.

- **Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave**

- Të ardhura të munguara në vlerën 2,830 mijë lekë nga mosarkëtimi nga kontratat e qirasë të lidhura ndërmjet Bashkisë dhe subjekteve për veprimtari ekonomike si Hec, gurore etj.

- Të ardhura të munguara në vlerën 87,518 mijë lekë nga detyrimet tatimore, detyrime të cilat janë detyrime nga biznesi i madh, i vogël etj.,

- Të ardhura të munguara nga mosarkëtimi nga 7 kundravajtës i vlerës prej 4,000 mijë lekë të gjobave të vëna nga IMTV.

- Të ardhura të munguara nga mosarkëtimi i tarifës së qirasë dhe detyrimeve për taksën e ndërtimeve informale në vlerën 2,037 mijë lekë

▪ **Procedurat e ndjekura për inventarizimin dhe regjistrimin e aseteve**

Nga auditimi pronave të paluajtshme të Aparatit të Bashkisë Prrenjas dhe Njësive Administrative nga 3741 prona që i janë transferuar Bashkisë Prrenjas vetëm 40 pasuri janë regjistruar, përfshirë sipërfaqet e fondit pyjor. Në veçanti, konstatohet se nuk janë regjistruar pasuritë e shërbimeve arsimore, ndonëse për to janë realizuar investime përgjatë viteve. Inventarët e pasurive të paluajtshme nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se Bashkia Prrenjas nuk ka ngritur një strukturë të posaçme bashkëpunimi me Zyrën Vendore të ASHK-së për të verifikuar statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Si rrjedhojë, inventari rezultoi i papërditësuar.

Bashkia Prrenjas ka në administrim një fond pyjor dhe kulloros prej 18399.9 ha, i ndarë në 7 ekonomi pyjore dhe 2 ekonomi kullorore dhe ka hartuar plane mbarështimi për 2 ekonomi pyjore, nga 7 gjithsej, ndërsa një i tretë është në proces. Në zbatim të detyrimeve ligjore, numri i punonjësve të strukturës përgjegjëse për pyjet përcaktohet në përpjesëtim me sipërfaqen e fondit pyjor si më poshtë: një specialist pyjesh për 750 – 1000 ha për pyjet e larta. Për bashkinë Prrenjas, me një fond pyjor 18399 ha numri i punonjësve duhet të ishte 18 ndërkohë që numëron vetëm 10 inspektorë, përfshirë kryeinspektorin.

**h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:** Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Njësia e Prokurimit Bashkia Prrenjas, të marrë masat e nevojshme që kriteret e veçanta për kualifikim në DST të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

- Kryetari i Bashkisë Prrenjas për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorit ekonomik, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim mirëpërdorimin e fondeve publike, si dhe rritjen e besueshmërisë dhe integritetit të institucionit në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike.

- Nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit (DPZHMT), Bashkia Prrenjas të merren të gjitha masat për të kërkuar, në çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi ose çertifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacione e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionit shoqërues të tij, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi, si dhe të mos miratojë asnjë leje ndërtimi me mangësi të tilla.

- Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit (DPZHMT), Bashkia Prrenjas duhet të marrë siguri të lartë mbi saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, në përputhje me dispozitat ligjore, përpara miratimit të këtyre lejeve, siç janë: plotësia e projektit arkitektonik dhe ndërtimor, të hartuara sipas dispozitave ligjore, rregullatorë dhe normativave, ngarkimi në sistem i planvendosjes së miratuar, raportit të auditimit të efikasitetit të energjisë, së bashku me çertifikatën paraprake të energjisë, ngarkimi në sistem i të gjithë dokumentacionit shoqërues për profesionistët që kanë hartuar projektet ndërtimore, etj.

- Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit (DPZHMT), Bashkia Prrenjas duhet të marrë siguri të lartë mbi saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, në përputhje me dispozitat ligjore, përpara miratimit të këtyre lejeve, siç janë: plotësia e projektit arkitektonik dhe ndërtimor, të hartuara sipas dispozitave ligjore, rregullatorë dhe normativave, ngarkimi në sistem i planvendosjes së miratuar, raportit të auditimit të efikasitetit të energjisë, së bashku me çertifikatën paraprake të energjisë, ngarkimi në sistem i të gjithë dokumentacionit shoqërues për profesionistët që kanë hartuar projektet ndërtimore, etj.

- Nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit (DPZHMT) dhe Bashkia Prrenjas të marren të gjitha masat për të mos miratuar asnjë leje ndërtimi në mungesë të lejes

së zhvillimit ose Planit të Detajuar Vendor për njësinë strukturore ku ndodhet parcela në zhvillim.

- Sektori i Menaxhimit të Aseteve si dhe Drejtoria e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, për pasurit e pa regjistruara, të marrin masa për përgatitjen e dosjeve me dokumentacionin e duhur tekniko-ligjor dhe regjistrimin e tyre në ASHK. Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Aseteve, të llogarisë në buxhetin e PBA dhe buxhetin vjetor fondet e nevojshme për regjistrimin e pasurive në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë Prrenjas.

-Bashkia Prrenjas të marrë masa për eliminimin e praktikave të marrjes së angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, me qëllim uljen e rriskut për lindjen e detyrimeve shtesë financiare, si rezultat i mos respektimit të detyrimeve kontraktuale me kontraktorët.

- Bashkia Prrenjas, Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së detyrimeve për taksën e ndërtimeve informale në vlerë **2,037 mijë lekë**, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Prrenjas.

## **I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit**

### **a. Opinion mbi Pasqyrat Financiare të vitit 2023:**

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Përrenjas për periudhën ushtrimore 01.01.2023–31.12.2023, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

*"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Përrenjas janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të modifikua, me rezervë**", e shprehur kjo në bazën për opinionin.*

### **Baza për opinionin e modifikuar, me rezervë:**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA<sup>16</sup>). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Njësia shpenzuese Bashkia Përrenjas, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISA 700-ISSAI 1700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura (ISA 705-ISSAI 1705). Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 është 444,363 mijë lekë.

Gabimet materiale në pasqyrat financiare të mbyllura në datë 31 dhjetor 2022, paraqiten si më poshtë:

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se:

-Llogaria nr.468 "Debitorë të ndryshëm", është pasqyruar më pak për vlerën 2,672,984 lekë;

- Llogaria nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, është pasqyruar më shumë për vlerën 15.209.327 lekë;
- Llogaria nr.26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, është pasqyruar më pak për vlerën 280,000 lekë;
- Llogaria nr.467 “Kreditor të tjerë” është pasqyruar më pak për vlerën 919,709 lekë;
- Llogaria nr. 4342 “Operacione me shtetin (detyrime)” është nënvlerësuar në vlerën 22,401,738 lekë.
- Ilogaria 202 “Studime dhe Kërkime” është mbivlerësuar në vlerën 11,899,243 lekë.

#### **b. Opinion i auditimit të përputhshmërisë.**

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Përrenjas, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të Bashkisë Përrenjas, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës për periudhën 01.01.2023-31.12.2023.

*“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Përrenjas, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale<sup>1</sup> por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të modifikuar/kualifikuar të përputhshmërisë.*

#### **Baza për opinionin e modifikuar/kualifikuar:**

Opinionin e dhënë mbi përputhshmërinë e mbështesim në konstatimet e mëposhtme:

- Në **14** procedura nga 16 të audituara, me vlerë totale të fondit limit 110,038 mijë lekë pa TVSH, janë konstatuar shkelje në hartimin e kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit, pasi nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.
- Në **7** procedura nga 16 të audituara, me vlerë totale të fondit limit 72,284 mijë lekë pa TVSH, OE/BOE e kualifikuar nuk përmbushin kriteret e vendosura.
- Mos respektimin e detyrimeve kontraktuale nga subjektet private për asete të marra me qira, në vlerën **5,561** mijë lekë pa TVSH bashkë me kamatëvonesat nga mos likuidimi i vlerave kontraktuale;
- Mos ndjekjen e procedurave për arkëtimin e TNI nga ndërtimet informale në shumën **2,037 mijë lekë**;
- Mos zbatim të procedurave për arkëtim të gjobave të IMT për vlerën **4,000 mijë lekë**;
- Mos tarifimi për tarifatat e pastrimit dhe mjedisit në vlerën **4,490** mijë lekë për 27 subjekte;
- Mos pajisje me autorizim dhe mos arkëtim të taksës së karburanteve me vlerë **1,600 mijë lekë**;
- Mos arkëtimin e debitorëve për kategorinë familjar për taksat dhe tarifatat e ndërtesës, pastrimit dhe ndriçimit në vlerën **46,921** mijë lekë;
- Mos arkëtimin e debitorëve kategoria biznes në vlerën **87,518** mijë lekë;
- Mos arkëtimin e taksës së tokës bujqësore në vlerën **16,865** mijë lekë;
- Bashkia Përrenjas në rolin e autoritetit vendor të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, në **8 raste** nuk ka zbatuar plotësisht kuadrin rregullator të fushës dhe atë sektorial, në miratimin e aplikimeve për leje ndërtimi dhe çertifikatë përdorimi.

<sup>1</sup> Materialiteti është përlllogaritur në bazë të shpenzimeve për mallra, shërbime, punë publike si dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore duke përcaktuar materialitetin 2% mbi popullatën e përzgjedhur.

## II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. prot., 189/1, datë 20.02.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 20.02.2024 deri në datë 05.04.2024, në subjektin Bashkia Prrenjas për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023 u krye auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë”, nga grupi i auditimit me përbërje:

- 1.A. G, përgjegjës grupi;
- 2.A. D, auditues;
- 3.S. D, auditues;
- 4.E. G, auditues;
- 5.R. A, auditues.

## OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

### 1.Objektivat e auditimit.

-Për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

-Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me prokurimin e mallra/shërbime e investimeve, planifikimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit.

-Për auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara, miratimin e lejeve të zhvillimit dhe ndërtimit, si dhe kontrollin e territorit për ndërtimin e objekteve pajisur me leje zhvillimi dhe ndërtimi, ose deklarata paraprake për kryerjen e punimeve ndërtimore, për periudhën objekt auditimi.

-Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

### Qëllimi i auditimit

Objekivi i auditimit financiar në Bashkinë Prrenjas është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim 2023, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

### Identifikimi i çështjes.

Raporti Përfundimtar i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Prrenjas, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Fushat të cilat u audituan janë si vijon:

- 1.Aktiviteti i Njësisë së Auditit të Brendshëm;
- 2.Implementimi dhe zbatimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit;
- 3.Planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit;



4. Raportimi financiar;
5. Planifikimi, realizimi i prokurimeve publike;
6. Aktiviteti i Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit;
7. Planifikimi dhe zhvillimi i teritorrit;
8. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

### **Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.**

Niveli drejtues i Bashkisë Prrenjas (Kryetari i Bashkisë, në rolin e Nëpunësit Autorizues të institucionit) dhe niveli i mesëm drejtues (Drejtori i Drejtorisë së Financës, në rolin e Nëpunësit Zbatues), kanë përgjegjësinë për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar; Për krijimin e kontrolleve të brendshme të nevojshme, për të mundësuar përgatitjen e drejtë të pasqyrave financiare, pa keq-raportime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit; dhe kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit.

Gjithashtu Kryetari i Bashkisë Prrenjas, Drejtorët e drejtorive dhe Përgjegjësit e sektorëve pranë Bashkisë Prrenjas kanë përgjegjësinë për kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit.

### **Përgjegjësitë e audituesve.**

Përgjegjësia e audituesve është të shprehin konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim, pra nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë pozicionin financiar dhe rezultatet financiare të njësisë ekonomike janë në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi (ISSAI 1200.3). Audituesit janë përgjegjës për përgatitjen e Raportit të Auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, duke respektuar kërkesat etike, duke planifikuar dhe kryer auditimin, sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së arsyeshme. Këto standarde kërkojnë që në të përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi.

Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozonë që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi profesional i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë gjithë procesit të auditimit, audituesi duhet të ushtrojë gjykim dhe skepticizëm profesional dhe ndër të tjera: Identifikon dhe vlerëson risqet e keq-pasqyrimit material, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, bazuar në të kuptuarit e entitetit dhe mjedisit të tij, përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë. Merr evidencat e duhura dhe të mjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e keqraportimeve materiale. Formon një opinion për pasqyrat financiare dhe objektivat shtesë mbi të cilat raportimi është i detyrueshëm bazuar në përfundimet e nxjerra nga evidencat e grumbulluara. (ISSAI 1200.7) Raporton rastet e mospërputhshmërisë me bazën ligjore, përfshirë buxhetin dhe përgjegjshmërinë, dhe/ose Raporton mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

### **Kriteret e vlerësimit**

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Prrenjas është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Prrenjas. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;
- Ligjin nr.20/2020 datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”;
- VKM nr.500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme Shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendor”
- V.K.M Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;
- VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar
- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i MF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;
- Udhëzimin e MF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”;
- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.05 datë 21.02.2022;
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
- *Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”;*
- *Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së”;*
- *Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.*
- *Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut;*
- *Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.*

### **Standardet e auditimit.**

Për kryerjen e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë në Bashkinë Prrenjas grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.

### **Metodat e auditimit**

Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që

auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Në gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kandidateve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik, dhe
- Peshat specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Ndjekja dhe zbatimi i hapave të mësipërm do të sjellin natyrshëm përcaktimin e elementëve kryesorë që do të ndiqen gjatë procesit të zbatimit të projektit të auditimit, nëpërmjet sigurimit të gjurmës së projektit të auditimit. Gjurma e auditimit është dokumentimi i procesit të realizimit të Projektit të Auditimit. Evidentimi i zbatimit të procedurave të auditimit nëpërmjet dokumentimit përfshin të gjitha fazat e kryerjes së Projektit të Auditimit që nga Planifikimi i Auditimit, Puna në Terren, Raportimi i Auditimit, Ndjekja e Rekomandimeve dhe Publikimi i Auditimit. Theksojmë se nga ana jonë do të auditohen pothuajse të gjitha fondet, si më poshtë:

#### ▪ Konrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Konrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

#### ▪ Konrolli me anë të pjesëve justifikuese

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga konrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) u konstatua se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar.

#### ▪ Inspektimi fizik dhe konrolli i gjendjeve ekzistuese

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Konrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

#### ▪ Konrolli i vlerësimeve

Konrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

#### ▪ Konfirmimi nga të tretët

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

#### ▪ Konrolli sipas një treguesi

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, të cilat përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

#### ▪ Intervista

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Prrenjas me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

- Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim

- Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231). Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrolleve është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit, konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke iu nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja<sup>2</sup>.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst, procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose në trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në observime, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur ka ndodhur observimi; dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetentë dhe të mirëinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

### **Dokumentimi i auditimit.**

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Me shkresën nr. 189/11, datë 29.04.2024, nga grupi i auditimit të KLSH është nisur Projektraport Auditimi në të cilën u evidentuan mangësitë e konstatuara gjatë procesit të auditimit, mangësi të cilat nuk gjeten argument dhe nga observacionet e paraqitura nga subjekti në fazën e aktkonstatime.

---

<sup>2</sup> Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm \* Risku i kontrollit \* Risku i Zbulimit

Me shkresën nr. 1508-1508/13, datë 24.05.2024 (*prot., KLSH nr. 189/16, datë 29.05.2024*), nga subjekti Bashkia Prrenjas u paraqitën kundërshtitë e Projektraport Auditimit, të cilat pasi u lexuan nga grupi, gjetjet mbi për të cilat nuk kishin argumentin e duhur ligjorë gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, i cili i përcillet subjektit për përmisimin e gjendjes në të ardhmen.

### **III.PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

#### **1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:**

Bashkia është person juridik. Ky autoritet ushtrohet nëpërmjet akteve të këshillit dhe kryetarit të bashkisë si organe të zgjedhura, në përputhje me kompetencat dhe në ushtrimin e funksioneve qeverisëse që ato kanë në bazë të ligjit.

Auditimi në subjektin “Bashkia Prrenjas”, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t’u audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan shmangie dhe të meta në fushën e financës (*materiale por jo të përhapura*), si dhe të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi, në fushën e prokurimeve, lejeve të ndërtimit etj.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, auditimeve të realizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, fondet e shpenzuara dhe të ardhurat e arkëtuara, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

#### **2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.**

##### **2.1. Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe Auditin i Brendshëm.**

Në zbatim të nënpikës 1.1 të programit të auditimit: “Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi dhe Komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Rregullorja e brendshme e miratuar;
2. Kod i brendshëm etik ose një kod sjellje, apo udhëzim për zbatimin e etikës;
3. Strukturën organike të institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore;
4. Shkresat e përcaktimit të NA në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
5. Shkresat për krijimin e grupeve të Menaxhimit Strategjik;
6. Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnime të tyre;
7. Strategjinë dhe Regjistrin e Riskut;
8. Lista ose harta e proceseve të punës;
9. Raportet e Monitorimit;
10. Pyetësori i Vetëvlerësimit.

Drejtimet kryesore të auditimit të MFK-së janë:

- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.
- Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi/Komunikimi, si dhe Monitorimi.
- Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

Krijimi dhe zbatimi i sistemit të kontrollit të brendshëm financiar në njësitë e sektorit publik është thelbësor për sigurimin e mirëmenaxhimit financiar, që mundëson realizimin e qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara në mënyrë etike, duke shfrytëzuar burimet në mënyrë të ligjshme, ekonomike, efektive dhe eficiente. Për shkak të kompleksitetit të tij, sistemi i kontrollit të brendshëm financiar publik kërkon monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm të përshtatshmërisë dhe funksionalitetit të tij, proces i cili realizohet nëpërmjet vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, performuar dhe raportuar nga nëpunësit autorizues të njërive të qeverisjes së përgjithshme si dhe nëpërmjet shërbimit të auditimit të brendshëm e të jashtëm.

Në drejtim të vlerësimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Prrenjas, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimin e objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “*Mjedisi i Kontrollit*”, “*Menaxhimi i Riskut*”, “*Aktivitetet e Kontrollit*”, “*Informimi dhe Komunikimi*” si dhe “*Monitorimi*”, sipas përcaktimit të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit, si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si: “*Mjedisi i kontrollit*”

Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime në moszbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 64, pika “h”, Ligjit nr. 10296 /2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe “Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Kapitulli III, pika 3.1

Përsa i përket politikave që lidhen me burimet njerëzore Konstatohet se për 32 punonjësit e larguar, në disa raste nuk është vepruar sipas udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 13.

-VKM nr. 360, datë 14.07.2000 “Për lirim nga shërbimi civil”, pikat 19, 20 dhe 21 “Dorëzimi i detyrës”

“*Menaxhimi i Riskut*”

-Nga auditimi, rezultoi se gjurmët standarde të auditimit nuk janë hartuar dhe miratuar nga titullari i njësisë, si një dokument i unifikuar për të gjitha proceset e Bashkisë Prrenjas, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 16, pika 2; “*Manualin e menaxhimit financiar dhe kontrollit*” kapitulli V; UMF nr. 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar, nenet 121 dhe 122;

-Bashkia Prrenjas nuk ka hartuar listën (hartën)/manualin e proceseve të punës, në moszbatim të Ligjit nr. 10296 /2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe “Manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit”, Kapitulli III, pika 3.3;  
“Aktivitetet e Kontrollit”

Nga Bashkia Prrenjas nuk është hartuar/miraturar një Plan i Kontrollit të Brendshëm periodik apo vjetor, kjo në moszbatim të nenit 22, pika 1 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, “Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.  
“Informimi dhe komunikimi”

- Sistemi i raportimit nuk ofron sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.- Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.

Komunikimi i brendshëm Një prej kanaleve më të rëndësishme të komunikimit nuk është në nivelet e duhura, në një njësi është ai ndërmjet titullarit, menaxherëve dhe punonjësve të tij “komunikimi vertikal”. Punonjësit nuk njihen sa duhet me sistemin e komunikimit të brendshëm dhe të kuptojnë rolin e tyre, detyrimet dhe përgjegjësitë që çdonjëri ka në këtë sistem. Falë komunikimit ata bëhen më të ndërgjegjshëm për rolin dhe përgjegjësitë që kanë në lidhje me arritjen e qëllimeve dhe objektivave të njësisë. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Manuali i MFK, miraturar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016. Kapitulli III. Komponentët E Menaxhimit Financiar Dhe Kontrollit pika 3.4.

“Monitorimi”

-Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 24. Manuali i MFK, miraturar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016. Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi, znj. Z. Ç Drejtore e Burimeve Njerëzore, znj. S. K Drejtore e Financës.

### **2.1.1. Auditim mbi organizimin e njësisë së auditit të brendshëm dhe vlerësimin e veprimitarisë së njësisë së auditit të brendshëm.**

Në zbatim të pikave 1.2 dhe 1.3 të programit të auditimit, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Karta e Auditimit të Njesisë Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Prrenjas;
2. Plani Strategjik dhe vjetor, si dhe pasqyrat shoqëruese;
3. Programimi i auditimeve të brendshme për vitin 2023;
4. Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm;
5. Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;
6. Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditimit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.

### **Përshkrimi i situatës mbi krijimin dhe përbërjen e strukturës së njësisë së auditit të brendshëm.**

-Njësia e Auditit të Brendshëm për vitin 2023 ka funksionuar me 2 Auditues me, 1 përgjegjës Sektori dhe 1 specialiste auditit, sipas VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, ku sipas pikës 3, të këtij vendimi thuhet se “Njësia e Auditit të Brendshëm përbehet nga jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e Njesisë”. Në strukturën e Njesisë së Auditit të Brendshëm mund të punësohen deri 1/3 e punonjësve të pa çertifikuar si Auditues te Brendshëm në sektorin publik.

Tabela nr. AB1 Struktura e Auditit të Brendshëm me të dhënat sipas tabelës.

Nr	Periudha	Funksioni	Emëruar	Arsimimi	Vjetërsi në pune	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnime te vijueshme
1	B. K	Pergjegjës	Nr.554 datë 20.11.2018	I Lartë Ekonomist	34	6	Viti 2021	Po
2	A. B	Audituese	Nr.472 datë 09.10.2018	I Lartë Ekonomist	10	10	Viti 2013	Po

Burimi: Bashkia Prrrenjas Njësia e Auditit të Brendshëm.

### **Plani strategjik:**

Planet Strategjikë dhe Vjetore të NJAB të Bashkisë Prrrenjas janë përcjellë në Ministrinë e Financave brenda afateve të përcaktuara në Ligjin 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, në “Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”  
Për vitin 2023 është miratuar nga Titullari i Bashkisë me shkresën nr.2598/1 datë. 05.10.2022 plani vjetor dhe ai strategjik për vitet 2023-2025 të veprimtarisë së Auditit të Brendshëm dhe me i është dërguar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave.

**Raportimi:** Për veprimtarinë e NJAB në Bashkisë Prrrenjas për periudhën objekt auditimi, është raportuar në mënyrë sistematike. Janë hartuar dhe dërguar në NJQHAB të MFE raportet periodike vjetore të shoqëruara këto me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmblyllës për veprimtarinë e NJAB, përkatësisht për vitin 2023 me shkresën nr. 5091/1 prot., datë 08.02.2024. Për veprimtarinë e NJAB në Bashkisë Prrrenjas për periudhën objekt auditimi, është raportuar në mënyrë sistematike.

**Karta e AB:** Karta e Auditimit të Njesisë AB dhe Urdhëri i Titullarit për miratimin e saj, është ngritur me Urdhërin e Titullarit nr. 82, date 10.01.2023 “Për miratimin e kartës së Auditit të Brendshëm” dhe Karta e Auditit të Brendshëm dhe e dërguar pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave me nr. 82/1 prot., datë 10.01.2023.

**Plani Vjetor:** Për vitin 2023 është miratuar me nr. 2593/3 prot., relacioni shpjegues nr. 2598/2 datë 05.10.2022.

Për vitin 2023 janë planifikuar 7 auditime janë realizuar 7 auditime si më poshtë:

- Program angazhimi për Drejtorinë e Financës Magazina (Inventari Ekonomik) nr.23 prot., datë 05.01.2023.
- Program angazhimi për Ndjekjen e Rekomandimeve nr. 841/1 842/1 843/1 844/1 845/1 prot., datë 20.03.2023.
- Program angazhimi për Drejtorinë e Financës (Për detyrimet e prapambetura) nr.1594/1 prot., datë 13.06.2023.
- Program angazhimi për Drejtorinë e të Ardhuave dhe Licencave nr. 1819/1 prot., datë 06.07.2023.
- Program angazhimi për Drejtorinë e Infrastrukturës rrugore nr. Prot., 2663 datë 04.10.2023.
- Program angazhimi për Drejtorinë Juridike Prokurimet nr. 3118 prot., datë 13.11.2023.
- Program angazhimi për Drejtorinë e Shërbimit Pyjor dhe Kullotave nr. Prot., 3232 datë 23.11.2023.

Tabela nr.AB2 Të dhënat sipas raportimit.

Nr	Periudha	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT								
		Auditime ta planifikuara	Auditime te realizuara	Nga te realizuarat, sipas llojit					Teknologjisë së informacionit	Zbatim Rekomandime
				Perputh	Financ	Kombinuar	Performace	Tematik		
1	Viti 2023	7	7	4		2				1

Burimi: Bashkia Prrrenjas Njësia e Auditit të Brendshëm.

Për periudhën e vitit 2023 janë realizuar 7 auditime ku 4 nga auditimet rezultojnë auditime përputhshmërie 2 auditime të kombinuara dhe një auditim zbatim rekomandimesh.



Tabela nr. AB3 Rekomandimet e shprehura në numër.

Nr.	Periudha	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT			
		Rekomandime të shprehura në numër			
		Gjithsej në numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
1	Viti 2023	62	-	62	

Burimi: Bashkia Prrrenjas Njësia e Auditit të Brendshëm.

Nga auditimet e kryera janë dhënë në total 62 rekomandime, nga të cilat 62 rekomandime janë në proces zbatimi.

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura u konstatua se përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, “Manuali i Auditimit të Brendshëm” (MAB). Rezultoni se në fillim të vitit janë hartuar deklaratat e pavarësisë, për çdo rast të angazhimit të auditimit janë bërë njoftimet për fillimin e angazhimit të auditimit si dhe autorizimet përkatëse me protokoll të veçantë, si dhe për çdo auditim janë hartuar deklaratat e pavarësisë. Është zhvilluar takimi i hapur prezantues dhe ai përmyllës, janë hartuar pyetësorët e vlerësimit të përgjithshëm të riskut dhe të fushës që është audituar, si dhe është bërë inventari i dosjeve me dokumentet përkatëse. Hartimi i projekt-raporteve dhe raporteve përfundimtare është bërë sipas strukturës së miratuar në manualin e auditimit. Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të MAB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të MF “Për miratimin e Manualit të AB në sektorin publik” kapitulli IV, pika 4.1.1 “planifikimi i një angazhimi auditimi”; kapitulli VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese”, pika 6.1 “Niveli i dokumentimit”; Kapitulli VII, “Sigurimi i cilësisë së punës të AB”, pika 7.1.1 “Vlerësimi i brendshëm i cilësisë që kryhet nga vetë NJAB”. Në lidhje me vlerësimin e brendshëm të cilësisë që kryhet nga vetë NjAB konstatohet se anekset “Monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë” dhe “vetëvlerësimin periodik” nuk janë plotësuar sipas përcaktimeve në pikën 7.1.1 në Kapitullin VII të MAB, të cilat nuk mbulojnë në të gjitha fazat e auditimit si dhe i mungon komponenti i tretë “Reagimet e subjektit të audituar”. “Për Auditin e Brendshëm Publik”. Në Programin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, nuk ka të përcaktuar Indikatorët e matjes së performancës, gjë që ka kushtëzuar hartimin e raporteve specifike të vlerësimit të performancës dhe si rrjedhim adresimin e rekomandimeve për përmirësim, duke munguar raportimi tek Titullari për këtë procedurë. Në disa dosje nuk ka gjurmë, nuk dokumentohet dhe nuk administrohet në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar (e konfirmuar dhe e nënshkruar nga titullari i subjektit të audituar dhe personat e përfshirë në auditim. Gjithashtu në disa dosje të auditimit mungon Memo e planifikimit, pra Projekt Drafti i programit të auditimit në fazën e hartimit të programit të angazhimit. Nga Përgjegjësi i Njësies së Auditimit të Brendshëm nuk është vepruar konform me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitullin III, pika 3.2 “Plani vjetor i Auditimit”, që kryhet nga vetë nga kjo njësi. Në fund të procesit të auditimit në disa dosje mungojnë letrat e punës për secilin auditues të cilat duhet të përfshijnë regjistrimin e punës së audituesit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemit. Në programet e auditimit nuk është përfshirë si drejtim “vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si pasojë audituesit e brendshëm nuk kanë marrë në shqyrtim identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar. Mungesa e planeve të veprimit ka sjellë mungesën e monitorimit nga NJAB për zbatimin e rekomandimeve nga ana e subjekteve të audituara brenda afateve të përcaktuara, në moszbatim të përcaktimeve të kreut 4.1.13.1 dhe 4.1.13.2 “Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit”, paragrafi 3, si dhe “Raportimi i ndjekjes së rekomandimeve”, paragrafi 4; mosraportimit të subjekteve të audituara në moszbatim të Kreut 4.1.13.3 “Përgjegjësitë e njësies për të zbatuar rekomandimet e auditimit të brendshëm” të “Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”. Bashkia Prrrenjas ka krijuar NJAB, e cila e ushtron funksionin e vet me dy auditues (1 përgjegjës dhe 1 specialist) në strukturën organizative të saj dhe me një vend vakant, në kundërshtim me Ligjin

nr. 114/2015, “Mbi auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, pika 3, “Manualin e procedurave të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, VKM-në nr. 83 datë 03.02.2016, “Për miratimin e kritereve të krijimit të njërive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, pikat 3 dhe 6.

*Për veprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi, B K, Përgjegjës i sektorit të auditit të Brendshëm. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe “Manuali i auditimit të brendshëm në sektorin publik”; Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; VKM nr. 83/2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njërive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”; Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; “Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, etj.*

## **2.2 Auditim mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit të vitit 2023.**

### **➤ Dokumentacioni i audituar si më poshtë:**

- 1. Dokumentacioni i hartimit të PBA-ve për periudhën objekt auditimi, miratimi i tyre dhe korrespondenca me Ministrinë e Linjës;*
- 2. Dokumentacioni i programimit të buxhetit vjetor për periudhën objekt auditimi, i miratuar me VKB, fondet e transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MFE, si dhe korrespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë kësaj periudhe buxhetore;*
- 3. Akt-rakordimet periodike me Degën e Thesarit për shpenzimet dhe të ardhurat;*
- 4. Dokumentacioni mbi çeljen e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative;*
- 5. Shkresat përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve, si fatura të palikuiduara dhe vendime gjyqësore;*
- 6. Dokumentacioni mbi transferimin e fondeve buxhetore gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe saktësia e pasqyrimin të ndryshimeve në shtesa dhe pakësim me planin përfundimtar.*
- 7. Dokumentet e hartuara në mënyrë periodike për monitorimin zbatimit të buxhetit për periudhën objekt auditimi;*
- 8. Dokumente të tjera mbështetëse (baza të ndryshme të dhënash në programin “EXCEL”, si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditarët, shpenzimet, të ardhurat etj.).*

### **2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2023.**

#### **• Përgatitja e Programeve Buxhetore Afatmesme 2023-2025**

Nga auditimi i dokumentacionit të sipërcituar, u konstatua se për vitin 2023 për përgatitjen e PBA 2023-2025 dhe buxhetet vjetore, që i korrespondojnë kësaj periudhe, janë miratuar me VKB nr.3, datë 26.12.2022, si dhe VKB përkatëse për miratimin e fondeve të trashëguara për çdo fillim viti buxhetor. Gjithashtu janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 33/1 prot., datë 13.01.2023. Në vija të përgjithshme gjatë hartimit dhe miratimit të kërkesave buxhetore, janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe asaj rurale, përmirësimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin, rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tregjeve të reja, përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe aksesit, mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të përmirësimit të biznesit, mbrojtjen e tokave bujqësore, rehabilitimin dhe investimin e infrastrukturën bujqësore, promovimin dhe marketingun e produkteve bujqësore, mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, përmirësimin e sistemit të edukimit dhe trajnimit profesional, mbulimin e territorit me shërbime sociale sipas nevojave të komunitetit, zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive, sigurimin e mbrojtjes civile dhe menaxhimin e katastrofave në të gjithë territorin e Bashkisë Prrenjas.

Fusha me prioritet në shpenzimet për investime janë konsideruar:

- a. Përmirësimi i infrastrukturës nëntokësore me shtrirjen e rrjetit të kanalizimeve
- b. Mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin e objekteve shkolllore.
- c. Mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin e rrugëve.
- d. Mbrojtja e mjedisit
- e. Shtimin e fondeve për mbështetjen e shtresave në nevojë.
- f. Kërkesa për strehim.
- g. Sherbimi shendetesor në zonat rurale.

PBA janë hartuar pjesërisht bazuar në Udhëzimin e MFE nr.23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor Afatmesëm të njësisive të Qeverisjes Vendore”. Është marrë në konsideratë instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion (kontratat në vazhdim), angazhimet (detyrimet e prapambetura sipas llojit), tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme (kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme).

Programi i të ardhurave për vitin 2023 është bërë mbi bazën e paketës fiskale të miratuar me VKB nr.11, datë 26.12.2022.

Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit.

Buxheti total i Bashkisë Prrrenjas për vitin 2023 është në vlerën **901,708,301** lekë.

Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë për vitin 2023, realizohen nga dy burime:

**Nga burimet e veta vendore**, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifatat vendore, të ardhura të tjera, donacione dhe të ardhura që trashëgohen;

**Nga burimet qendrore**, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike për funksionët e reja, që i janë transferuar Bashkisë dhe transfertat e kushtëzuar.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2023, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet planifikimi sipas PBA-ve dhe buxheti vjetor.

Tabela nr.1 PBA për periudhën 2023-2025 sipas programeve ekonomike që menaxhon Bashkia Prrrenjas

Nr.	Emërtimi	PBA	Buxheti vjetor	Realizimi i	Diferenca
		Plan viti 2023	2023 (Plani i rishikuar)	periudhës progresiv	
		(1)	(2)	(3)	(3-2)
1	Planifikim Menaxhim Administrimi	219,742,841	219,742,841	175,479,162	44,263,679
2	Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit	22,632,588	22,632,588	19,597,598	3,034,990
3	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	18,572,400	18,572,400	15,785,385	2,787,015
4	Shërbimi i mbrojtjes ndaj zjarrit	18,027,709	18,027,709	13,993,936	4,033,773
5	Menaxhimi I Rrugëve Rurale	115,936,442	115,936,442	60,975,278	54,961,164
6	Sherbimi i Policisë Vendore	4,381,080	4,381,080	3,680,324	700,756
7	Shërbimet publike vendore Ndërmarrja e Sherbimeve	38,906,006	38,906,006	33,737,736	5,168,270
8	Sherbimet publike vendore (sherbimi I pastrimit )	42,427,688	42,427,688	28,804,087	13,623,601
9	Zhvillimi i Sportit	1,500,000	1,500,000	0	1,500,000
10	Arti dhe Kultura	4,500,000	4,500,000	3,483,700	1,016,300
11	Arsimi baze (përfshi dhe parashkollorin )	83,105,760	83,105,760	58,714,951	24,390,809
12	Arsimi mesem I përgjithshëm	4,148,443	4,148,443	2,790,394	1,358,049
13	Cerdhja e femijeve	12,938,485	12,938,485	9,096,448	3,842,037
14	Mbrojtja Sociale	591,621	591,621	563,655	27,966
15	Fondi rezerve	3,015,103	3,015,103	2,759,761	255,342
16	Emergjencat Civile	1,500,000	1,500,000	0	1,500,000
17	Kujdesi Social për Familjet dhe Fëmijet	475,728,461	475,728,461	442,212,391	33,516,070
18	Kapitale të trupëzuara	33,437,790	33,437,790	30,033,495	3,404,295
<b>Totali i Shpenzimeve të Njesisë</b>		<b>1,101,092,417</b>	<b>1,101,092,417</b>	<b>901,708,301</b>	<b>199,384,116</b>

Burimi: Bashkia Prrrenjas, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme, mbi planifikimin buxhetor afatmesëm 2023-2025, pjesë e të cilit është edhe planifikimi për vitin buxhetor, si dhe krahasimi i tij me planin progresiv të vitit buxhetor, rezulton se diferenca ndërmjet planit fillestar dhe atij final është 199,384,116 lekë. Diferencë e konsiderueshme rezulton në programin ekonomik për “Menaxhimi i rrugëve rurale”, “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”, “Kujdesi social për familjet dhe fëmijë”, “Arsimi bazë dhe Parashkollori”, “Shërbimet publike vendore (shërbimi i pastrimit)”, “Shërbimet publike vendore Ndermarrja e Shërbimeve” dhe “Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri”, etj..

Pjesë e PBA dhe planifikimit të buxhetit vjetor, është edhe planifikimi i të ardhurave, si burim i integruar në programet buxhetore, të pasqyruara në tabelën e mësipërme. Kështu për periudhën 2023-2025 Bashkia Prrenjas ka planifikuar të arkëtojë të ardhura tatimore dhe jo tatimore, pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon:

Tabela nr.2 Planifikimi i të ardhurave

Përshkrimi	Plan 2023
Te ardhura tatimore	51,250
Te ardhura jotatimore	83,750
<b>TOTAL</b>	<b>135,000</b>

Burimi: Bashkia Prrenjas, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për PBA 2023-2025 nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në pikën 1 të nenit 37 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, si vijon:

*“Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të përditësuara të të ardhurave dhe transfertave nga Buxheti i Shtetit, të përcaktuara në udhëzimin plotësues të përgatitjes së buxhetit vendor të Ministrisë së Financave, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe paraqet për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik”.*

-Për PBA 2023-2025 nga Kryetari i Bashkisë nuk është nxjerrë udhëzimi vjetor për përgatitjen e buxhetit;

-Për PBA 2023-2025 nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e përcaktuara në shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisë të vetëqeverisjes vendore”, për drejtuesit e ekipit të menaxhimit të programeve buxhetore të Bashkisë Prrenjas, lidhur me hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, për realizimin e qëllimeve, objektivave dhe produkteve të programit gjatë procesit të zbatimit të buxhetit. Konkretisht në dosjet përkatëse të PBA dhe buxheteve vjetore, (nuk) administrohet dokumentacion mbi kërkesat për fondet të bëra nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Prrenjas, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse, (nuk është bërë analize e detajuar);

-Tavanet Përfundimtare të PBA-së 2023-2025, janë miratuar jashtë afateve;

-Nuk janë zbatuar të gjitha fazat e hartimit të PBA, nuk është i dokumentuar i plotë i gjithë procesi i hapave të punës që duhet të ndiqen nga EMP dhe GMS-ja;

Veprime në kundërshtim me Shkronja “ç” në nenin 5, pika 3 në nenin 13, pika 1 në nenin 33, pika 1 në nenin 35, pika 1 në nenin 37 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pika 6, pika 10, pika 33, pika 34, pika 29, shkronjat “a-h” të pikës 40 në Udhëzimin nr.23, datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisë të vetëqeverisjes vendore”. Udhëzimi nr. 7, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025”.

**2.2. Celja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.**

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit duke u bazuar në faktin e vitit parardhës.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Këto lëvizje, në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet ndërmjet programeve buxhetore janë kryer me Vendim të Kryetarit të Bashkisë.

Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Librazhd dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve, sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit, duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Gjatë vitit buxhetor, buxheti i Bashkisë Prrenjas ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

Nga Këshilli i Bashkisë është bërë miratimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas burimeve të financimit, strukturës buxhetore dhe institucioneve.

Tabela nr. 3, Planifikimi i buxhetit për vitin 2023, Bashkia Prrenjas

Planifikimi i të ardhurave 2023		Planifikimi i shpenzimeve 2023	
Burimi i të ardhurave	000/ lekë	Emërtimi i zërave	000/ lekë
Të ardhura të trashëguara nga viti paraardhës	37,100		
Transferta e pakushtëzuar trashëguar viti paraardhës	60,417		
Trashëguar nga transfertat specifike	19,814		
Të trashëguara nga FZHR			
Plani i të ardhurave viti ushtrimor	135,000		
Granti	734,611		
Transferta specifike	114,149		
		Paga (600) + sigurime shoqërore (601)	248,467
		Shpenzime operative (602)	143,478
		Investime (230+231) nga të ardhurat dhe tr.e pakushtëzuar	189,624
		Fondet emergjencë dhe fondet rezervë	3,992
		Investime (230+231) nga buxheti i shtetit	33,438

		Shpenzime (603+604+606)	482,094
<b>Totali të Ardhurave</b>	<b>1,101,093</b>	<b>Totali Shpenzimeve</b>	<b>1,101,093</b>

Burimi: Bashkia Prrenjas, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Rezulton se buxheti i konsoliduar (Bashki + Njësia e Varësisë) vitit 2023 është miratuar i balancuar dhe pa defiqite. Të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën **1,101,093 mijë lekë**.

Përgjatë vitit 2023, kanë ndodhur 4 ndryshime buxhetore me efekt në shtesa/pakësim të fondeve për artikull ekonomik, veprime që tregojnë për planifikime jo optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit, si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv.

Tabela nr.4, Ndryshimet buxhetore për vitin 2023

Periudha Buxhetore	Buxheti fillestar		Ndryshime gjatë vitit		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve					
	Nr. datë	Vlera	Nr. Datë	Vlera	Pakësuar artikulli / shtuar artikulli					
					Shtesa. Art.	Shuma	Pakësim. Art.	Shuma		
Viti 2023	NR.03 DT 26.12.2022	1,101,092,417	NR.66 DT 30.06.2023	3,261,518	600	2,716,844				
					601	544,674				
					600	469,160	602	11,485,500		
					601	78,350	231	7,549,694		
					602	6,500,000		0		
					NR.67 DT 30.06.2023	19,035,194	231	11,987,684		0
					600	7,371,464		0		
					NR.81 DT 30.08.2023	8,626,464	601	1,255,000		0
					NR.83 DT 30.08.2023	2,310,051	602	174,316	602	2,085,794
					231	2,135,735	231	224,257		
								0		0
					<b>Totali Viti 2023</b>			<b>33,233,227</b>		<b>33,233,227</b>

Burimi: Bashkia Prrenjas, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Mbështetur në përcaktimin e bërë në pikën 149 të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, në gjykimin e grupit të auditimit ndryshimet buxhetore përgjatë vitit buxhetor, tregojnë për një performancë jo të mirë në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit.

Tabela nr.5, Realizimi i buxhetit vjetor në nivel programi ekonomik viti 2023

Nr.	Emërtimi	Buxheti Vjetor 2023 (Plani i rishikuar)	Realizimi	Në %
1	Planifikim Menaxhim Administrimi	219,742,841	175,479,162	80%
2	Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit	22,632,588	19,597,598	87%
3	Administrimi I pyjeve dhe kullotave	18,572,400	15,785,385	85%
4	Sherbimi I mbrojtjes ndaj zjarrit	18,027,709	13,993,936	78%
5	Menaxhimi I Rrugeve Rurale	115,936,442	60,975,278	53%
6	Sherbimi I Policise Vendore	4,381,080	3,680,324	84%
7	Sherbimet publike vendore Ndermarrja e Sherbimeve	38,906,006	33,737,736	87%
8	Sherbimet publike vendore (Sherbimi i pastrimit )	42,427,688	28,804,087	68%
9	Zhvillimi i Sportit	1,500,000	0	0%
10	Arti dhe Kultura	4,500,000	3,483,700	77%
11	Arsimi baze (perfshi dhe parashkollorin )	83,105,760	58,714,951	71%
12	Arsimi mesem I pergjithshem	4,148,443	2,790,394	67%
13	Cerdhja e femijeve	12,938,485	9,096,448	70%
14	Mbrojtja Sociale	591,621	563,655	95%
15	Fondi rezerve	3,015,103	2,759,761	92%
16	Emergjencat Civile	1,500,000	0	0%
17	Kujdesi Social për Familjet dhe Fëmije	475,728,461	442,212,391	93%
18	Kapitale të trupëzuara	33,437,790	30,033,495	90%
	<b>Totali i Shpenzimeve të Njesisë</b>	<b>1,101,092,417</b>	<b>901,708,301</b>	<b>82%</b>

Burimi: Bashkia Prrenjas, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se:

**Për vitin 2023** realizimi i buxhetit është në nivelin 82%, si dhe programi ekonomik që paraqitet me realizimi më të lartë është “Mbrojtja Sociale”, “Kujdesi social për familje dhe

dhe fëmijë”, “Fondi rezervë” “Shërbime publike vendore”, “Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit”, “Administrimi i pyjeve dhe kullotave”, “Policia Bashkiake”, “Menaxhim, Planifikimi dhe Administrimi dhe Shërbimi i mbrojtjes ndaj zjarrit. Programi me realizimin më të ulët është “Menaxhimi i rrugëve rurale”;

### **2.3. Auditimi mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.**

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Librazhd, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar në përgjithësi janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Librazhd, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv, të realizuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë ose të diktuar nga Transferta e deleguar nga pushteti qendror.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për periudhën 2023-2025, referuar akt-rekomandimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme;

Tabela nr.6 Realizimi i buxhetit në nivel artikulli ekonomik – viti 2023

Art.	Emertimi	Plani progresiv	Fakti	%
600	Paga	213,314,005	196,679,762	92%
601	Sigurime Shoqërore	35,152,895	32,547,840	93%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	133,478,017	93,002,634	70%
604	Transferta Korente të Brendshme	7,065,103	5,192,036	73%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	475,028,882	441,512,812	93%
230-231	Investimet	221,665,954	116,943,446	53%
466	Garancitë	15,387,561	15,387,561	100%
	<b>TOTAL</b>	<b>1,101,092,417</b>	<b>901,708,301</b>	<b>82%</b>

Burimi: Bashkia Prrenjas, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme rezulton se për vitin 2023 realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomik është 82%, ku realizimin më të lartë e ka artikulli 606 “Transferta për buxhet familjar dhe individ”, duke vijuar me shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore, mallra dhe shërbime të tjera, si dhe realizimin më të ulët e kanë Kapitale të Trupëzuara. Vihet re se për vitin 2023 art. (231) kapitale të trupëzuara paraqiten 53 %, pra në krahasim me artikujt e tjerë ekonomik, ka realizimin më të ulët.

#### ➤ **Realizimi i buxhetit sipas burimeve të financimit.**

Tabela nr.7 Buxheti sipas burimeve të financimit 2023

Emertimi	Fakt 2023			
	Gjithsej	Tr.Pakushtëzuar	Të ardhurat e veta	Transf.e kushtëzuar dhe specifike
231-Investime	132,331,007	57,608,496	44,689,016	30,033,495
600-Paga	196,679,762	107,371,888		89,307,874
601-Sigurime shoqërore	32,547,840	17,945,250		14,602,590
602-Shpenzime operative	93,002,634	56,224,399	23,344,503	13,433,732
606-Transf. Buxh.Fam.Ind	445,947,058	1,799,761	2,192,275	441,955,022
Kuotë qarku	1,200,000		1,200,000	
<b>Totali</b>	<b>901,708,301</b>	<b>240,949,794</b>	<b>71,425,794</b>	<b>589,332,713</b>

Burimi: Bashkia Prrenjas, përpunuar nga grupi i auditimit KLSH-së

-Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se fondet e shpenzuara nga transferata e kushtëzuar dhe specifike, në vlerën 589,332 mijë lekë, kanë peshën më të lartë në krahasim me burimet e tjera të të ardhurave të Bashkisë Prrenjas, ndjekur nga transferata e pakushtëzuar në vlerën 240,949 mijë lekë dhe të ardhurate veta në vlerën 71,425 mijë lekë.

### **Transferta e pakushtëzuar.**

-Buxheti nga transferta e pakushtëzuar për vitin 2023 është realizuar në vlerën 240,949 mijë lekë, ose 27% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2023, ku peshën kryesore brenda transfertës së pa kushtëzuar, e zënë fondet e shpenzuara për investime, paga dhe shpenzime operative.

### **Transferta e kushtëzuar dhe specifike.**

-Buxheti nga transferta e pakushtëzuar për vitin 2023 është realizuar në vlerën 589,332 mijë lekë, ose 65% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2023, ku peshën kryesore brenda transfertës kushtëzuar për transfertën e kushtëzuar dhe specifike, e zënë transferta për familje dhe individ, paga dhe fonde të shpenzuara për transferime korrente të brendshme.

### **Të ardhurat e veta.**

-Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2023 është realizuar në vlerën 71,425 mijë lekë, ose 8% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2023, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për investime dhe shpenzime operative.

#### ➤ **Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës.**

Me miratimin e buxhetit për vitin 2023, Bashkia Prrenjas ka parashikuar dhe miratuar fondin rezervë/dhe të kontigjencës në vlerën 2,759 mijë lekë, dhe gjatë vitit është përdorur në vlerën 4,543 mijë lekë si më poshtë vijon:

Me VKB nr.13 datë 27.01.2023 për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore, për projektin qëndra ditore “Shtëpika e të moshuarve” në vlerën 1,752 mijë lekë, për qira ambjentesh në vlerën 660 mijë lekë dhe blerje materiale për kënd lojrash për shkollën e mesme Dilaver Nezha Qukës-Shkumbin në vlerën 285 mijë lekë.

Me VKB nr. 37 datë 24.03.2023 është përdorur në vlerën 1,066 mijë lekë për “Ndihmë financiare për familjet në nevojë”.

Me VKB nr. 72 datë 26.07.2023 është përdorur në vlerën 780 mijë lekë për “Ndihmë financiare për familjet në nevojë”.

Në fund të vitit 2023 mbetet pa u përdorur fondi në vlerën 272 mijë lekë.

#### ➤ **Subvencionet nga/dhe për Bashkinë Prrenjas.**

Nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton se Bashkia Prrenjas përgjatë periudhës 2023 nuk ka marrë nuk ka dhënë asnjë subvencion.

#### ➤ **Realizimi i Investimeve.**

Grupi i KLSH konstaton se, niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara paraqitet jo të mira në vitin 2023, konkretisht në masën 53%. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Prrenjas në fillim të vitit buxhetor planifikon procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara.

Veprime në kundërshtim me Shkronja “a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

Pika 24 dhe 25 në nenin 3, neni 47 në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.

#### ➤ **Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 muhor në Këshillin Bashkiak.**

Në zbatim të nenit 48 “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor” të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, udhëzimin nr. 22 datë 30.07.2018 “Për Procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në



Njësitë e Qeverisjes Vendore”, si dhe nenin 44<sup>3</sup>, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Për vitin 2023 Bashkia Prrenjas me shkresën nr. 1416 prot., datë 25.05.2023, ka përcjellë në MFE raportin e monitorimit të buxhetit për 4 mujorin e parë të vitit 2023, me shkresën nr. 2543 prot., datë 21.09.2023 ka përcjellë në MFE raportin e monitorimit të buxhetit për 4 mujorin e dytë të vitit si dhe me shkresën nr. 664 prot., datë 21.02.2024 ka përcjellë në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë raportin vjetor të monitorimit të buxhetit.

#### **2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.**

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Lidhur me detyrimet e konstatuara nga Bashkia Prrenjas, rezulton se është bërë planifikimi i likuidimit të tyre për çdo vit buxhetor, si dhe në fund të vitit 2023 janë raportuar në Këshillin Bashkiak dhe MFE, pra jo raportim periodik të tyre.

Me fondet buxhetore të vitit 2023, përgjithësisht janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale. Sipas raportimit të kryer në strukturat/institucionet e mësipërme, shuma e detyrimit përgjatë periudhës 01.01.2023-31.12.2023 ka ardhur duke u rritur. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet zhvillimi i shumës së detyrimit përgjatë vitit 2023.

Tabela nr.8 Detyrimet e prapambetura në fund të periudhës 31.12.2023

Detyrime	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur në 31.12.2023	Detyrimi i krijuar për vitin 2023	Total Detyrime	Shlyerja e detyrimeve vitit 2023	Mbetja e Detyrimeve 31.12.2023
Investime		358,117	358,117	358,117	0
Investime nga FZSHSH	23,245,810		23,245,810	23,245,810	0
Mallra dhe shërbime	1,582,615	1,320,672	2,903,287	1,582,615	1,320,672
Vendime gjyqësore	1,634,429		1,634,429	1,634,429	0
<b>Totali</b>	<b>24,828,425</b>	<b>1,678,789</b>	<b>26,507,214</b>	<b>25,186,542</b>	<b>1,320,672</b>

Burimi: Bashkia Prrenjas, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Vlera e detyrimeve të mësipërme është kryqëzuar me vlerën e detyrimeve që Bashkia Prrenjas ka ndaj palëve të treta, të pasqyruar në Pasqyrat Financiare të vitit 2023, si dhe dokumentacionin justifikues dhe detyrues (faturë tatimore/vendim gjykatë) që krijojnë detyrimin përkatës.

-Nga shqyrtimi i raportit të vetëvlerësimit financiar për vitin 2023, përcjellë në MFE me shkresën nr. 479 prot., datë 07.02.2024, rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Prrenjas ndaj palëve të treta raportuar në MFE është në vlerën **1,320,672 lekë**, e cila përbëhet nga detyrime për shpenzime kapitale, pasqyruar në tabelën më poshtë:

Tabela nr.9 Situata Financiare për vitin 2023

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua sfatgjatë	0		
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër	0		
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve			
<b>II</b>	<b>Detyrime (a+b+c)</b>	<b>1,320,672</b>		<b>0.23%</b>
a	Shpenzime korrente			
a,1	Mallra dhe shërbime	1,320,672		
a,2	Paga dhe sigurime			

<sup>3</sup> Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim të këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport paraqitet në këshill jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.

a.3	Të tjera			
b	Shenzime kapitale	0		
b,1	Insitucione buxhetore	0		
b,2	Subjekte private			
c	<b>Vendime gjyqësore</b>	0		
c,1	Marrëdhënie pune	0		
c,2	Mallra dhe shërbime	0		
c,3	Investime			
c,4	Të tjera	0		
III	<b>Totali (I+II)</b>	<b>1,320,672</b>	<b>584,162,648</b>	<b>0.23%</b>

Burimi: Bashkia Prrenjas, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Në vijim parashtrojmë përcaktimet e bëra për detyrimet e prapambetura, cfarë përfaqësojnë dhe cilat detyrime përfshihen:

“Detyrime të prapambetura ndaj palëve të treta”, nënkupton të gjitha llojet e detyrimeve financiare të NJVQV-ve, të pa paguara brenda 60 ditëve kalendarike (30 ditë për procedurat 3 e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit e procesimit të pagesës në degën e thesarit) nga data e pagesës së specifikuar në kontrat, faturë ose sipas ligjit”.

“Detyrimet e prapambetura rregjistrohen në llogarinë ekonomike nr. 4864 “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura”<sup>4</sup>.

“Njësitë e qeverisjes së përgjithshme përpara mbylljes së llogarive vjetore 2022, kryejnë veprimin e mbylljes së llogarisë nr.486 në debi të llogarisë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm për totalin e detyrimeve të prapambetura që figurojnë në llogari në datën 31.12.2022”<sup>5</sup>”.

-Pra sa më sipër vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura është në masën 0.23% ndaj totalit të shpenzimeve të miratuara për vitin 2023.

Stoku i detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta paraqitet më pak se 15% të shpenzimeve vjetore të miratuara, **ç’ka do të thotë se Bashkia Prrenjas në fund të vitit 2023 rezulton në një situatë normale.**

Stoku i detyrimeve nga Ministritë e Linjës është në vlerën **46,050,506 lekë.**

#### ➤ Detyrimet nga vendimet gjyqësore.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2023, Bashkia Prrenjas rezulton se nuk ka detyrime nga Vendimet Gjyqësore. Përgjatë vitit 2023 janë kryer likuidime të vlerës së detyrimeve të mbartura nga vitet e mëparshme, në vlerën 1,634,429 lekë.

Nga kryqëzimi i të dhënave mbi detyrimet e Bashkisë Prrenjas ndaj palëve të treta, kryesisht të detyrimeve të krijuara si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largim nga puna, konstatohet se:

-Si rrjedhojë e Vendimit nr. 405 (86-203-580), datë 18.05.2023 të Gjykatës së Apelit Tiranë, ndaj Bashkisë Prrenjas është krijuar detyrimi për kryerjen e pagesës në favor të subjektit “Bujar Qorri”, në vlerën 394,820 lekë, të cilat përbëjnë shpenzime pa economicitet, efikasitet dhe efektivitet.

-Si rrjedhojë e Vendimit nr. 210 (13-2022-1418), datë 11.04.2023 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ndaj Bashkisë Prrenjas është krijuar detyrimi për kryerjen e pagesës në favor të subjektit “Mersin Alla”, në vlerën 919,709 lekë.

<sup>4</sup> Udhëzimin e MFE nr.37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”.

<sup>5</sup> Udhëzimi nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar”.

-Si rrjedhojë e Vendimit nr. 723 (13-2022-4315), datë 27.09.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ndaj Bashkisë Prrenjas është krijuar detyrimi për kryerjen e pagesës në favor të subjektit “Xhevit Kushta”, në vlerën 243,700 lekë.

-Si rrjedhojë e Vendimit nr. 10-2022-1929/446, datë 16.12.2022 të Gjykatës së Apelit Durrës, ndaj Bashkisë Prrenjas është krijuar detyrimi për kryerjen e pagesës në favor të subjektit “Avni Alliu”, në vlerën 76,200 lekë, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona.

Gjithashtu konstatohet se për likuidimin e subjekteve të mësipërme janë nxjerrë urdhrat përkatës nga titullari i institucionit, por nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet.

-Sa më sipër vlera e likuidimit të vendimeve gjyqësore në shumën 1,634,429 lekë, përbën shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.

Veprime në kundërshtim me Pika 60 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”.

➤ **Shpronësimet për interes publik.**

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Financës rezultoi se përgjatë vitit 2023 nuk ka pasur detyrime për shpronësime të krijuara në vitin 2023 apo nga vite të mëparshme dhe të palikujduara.

➤ **Faturat e palikuiduara brenda afatit 30 ditor.**

Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit **30 ditor** të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqëruar në Degën e Thesarit Librazhd, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për periudhën 2023, ky afat nuk është respektuar në 8 raste për vlerën 47,371,178 lekë, pasqyruar në tabelën përmbledhëse më poshtë dhe tabelën analitike në Kapitullin Anekse-Aneksi nr.2, tabela nr. 1, 2 dhe 3, bashkëngjitur Projekt Raportit.

Tabela nr.10 Përmbledhëse e faturave për vitin 2023

Artikulli	Sasia	Viti 2023/lekë
230-231	7	46,050,506
602	1	1,320,672
<b>Totali</b>	<b>8</b>	<b>47,371,178</b>

Burimi: Bashkia Prrenjas, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për periudhën deri në fund të vitit 2023 janë 8 fatura të palikujduara për investime dhe shpenzime për mallra dhe shërbime, në vlerën 47,371,178<sup>6</sup> lekë, nga të cilat vlera **25,498,780 lekë**, është parashikuar të likuidohet nga Bashkia Prrenjas nëpërmjet të ardhurave të veta dhe nga granti i nivelit qendror (fonde nga Ministritë e Linjës). Detyrimi në vlerën **20,551,726 lekë** për kryerjen e punimeve në objektin “Pyllëzim me drurë frutorë (Arra dhe Lajthi)”, me vlerë kontrate 20,856,661 lekë, ka mbetur për likuidim në vlerën **13,087,846 lekë**, Referuar shkresës nr. 2521/1 prot, datë 21.08.2020 rezulton se për këtë objekt është regjistruar procedimi penal nr.327/2020 dhe është në hetim nga Prokuroria. Gjithashtu, referuar Vendimit nr. 859, datë 14.11.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, Bashkia Prrenjas është në

<sup>6</sup> Analitikisht pasqyruar në Anekse.

Proces gjyqësor me Subjektin Ergi SHPK, si dhe për kryerjen e punimeve në objektin “Gjelbërimi nëpërmjet pyllëzimeve i Kurorës së Qytetit Prrenjas”, me vlerë kontrate 10,584,173 lekë, ka mbetur për likuidim vlera **7,463,880 lekë**, referuar shkresës nr. 3459 prot., datë 20.12.2023, rezulton se për këtë objekt është regjistruar procedimi penal nr. 1566/2022 dhe është në hetim nga Prokuroria.

-Likuidim me vonesë i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh dhe mos likuidimi i vlerës së plotë të faturës, në pjesën më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mosrealizim të ardhurash.

Veprime në kundërshtim me Pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

### **2.5. Celja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR/Ministritë e linjës, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.**

Nga auditimi i evidencave të marra nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për vitin 2023, në lidhje me investimet publike, rezultoi se Bashkia Prrenjas ka marrë 5 financime projektsh nga FSHZH/FZHR.

Tabela nr.11 Fonde të deleguara për vitin 2023 për investime të cilat kanë filluar në vitin 2020, kanë vazhduar në vitin 2021-2022 dhe sipas kontratës përfundojnë në vitin 2023, ose janë në proces gjatë vitit 2024

Nr	Objekti i investimit	Burimi Financimit	Operat. Fitues	Dt. Lidhjes Kontrates	Ofert. Fituese	Likuiduar 31.12.2023	Detyrimi 31.12.2023
1	Permiresim i banesave ekzistuse per komunitete te varfera dhe te pafavorizuar viti 2021	MF	N SHPK	Nr.2829 prot., Datë 21.10.2021	20,323,310	15,813,640	4,509,670
2	"Permiresim i Banesave Ekzistuse Per Komunitete Te Varfera Dhe Te Pafavorizuar" VITI 2022	20% BASHKIA dhe 80% MF	I SHPK	Nr.2798 Prot., Datë 12.10.2022	28,539,210	28,536,366	2,844
3	"Permiresim i Banesave Ekzistuse Per Komunitete Te Varfera Dhe Te Pafavorizuar" VITI 2023	20% BASHKIA dhe 80% MF	I SHPK	Nr.3025 prot., Datë 06.11.2023	39,444,209	18,458,000	20,986,209
4	Rikonstruksion i kanalit kryesor perroi i lagjes nga rruga e fushes deri tek lagja hallidri, njadm rrajce, Bashkia Prrenjas	M.MBROJTJ ES, A.K. M. CIVILE	B N SHPK	Nr.2347 prot., Datë 04.09.2023	7,483,957	7,483,900	57
5	Blerje paisje mobilierie per shkollen e mesme të bashkuar "Dalip Toçka"	M. ARSIMIT	B B SHPK	Nr.3162 prot., Datë 16.11.2023	2,142,840	2,142,840	0
<b>Totali</b>					<b>97,933,526</b>	<b>72,434,746</b>	<b>25,498,780</b>

*Burimi: Drejtoria e Financës Bashkia Prrenjas, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

-Për vitin 2021, Bashkia Prrenjas ka lidhur kontratë për investim në punë publike me objekt “Permiresim i banesave ekzistuse per komunitete te varfera dhe te pafavorizuar viti 2021” me burim financimi nga MFE.

Vlera e investimit është 20,323,310 lekë, deri në 31.12.2023, për këtë objekt janë likuiduar fondet e përcjella nga MFE në vlerën 15,813,640 lekë. Sipas kontratës ky investim ka nisur në vitin 2021, dhe përfundon në vitin 2022.

-Për vitin 2022, Bashkia Prrenjas ka lidhur kontratë për investim me objekt “Permiresim i Banesave Ekzistuse Për Komunitete të Varfëra dhe të Pafavorizuar” viti 2022, me burim financimi 20 % nga Bashkia Prrenjas dhe 80 % nga MFE. Vlera e investimit është 28,539,210 lekë, deri në 31.12.2022 janë likuiduar fondet e përcjella nga MFE në vlerën 22,831,368 lekë dhe nga Bashkia Prrenjas është likuiduar në vlerën 5,704,998 lekë. Sipas kontratës ky investim ka nisur në 2022 dhe përfundon në vitin 2023.

-Për vitin 2023, Bashkia Prrenjas ka lidhur kontratë për investim me objekt “Permiresim i Banesave Ekzistuse Për Komunitete të Varfëra dhe të Pafavorizuar” viti 2023, me burim financimi 20 % nga Bashkia Prrenjas dhe 80 % nga MF. Vlera e investimit është 39,444,209 lekë, deri në 31.12.2022 janë likuiduar fondet e përcjella nga MF në vlerën 18,458,000 lekë

dhe nga Bashkia Prrenjas nuk është kryer asnjë likujdim. Sipas kontratës ky investim ka nisur në 2023 dhe përfundon në vitin 2024.

-Për vitin 2023, Bashkia Prrenjas ka lidhur kontratë për investim në punë publike me objekt “Rikonstruksion i kanalit kryesor përroi i lagjes nga rruga e fushes deri tek lagja hallidri, Nj. Adm Rrajce, Bashkia Prrenjas” me burim financimi nga Ministria e Mbrojtjes.

Vlera e investimit është 7,483,957 lekë, deri në 31.12.2023, për këtë objekt janë likujduar fondet e përcjella nga Ministria e Mbrojtjes në vlerën 7,483,900 lekë. Sipas kontratës ky investim ka nisur në vitin 2023, dhe përfundon në vitin 2023.

-Për vitin 2023, Bashkia Prrenjas ka lidhur kontratë për investim në punë publike me objekt “Blerje paisje mobilerie për shkollen e mesme të bashkuar Dalip Toçka” me burim financimi nga Ministria e Arsimit.

Vlera e investimit është 2,142,840 lekë, deri në 31.12.2023, për këtë objekt janë likujduar fondet e përcjella nga Ministria e Arsimit në vlerën 2,142,840 lekë. Sipas kontratës ky investim ka nisur në vitin 2023, dhe përfundon në vitin 2023.

-Kontratat e mësipërme janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në SIFQ nga Dega e Thesarit Librazhd dhe të shtrira në kohë sipas financimit e ndarë në tre vitet sipas shkresës përcjellëse nga Ministria e linjës. Për çdo rast të depozitimit të kontratave në thesar është hartuar shkresë përcjellëse, ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit, kur është e shtrirë në disa vite, vlera për secilin vit.

## **2.2.6. Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.**

Në zbatim të pikës së mësipërme të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Vendim i Këshillit Bashkiak për miratimin e paketës fiskale për vitin 2023

Vendim i Këshillit Bashkiak për miratimin e buxhetit për vitin 2023.

Rregjistri i taksapaguesve privat dhe familjar.

Rakordimet me agjentët tatimor.

Evidenca e planifikimit të të ardhurave.

Aktet e rakordimit me degën e thesarit për të ardhurat.

Regjistrat e subjekteve debitorë në 31.12.2023.

Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, në lidhje me çështjen e të ardhurave.

### ***Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi se:***

Struktura e taksave ka funksionuar me 9 punonjës në total, me 1 Drejtor për periudhën për periudhën 23.06.2020 - 29.08.2023 dhe Drejtori Aktual nga periudha 29.08.2023 e në vazhdim. Gjithashtu struktura është e përbërë me (1) përgjegjëse sektori, specialist, inspektor njësia rrajcë, specialist biznesi, specialist njësia Qukës, inspektor tatimor në Bashki, dhe Specialiste në Sektorin e Lejeve dhe Licencave. *Struktura e taksave pasqyruar në kapitullin Aneksi nr.3, bashkangjitur Raportit Përfundimtar.*

### **Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve**

Për vitin 2023 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Prrenjas është miratuar me VKB-në nr. 11, datë 26.12.2022 “Mbi caktimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023”, konfirmuar nga Prefekti me shkresë nr. 41 prot., datë 10.01.2023. Referuar të dhënave të paraqitura nga sektori i taksave dhe i tarifave vendore për periudhën nën auditim realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Prrenjas për vitin 2023 janë realizuar në masën 70 %, nga 135,000 mijë lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 94,646 mijë lekë. Vërehet se, në disa lloje taksash/tarifash ka realizim më shumë se planifikimi, për arsye se gjatë vitit janë arkëtuar edhe detyrime për taksa/tarifa të papambetura, si edhe në raste të caktuara për disa lloje taksash/tarifash nuk planifikohet vlerë

për t'u arkëtuar, megjithëse gjatë vitit kanë ndodhur arkëtime. *Parashikimi dhe realizimi i taksave pasqyruar në kapitullin Aneksi nr.3, bashkangjitur Raportit Përfundimtar.*

### **Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet**

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet llogaritet në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 3.c dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5. VKB-nr. 11, datë 26.12.2022 "Mbi caktimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023.

Në Bashkinë Prrrenjas struktura që administron dokumentacionin dhe përllogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë referuar kërkesave ligjore të sipër cituara për subjektet dhe qytetarët që pajisen me certifikatën e pronësisë është Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Lidhur me ecurinë në procesin e legalizimeve për vitin 2023 rezulton se, janë legalizuar 108 objekte me vlerë totale 3,118,638 lekë nga të cilat janë paguar 1,080,846 lekë. Struktura e ngarkuar për realizimin e planit të kësaj takse, përllogaritjen dhe lëshimin e kërkesës për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit. Nga auditimi konstatohet se, lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë rezulton se, në fund të vitit 2022 janë 71 subjekte debitorë për vlerën 1,843,228 lekë, nga të cilat krijuar në vitin 2023, janë 6 subjekte debitorë në vlerën 194,563 lekë, vlera e mbetur vazhdon të jetë detyrim që përbën në total 2,037,791 lekë, të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Prrrenjas.

#### Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale.

Debitor TNI deri në 31.12.2023	Subjekte	Vlerë
<b>Gjithësej progresive</b>	<b>Nr</b>	<b>2,037,791</b>
Nga të cilat krijuar në 2023	6	194,563
Nga të cilat progresive deri në 31.12.2022	71	1,843,228

*Burimi: Bashkia Prrrenjas*

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27; Ligji nr. 95/2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar", neni 9, pika 3/c; Ligji nr. 98/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar", neni 1, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim" pika 5; etj.

### **Administrimi i taksave dhe tarifave vendore**

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj, në Bashkinë Prrrenjas kryhet në programin Excel. Drejtoria e të Ardhurave dhe Licensave gjithashtu kryen edhe regjistrim manual të të dhënave (regjistra fizik) dhe të çdo informacioni lidhur me subjektet apo familjet objekt i taksave dhe tarifave vendore. Duke iu referuar të dhënave të vendosura në dizpozicion nga bashkia prrenjas rezulton se, Bashkia Prrrenjas ka gjëndje në fillim të vitit 398 biznese, nga të cilat regjistrime të reja janë 22 Biznese, ndërsa aktivitete të mbyllura janë 10 Biznese, dhe gjëndja në fund të vitit është në një numër prej 410 Biznese.

Taksa e tokës bujqësore për vitin 2023 është realizuar në 3,182 mijë lekë nga 4,700 mijë lekë të planifikuara ose në masën 67.7 %, planifikimi i taksës së tokës bëhet nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Licensave prane Bashkisë Prrrenjas. Referuar të dhënave të vëna në dizpozicion nga Bashkia Prrrenjas rezulton se vlera debitorë për taksën e tokës bujqësore, deri në fillim të vitit 2023 është 16,272,478 lekë. Përsa i përket debitorëve të cilët janë krijuar gjatë vitit 2023

rezulton vlera debitore prej 2,757,315 lekë, si rrjedhojë detyrimi deri më 31.12.2023 rezulton në vlerën 16,865,439 lekë vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Prrenjas. Theksojmë se, sipërfaqja e tokës bujqësore të taksuar, është bërë mbi bazën e vetëdeklarimeve të familjeve që përdorin tokë bujqësore, si dhe jo të jenë bërë verifikime me qëllim sigurimin e të dhënave dhe krijimin e kadastrës vendore të tokës bujqësore. Mangësi konstatohen edhe në organizimin e strukturave për ndjekjen e kësaj takse, mos përditësimi i regjistrave të familjeve fermere që disponojnë toke si dhe niveli i ulët i realizimit të taksës së tokës bujqësore, duke u evidentuar një numri i madh i familjeve debitore në vlera të konsiderueshme debitore. Regjistrat nuk janë të përditësuar sipas ndryshimeve të bëra vit pas viti në kadastrë për tokat në disponim dhe përdorim. Nuk janë bërë njoftim detyrime për të gjithë fermerët e evidentuar në regjistrat, pasi faturimet dhe arkëtimet janë kryer vetëm në rastet, kur fermerët janë paraqitur pranë Bashkisë.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore është *Drejtoria e të Ardhurave dhe Licensave pranë Bashkisë Prrenjas* dhe zyrat e *tatim taksave pranë Njësi Administrative*. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 dhe 24. ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10. VKB nr. 11 prot., datë 26.12.2022 pika A.2/b Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 dhe 24. ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10. VKB nr. 11 prot., datë 26.12.2022 pika A.2/b Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore.

*Përsa është trajtuar në Projekt Raport, nga z. Y. K, A. E, E. D, është paraqitur observacioni me nr.1133/1 prot., datë 24.05.2024, i administruar në KLSH me nr. 189/14 prot., datë 29.05.2024, si më poshtë:*

**Pretendimi i Subjektit:** Në lidhje me konstatimin për taksën e tokës bujqësore në bazë të urdhrit të kryetarit me nr.159, datë 11.03.2024 për “Ngritjen e komisionit për saktësimin e regjistrat të taksave të tokës bujqësore në bashkinë Prrenjas” Drejtoria e të Ardhurave, Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë dhe Konsumatorit, kanë bërë verifikimin sipas formularit 6 për ndarjen e tokës dhe kanë bërë sistemit në regjistrin e taksave (bashkëngjitur urdhri dhe relacionet).

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Në përgjigje të kundërshtimit tuaj, theksojmë nga ana juaj është vënë në dispozicion vetëm urdhëri për "ngritjen e komisionit për saktësimin e regjistrat të taksave të tokës bujqësore në Bashkinë Prrenjas" urdhër i ngritur në vitin 2024, periudha e audituar i përket vitit 2023, observacioni juaj nuk meret në konsideratë.

### **Mbi realizimit e të ardhurave nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit .**

Nga auditimi i dokumentacionit që administron IMTV-ja në Bashkinë Prrenjas u konstatua se në fund të vitit 2022 si rrjedhojë e gjobave të vendosura është krijuar detyrimi në vlerën 1,000,000 lekë për 2 gjoba të vendosura, detyrimi i krijuar brenda vitit 2023 është në vlerën 3,000,000 lekë për 6 gjoba të vendosura, në total detyrimi i krijuar në datën 31.12.2023 është për 8 gjoba në vlerën 4,000,000 lekë vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Prrenjas. Nga auditimi konstatohet se, Drejtoria e IMTV nuk ka ndjekur hapat e nevojshëm në çdo rast për të dërguar në gjykatë vendimet për të nxjerrë Urdhrin e Ekzekutimit për të gjithë gjobat e vendosura të këtij viti, sipas kërkesave të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, pika 4. *Gjobat analitike janë të pasqyruara në kapitullin Aneks-Aneksi nr.3, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar.*

### **Debitor nga gjoba të vendosura nga Policia Bashkiake.**

Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake, u konstatua se deri më datë 31.12.2023 në mënyrë progresive janë krijuar të

ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Prrenjas në vlerën 7,500 lekë lekë për 10 subjekte. Për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për gjobat e Policisë Bashkiake, konstatohet se nuk janë marrë masat përkatëse, gjithashtu nuk janë të kontabilizuara. Nuk rezulton në asnjë rast të jetë bërë kërkesë për titull ekzekutiv ashtu sikurse përcaktohet në pikën 10 të ligjit nr. 10279 datë 20.05.2010 “për kundravajtjet administrativë” *Gjobat analitike janë të pasqyruar në kapitullin Anekse.- Aneksi nr.3, bashkangjitur Raportit Përfundimtar.*

*Përsa është trajtuar në Projekt Raport, nga z. G. A, është paraqitur observacioni me nr.1133/1 prot., datë 24.05.2024, i administruar në KLSH me nr. 189/14 prot., datë 29.05.2024, si më poshtë:*

**Pretendimi i subjektit:** Lidhur me debitorët nga gjoba të vendosura nga Policia Bashkiake theksojmë se deri më datë 31.12.2023 vlera e detyrimit të prapambetur debitor në mënyrë progresive është 7,500 lekë për 10 subjekte. Vlera prej 17,500 lekësh është vlera e gjobave të arkëtuara për vitin 2023. Gjithashtu gjobat mbahen dhe kontabilizohen në mënyrë analitike në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit. Bashkia Prrenjas është në pritje që gjobat e vendosura nga policia bashkiake të futen në sistem duke shmangur kështu mospagesat nga ana e subjekteve të ndryshme.

**Oëndrimi i grupit të auditimit:** Duke iu referuar kundërshtimit tuaj theksojmë se përsa i përket vlerës progresive qëndron dhe do të reflektohet në material, për këtë çështje observacioni meret në konsideratë.

## **Menaxhimi i borxhit**

### **Subjektet Debitorë**

Nga auditimi i dokumentacionit të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore u konstatua se gjendja e debitorëve progresiv për subjektet fizik/juridik në fund të vitit 2022 rezultojnë, 212 subjekte në vlerën 18,312,760 lekë, si dhe për vitin 2023 paraqitet si mëposhtë:

#### Subjektet debitorë progresiv sipas njësive për vitin 2023

Nr	Natyra e debitorëve	Nr	Debitor Deri Me 31.12.2022	Pakësime nga vlera debitorë	Shtesa 2023	Pakesime 2023	Nr	Detyrimi krijuar në 2023	Nr	Debitore Deri Me 31.12.2023
	<b>DEBITOR BIZNESI 2023</b>	<b>212</b>	<b>18,312,760</b>	<b>6,099,961</b>	<b>35,930,028</b>	<b>26,448,778</b>	<b>87</b>	<b>9,481,250</b>	<b>245</b>	<b>21,694,048</b>
1	Biznes i madh	34	11,646,648	3,589,643	28,487,255	22,727,044	24	5,760,211	37	13,817,215
2	Biznes i vogel Prrenjas & Stravaj	116	4,996,937	1,905,152	5,639,901	2,898,671	31	2,741,230	136	5,833,015
3	Biznes i vogel Qukes	26	661,538	163,402	572,528	223,979	16	348,549	29	846,685
4	Biznes i vogel Rrajce	36	1,007,637	1,007,637	1,230,344	599,084	16	631,260	43	1,197,133

*Burimi: Bashkia Prrenjas përpunoi grupi i auditimit.*

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Bashkia Prrenjas lidhur me gjendjen e debitorëve progresiv për subjektet fizik/juridik, në fund të vitit 2022 rezulton në një numër prej 212 subjekte në vlerën 18,312,760 lekë, si rrjedhojë detyrim i krijuar gjatë vitit 2023 rezulton për 87 subjekte në vlerën 9,481,250 lekë. Në fund të vitit 2023 konstatohet një numër debitorësh prej 245 subjektësh me vlerë debitorë prej 21,694,048 lekë.

### **Taksat dhe Tarifat Familjare**

Përsa i përket taksave dhe tarifave vendore për familjarët në Bashkinë Prrenjas familjarët ngarkohen me taksa dhe tarifa për Tokën, Banesën, Ndriçimin dhe Shërbimet Publike nga Drejtoria e Tatim Taksave Vendore. Në tabelën e mëposhtme janë të identifikuar familjet debitorë.

#### Familjarë debitorë pa përfshirë taksën e Tokës Bujqësore

Nr	Njësi administrative	Progresive deri në fillim të vitit 2023		Pakesime nga vlera debitorë	Familje Debitorë krijuar brenda vitit 2023		Progresive deri në vitin 2023	
		Nr	Vlerë		Nr	Vlerë	Nr	Vlerë
1	Prrenjas	1,448	13,918,447	1,634,962	1,290	3,980,626	1,513	16,264,111
2	Qukes	1,639	4,721,282	582,166	1,609	2,383,225	1,617	6,522,834
3	Rrajce	1,783	8,424,622	2,029,102	1,521	2,589,870	1,567	8,984,897
4	Stravaj	596	1,741,987	145,128	422	414,317	578	2,011,176



	<b>TOTAL</b>	<b>5,466</b>	<b>28,806,338</b>	<b>4,391,358</b>	<b>4,842</b>	<b>9,368,038</b>	<b>5,275</b>	<b>33,783,018</b>
--	--------------	--------------	-------------------	------------------	--------------	------------------	--------------	-------------------

Burimi: *Bashkia Prrenjas*

Nga auditimi konstatohet se kemi të bëjmë me një numër familje debitorë prej 5,466 debitorë deri në fillim të vitit 2023 në vlerën 28,806,338 lekë. Përsa i përket debitorëve të cilët janë krijuar brenda viti 2023 është në vlerën 9,368,038 lekë për 4842 familje, dhe debitorë progresiv deri më 31.12.2023 rezulton për një numërdebitorësh prej 5,275 familje debitorë në vlerën 33,783,018 lekë. Në total vlera progresive e detyrimit të paraqitur nga Bashkia Prrenjas e familjeve debitorë është 33,783,018 lekë.

Përsa i përket debitorëve familjarë deri më 31.12.2023 për tarifën e ujit të pijshëm kemi të bëjmë me një vlerë debitorë prej 13,138,092 lekë. Në tabelën e mëposhtme janë të identifikuar familjet debitorë për tarifën e ujit të pijshëm si më poshtë vijon:

INSTITUCIONI	DEBITOR	Arketuar/Likujduar Ne Leke 2023	Debitor deri me
	31.12.2022		31.12.2023
Bashkia Prrenjas	1,833,325	362,576	1,470,749
Njesia Rrajce	8,643,570	2,308,885	6,334,685
Njesia Qukës	4,956,129	1,224,665	3,731,464
Njesia Stravaj	1,871,996	270,802	1,601,194
<b>TOTALI</b>	<b>17,305,020</b>	<b>4,166,928</b>	<b>13,138,092</b>

Burimi: *Bashkia Prrenjas*

Nga auditimi i dokumentacionit të Sektorit të Tatim Taksave, vlera totale borxhit tatimor në mënyrë progresive në Bashkinë Prrenjas paraqitet:

1. Taksa dhe tarifa familjare në vlerë 46,921,110 lekë.
2. Taksa e ndikimit në infrastrukturë 2,037,791 lekë.
3. Biznese Debitorë në vlerë 21,694,048 lekë.
4. Taksa e tokës Bujqësore 16,865,439 lekë.

Nga auditimi konstatohet se, në fund të vitit 2023 borxhi tatimor është në vlerën **87,518,388 lekë** të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Prrenjas.

### **Dinamika e Debitorëve:**

Nga analiza e debitorëve sipas moshës së krijimit konstatohet se,

Për një periudhë nga 1 deri në 3 vite rezulton një numër prej 45 debitorësh për vlerën 4,849,112 lekë.

Debitorë për një periudhë nga 3 deri në 5 vite rezulton një numër prej 18 debitorësh për vlerën 8,082,126 lekë.

Debitorë mbi 5 vite rezulton një numër prej 7 debitorësh për vlerën 778,057 lekë.

Debitorë pa shpresë arkëtimi janë 22 debitorë, për vlerën 3,540,673 lekë, dhe debitorë me status pasiv/mbyllje janë 16 debitorë, për vlerën 1,377,162 lekë.

### **Masat e marra për uljen e borxhit**

Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Prrenjas është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Tatim Taksave lidhur me zbatimin e hapave që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë njoftuar bizneset debitorë që kryejnë aktivitetin e tyre pranë Bashkisë Prrenjas.

Nga auditimit konstatohet se, pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet e vitit 2023, nuk janë nxjerrë urdhrat përkatës për të ndërmarrë hapa të tjera bazuar në masat e parashikuara në kuadrin ligjor të sipër cituar ndaj debitorëve të Bashkisë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Bashkia Prrenjas lidhur me gjendjen e debitorëve progresiv për subjektet fizik/juridik, në fund të vitit 2022 rezulton një numër debitorësh prej 212 subjekte në vlerën 18,312,760 lekë, si rrjedhojë detyrim i krijuar gjatë vitit 2023 rezulton për 87 subjekte në vlerën 9,481,250 lekë. Në fund të vitit 2023 konstatohet një numër debitorësh prej 245 subjektësh me vlerë debitore prej 21,694,048 lekë. Përsa i përket taksave dhe tarifave vendore për familjarët në Bashkinë Prrenjas familjarët ngarkohen me taksa dhe tarifa për Tokën, Banesën, Ndriçimin dhe Shërbimet Publike nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Licensave Bashkia Prrenjas.

Nga auditimi konstatohet se kemi të bëjmë me një numër familje debitore prej 5,466 debitorë deri në fillim të vitit 2023 në vlerën 28,806,338 lekë. Përsa i përket debitorëve të cilët janë krijuar brenda viti 2023 rezultojnë në vlerën 9,368,038 lekë për 4842 familje, dhe debitorë progresiv deri më 31.12.2023 rezulton në një numër prej 5,275 familje debitore në vlerën 33,783,018 lekë. Në total vlera progresive e detyrimit të paraqitur nga Bashkia Prrenjas e familjeve debitore është në vlerën 33,783,018 lekë. Përsa i përket debitorëve familjarë të cilët tarifohen për tarifën e ujit të pijshëm deri më 31.12.2023 kemi të bëjmë me një vlerë debitore prej 13,138,092 lekë. Në fund të vitit 2023 borxhi tatimor në Bashkinë Prrenjas është në vlerën 87,518,388 lekë vlerë e cila përpën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Prrenjas. Gjithashtu nga auditimi konstatohet se, pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet e vitit 2023, nuk janë nxjerrë urdhrat përkatës për të ndërmarrë hapa të tjera bazuar në masat e parashikuara në kuadrin ligjor të fushës ndaj debitorëve të Bashkisë Prrenjas. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94. *Subjektet debitorë paraqitur analitikisht në kapitullin Anekse.- Aneksi nr.3, bashkangjitur Raportit Përfundimtar.*

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94.

### **Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve**

Në territorin e Bashkisë Prrenjas për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 6 subjekte. Grupi i auditimit auditori dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe pagesën e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore për vitet 2023.

Nga auditimi i dosjeve fizike të subjekteve përkatësisht rezulton:

-Subjekti L BL Shpk me NIPT J.....M rezulton të mos ketë paguar detyrimin për vitin 2023 duke mbetur debitorë për vlerën 1,000,000 lekë.

-Subjekti K Shpk me NIPT L.....J rezulton të mos ketë paguar detyrimin prej e plotë për vitin 2023 duke mbetur debitorë për vlerë 600,000 lekë.

Nga auditimi konstatohet se, nga informacioni dhe dokumentacioni që Bashkia Prrenjas disponon, rezultojnë 6 subjekte që ushtrojnë aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë nga të cilat 2 subjekte nuk kanë paguar detyrimet sipas kërkesave ligjore duke sjellë efekt financiar me vlerë totale **1,600,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Prrenjas.** *Subjektet debitorë pasqyruar në kapitullin Anekse.- Aneksi nr.3, bashkangjitur Raportit Përfundimtar.*

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” VKM nr. 344 datë 19.4.2017, për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 2.12.2015.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi asetet e dhëna me qira, u konstatua se në Bashkinë Prrenjas operojnë gjithsej 22 subjekte të cilat kanë lidhur kontrata qiraje për HEC, gurorë, objekte, veprimtari ekonomike, telefoni, duke përllogaritur një detyrim vjetor në vlerën 11,913,677 lekë, nga e cila është likuiduar vlera 13,750,767 lekë, duke mbetur pa likuiduar vlera 2,729,835 lekë. Në Bashkinë Prrenjas rezultojnë debitorë për kontratat e qirasë 5 subjekte, si vijon:

- 2 subjekte me veprimtari telefonisë celulare, në vlerën 450,360 lekë.
- 1 me veprimtari turistike në vlerën 149,700 lekë.
- 1 subjekt me veprimtari gurore në vlerën 74,000 lekë.
- 1 subjekt HEC në vlerën 2,055,775 lekë.

Nga auditimi, u konstatua se referuar nenit 5, pika 5.5 e kontratave, për subjektet të cilat janë debitorë nga Bashkia Prrenjas (personat përgjegjës), nuk janë llogaritur penalitetet në masën 0.1%, por jo më shumë se 10%. Nga ku detyrimi pa penalitet për kontratat e qerasë për të cila nuk është paguar detyrimi deri në datën 31.12.2023 rezulton në vlerën 2,729,835 lekë. Detyrimi me penalitet për kontratat e qerasë për të cilat nuk është paguar deri në datën 31.12.2023 rezulton në vlerën 2,830,759 lekë vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Prrenjas. Penaliteti i kontratave të qerasë është në vlerën 272,984 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 5, pika 5.5 e kontratës.

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar; VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”. nenit 5, pika 5.5 e kontratës.

*Përsa është trajtuar në Projekt Raport, nga znj. M. V, është paraqitur observacioni me nr.1133/1 prot., datë 24.05.2024, i administruar në KLSH me nr. 189/14 prot., datë 29.05.2024, si më poshtë:*

**Pretendimi i subjektit:** Përsa i përket pikës Asetet e dhëna me qira për subjektin me veprimtari telefonike pagesa me vlerë 220,360 lekë është kryer më datë 30.01.2024. për subjektin me veprimtari turistike pagesa me vlerë 149,700 lekë është kryer më datë 08.01.2024. për subjektin me veprimtari gurore pagesa me vlerë 111,000 lekë është kryer më datë 24.04.2024. për subjektin HEC është në proces gjyqësor për vlerën 1,550,926 lekë. Detyrimi për vitin 2023 është paguar.

**Oëndrimi i grupit të auditimit:** Në përgjigje të observacionit tuaj theksojmë se, nga ana e sektorit të ardhurave janë vënë në dispozicion faturat ku kanë kryer likujdime nga ana e subjekteve one telecom për vlerën 220,360 lekë dhe nga subjekti Neg 2018 për vlerën 149,700 lekë. Pagesat e sipër përmendura do të reflektohen në material, për këtë çështje observacioni meret në konsideratë.

### **Mos Tarifimi për tarifën e Mbrojtjes dhe Permiresimin e Mjedisit dhe Tarifën e Pastrimit përcaktuar me VKB.**

Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin lidhur me tarifën e pastrimit dhe tarifën e mjedisit, tarifa këto të përcaktuara në VKB-në nr.11 prot datë 26.12.2022 për miratimin e paketës fiskale të Bashkisë Prrenjas për vitin 2023 ku specifikohet se subjektet të cilët do të tarifohen me tarifën e mjedisit dhe Tarifën e pastrimit sipas veprimtarisë së tyre janë :

- Subjektet Hece deri në 2 Mega për një nivel tarife 300,000 lekë.
- Subjekte Hece nga 3 - 4 Mega për një nivel tarife 350,000 lekë.
- Subjektet Hece deri në 5 Mega për një nivel tarife 400,000 lekë.
- Subjektet persona juridik që ushtrojnë aktivitet të tillë si, Karrierë guri (gurore) Shfrytëzim karrierash lumore dhe malore, prodhim inertesh,shfrytëzim minierash, hekur nikeli, shfrytëzim pyjorësh dhe industri të tjera të cilat ndikojnë në mjedis, për një nivel tarife 250,000 lekë.

Nga auditimi konstatohet se, për 9 subjekte që ushtrojnë aktivitet si, Karrierë Guri, Inerte, shfrytëzim pyjorësh etj, nuk rezulton të jenë tarifuar me llojin e tarifës “Për Mbrojtjen dhe Përmirësimin e Mjedisit” duke sjellë një vlerë debitore prej 2,250,000 lekë. Subjektet e pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	NIPTI	Zona	Lloji Aktivitetit	Niveli I Tarifës	Debitor
1	N-2018 SHPK	L..... G	Bashkia Prrenjas	kontrat Qiraje ,fondi pyjor 19.04.2019-18.04.2029	250.000	250,000
2	F-C A	L.....Q	Bashkia Prrenjas	Grumbullim Kromi	250.000	250,000
3	K-12 SHPK	K.....C	Bashkia Prrenjas	Perpunim Mineralesh	250.000	250,000
4	B X SHPK	K.....N	Bashkia Prrenjas	Ndertime ,punime dheu rruge tarracime etj	250.000	250,000
5	D E	L.....O	Bashkia Prrenjas	HecNERGJIA E TURBINAVE ME ERE	250.000	250,000
6	E SHPK	K.....C	Bashkia Prrenjas	Shfrytezim pyjesh + miniere	250.000	250,000
7	L B SHPK	J.....M	Bashkia Prrenjas	KARBURANTI + nxjerrje minerali gurore	250.000	250,000

Nr.	Subjekti	NIPTI	Zona	Lloji Aktivitetit	Niveli I Tarifës	Debitor
8	A SHPK	J.....Q	Bashkia Prrrenjas	TE Shfrytezim karrierash lumore dhe malore,	250.000	250.000
9	E-F	L.....I	Bashkia Prrrenjas	Shfrytezim karrierash	250.000	250.000
	<b>TOTALI</b>					<b>2,250,000</b>

Burimi: Bashkia prrenjas përpunuar nga grupi i auditimit.

Përsa i përket subjekteve me aktivitet HEC konstatohet se 2 nga subjektet nuk janë tarifuar me tarifën “Për Mbrojtjen dhe Përmirësimin e Mjedisit”, konkretisht subjektet:

-Bushtrica 2017 me NIPT L.....K me lloj aktiviteti HEC për një nivel tarife prej 350,000 lekë.

Për subjektin R E Shpk me NIPT L.....N me lloj aktiviteti HEC është tarifuar me nivel tarife prej 250,000 lekë ku duhej tarifuar me një tarifë prej 350,000 lekë sipas VKB-së.

#### Subjektet HEC pasqyruar në tabelën e mëposhtme

Nr.	Subjekti	NIPTI	Zona	Lloji Aktivitetit	Niveli I Tarifës	Debitor
1	B 2017	L.....K	Bashkia Prrrenjas	Hec	350,000	350,000
2	R E shpk	L.....N	Bashkia Prrrenjas	HEC	350,000	350,000
	<b>TOTALI</b>					<b>700,000</b>

Burimi: Bashkia prrenjas përpunuar nga grupi i auditimit

#### **Tarifa e pastrimit:**

Nga mos tarifimi i tarifës së Pastrimit përcaktuar me VKB rezultojnë 14 subjekte me veprimtari Hec, Tec, Gurore, Minierat dhe Nyje betoni të cilët nuk janë tarifuar për taifën e pastrimit. Subjektet e pa tarifuar paraqitur në tabelën e mëposhtme:

#### Subjetet debitorë nga mos pagesa e Tarifës së Pastrimit përcaktuar me VKB.

Nr.	Subjekti	NIPTI	Zona	Lloji Aktivitetit	Niveli I Tarifës	Debitor
1	F-C A	L.....Q	Bashkia Prrrenjas	Grumbullim Kromi	110,000	110,000
2	T T&M&C	K.....P	Bashkia Prrrenjas	Shfrytezim Miniere Kromit	110,000	110,000
3	N Sh.P.K	K.....I	Bashkia Prrrenjas	Hfrytezim Mineralit Te Kromi	110,000	110,000
4	P 2010 Shpk	L.....E	Bashkia Prrrenjas	Gurore, Prodhim Inertesh Dhe Materiale Ndertimi.	110,000	110,000
5	E T M G Shpk	K.....I	Bashkia Prrrenjas	Nxjerrje Kromi	110,000	110,000
6	K-12 Shpk	K.....C	Bashkia Prrrenjas	Perpunim Mineralësh	110,000	110,000
7	B 2017	L.....K	Bashkia Prrrenjas	Hec	110,000	110,000
8	E	L.....B	Bashkia Prrrenjas	Hec	110,000	110,000
9	K Shpk	K.....H	Bashkia Prrrenjas	Gurore	110,000	110,000
10	S & D L	J.....S	Bashkia Prrrenjas	Shfrytezim I Lendeve Drusore	100,000	100,000
11	S & R	L.....P	Bashkia Prrrenjas	Frytezimi I Mineraleve Te Kromi	110,000	110,000
12	E H Shpk	L.....M	Bashkia Prrrenjas	Hec	110,000	110,000
13	M-F N	L.....F	Bashkia Prrrenjas	Prodhime Karbonike	110,000	110,000
14	L B Shpk	J.....M	Bashkia Prrrenjas	Karburanti + Nxjerrje Minerali Gurore	110,000	110,000
	<b>TOTALI</b>					<b>1,540,000</b>

Burimi: Bashkia Prrrenjas përpunuar nga grupi i auditimit

Nga auditimi arrihet në konkluzion se, nga ana e Drejtorisë e të Ardhurave dhe Licencave dhe inspektoriati i mjedisit pranë bashkisë Prrrenjas nuk janë tarifuar për tarifën e “Mjedisit” 9 subjekte për llojin e aktivitetit si, Karrierë Guri, inerte, shfrytëzim pyjorësh etj, për vlerën 2,250,000 lekë. Për subjektet me aktivitet HEC nuk janë tarifuar 4 subjekte në vlerën 1,400,000 lekë. Përsa i përket tarifës së “Pastrimit” rezultojnë 14 subjekte me veprimtari Hec, Tec, Gurore, Minierat dhe Nyje betoni të cilët nuk janë tarifuar me tarifën e pastrimit duke sjellë një vlerë debitorë prej 1,540,000 lekë. Në total nga mos tarifimi i tarifës së “Mjedisit” dhe tarifës së “Pastrimit” rezulton vlera debitorë prej 4,490,000 lekë vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Prrrenjas. Këto veprime janë në kundërshtim me VKB nr.11 prot., datë 26.12.2022 për miratimin e paketës fiskale të Bashkisë Prrrenjas Kapitulli III pika 1 dhe pika 15. Struktura e ngarkuar për përllogaritjen dhe vjeljen e tarifës së Mjedisit, VKB-së nr. 11, datë 26.12.2022 “Mbi caktimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023”. Kapitulli III pika 15 është **Drejtorja e të Ardhurave dhe Licencave dhe Inspektoriati i Mjedisit** pranë Bashkisë Prrrenjas.

Veprime në kundërshtim me VKB nr.11 prot., datë 26.12.2022 për miratimin e paketës fiskale të Bashkisë Prrrenjas Kapitulli III pika 1 dhe pika 15.

Përsa është trajtuar në Projekt Raport, nga znj. M. V është paraqitur observacioni me nr.1133/1 prot., datë 24.05.2024, i administruar në KLSH me nr. 189/14 prot., datë 29.05.2024, si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:** Për pikën “Mostarifim për tarifën e Mbrojtjes dhe Përmirësimin e Mjedisit ju bëjmë me dije se: Subjekti K-12 me nipt K.....C dhe subjekti L B me nipt J.....M janë tarifuar me Tarifën “Për Mbrojtjen dhe Përmirësimin e Mjedisit”, subjekti F- C A me nipt L.....Q është i pezulluar si aktivitet prandaj nuk është tarifuar për vitin 2023. Subjekti D E me nipt L.....O ka zyrat qendrore në Bashkinë Prrrenjas dhe aktivitetin (Import Eksport, Projektim) e kryen në Tiranë. Subjekti E-F me nipt L.....I ka magazinimin e materialeve të ndryshme dhe jo shfrytëzim karrierash në Bashkinë Prrrenjas. Subjektet me aktivitet HEC: Subjekti B 2017 me Nipt L.....K ka lidhur kontratë qiraje me fond pyjor por nuk ka filluar akoma aktivitet dhe nuk ka hapur adresë për ushtrim aktiviteti në territorin e Bashkisë Prrrenjas. Subjektet H I Shpk dhe G Shpk janë tarifuar dhe kanë paguar detyrimet lidhur me këtë taksë. (bashkangjitur akt konstatimet dhe pagesat për subjektet). Për sa i përket Tarifës së Pastrimit në tabelën nr.A.14 Subjekti “E H shpk” Hec i cili ka lidhur kontratë qiraje me nr. 782 prot., datë 09.04.2021 me vlerë vjetore 1,114,110 lekë, nuk ka kryer aktivitet akoma në territorin e bashkisë Prrrenjas dhe për këtë arsye nuk është tarifuar me Tarifën e Pastrimit. Gjithashtu subjektet B 2017 dhe E nuk kanë hapur akoma adresë për ushtrim aktiviteti në bashkinë Prrrenjas por vetëm kanë lidhur kontratë qiraje. Për subjektin S & A; D L shpk cili ka lidhur kontratë me nr. 3091 prot., datë 15/11/2021 për “Shfrytëzimin e Lëndës Drusore në Këmbë” me vlerë 1,790,820 lekë ka kryer pagesën për këstin e parë në vlerën 895,410 lekë me datë 15.11.2021, dhe kësti i dytë në vlerën 895,410 lekë është paguar në datë 14.07.2022.

**Oëndrimi i grupit të auditimit:** Në përgjigje të kundërshtim tuaj theksojmë se, për subjektin D E nuk rezulton të mos ushtrojë aktivitetin në territorin e Bashkisë Prrrenjas. Për subjektin F Ch nuk rezulton të jet pasiv në QKB, përsa i përket subjektit E-F e ka të përcaktuar qartë në ekstraktin historik ku ka si objekt aktiviteti shfrytëzim Karrierash, gjithashtu dhe në regjistrin e taksapaguesve hartuar nga sektori i taksave. Përsa më lart observacioni juaj nuk meret në konsideratë. Përsa i përket subjekteve G dhe H I nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e sektorit të taksave dhe i tarifave rezulton se është kryer pagesa nga këto dy subjekte, për këtë çështje observacioni meret në konsideratë dhe do të reflektohet në material.

**Konkluzion: Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Prrrenjas janë:**

- Nga taksa së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet në vlerën **2,037,791 lekë;**
- Nga gjoba të vendosura nga IMTV në vlerën totale **4,000,000 lekë;**
- Nga familjet për taksat dhe tarifatat, ndërtesës, pastrimit, ndriçimit, etj., në vlerën **46,921,110 lekë;**
- Nga bizneset debitore, në vlerën **21,694,048 lekë;**
- Nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve në vlerën **1,600,000 lekë;**
- Nga kontrata e qirasë në vlerën **3,002,819 lekë.**
- Taksa e tokës Bujqësore **16,865,439 lekë.**
- Mos Tarifimi Për tarifën e Mjedisit dhe Tarifën e Pastrimit **4,490,000 lekë.**
- Gjobat e Policisë Bashkiake **7,500 lekë.**

**2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.**

Mbi auditimin e ushtuar në Bashkinë Prrrenjas “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, në Bashkinë Prrrenjas.

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Pasqyrat financiare të vitit 2023

Dokumente kontabël.

Të tjera dokumente mbështetëse.

Përshkrimi i situatës.

Auditimi u krye sipas programit të auditimit, pika 3. Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë. Nën pikat:

-Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht në, udhëzimin e MF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të njësitë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj”; udhëzimin e MF nr. 26, datë 27.12.2007, për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e MF nr. 14, date 28.12.2006, dhe udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësitë të Qeverisjes së Përgjithshme“, ndryshuar me udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022.

-Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;

-Vlerësimi i arsyeshem e i bazuar (në rastet kur vlerësimet janë të domosdoshme);

***Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:***

***Nxjerrja e pasqyrave financiare për vitin 2023.***

***Për vitin 2023***, Në përputhje me kërkesat e UMF nr. 8 datë 9.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, janë përgatitur pasqyrat financiare, dërguar Degës së Thesarit Librazhd me shkresën nr. 724 prot., datë 28.02.2024, të përbëra si vijon:

Format nr. 1 –Pasqyra e pozicionit financiar.

Format nr. 2 –Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).

Format nr. 3 – Pasqyra e flukseve monetare (Caush-Floë).

Format nr. 4 –Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.

Format nr. 5 –Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.

Format nr. 6 –Investimet dhe burimet e financimit.

Format nr. 7/a –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve (kosto historike).

Format nr. 7/b –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve (vlera neto).

Format nr. 8 –Numri i punonjësve dhe fondi i pagave. (*Bashkëngjitur Pasqyra Nr. 1 e Pozicionit Financiar bilanci i v. 2023*)

Gjithashtu, Pasqyrat Financiare për nga forma janë përgatitur dhe janë plotësuar sipas kërkesave të udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar, ku janë është dhënë informacion mbi:

Emrin e njësisë ekonomike raportuese, Bashkia Prrenjjas me NIPT K.....U;

Periudhën kontabël të mbuluar nga pasqyrat financiare, nga 01.01.2023-31.12.2023;

Monedhën e paraqitjes së pasqyrave financiare, në lekë;

Data e hartimit të Pasqyrave Financiare, 28.02.2023;

Përgatitur nga znj. S. K.

Pasqyrat Financiare janë dërguar në Degën e Thesarit Librazhd me shkresën nr.724, datë 28.02.2023, nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Prrenjjas z. N. B.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Totali i Aktivit për vitin 2023 është 1,764,404,822 lekë dhe për vitin 2022 është 2,175,308,277 lekë, i paraqitur në formatin 1 dhe i zberthyer në llogari *paqyruar në kapitullin Aneksë – Aneksi nr. 1, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar*:

#### **A. AKTIVE AFATSHKURTRA.**

***Rakordimi i llogarive me Degën e Thesarit llogaria 520, 466 dhe llogaritë e të Ardhurave. V, 2023***

Llogaritë kryesore të rakordueshme me degën e Thesarit; llogaria 520 “Disponilitete në Thesar”, në pasqyrat financiare është për vlerën për vlerën 190,338,038 lekë. Referuar aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Librazhd kjo llogari është për vlerën 190,338,038 lekë. Rezulton se “Teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor e pasqyruar në formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOË) sipas metodës direkte”.të paraqitur është e rakorduar me shumën e “Mjeteve monetare dhe ekujvalente të tyre” në vlerën 190,710,648 lekë e rakorduar me pasqyruar në formatin nr. 1. “Mjete monetare dhe ekujvalent të tyre”.

Teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor e pasqyruar në formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOË) sipas metodës direkte” është *paqyruar në kapitullin Aneksë – Aneksi nr. 1, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar.*

Në këtë rast, llogaria 520 “Disponilitete në Thesar” e rakorduar me të dhënat e Degës së Thesarit, në pasqyrat financiare, pasqyron saktë vlerën e saj në fund të vitit ushtrimor, sipas kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50.

2.Nënrubrika, gjendje e inventarit qarkullues, gjendja e llogarisë 31 “Materiale”, në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2022 paraqitet në vlerën 13,463,338 lekë, ndërsa në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2023 paraqitet në vlerën 10,968,007 lekë. Vlerat e kësaj llogarie janë të barabarta me vlerën e dokumentuar në aktin e rakordimit në fund të çdo viti të mbajtur midis magazinierit, përgjegjësit të financës dhe drejtorit të financës.

-Gjendja e llogarisë 32 “Inventar i imët” në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2022 paraqitet në vlerën 25,967,007 lekë, ndërsa në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2023 paraqitet në vlerën 24,074,419 lekë. Vlerat e kësaj llogarie janë të barabarta me vlerën e dokumentuar në aktin e rakordimit në fund të çdo viti të mbajtur midis magazinierit, përgjegjësit të financës dhe drejtorit të financës.

3.Nënrubrika, llogari të arkëtueshme, -Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2023 paraqitet në vlerën 94,462,552 lekë, të cilat janë detyrimet e subjekteve të ndryshme ndaj bashkisë për taksa, tarifa vendore dhe detyrime të lëna nga aktet e kontroleve të ndryshme të papaguara deri në 31.12.2023. Në mënyrë analitike paraqitet si më poshtë:

Nr	Natyra e debitoreve	Debitor deri 31.12.2022	Shtesa 2023	Pakësime 2023	Debitore deri 31.12.2023
<b>A</b>	<b>DEBITOR BIZNESI 2023</b>	<b>20.533.843</b>	<b>35.930.028</b>	<b>33.169.823</b>	<b>23.294.048</b>
1	Biznes i madh	11.646.648	28.487.255	26.316.688	13.817.215
2	Biznes i vogel Prenjas & STRAVAJ	4.996.937	5.639.901	4.803.823	5.833.015
3	Biznes i vogel Qukes	661.538	572.528	387.381	846.685
4	Biznes i vogel Rrajce	1.007.637	1.230.344	1.040.848	1.197.133
5	Pikat e Tregëtimit te Karburantit (detyrime) KLSH	2.221.083		621.083	1.600.000
<b>B</b>	<b>Debitore taksa e tarifa vendore 2023</b>	<b>45.078.816</b>	<b>17.443.620</b>	<b>11.873.979</b>	<b>50.648.457</b>
1	Qyteti Prenjas familjaret	15.091.428	6.039.316	3.605.080	17.525.664
2	Njësia administrative Qukes	10.024.410	4.613.932	2.319.231	12.319.111
3	Njësia administrative Rrajce	14.043.398	5.824.463	5.432.996	14.434.865
4	Njësia administrative Stravaj	5.919.580	965.909	516.672	6.368.817
<b>C</b>	<b>DEBITORE PER UJIN E PIJSHEM</b>	<b>17.305.020</b>	<b>-</b>	<b>4.166.928</b>	<b>13.138.092</b>
1	Bashkia Prenjas	1.833.325		362.576	1.470.749
2	Njesia Rrajce	8.643.570		2.308.885	6.334.685
3	Njesia Qukes	4.956.129		1.224.665	3.731.464
4	Njesia Stravaj	1.871.996		270.802	1.601.194
<b>D</b>	<b>DEBITORE PER KOPEST/ CERDHE</b>	<b>849.375</b>	<b>3.805.971</b>	<b>3.318.678</b>	<b>7.381.960</b>
1	Debitore Kopesht	643.716	2.772.311	2.425.478	990.549
2	Debitore cerdhe	205.659	1.033.660	893.200	346.119
3	<b>GJOBE INSPEKTORIATI I MBROJTJES SE TERRITORIT</b>				4.007.500
4	<b>DEBITORET LEGALIZIME 2023</b>				2.037.792
	<b>GJITHSEJ A +B+C+D</b>	<b>83.767.054</b>	<b>57.179.619</b>	<b>52.529.408</b>	<b>94.462.557</b>

*Burimi: Bashkia Prenjas Drejtoria e Financës.*

Llogaria nr. 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fillim të vitit 2023 është në vlerën 84,536,862 lekë dhe në fund të vitit 2023 është në vlerën 94,462,552 lekë, pra me një rritje të vlerës së debitorëve të Bashkisë Prenjas në vlerën (9,925,690) lekë. Nga verifikimi i listës analitike të

debitorëve në fund të vitit 2023, konstatohet se nuk janë kontabilizuar të drejtat për arkëtim në vlerën 2,672,984 lekë. Konkretisht për vlerën 2,400,000 lekë kamat-vonesë e papërlllogaritur për gjokat e IMTV dhe vlera 272,984 lekë kamat - vonesë e papërlllogaritur për kontratat e qerasë. Konstatohet se në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet llogaria nr. 470 “Llogari në pritje – të ardhura për t’u marrë” (me kundërparti llogarinë nr.468), e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, shkronja “ë”, pika 3, neni 12;

Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, rubrika 2.3, paragrafi 21, shkronja “c”.

**Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”**, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 101,103,958 lekë dhe nuk kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e pasqyruar në vlerën 117,077,498 lekë. Vlera prej 101,103,958 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga:

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

**Pasqyra PF:** Detajet e nënrubrikës “Të tjera operacione me shtetin”.

Emërtimi i llogarive	Vlera
Llogari 401-408	81,703,882
Paga personeli llog 42	13,953,770
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	736,879
Sigurime shoqërore llog.435	4,074,938
Sigurime shëndetësore llog.436	565,189
<b>Totali</b>	<b>101,103,958</b>

**Burimi:** Bashkia Prrenjas

Nga analiza e mësipërme llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” është paraqitur e nënvlerësuar në bilanc me vlerën 22,332,438 lekë ndërsa llogari 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” është nënvlerësuar me vlerën 6,358,898 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

### **Llogaritë e Marrëdhënive me shtetin**

Në marrëdhëniet e institucioneve me shtetin përdoren dy llogari specifike dhe karakteristike për sektorin publik buxhetor.

- Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”
- Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”.

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm. Veprimet kontabile në lidhje me këtë llogari janë si më poshtë:

#### **a) Gjatë konstatimit të shpenzimit është bërë veprimi:**

- Debitohen llogaritë respektive të klasës 6 “Shpenzime sipas natyrës”;
- Kreditohen llogaritë e detyrimeve për konstatimin e detyrimit (42,43,40,e të tjera).

#### **b) Në fund të periudhës duhet të bëhet veprimi:**

- Debitohet llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”;
- Kreditohet llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.

#### **c) Me akordimin e fondeve vitin e ardhshëm dhe ekzekutimin e pagesës bëhet veprimi:**

Debitohen llogaritë përkatëse të detyrimeve (klasa 4);



Kreditohet llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”.

**d) Paralel me veprimin e mësipërm artikullohet veprimi tjetër:**

Debitohet llogaria 476” Të ardhura të caktuara për tu përdorur”;

56

Kreditohet llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”.

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta) në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 101,103,958 lekë dhe nuk kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” e cila është pasqyruar në vlerën 117,077,498 lekë sipas Pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve.

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta) sipas udhëzimit të MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” përbëhet nga gjendja e llogarive të klasës 4 llogaritë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në vlerën 81,703,882 lekë , 42 “Detyrime ndaj personelit” në vlerën 13,953,770 lekë, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa në vlerën 736,879 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 4,074,938 lekë, 436 “Sigurime shëndetsore” në vlerën 565,189 lekë dhe llogaria 467 “Kreditor të ndryshëm” në vlerën 22,401,738 lekë. Gjendja e llogarive të klasës 4 është paraqitur në vlerën 123,436,396 lekë.

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është nënvlerësuar për vlerën 22,332,438 lekë ndërsa llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” është nënvlerësuar për vlerën 6,358,898 lekë.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimit të MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

Llogaria 467 në fund të vitit 2023 paraqitet me vlerën 22,401,738 lekë. Nga auditimi i llogarisë analitike, konstatohet se nuk janë kontabilizuar detyrimet për vendime gjyqësore në vlerën 919,709 lekë, të cilat janë likuadruar gjatë vitit 2024 për llogari të vitit 2023, pasqyruar si më poshtë vijon:

Nr. Urdhër Shpenzimi	Data e pagesës	Përshkrimi	Vlera
47	26.01.2024	Ekzekutim vendimi gjyqsor-Mersin Alla	919,709

Funksionimi kontabël i llogarive të klasës 4, në Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

## **II. AKTIVET AFATGJATA**

Në formatin nr. 1 “**Aktivet Afatgjata**” në vlerën neto paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën **1,340,015,440 lekë**.

Klasa 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” që përbëhet nga:

- Gjendja e llogarisë 202 “*Studime dhe Kërkime*” paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 11,899,243 lekë. Sipas të dhënave kontabël të paraqitura sipas kostos historike, dhe sipas inventarizimit fizik kjo llogari është e analizuar në 11 raste në vlerën 11,899,243 lekë, sipas inventarit kontabël. Në analizë të llog. 202 llogari “*Studime dhe Kërkime*” konstatohet se vlera e mbetur në fund të vitit 2023 prej 11,899,243 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “*Studime dhe Kërkime*”, për 11 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën

është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Kjo procedurë është ndjekur në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël) e cila përcakton: “*Trajtimet kontabël për AAGJM-në, lidhen me njohjen fillestare të aktivitetit, si dhe vlerësimin e mëpasshëm:*

a) *Njohja fillestare - AAGJM-ja, duhet të plotësojnë kriteret e njohjes në pasqyrën e pozicioni financiar, pra, duhet të vlerësohen me kosto që janë:*

- *Kostoja e blerjes së bashku me taksat e importit;*
- *Kosto të tjera të drejtpërdrejta deri në sjelljen e aktivitetit në vendndodhje apo dhe kosto të tjera që i shtohen nga prodhimi i elementeve të aktivitetit (kosto projektimi, paga dhe kontribute për prodhimin e elementeve të aktivitetit, materiale të përdorura për këto elemente, kosto transporti, kosto instalimi, kosto testimi etj.).*

*Aktivet afatgjata jo materiale përcaktohen dhe klasifikohen të tilla si: programet kompjuterike, markat, patentat, licencat, të drejtat e përdoruesit etj. Mund të ketë aktive me karakteristika si të AAGJM-së ashtu edhe të AAGJ/JM-së. Në këto raste, ato klasifikohen në varësi të karakteristikave dominuese. Shembull, një program kompjuterik (soft) përfshihet në AAGJM, nëse është pjesë përbërëse e pajisjeve kompjuterike, në të kundërt (pra, kur nuk është pjesë), trajtohet si AAGJ/JM”.*

Kreu II. “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Pika 16/b. d të cilat përcaktojnë: “Për regjistrimin në kontabilitet të operacioneve të funksionimit, ndiqet procedura e mëposhtme:

b) *Për shpenzimet e njohura të investimeve bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:*

- *Debitohet llogaria përkatëse e investimeve (të grupit 23); dhe*
- *Kreditohet llogaria përkatëse e detyrimeve (klasa 4).*

d) *Në rastin e kapitalizimit të aktiveve afatgjata, të përfituara nëpërmjet shpenzimeve të investimeve (të regjistruar sipas pikës “b” më sipër), bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:*

- *Debitohet llogaria përkatëse e grupit 20 ose 21 të aktiveve afatgjata; dhe - Kreditohet llogaria përkatëse e investimeve (grupi 23).*

Gjendja e llogarisë 202 “*Studime dhe Kërkime*” paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 11,899,243 lekë, sipas akt rakordimit me Degën e Thesarit Librazhd.

Duke iu referuar të dhënave kontabël të paraqitura sipas koston historike, dhe sipas inventarizimit kontabël kjo llogari është e analizuar në 11 raste në vlerën 11,899,243 lekë Në analizë të llog. 202 llogari “*Studime dhe Kërkime*” konstatohet se vlera e mbetur në fund të vitit 2023 prej 11,899,243 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “*Studime dhe Kërkime*”, për 11 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë.

Veprime në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), me VKM nr 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qendrueshme Patrupëzuar” Pika 1/b “Klasifikimi kontabël” e cila ndër të tjera përcakton se: “*Shpenzimet e kërkimeve të aplikuara dhe të zhvillimi - Llogaria 202*”, “*Studime dhe Kërkime*”.

## **2.Nënrubrika, aktive afatgjata materiale**

-Gjendja e llogarisë 210 “*Toka, Troje, Terrene*” në datën 31.12.2023, paraqitet në vlerën 4,918,360 lekë. Në këtë llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera ndër vite. Për këtë

Ilogari nuk është llogaritur amortizimi në zbatim të udhëzimit nr 8 datë 09.03.2018 ndryshuar me udhëzimin numër 5 datë 21.02.2022.

-Gjendja në Llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione” më 31.12.2023, paraqitet në vlerën 618,437,942 lekë, e cila përfaqëson vlerën e investimeve të kryera ndër vite për ndërtime e rikonstruksione dhe shtesat gjatë periudhës, paksimet janë për transferimet dhe për vlerën e amortizimit.

-Gjendja në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore” më 31.12.2023, paraqitet në vlerën 501,633,730 lekë, më 31.12.2023, e cila përfaqëson vlerën e investimeve të kryera ndër vite për rrugë, rrjete dhe vepra ujore si dhe shtesat gjatë periudhës raportuese.

-Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” më 31.12.2023 paraqitet në vlerën neto 8,203,353 lekë, e cila paraqet vlerën e objekteve të investimeve të kryera ndër vite, shtesat gjatë periudhës dhe paksimet nga amortizimi. Gjendja e kësaj llogarie në mënyrë të përmbledhur është analizuar sipas inventarit fizik.

-Gjendja e llogarisë 215 “Mjete transporti” më 31.12.2023 paraqitet në vlerën neto 19,127,590 lekë. Kjo llogari përbëhet nga 20 mjete të cilat përdoren për funksionet e institucionit.

-Gjendja e llogarisë 218 “Inventar ekonomik”, më 31.12.2023 paraqitet në vlerën neto 19,058,185 lekë, e cila paraqet vlerën e objekteve të investimeve të kryera ndër vite dhe paksime gjatë vitit 2023, sipas listës analitike të sektorit të financës.

### **Testi substancial i amortizimit**

Qëllimi: Ripërdorimi i amortizimit duke u bazuar në udhëzimin nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” për të parë diferencat ndërmjet amortizimit të ripërfunduar sipas udhëzimit dhe atij faktikut të gjendur në regjistrat e aktiveve përkatëse dhe në kontabilitet. Gjendja e aktiveve afatgjata në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet nga viti 2023 paraqiten në Formatin nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”

-Gjendja e llogarisë 230 “Aktive afatgjata jo materiale”, më 31.12.2023 paraqitet në vlerën 0, e cila përfaqëson, vlerën e studimeve e projekteve për investimet në proces, të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë te llogaritë e klasës 2 “Aktive afat gjata materiale”.

- Gjendja e llog. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 132,618,378 lekë.

3.Nënrubrika, aktive afatgjata financiare, ku bëjnë pjesë referencat e llogarive 25 “Huadhënie e nën huadhënie” dhe 6 “Pjesëmarrje në kapitalin e vetë”, nuk janë kryer veprime të tilla, për rrjedhojë gjendja e tyre në pasqyrat e pozicionit financiar paraqitet me zero.

Nga shqyrtimi i ekstraktit historik të Shoqërisë Aksionare “E A Sh.A” me NIPT M.....T, u konstatua se Bashkia Prrenjas zotëron 8% të aksioneve të kësaj shoqërie ose 0.56 aksion me vlerë nominale 500,000 lekë secili, në total 280,000 lekë.

-Pra sa më sipër llogaria nr.26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” është nënvlerësuar me 280,000 lekë.

Veprime në kundërshtim me Urdhri i Ministrisë nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”.

VKM nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.

Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu 3.1, pika 31, shkronja “b”, i ndryshuar.

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Prrenjas, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 36,630,270 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Vlera e mësipërme është e rakorduar me Degën e Thesarit Librazhd. Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2023, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të Bashkisë ndaj subjekteve private, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466. Në mënyrë analitike, garancitë të cilave u ka kaluar afati i shlyerjes, si dhe objekti për të cilën është mbajtur kjo garanci ka përfunduar, *paraqiten në kapitullin Anekse – Aneksi nr.1 bashkëngjitur Raportit Përfundimtar.*

-Llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” është mbivlerësuar për 15,209,327 lekë për vitin 2023.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, pika 3.2 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të tretëve (klasa 4) funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4”.

#### **2.3.4. Auditim mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si edhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.**

Në zbatim të pikës 2.3, nën-pika 2.3.4, të programit të auditimit, janë administruar evidencat si mëposhtë:

- Lista e pasurive të paluajtshme të transferuar në Bashkinë Prrenjas
- Lista e pasurive të paluajtshme të regjistruar në kadastrë
- Inventari i fondit pyjor
- Kontratat e lidhura për dhënien me qira të fondit pyjor

#### **I. PASURITË E PALUAJTSHME**

Sipas ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, bashkitë ishin të detyruara të paraqisnin në Këshillin e Ministrave listën e pronave për transferim. Për bashkinë Prrenjas, lista e pronave është miratuar me VKM nr.1642 datë 17.12.2008 ‘Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Prrenjas’, i ndryshuar me VKM nr. 668 datë 11.06.2009, ku janë shtuar tre prona me funksion për zhvillim ekonomik.

Tabela 1: Prona që përdoren në fushën e administratës

Nr. Pasurisë	Lloji	Emërtesa	Sipërfaqe trualli në m <sup>2</sup>	Sipërfaqe ndërtesë në m <sup>2</sup>	Funksioni	Institucioni me përgjegjësi administrative	Statusi juridik i përdorimit
5/140	Truall + Ndertese	Zyrat E Keshillit Te Qarkut Bashkia Prrenjas	260	228	Zyra	Keshilli Qarkut Elbasan	Bashkia Prrenjas
5/141/1	Truall + Ndertese	Zyrat E Keshillit Te Qarkut Bashkia Prrenjas	260	16	Zyra	Keshilli Qarkut Elbasan	Deputeti
5/141/2	Truall + Ndertese	Zyrat E Gjendjes Civile Bashkia Prrenjas	260	16	Zyra	Keshilli Qarkut Elbasan	Këshilli i Qarkut Elbasan
690/1	Truall + Ndertese	Ish-Komuna Stravaj	1540	256	Zyra e Komunës	Bashkia	Bashkia

Në lidhje me godinën ku ushtron veprimtarinë Bashkia e Prrenjasit, ky objekt rezulton të jetë në pronësi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe nuk është e regjistruar në emër të Bashkisë. Me

shkresën nr. 2839 prot., datë 14.10.2022, Bashkia Prrenjas ka bërë kërkesë për kalim pronësie në Ministrinë e Mbrojtjes. Konkretisht, prona me nr. 1111 sipas VKM nr. 515 datë 18.07.2003 është në përgjegjësi administrimi të MM, ndërsa bashkia e përdor godinën për ushtrimin e veprimtarisë së saj ndërsa territori është projektuar për t'u përdorur si treg industrial javor.

Tabela 2: Prona që përdoren në fushën arsimore për Bashkinë Prrenjas

Nr. pasurie	Lloji i pronës	Emërtesa	Sipërfaqe trualli në m2	Sipërfaqe ndërtesë në m <sup>2</sup>	Funksioni
3/8.	Truall+ Ndertese	Shkolla E Mesme E Pergjithshme, Bashkia Prrenjas	868	868	Arsimi Parauniversitar
3/7.	Truall+ Ndertese	Kabinetet Dhe Ambjente Te Shkolles Se Mesme, Bashkia Prrenjas	101	101	Arsimi Parauniversitar
3/6.	Truall+ Ndertese	Palestra E Shkolles Se Mesme, Bashkia Prrenjas	320	320	Arsimi Parauniversitar
3/5.	Truall+ Ndertese	Ish Oficina Mesimore E Shkolles Se Mesme, Bashkia Prrenjas	253	253	Arsimi Parauniversitar
	Truall+ Ndertese	Ish Konvikti Sh.M.Gjeologji-Miniera, Bashkia Prrenjas	722	722	Arsimi Parauniversitar
	Truall	Truall Rreth Godines Se Shkolles, Bashkia Prrenjas	25124,5		Arsimi Parauniversitar
	Truall+ Ndertese	Ish Banjot E Shkolles Se Mesme, Bashkia Prrenjas	45	45	Arsimi Parauniversitar
	Truall+ Ndertese	Kopesht Femijesh L.Nr.5, Bashkia Prrenjas	319	319	Arsimi Parauniversitar
	Truall+ Ndertese	Shkolla 9-Vjecare , Bashkia Prrenjas	8391	538	Arsimi Parauniversitar
	Truall+ Ndertese	Shkolla 9-Vjecare, Prrenjas Fshat, Bashkia Prrenjas	2200	425	Arsimi Parauniversitar
	Truall+ Ndertese	Shkolle Fshati Rashtan, Bashkia Prrenjas	10000	190 +180	Arsimi Parauniversitar
	Truall+ Ndertese	Ish Shkolle Fshati Rashtan, Bashkia Prrenjas	6880	160	Arsimi Parauniversitar
	Troje+Truall	Shkolla E Mesme E Pergjithshme, Bashkia Prrenjas	25124		Arsimi Parauniversitar

Pronat e mësipërme i përkasin juridiksionit të Bashkisë Prrenjas, pa përfshirë pronat e transferuara të ish-komunave. Në lidhje me ish-shkollën e fshatit Rashtan, godina rezulton e amortizuar.

Me vendimet për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të ish-komunave, Bashkia Prrenjas, ka në pronësi:

- 13 prona arsimore të Bashkisë
- 7 prona arsimore të ish-komunës Rrajcë
- 16 prona arsimore të ish-komunës Qukës
- 7 prona arsimore të ish-komunës Stravaj

Si konkluzion, nga 43 prona në fushën e arsimit Bashkia Prrenjasit nuk ka regjistruar asnjë pronë, ndonëse përgjatë viteve në disa prej shkollave dhe kopshteve janë kryer investime. Kjo sjellë si pasojë që lejet e ndërtimit për këto investime të mos jenë të pasqyruar në regjistrat kadastralë.

Në total, nga 899 prona që i janë transferuar me listë përfundimtare Bashkisë Prrenjas, përfshirë ish-komunën Rrajcë, vetëm 19 pasuri që i përkasin inventarit të pasurive të paluajtshme janë regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

Tabela 3: Totali i pronave të transferuara dhe regjistruara në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës

Nr.	Bashkia/Njësitë	Numri i pronave në inventar	Prona në përdorim	Në pronësi	Prona të regjistruara në kadastrë
1	Bashkia Prrenjas	631	455	176	19
2	Njësia administrative Rrajcë	268	59	209	
3	Njësia administrative Qukës	-			Nuk ka listë përfundimtare
4	Njësia administrative Stravaj	-			Nuk ka listë përfundimtare
<b>Totali</b>		<b>899</b>	<b>514</b>	<b>385</b>	<b>8</b>

Pronat në përdorim janë troje të lira, hapësira të pazëna si dhe prona që përdoren në fushën e bujqësisë, për të cilat nuk ka informacion mbi statusin juridik nëse janë përfituar me AMTP apo përmes procesit të legalizimeve.

Nga verifikimi i deritanishëm i evidencave, rezulton se:

-Inventarët e pasurive të paluajtshme nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Prrenjas nuk është rakorduar me Zyrën Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Si rrjedhojë, inventari rezultoi i papërditësuar, në kundërshtim me nenin 37, të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se *“bashkitë kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Procedura e përditësimit mbështetet në verifikimin e gjendjes faktike të pronës, nëpërmjet evidentimit në terren dhe verifikimit juridik, që kryhet me asistencën apo pjesëmarrjen e ASHK-së. Po ashtu, bashkia i kërkon ASHK-së informacion të plotë për gjendjen e pronësisë, sipas dokumentacionit që kjo e fundit administron, përfshirë edhe informacionin për proceset e tjera tranzitore të parashikuara në këtë ligji”*.

- Në total, nga 899 prona që i janë transferuar me listë përfundimtare Bashkisë Prrenjas, përfshirë ish-komunën Rrajcë, vetëm 19 pasuri që i përkasin inventarit të pasurive të paluajtshme janë regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

-Në bazë të VKM nr.28 datë 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve”, nga Bashkia Prrenjas nuk është krijuar struktura e posaçme e bashkëpunimit me drejtorinë përkatëse të ASHK-së, të cilat rakordojnë ndërmjet tyre, me qëllim realizimin e procedurave të parashikuara nga neni 37, i ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

## **II. FONDI PYJOR**

Bashkia Prrenjas ka në administrim një fond pyjor dhe kullësor prej 18399.9 ha, i ndarë në 7 ekonomi pyjore dhe 2 ekonomi kullësore, sipas VKM nr.684, datë 02.09.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 433, datë 08.06.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish komunave/bashkive”, të ndryshuar.

Në lidhje me sipërfaqet pyjore, Bashkisë Prrenjas i janë transferuar 1028 ngastra gjithsej dhe janë regjistruar 21 pasuri të llojit pyll, kullota dhe shkembore. Nga këto, 10 pasuri të llojit “pyll” janë regjistruar në ASHK gjatë vitit 2023.

Në lidhje me menaxhimin e fondit pyjor, sipas detyrimeve të nenit 27 të ligjit nr. 57/2020 “Për Pyjet”, rezultoi se Bashkia Prrenjas ka hartuar plane mbarështimi për dy ekonomi pyjore, nga 7 gjithsej, ndërsa një i tretë është në proces.

Në bazë të pikës 3 të nenit 16, bashkitë ngrenë strukturën përgjegjëse për pyjet brenda territorit të tyre, me personel me arsim profesional dhe të lartë pyjor, duke garantuar një raport të drejtë gjinor. Numri i punonjësve të strukturës përgjegjëse për pyjet përcaktohet në përpjesëtim me sipërfaqen e fondit pyjor si më poshtë: një specialist pyjesh për 750 – 1000 ha për pyjet e larta. Për bashkinë Prrenjas, me një fond pyjor 18399 ha numri i punonjësve duhet të ishte 18 ndërkohë që numëron vetëm 10 inspektorë, përfshirë kryeinspektorin.

### **II.1 Aktivitetet në fondin pyjor**

Në bashkinë e Prrenjasit janë 18 subjekte që kanë lidhur kontrata qiraja për marrjen në përdorim të fondin pyjor, nga të cilat në lidhje me veprimtaritë me risk rezultojnë se 7 janë aktivitete të llojit HEC, 1 aktivitet për ndërtim të impianteve fotovoltaike dhe 1 aktivitet “gurore”.

Tabela 4: Lista e subjekteve që operojnë në fondin pyjor të Bashkisë Prrenjas

Nr	Subjekti (shoqëria)	Aktiviteti	Kontratat e lidhura (Numër/datë)	Sipërfaqja hequr (ha)	Sipërfaqja në përdorim			Vlera e kontratës
					Ha	Km	Kohëzgjatja	
1	S E	HEC	Nr.2491/1 datë 20.09.2022		0.008	9.48	02.03.2022-02.03.2031	446,448
2	H	HEC-1 & HEC-2	Nr. 1874 datë 29.06.2022		0.0052	11.444	29.06.2022-28.06.2031	896,180
3	G E	HEC.G & G 1	Nr. 3076 datë 08.11.2023	0.0657		2.602	05.09.2023-05.09.2032	275,900
4	R E	Hec/ L 1&2	Nr.1414 datë 14.05.2018	0.0391		5.924	14.05.2018 -13.05.2027	858,980
5	E	Hec B 1	Nr.1765 datë 17.06.2019	0.148		4.155	17.06.2019 - 17.06.2028	517,532
6	B 2017	Hec B 2	Nr.1766 datë.17.06.2019	0.143		8.587	17.06.2019 - 17.06.2028	1,109,805
7	E H	HEC-1 & HEC-2	Nr.782 datë 09.04.2021	0.173		11.114	09.04.2021 - 25.03.2031	1,114,110
8	N 2018	Vep.Turistike	Nr.1118 datë 19.4.2019		0.5	0.29	19.04.2019-18.04.2029	48,650
9	A Ll	R.Peshku	Nr 4712 datë 15.12.2017		0.2289		01.05.2017-01.05.2026	41,202
10	"E-F" Sh.p.k	Pikë tranziti	Nr.1223 datë 19.04.2022		0.25		19.04.2022 - 19.04.2031	75,120
11	P 2010	Gurore	datë 18.11.2010		1.567		18.11.2010-19.11.2030	37,000
12	OST	Ndërtim linjë tensioni 400 kV	Nr.2500 Datë 16.09.2022			15.035	16.09.2022 -16.09.2024	504,260
13	A sh.a	Anten	Nr.4641 date.12.12.2017		0.0276	0.41	03.10.2017-03.10.2026	235,150
14	V	Anten	Nr.1253 date.09.05.2019		0.025	0.42	01.05.2019-30.04.2028	221,000
15	A sh.a	Anten	Nr.2181date 27.07.2018		0.02875		22.07.2018-21.07.2027	230,000
16	T	Anten	Nr.4640 date.12.12.2017		0.0273	0.056	24.12.2017-23.12.2026	220,360
17	"S R E" Shpk	Për ndërtim të impianteve fotovoltaike	Nr.2122 datë 02.08.2023		23.25		02.08.2023 - 02.08.2032	4,650,000
18	OST	Ndërtim/rikonstuksioin linjë tensioni 110 kV	Nr.2844 datë 18.10.2023		0.1812	6.259	18.10.2023 - 18.10.2024	341,680
<b>TOTALI</b>					<b>0.5688</b>	<b>26.09895</b>	<b>75.776</b>	<b>11,823,377</b>

Për vitin 2023 objekt auditimi janë lidhur dy kontrata si mëposhtë:

-Me vendimin nr. 43 datë 24.03.2023 të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Prrenjas është miratuar dhënia në përdorim e fondit pyjor/kullor publik “Për ndërtimin e impianteve fotovoltaike në ngastrat nr.84 c, 98b, 99a, 100a, 101a të ekonomisë pyjore Prrenjas,” me sipërfaqe 23.25 ha me vlerë 4,466,340 lekë.

-Në bazë të raportit tekniko-ekonomik me nr. 847/1 datë 20.03.2023 është bërë vlerësimi i tarifës së qirasë bazuar në VKM nr. 559 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar” si mëposhtë:

Pyje shkurre	12.24 ha*176,000 lekë/ha/vit	2,154,240
Trungishte	4.57 ha*210,000 lekë/ha/vit	959,700
Trungishte	2.47 ha *210,000 lekë/ha/vit	518,700
Trungishte	1.35 ha*210,000 lekë/ha/vit	283,500
Trungishjte	2.62 ha *210,000	550,200
<b>Totali</b>	<b>23.25 ha</b>	<b>4,466,340 lekë/vit</b>

Vlera e bimësisë pyjore është 58,400 lekë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultojnë se:

-Me urdhrin nr. 217 datë 27.04.2023 është ngritur njësia për realizimin e procedurës së hapur të ankandit për sipërfaqen përkatëse

-Me datë 31.05.2023 është publikuar njoftimi për ankand në Agjencinë e Prokurimit Publik. Në këtë ankand kanë marrë pjesë dy kompani, "S" sh.pk. me ofertë 4,466,340 lekë dhe S R E sh.p.k me vlerë 4,650,000 lekë

Është shpallur fitues S R E sh.p.k me vlerë 4,650,000 lekë

-Me kontratën nr. 3076 prot., datë 08.11.2023 është lidhur kontrata e qirasë (rinovim) për dhënien në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor për HEC-et G 1 & G" me subjektin "G E" sh.p.k.

Në bazë të raportit mbi studimin tekniko-ekonomik rezulton se sipërfaqja që është objekt përdorimi të përhershëm shtrihet në gjatësinë lineare prej 2.602 km me vlerë 275,900 lekë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton kjo kontratë ka pësuar ndryshime :

Në kontratën e qirasë nr.3493 prot., datë 08.09.2017 subjektit "Gi E" i është dhënë në përdorim sipërfaqja prej 6.7 km me vlerë 1,141,735 lekë

Me amendimin e kontratës nr.662 datë 23.02.2022 është ndryshuar sipërfaqja dhe vlera e qirasë, nga 6,907 km me vlerë 1,141,735 lekë në 2.557 km në vlerën 275,850 lekë.

Me kontratën nr.3076 prot., datë 08.11.2023 është miratuar qiraja për sipërfaqen 2.602 km me vlerë 275,900 lekë.

Ndryshimet e mësipërme kanë ardhur si pasojë e kërkesës së subjektit me shkresën e datës 09.07.2019 drejtuar Bashkisë Prrenjas, në lidhje me heqjen nga objekti i kontratës së linjave të tubacionit që janë rehabilituar. Për këtë qëllim, është kërkuar interpretim edhe nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, e cila ka kthyer përgjigje me shkresën nr.9022/1 datë 18.11.2019. Si rrjedhojë, janë hequr nga objekti i kontratës sipërfaqet e rehabilituara të tubacioneve nëntokësore, që sipas Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit jepen në përdorim për kohën e ndërtimit.

Nga auditimi ka rezultuar se planvendosja që shoqëron lejen e ndërtimit miratuar me Vendimin nr. 5 datë 05.05.2015 të Këshillit Kombëtar të Territorit nuk përputhet me planvendosjen e administruar në dosje.

**Koment i subjektit:** Me shkresën nr. 189/12 datë 13.05.2024 nga Bashkia Prrenjas është përcjellë observacioni mbi planvendosjen e HEC Gavrani se "nga dokumentacioni që disponojnë rezulton se subjekti "G E" sh.p.k në vitin 2017 ka bërë ndryshimin e planvendosjes së gjurmës së "HEC", bashkëlidhur shkresën nr.1000/1 prot., datë 23.02.2017 të AKBN Tiranë mbi oponencën teknike mbi ndryshimin e projekt-zbatimit, projekt-zbatimin dhe relacionin për ndryshimin e gjurmës".

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Observacioni do të merret pjesërisht në konsideratë, për arsyen se megjithëse nga ana juaj është përcjell një dokumentacion për ndryshim në projekt-zbatim, këto evidenca nuk ofrojnë siguri të arsyeshme përse kohë në dosje nuk është administruar leja e ndërtimit me ndryshimet përkatëse, të cilat duhet të miratohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit(nga ana juaj është përcjell korrespondenca me AKB, por jo miratimi i KKT për ndryshimin përkatës). Për këtë qëllim do të lihet si rekomandim që të plotësohet dosja me lejen e ndërtimit dhe planvendosjen me ndryshimet përfundimtare.

**Komenti i subjektit:** Nga Bashkia Prrenjas është përcjellë observacioni se "Bashkia Prrenjas ka në Drejtorinë e Planifikimit, Zhvillimin e Territorit dhe Aplikimin e Projekteve Sektorin e Regjistrimit të Pronave me përgjegjës sektori z. R B dhe znj. J B – Specialiste asetëve. Bashkia Prrenjas ka ngritur strukturën e posaçme për përditësimin e listave të pronave shtetërore me urdhër nr. 138, datë 22/02/2024. Gjithashtu është ngritur urdhri me nr. 178, datë 28/03/2024, për caktimin e personit përgjegjës për përdorimin e sistemit e-albania të Bashkisë Prrenjas për regjistrimin e pronave në inventarin e bashkisë Prrenjas. Pasuritë e shërbimeve arsimore janë në juridiksionin e drejtorive arsimore dhe nuk kanë kaluar akoma në pronësi të bashkisë.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Nga auditimi është konstatuar moskryerja e veprimeve të përditësimit dhe rakordimit me ASHK në lidhje me inventarin e pronave. Miratimi i një urdhri nuk nënkupton se veprimet e përcaktuara në të janë zbatuar. Ndërsa për pasuritë e shërbimeve arsimore e paraarsimore, ato i janë transferuar Bashkisë e për rrjedhojë duhet të regjistrohen.



## **2.4. Auditim mbi planifikimin dhe zbatimin procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave për investime në punë publike.**

Në zbatim të pikës 2.4 të Projekt Raportit të Auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1- Regjistri i realizimit të prokurimeve të periudhës 01/01/2023 – 31/12/2023;
- 2- Dosjet e procedurave të përcaktuara për auditim, sipas analizës së riskut;
- 3- DST e hartuar nga NJP për procedurat e përcaktuara për auditim;
- 4- Sistemi elektronik i APP, sipas kodit të marrë nga APP si Auditues;
- 5- Dosjet fizike të OE/BOE shpallur fitues;
- 6- Urdhër pagesat e vlerës së kontratave të lidhura.

### -Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me VKB sipas viteve përkatëse bashkë me ndryshimet gjatë vitit.

### -Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

Për arritjen e objektivave dhe përbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SPE, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, nga subjekti Bashkia Prrenjas referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve janë zhvilluar gjithsej **74** procedura prokurimi me fond limit **152,736,284 lekë pa TVSH**, me vlerë kontrate **133,735,871 lekë pa TVSH**, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën **19,000,413 lekë pa TVSH**, ose **12.5%**. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënave janë në pasqyrën si vijon:

Procedura 01.01.2023 – 31.12.2023	Nr.	Vl.Fond Limit (pa tvsh )	Vl.Kontrate (pa tvsh))
<b>GJITHESEJ</b>	<b>74</b>	<b>152,736,284</b>	<b>133,735,871</b>
-Të hapura	2	49,304,749	43,312,982
- Shërbim konsulence	1	4,145,202	3,688,000
-Negocim pa shpallje	S'ka	-	-
-E hapur e thjeshtuar	21	81,548,161	71,503,520
-Me vlerë të vogël	50	17,738,172	15,231,369
<b>Sipas objekteve</b>			
-Objekte në fushën e punëve publike	15	87,335,866	75,678,779
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	59	65,400,417	58,057,092

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej 677 OE/BOE, nga të cilat janë s'kualifikuar 163 OE/BOE. Procedura me 1 (një) OE janë gjithsej 5 procedura ose 13.7% e procedurave të zhvilluara në total për periudhën objekt auditimi.

### -Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit etj), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

Për arritjen e objektivave dhe përbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave/informacioneve të paraqitura dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, përzgjodhi për auditim:

- 24 procedura prokurimi me vlerë kontrate **108,979,333 lekë**, ose 71 % e totalit të fondit të kontratave të lidhura për periudhën objekt auditimi 01.01.2023-31.12.2023;  
*Nga auditimi i procedurave të prokurimit u konstatuan mangësi në procedurat si më poshtë vijon<sup>7</sup>:*

### **Periudha 01.01.2023-31.12.2023**

#### **Prokurimet me vlerë të lartë**

1. Tenderi me objekt: “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”;
2. Tenderi me objekt: “ Rikonstruksion i kanalit të Xhelos faza e I (parë) qyteti Prrenjas”.
3. Tenderi me objekt: “Asfaltim i rruges “Halit Berzeshta”;
4. Tenderi me objekt: “Blerje materiale për riparime, sistemime dhe mirembajtje të rrjetit ujitës dhe kullues”;
5. Tenderi me objekt: “Blerje materiale për mirmbajtjen e rrugëve ,trotuareve,dhe materiale për shtrimin e rrugicave midis pallateve”.
6. Tenderi me objekt: “Blerje dru zjarri për shkollat, kopshtet, çerdhet dhe institucionet e Bashkisë Prrenjas”.
7. Tenderi me objekt: “Blerje karburanti me lote: Loti 1 Blerje Naftë, Loti 2 Blerje Benzine, Loti 3 Blerje Gazi”.
8. Tenderi me objekt: “Blerje kontenier mbetjesh për zonën shtesë”.
9. Tenderi me objekt: “Blerje Ushqime për kopshtin dhe çerdhen”.
10. Tenderi me objekt: “Rikonstruksion i kanalit kryesor përroi i Lingajcës nga rruga e fushës deri tek lagjia Hallidri, fshati Rrajcë, Njësia Administrative Rrajcë, Bashkia Prrenjas”.
11. Tenderi me objekt: “Rikonstruksion i palestrës së shkollës 9-vjeçare Qybra Sokoli qyteti Prrenjas”.
12. Tenderi me objekt: “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme Bashkia Prrenjas”.
13. Tenderi me objekt: “Transporti i mbetjeve të grumbulluara (urbane) për në Inceneratorin në Elbasan”.
14. Tenderi me objekt: “Asfaltim i rrugës së Lagjes së re “Degëzimi i Toromanit”.
15. Tenderi me objekt: “Rikonstruksion i kalçetos pranë shkollës 9- vjeçare Prrenjas Fshat”.
16. Tenderi me objekt: “Hartimi i planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore, Sopot”.

#### **Prokurimet me vlerë të vogël**

17. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Rikonstruksion kanale ujitëse”;
18. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Rikonstruksion i rrugëve të fshatit Karkavec, Njësia Administrative Qukës, Bashkia Prrenjas”;
19. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi për mjetet”;
20. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Dekorimi i qytetit për Vitin e Ri.
21. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Punime rikonstruksioni në ambientet private që do të përdoren për shkollën e mesme, Sali Halili Rrajcë”.
22. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje karrige për zyrën e këshillit dhe administratën”.
23. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Shpenzime internet”.
24. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Shpenzime për lyerje, meremetime, ambientesh në varësi të Bashkisë Prrenjas”.

**1.Tenderi me objekt: “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara” me këto të dhëna:**

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:</b> “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”.
---

<sup>7</sup> Ndikimi, kriteri, shkaku dhe rekomandimi janë dhënë në fund të trajtimit të procedurave të prokurimit në mënyrë të përmbledhur, me qëllim eliminimin e përsëritjes.

<b>1.Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> REF-.....-09-02-2023 Urdhri nr. 61 prot., datë 31.08.2023	<b>2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit</b> Urdhri nr. 354, datë 08.08.2023 1.M. P -Kryetar 2.R. B -Anëtar 3.L. K-Anëtar	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 61, datë 31.08.2023 1.M. R-Juriste 2.M. P-Ing. Topograf 3.L. K-Ekonomist	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 368 prot., datë 31.08.2023. 1.Z. C - Kryetar 2.A. K – Anëtar 3.M. H - Anëtar
<b>1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Procedurë e hapur”			
<b>5. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 34,916,345 lekë	<b>6. Oferta fituese, vlera fituese:</b> OE “I” shpk me vlerë 32,870,174 lekë pa tvsh.		<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 2,046,171 lekë pa tvsh
<b>8. Data e hapjes së tenderit:</b> Data 25.09.2023	<b>9. Burimi Financimit</b> Ministria e Financave dhe Ekonomisë 80% Buxheti i Bashkisë 20%		<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender, <b>4 OE</b> b) S’kualifikuar <b>2 OE</b> , c) Kualifikuar <b>2 B/OE</b>
<b>11. Ankimime</b> AK-s’ka APP-s’ka KPP-s’ka	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> S’ka		<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP:</b> S’ka
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</b>			
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 3025, datë 06.11.2023	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSH)</b> 39,444,209 lekë		<b>16. Likuiduar:</b> 18,458,000 lekë
<b>17.Situacioni Përfundimtar</b> - s’ka	<b>18.Afati i kontratës në ditë</b> - (6 muaj)		<b>19. Zgjatja e kontratës me ditë</b> - s’ka

*Sa më sipër u konstatua:*

Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

**Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s’ka, datë 01.09.2023, nga NJP, i ndryshuar, nëpërmjet shtojcës nr.2446 prot., datë 13.09.2023.**

**Pika 2.3.1.** AK ka kërkuar përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

a.Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

b.Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet.

-Kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me pikën 5 në nenin 39 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Konkretisht sipas referencës ligjore, përcaktohet se për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Për më tepër që edhe në rekomandimin e APP nr. 3872, datë 10.06.2021 (bashkëlidhur procesverbali për argumentimin e kriterëve, sipas procedurës përkatëse) ka një shënim për kriterin e mësipërm: “*Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi*”, pra VKM përcakton kufirin maksimal, nga 0-50%, ndërkohë proceverbali tip, e përcakton qartë, zgjidh një marzh brenda këtij intervali, si p.sh jo më pak se 40% e fondit limit dhe ky marzh duhet argumentuar. Sjellim

në vëmendje këtu edhe rekomandimin e APP me shkresën nr.7998 prot., datë 24.12.2021, pika 8, paragrafi 3.

**Pika 2.3.2.** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë një punësim mesatar prej të paktën 38 punonjës të siguruar, për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave, të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve, për muajin e kërkuar;
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

**Pika 2.3.3.** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf teknik (drejtues teknik) për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune noteriale të vlefshme dhe diplomë, të figurojnë në licencën profesionale të shoqërisë në zbatim, si dhe në listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave, si mëposhtë:

- 2 (dy) Inxhinier ndërtimi

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

-Nuk argumentohet kërkesa se përse duhen dy inxhinier (Inxhinier Ndërtimi) si drejtues teknik dhe jo vetëm 1 prej tyre të jetë drejtues teknik.

**Pika 2.3.4.** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf mbështetës të kualifikuar, i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave, minimalisht:

- 3 (tre) karpentier
- 2 (dy) pllaka shtrues
- 2 (dy) bojaxhi
- 2 (dy) suvatues
- 2 (dy) shofer për përdorimin e mjetit kamion
- 2 (dy) shofer për përdorimin e mjetit kamionçinë
- 1 (një) manovrator për përdorimin e vinçit

-Ndërkohë që numri i punonjësve për të cilët është përcaktuar edhe profesioni i tyre, është 16 punonjës (2 inxhinier dhe 14 staf teknik), pra ngelen edhe 22 punonjës për të cilët nuk argumentohet numri si dhe nuk përcaktohet profesioni, ç’ka e bën një kriter jo konkret dhe jo në përputhje me qëllimin që kërkohet “*Kapacitetet teknike dhe profesionale për të realizuar projektin*”.

-Për numrin e punonjësve nuk është përcaktuar sasia e orëve të punës për çdo zë pune, volumi për ditë pune për punonjës, e cila të sjellë vlerësimin dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të nevojshëm për zbatimin e projektit.

**Pika 2.3.5.** Operatori Ekonomik ofertues, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i mjetit/pajisjes teknike	Statusi	Njesi	Sasia
2	Kamion	Në pronësi ose me qira	Copë	2
3	Kamioncine	Në pronësi ose me qira	Copë	2
4	Betoniere	Në pronësi ose me qira	Copë	2
5	Vinç Kullë	Në pronësi ose me qira	Copë	1
6	Pompë suvatimi	Në pronësi ose me qira	Copë	2
7	Skela	Në pronësi ose me qira	M2	500

Në procesverbalin përkatës nuk argumentohet numri dhe lloji i mjeteve që kërkohet, në përputhje me punën që do të kryejnë, volumin dhe grafikun e punimeve.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: znj. M. R, znj. M. P dhe znj. L. K.

### **Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.**

Nga KVO është mbajtur procesverbali nr. s'ka, datë 25.09.2023 për hapjen e tenderit, procesverbali nr.s'ka, datë 29.09.2023 për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim me nr.s'ka datë 12.10.2023. Me shkresën nr. prot., s'ka datë 29.09.2023, NJP i është drejtuar OE "I" Sh.P.K për dorëzimin e dokumentacionit pranë Bashkisë Prrenjas.

Gjithashtu nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 03.10.2023 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

*Në këtë tender kanë marrë pjesë 4 OE (renditur OE diferenca më e lartë nga fondi limit – diferenca më e ulët), përkatësisht:*

- 1- BOE "L K" Sh.P.K dhe "M" Sh.P.K, me ofertë ekonomike 33,721,581 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 1,194,764 lekë/3.4% më pak;
- 2- OE "I" Sh.P.K, me ofertë ekonomike 32,870,174 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 2,046,171 lekë/5.8% më pak;
- 3- OE "N" Sh.P.K, me ofertë ekonomike 28,781,578 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 6,134,767 lekë/17.5% më pak;
- 4- BOE "A I" Sh.P.K dhe "K" Sh.P.K, me ofertë ekonomike 25,800,805 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 9,115,540 lekë/26% më pak;

-Nga BOE dhe OE të mësipërm, janë s'kualifikuar 2 OE/BOE, si më poshtë:

OE/BOE	Arsyet e s'kualifikimit
1.BOEA I" sh.p.k &"K" sh.p.k	<p>S'kualifikuar; (Arsyet e s'kualifikimit sipas vlerësimit të KVO) Konkretisht:</p> <p><b>1.1.</b> BOE "A I" Sh.p.k me nr. NIPT "M....H &amp; "K" Sh.p.k nuk ka arritur të paraqesë dokumentacionin e saktë kërkuar sipas pikës 1/b Kriteret e vecanta të kualifikimit. Konkretisht nuk ka bërë saktë vlerën e sigurimit të ofertës 2% të fondit limit. Operatori Ekonomik ka paraqitur Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3, por shuma e sigurimit të ofertës nuk është sipas përcaktimeve të DST sa 2% e fondit limit 698,326. Shuma e sigurimit të ofertës është me pak se sa është kërkuar, konkretisht 628,326 &lt; 698,326.</p> <p><b>1.2.</b> OE "K" Sh.p.k nuk ka arritur të përmbushë kriterin nr.2.3.1 të Kapacitetit Teknik ku është kërkuar: 1.Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën: Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më e vogël se 30 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. b.Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.</p> <p><b>Pika 1/a</b> plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.</p> <p>Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.</p> <p><b>1.2.</b> Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme: Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm: Formular vlerësimi për realizimin e punimeve, shoqëruar me: Kontratë Sipërmarrje Situacionin përfundimtar; Aktin e kolaudimit; Çertifikatën e marrjes në dorëzim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim. Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm: Kontrate Sipërmarrje; Situacionin përfundimtar; Fatura tatimore për cdo situacion punimesh.</p> <p><b>Konkretisht:</b> -Përsa i përket përvojës së mëparshme me sektorin privat OE "K" Sh.p.k ka paraqitur kontratën me objekt: "Godinë shërbimi (dyqane) dy kate" të lidhur me Z.I Ç, kontratë e cila rezultoi se nuk është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.</p>

	<p>Konkretisht sipas formularit të vlerësimit të paraqitur nga OE “K” Sh.p.k afati fillimit të kontratës me objekt: “Godinë shërbimi (dyqane) dy kate” është data 12.06.2013 dhe mbarimi i kontratës është në datë 26.07.2018. (e cila rezulton se nuk është realizuar gjatë pesë viteve të fundit)</p> <p><b>1.3.</b> BOE “A I” Sh.p.k &amp; “K” Sh.p.k nuk ka arritur të përmbushë kriterin e kërkuar sipas pikës <b>2.3.4</b> të Kapacitetit Teknik të DST ku është kërkuar:</p> <p><b>2.3.4</b> Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf mbështetës të kualifikuar, i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave, minimalisht:</p> <p>3 (tre) karpentier  2 (dy) pllaka shtrues  2 (dy) bojaxhi  2 (dy) suvatues  2 (dy) shofer për përdorimin e mjetit kamion  2 (dy) shofer për përdorimin e mjetit kamioncinë  1 (një) manovrator për përdorimin e vincit</p> <p>Për punonjësit e mësipërm të paraqiten kontratat e punës të vlefshme si dhe certifikata/diploma profesionale për secilin. Certifikatat/diplomat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”</p> <p>Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.</p> <p><b>Konkretisht:</b>  BOE “A I” Sh.p.k &amp; “K” Sh.p.k nuk kanë të deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8) punonjësit:  -2 karpentier  -1 pllakashtrues  -1 bojaxhi</p> <p>Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se oferta nuk përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të nenit 82 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshur.</p> <p>Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 77, 87,92 të Ligjit 162/2020, “Për Prokurimin publik” si dhe Dokumentave Standarde të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik BOE “A I” Sh.p.k &amp; “K” Sh.p.k nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilësuar <u>si ofertë të pavlefshme</u>.</p>
2.OE“N”shpk	<p>S’kualifikuar;  Përkatësisht:</p> <p><b>2.1.</b> OE “N” shpk nuk ka arritur të përmbushë kriterin nr.2.3.3 të Kapacitetit Teknik të DST ku është kërkuar:</p> <p><b>2.3.3</b> Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf teknik (drejtues teknik) për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune noteriale të vlefshme dhe diplomë, të figurojnë në licencën profesionale të shoqërisë në zbatim, si dhe në listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave, si mëposhtë:</p> <p>2 (dy) <i>Inxhinier ndërtimi</i>  - OE “N” shpk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8):  2 (dy) <i>Inxhinier Ndërtimi: ing. G M dhe ing. A K, nga ku rezulton se inxhinieri i ndërtimit z.A K nuk figuron në licencën profesionale të shoqërisë “N” shpk.</i></p> <p><b>2.2.</b> OE “N” shpk nuk ka arritur të përmbushë kriterin e kërkuar sipas pikës <b>2.3.4</b> të Kapacitetit Teknik të DST ku është kërkuar:</p> <p><b>2.3.4</b> Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf mbështetës të kualifikuar, i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave, minimalisht:</p> <p>3 (tre) karpentier  2 (dy) pllaka shtrues  2 (dy) bojaxhi  2 (dy) suvatues  2 (dy) shofer për përdorimin e mjetit kamion  2 (dy) shofer për përdorimin e mjetit kamioncinë  1 (një) manovrator për përdorimin e vincit</p> <p>Për punonjësit e mësipërm të paraqiten kontratat e punës të vlefshme si dhe certifikata/diploma profesionale për secilin. Certifikatat/diplomat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”</p> <p>OE “N” shpk nuk ka të deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8) punonjësit:  -2 bojaxhi</p> <p><b>2.3.</b> OE “N” shpk, rezulton se sipas shkresës me nr.2586/1 datë 29.09.2023 nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Aplikimit të Projekteve, Operatori ekonomik ka shfaqur mangësi në zbatimin e kontratës së mëparshme me Bashkinë Prenjas dhe ka punime të pa perfunduara në afat referuar kontratës me nr.2828 datë 21.10.2021 me objekt: “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”, gjë e cila çënon reputacionin dhe besueshmërinë për të zbatuar kontratën.</p> <p>Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se oferta nuk përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të nenit 82 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshur.</p> <p>Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 77, 87, 92 të Ligjit 162/2020, “Për Prokurimin publik” si dhe Dokumentave Standarde të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik OE “N” shpk nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilësuar <u>si ofertë të pavlefshme</u>.</p>

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 12.10.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 4 operatorë pjesëmarrës janë s’kualifikuar 2 OE, janë kualifikuar 2 OE.

-Në kushtet e mësipërme është përzgjedhur fitues OE "I" Sh.P.K me ofertën ekonomike me vlerë 32,870,174 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 2,046,171 lekë/5.8% më pak.

-S'kualifikimi i ofertave nga KVO qëndron.

**Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht<sup>8</sup>, nga BOE shpallur fitues, konstatohet se:**

-Nuk është plotësuar pika **2.2.3 e DST**, dorëzimi i vërtetimit për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për aktivitetet e kryera në Bashkinë Prrenjas, Bashkinë Maliq, Bashkinë Shijak, Bashkinë Vlorë, Bashkinë Gjirokastrë, Bashkinë Berat, Bashkinë Korçë dhe Bashkinë Elbasan përgjatë periudhës 2022-2023.

**Konkluzion.**

OE "I" Sh.P.K, nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte në zbatim të nenit 98 të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", KVO duhet të kishte vazhduar me OE e rradhës ose anuluar procedurën e prokurimit.

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje si vijon, znj. Z Ç, Kryetar, znj. A K dhe znj. M H, Anëtar.

*Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1508-1508/13 datë 24.05.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 189/16 datë 29.05.2024 nga KVO, znj. M H, znj. A K dhe znj. Za Ç janë shprehur objeksionet për procedurat si më poshtë:*

**Pretendimi i Subjektit:** Sqarojmë se në lidhje me sa më sipër, KVO – ka bere vleresimin referuar kërkesave dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, konkretisht referuar regjistrimit sipas QKB-së, subjekti "I" shpk, rezulton se vënd të ushtrimit të aktivitetit ka Tiranën, për të cilën ka paraqitur dhe vërtetim për likuidimin e detyrimeve vendore nga Bashkia Tiranë për vitin 2022 dhe 2023. sipas përcaktimeve të kriterit 2.2.3 te DST.

OE "Ina" shpk, rezulton të ketë shlyer të gjitha detyrimet vendore për vendet e ushtrimit të aktivitetit të regjistruara në QKB duke përmbushur tërësisht kërkesat e kriterit të kualifikimit per dorëzimin e vërtetimeve për shlyerjen e taksave vendore për selinë qendrore dhe niptet sekondare nëse ka të tilla. Përsa më sipër kërkojmë marrje në konsideratë të observimeve.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se, në observacionin e dërguar nga ju, nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve. Nuk vërehen pretendime, prova, fakte apo referenca ligjore të reja, nga ato çka janë përmendur në dokumentat e paraqitura nga Bashkia Prrenjas, gjatë fazës së auditimit në terren. Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

**2. Tenderi me objekt: "Rikonstruksion i kanalit të Xhelos faza e I (parë) qyteti Prrenjas" me këto të dhëna:**

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i kanalit të Xhelos faza e I (parë) qyteti Prrenjas".			
<b>1.Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> REF-.....-10-12-2023 Urdhri nr. 63 prot., datë 14.09.2023	<b>2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit:</b> Urdhri nr. 400, datë 13.09.2023 1.M P- Kryetar 2.R B- Anëtar 3.H K- Anëtar	<b>3. Njësia e Prokurimit:</b> Urdhri nr. 63, datë 14.09.2023 1.Z Ç - Juriste 2.M P -Ing. Topograf 3.R D-Ekonomist 4.R B -Ing. Gjeolog 5.A K - Juriste	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave:</b> Urdhri nr. 405 prot., datë 14.09.2023. 1.M R – Kryetar 2.M V –Anëtar 3.M H – Anëtar
<b>1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> "E hapur e thjeshtuar"			
<b>5. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 2,326,327.3 lekë	<b>6. Oferta fituese, vlera fituese:</b> OE "A I" shpk me vlerë 1,784,025 lekë pa tvsh.		<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 542,302 lekë pa tvsh

<sup>8</sup> Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

<b>8. Data e hapjes së tenderit:</b> Data 24.10.2023	<b>9. Burimi Financimit</b> Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile .	<b>10. Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender, <b>3 OE</b> b) S'kualifikuar s'ka, c) Kualifikuar <b>3 B/OE</b>
<b>11. Ankimime</b> AK-s'ka/ka; ka APP-s'ka/ka; KPP-s'ka/ka	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> S'ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP:</b> S'ka
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 3160 prot, datë 16.11.2023	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSH)</b> 2,140,830	<b>16. Likuiduar:</b> 2,033,788 lekë
<b>17. Situacioni Përfundimtar</b>	<b>18. Afati i kontratës në ditë</b> 1 muaj	<b>19. Zgjatja e kontratës me ditë</b> - s'ka

*Sa më sipër u konstatua:*

Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

**Mbi përcaktimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, dokumentuar nëpërmjet procesverbalit nr.ska datë 12.10.2023 të mbajtur nga NJP për argumentimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit.**

**Pika 2.3.1** - Në lidhje me përvojën e mëparshme të ofertuesit, kërkohet shërbime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël 30% të fondit limit për të cilin prokurohet, të realizuara nga operatori ekonomik gjatë tri vitet e fundit – Kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me pikën 5 në nenin 39 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Konkretisht sipas referencës ligjore, përcaktohet se për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30% e vlerës së përllorë të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

**Pika 2.3.3.** AK kërkon Një punësim mesatar i të paktën 6 (gjashtë) punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhen e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave – Ndërkohë që numri i punonjësve për të cilët është përcaktuar edhe profesioni i tyre, është 4 punonjës (1 inxhinier Topograf/Markshajder/Gjeodet, 1 teknik ndërtimi, 1 manovrator dhe 1 shofer), pra ngelen edhe 2 punonjës për të cilët nuk argumentohet numri si dhe nuk përcaktohet profesioni, ç'ka e bën një kriter jo konkret dhe jo në përputhje me qëllimin që kërkohet “*Kapacitetet teknike dhe profesionale për të realizuar projektin*”.

-Për numrin e punonjësve nuk është përcaktuar sasia e orëve të punës për çdo zë pune, volumi për ditë pune për punonjës, e cila të sjellë vlerësimin dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të nevojshëm për zbatimin e projektit.

**Pika 2.3.5.** Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Eskavator me zinxhir	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Kamion	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Betoniere	copë	1	Në pronësi ose me qera

-Sa më sipër është kërkuar eskavator me zinxhir, AK duhet të kërkonte edhe disponimin e rimorkiatorit për transportimin e tij dhe në këto kushte veç disponimit të rimorkiatorit, rimorkiatori duhet të jetë i pajisur me certifikatë pronësie, targa, siguracion etj.



*-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: znj. Z Ç, znj. M P, znj. R D, z. R B dhe znj. A K.*

### ***Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Nga KVO është mbajtur procesverbali nr. s'ka, datë 24.10.2023 për hapjen e tenderit, procesverbali nr.s'ka, datë 25.10.2023 për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim me nr.s'ka datë 10.11.2023. Me shkresën nr. prot., s'ka datë 25.10.2023, NJP i është drejtuar OE "A I" Sh.P.K për dorëzimin e dokumentacionit pranë Bashkisë Prrenjas.

Gjithashtu nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 02.11.2023 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

*Në këtë tender kanë marrë pjesë 3 OE (renditur OE diferenca më e lartë nga fondi limit – diferenca më e ulët), përkatësisht:*

1-OE "A I" Sh.P.K, me ofertë ekonomike 1,784,025 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 542,302 lekë/23.3% më pak;

2-OE "S" Sh.P.K, me ofertë ekonomike 2,242,334 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 83,993 lekë/3.6% më pak;

3-OE "2 Z K" Sh.P.K, me ofertë ekonomike 2,277,800 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 48,527 lekë/2% më pak;

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 10.11.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 3 operatorë pjesëmarrës janë kualifikuar 3 OE.

-Në kushtet e mësipërme është përzgjedhur fitues OE "A I" Sh.P.K me ofertën ekonomike me vlerë 1,784,025 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 542,302 lekë/23.3% më pak.

### **Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht<sup>9</sup>, nga OE shpallur fitues, konstatohet se:**

-Nuk është plotësuar pika **2.2.3 e DST**, dorëzimi i vërtetimit për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për aktivitetet e kryera në Bashkinë Tiranë, Bashkinë Prrenjas, Bashkinë Mat, Bashkinë Himarë dhe Bashkinë Pogradec përgjatë periudhës 2022-2023.

Për mjetet e mëposhtme janë konstatuar mangësi në dokumentacionin e kërkuar në DST;

-Për mjetet e marra me qira nga OE "A I" Sh.P.K nuk plotësohet pika **2.3.5 e DST**, pasi AK ka kërkuar që "*për mjetet e marra me qira të paraqitet kontratë noteriale e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës*", nuk disponohet kontratë noteriale për mjetet e marra me qira.

-OE "A I" Shpk nuk disponon dokumentacion vërtetues për mjetin eskavator me zinxhir.

### **Konkluzion.**

BOE "R G-K" Sh.P.K dhe "V K" Sh.P.K, nuk plotëson kriteret e vendosura në DST dhe në këto kushte në zbatim të nenit 98 të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", KVO duhet të kishte vazhduar me OE e rradhës ose anuluar procedurën e prokurimit.

*-Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje si vijon, znj. M R, Kryetar, znj. M V dhe znj. M H, Anëtar.*

*Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1508-1508/13 datë 24.05.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 189/16 datë 29.05.2024 nga KVO, znj. M R, znj. M V dhe znj. M H janë shprehur objeksionet për procedurat si më poshtë:*

<sup>9</sup> Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

**Pretendimi i Subjektit:** Sqarohet se në lidhje me sa më sipër, KVO bashkëngjitur këtij observacioni ju dërgon dokumentacionin për shoferin H N.

Përsa më sipër kërkojmë marrje në konsideratë të observimeve.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Për sa trajtuar më sipër observacioni juaj në lidhje me shoferin H N merret në konsideratë dhe do reflektohet në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

### 3- Tenderi me objekt: “Asfaltim i rrugës “Halit Berzeshta” Prrenjas, me këto të dhëna:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Asfaltim i rrugës “Halit Berzeshta” Prrenjas”.		
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit:</b> Ref-.....-06-05-2023 Urdhri nr. 41 prot., datë 25.05.2023	<b>2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit:</b> Urdhri nr. 18, datë 19.01.2023 1.M P -Kryetar 2.D C-Anëtar 3.M H -Anëtar	<b>3. Njësia e Prokurimit:</b> Urdhri nr. 41, datë 25.05.2023  1.Z C-Juriste 2.M P-Ing. Topograf 3.R D-Ekonomist
<b>1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “E hapur”		<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave:</b> Urdhri nr. 239 prot., datë 25.05.2023. 1.M R - Kryetar 2.A K -Anëtar 3.M H -Anëtar
<b>5. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 14,388,404 lekë	<b>6. Oferta fituese, vlera fituese:</b> OE “Rr U A Nr.2 E” sha, vlera fituese 10,442,808 lekë pa tvsh.	<b>7. Diferenca me fondin limit:</b> 3,945,595 lekë pa tvsh
<b>8. Data e hapjes së tenderit:</b> Data 27.06.2023	<b>9. Burimi Financimit:</b> Të ardhurat e Bashkisë	<b>10. Operoret Ekonomike:</b> a) Pjesëmarrës në tender, 12 OE b) S’kualifikuar 5 B/OE, c) Kualifikuar 7 B/OE
<b>11. Ankimime:</b> AK-s’ka APP-s’ka KPP-s’ka	<b>12. Përgjigje Ankesës:</b> nga AK S’ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP:</b> S’ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
<b>14. Lidhja e kontratës:</b> Nr. 2678, datë 05.10.2023	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSH)</b> 12,531,370 lekë	<b>16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës:</b> Nuk është likuiduar.
<b>17. Situacioni Përfundimtar:</b> 12,531,370 lekë me tvsh	<b>18. Afati i kontratës në ditë:</b> 1 muaj	<b>19. Zgjatja e kontratës me ditë:</b> S’ka

Sa më sipër u konstatua:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

#### **Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s’ka, datë 05.06.2023, nga NJP.**

**Pika 2.2.1.** AK ka kërkuar që për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet (jo më e vogël se vlera e fondit limit) – Për këtë kërkesë nga NJP (përrjashtuar specialistin e fushës) është pasqyruar vetëm baza ligjore, pa dhënë argumentimin se si ndikon ky marzh në përmbushjen e kontratës së prokurimit. Gjithashtu përcaktimi në pikën 2.2.1 nuk është në përputhje shkronjën “b”, pika 2 në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Konkretisht sipas referencës ligjore, vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Për më tepër që edhe në rekomandimin e APP nr. 3872, datë 10.06.2021 (bashkëlidhur procesverbali për argumentimin e kriterëve, sipas procedurës përkatëse) ka një shënim për kriterin e mësipërm: “Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi”, pra VKM përcakton kufirin maksimal, nga 0-

deri në vlerën e kontratës, ndërkohë proceverbali tip, e përcakton qartë, zgjidh një marzh brenda këtij intervali, si p.sh jo më pak se 80% e fondit limit dhe ky marzh duhet argumentuar. Sjellim në vëmendje këtu edhe rekomandimin e APP me shkresën nr.1797/1 prot., datë 10.03.2022, pika 3.

**Pika 2.3.1.** AK ka kërkuar përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

b. Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet.

Kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me pikën 5 në nenin 39 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Konkretisht sipas referencës ligjore, përcaktohet se për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Për më tepër që edhe në rekomandimin e APP nr. 3872, datë 10.06.2021 (bashkëlidhur procesverbali për argumentimin e kriterëve, sipas procedurës përkatëse) ka një shënim për kriterin e mësipërm: “*Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi*”, pra VKM përcakton kufirin maksimal, nga 0-50%, ndërkohë proceverbali tip, e përcakton qartë, zgjidh një marzh brenda këtij intervali, si p.sh jo më pak se 40% e fondit limit dhe ky marzh duhet argumentuar. Sjellim në vëmendje këtu edhe rekomandimin e APP me shkresën nr.7998 prot., datë 24.12.2021, pika 8, paragrafi 3.

**Pika 2.3.3.** AK ka kërkuar që OE duhet të ketë një punësim mesatar prej të paktën 25 (njëzetë e pesë) punonjës të siguruar, për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave - Ndërkohë që numri i punonjësve për të cilët është përcaktuar edhe profesioni i tyre, është 17 punonjës (2 inxhinier, 1 teknik ndërtimi, 2 manovrator, 4 shoferë, 2 hidraulik, 1 saldator, 3 karpentier dhe 2 hekurkthyes), pra ngelen edhe 8 punonjës për të cilët nuk argumentohet numri si dhe nuk përcaktohet profesioni, ç’ka e bën një kriter jo konkret dhe jo në përputhje me qëllimin që kërkohet “*Kapacitetet teknike dhe profesionale për të realizuar projektin*”.

**Pika 2.3.4.** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf teknik (drejtues teknik) për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune noteriale të vlefshme dhe diplomë, të figurojnë në licencën profesionale të shoqërisë në zbatim, si dhe në listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave, si mëposhtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Topograf/Markshajdet/Gjeodet

**Pika 2.3.5.** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf mbështetës të kualifikuar, i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave, minimalisht:

1 (një) Manovratorë/eskavatoristë, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme, dëshmitë e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë, lëshuar nga DPSHTRR;

1 (një) Automakinistë, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme, dëshmitë e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë, lëshuar nga DPSHTRR;

4 (katër) Shoferë për 2 (dy) kamionin dhe 2 (dy) për kamiocinë, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme) lëshuar nga DPSHTRR;

1 (një) Teknik ndërtimi, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë”;

2 (dy) Hidraulik shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë”;

1 (një) Saldator shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë”;

2 (dy) Hekurkthyes shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë”;

3 (tre) Karpentier shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë”;

Për sa trajtuar më sipër, kriteret **2.3.3**, **2.3.4** dhe **2.3.5**, nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërish për asyë se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrin ndërmjet grafikut të punimeve, normës së punës së punëtorëve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës.

**Pika 2.3.6.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i mjetit/pajisjes teknike	Statusi	Sasia
	Kamion vetëshkarkues mbi 15 ton	Në pronësi ose me qira	2
	Kamioncine	Në pronësi ose me qira	2
	Grejder	Në pronësi ose me qira	1
	Asfaltoshtruese	Në pronësi ose me qira	1
	Eskavator me goma	Në pronësi ose me qira	1
	Autobitumatriçe	Në pronësi ose me qira	1
	Autobot uji	Në pronësi ose me qira	1
	Rrul asfalti	Në pronësi ose me qira	1
	Makine vijezi	Në pronësi ose me qira	1
	Auto Betoniere	Në pronësi ose me qira	1
	Fadrome	Në pronësi ose me qira	1

-Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit nuk argumentohet numri i mjeteve dhe makinerive, por është bërë vetëm argumentimi i domosdoshmërisë (*pra nevojitet kamioni vetëshkarkues pasi kemi materiale ndërtimi për t'u transportuar, apo fadromë pasi kemi punime gërmimi*) së llojit të mjeteve në përputhje me zërat e preventivit. Gjithashtu nuk është përcaktuar sasia e orëve të punës për çdo zë pune, e cila të sjellë vlerësimin dhe përcaktimin e numrit të mjeteve të nevojshëm për zbatimin e projektit. Pra nuk është bërë një përcaktim konkret dhe me analizë teknike, cilat do të jenë materialet që do të transportohen me kamionin vetëshkarkues, sa është pesha totale e materialeve, sa peshë mund të transportojë kamioni në një rrugë, sa rrugë në ditë mund të bëjë, dhe në bazë të kësaj përcaktohet sa pesha mund të transportojë kamioni në një ditë pune (8 orë) dhe me pas në 176 orë pune gjithësej (1 muaj), për të arritur në përcaktimin e numrit të kamionave.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: znj. Z Ç, znj. M P dhe znj. R D.

#### ***Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 27.06.2023 për hapjen e tenderit, procesverbali nr.s'ka, datë 14.07.2023 për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimin të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim datë 29.08.2023. Nëpërmjet kërkesës në SPE, datë 14.07.2023, KVO i është drejtuar OE “Sh 07” për dorëzimin

e dokumentacionit. Me shkresën nr. prot., s'ka datë 19.07.2023 nga OE "Sh 07" është dorëzuar dokumentacioni pranë Bashkisë Prrenjas. Gjithashtu nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 27.07.2023 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij dhe u konstatua se OE nuk plotëson kriteret e kërkuara nga AK. Nëpërmjet kërkesës në SPE, datë 27.07.2023, KVO i është drejtuar OE "Rr U A Nr.2 E" për dorëzimin e dokumentacionit. Me shkresën nr. prot., s'ka datë 04.08.2023 nga OE "Rr U A Nr.2 E" është dorëzuar dokumentacioni pranë Bashkisë Prrenjas. Gjithashtu nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 04.08.2023 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij dhe u konstatua se OE nuk plotëson kriteret e kërkuara nga AK.

*Në këtë tender kanë marrë pjesë 12 OE/BOE, përkatësisht:*

- 1.OE "N" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 9,645,556 lekë pa TVSH.
- 2.OE "Sh 07" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 9,875,939 lekë pa TVSH.
- 3.OE "Rr U A Nr.2 E" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 10,503,534 lekë pa TVSH.
- 4.OE "O" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 10,642,911 lekë pa TVSH.
- 5.OE "2 N" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 11,500,000 lekë pa TVSH.
- 6.OE "B" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 11,535,663 lekë pa TVSH.
- 7.OE "I" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 11,773,471 lekë pa TVSH.
- 8.OE "A" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 11,971,297 lekë pa TVSH.
9. OE "M" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 12,222,966 lekë pa TVSH.
10. OE "S" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 12,702,037 lekë pa TVSH.
11. OE "B-X" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 13,188,232 lekë pa TVSH.
12. OE "K C" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 14,386,566 lekë pa TVSH.

-Nga BOE dhe OE të mësipërm, janë s'kualifikuar 5 OE/BOE, si më poshtë:

OE/BOE	Arsyet e s'kualifikimit
1.OE "SH 07"	<p>S'kualifikuar;</p> <p><b>-Me formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Operatori Ekonomik ka deklaruar se</b> ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjisllacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p> <p>Nga verifikimi i listës së debitorëve në bashkinë Prrenjas, rezulton se Operatori ekonomik nuk ka shlyer taksat dhe tarifat vendore për punimet e realizuara në bashkinë Prrenjas.</p> <p><b>-Ne pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik është kërkuar:</b></p> <p>Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf mbështetës të kualifikuar i cili duhet të figurojë në listepagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave, minimalisht:</p> <p>-3 Karpentier shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional ne Republikën e Shqipërisë".</p> <p>Me formularin përmbledhës të vetëdeklarimit është deklaruar i punësuar si karpentier K.K .</p> <p>Për këtë punonjë është paraqitur kontratë pune dhe certifikatë trajnimi e lëshuar nga AQSCERT.</p> <p>Nga verifikimi rezulton se këto dëshmi të lëshuara nga "Aqscert" shpk e të paraqitura nga operatori janë të pavlefshme sepse shoqëria ASQCERT, nuk është licensuar nga ana Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe nuk disponon asnjë licensë për të ofruar kurse trajnimi për formimin profesional në përputhje me ligjin nr.15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë. "Në këtë rast KVO i referohet vendimit të KPP 441/2020 ku theksohet se; fq 20 e vendimit.</p> <p>-Gjithashtu ky punonjë nuk figuron në listepagesa për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.</p>
2.OE "B" Shpk	<p>S'kualifikuar;</p> <p>Operatori Ekonomik "S" shpk nuk ka arritur të përmbushë kriterin nr.2.3.1 të Kapacitetit Teknik të DT, përvojën e mëparshme.</p> <p>Përsa i përket përvojës së mëparshme me një ent publik OE "S" shpk, ka deklaruar si pune të ngjashme kontratat e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kontrata me objekt "Sistemim Asfaltim rruga e Rrahit Bashkia Krujë pranë objktit të kultit Arremerras Fushë-Krujë" të lidhur me Bashkinë Krujë, dokumentacioni i kësaj kontrate nuk është paraqitur i plotë pasi mungon Formulari i Vlerësimit.</li> <li>2. Kontrata me objekt "Shpenzime për riparime me asfaltobeton" të lidhur me Bashkinë Elbasan, dokumentacioni i kësaj kontrate është i plote, por vlera e kësaj kontrate është më e vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.</li> <li>3. Kontrata me objekt "Sistemim Asfaltim rruga e gështenjave Rrenc, Guri I Zi" të lidhur me Bashkinë Shkodër, dokumentacioni i kësaj kontrate nuk është paraqitur i plotë pasi mungon Formulari i Vlerësimit.</li> <li>4. Kontrata me objekt "Rikonstruksion i rrugeve te brendshme në Bashkinë Prrenjas, Rruga 1 Qershori /Rruga 5 Maji" të lidhur me Bashkinë Prrenjas, dokumentacioni i kësaj kontrate nuk është paraqitur i plotë pasi mungon Formulari i Vlerësimit.</li> <li>5. Kontrata me objekt "Sistemim Asfaltim i rrugës nga rruga e tregut Pallati i Kulturës Krujë" të lidhur me Bashkinë Krujë, dokumentacioni i kësaj kontrate nuk është paraqitur i plotë pasi mungon Formulari i Vlerësimit.</li> </ol>
3.OE "T" shpk	Skuallifikuar.

	<p>-Operatori ekonomik "I" shpk rezulton të jetë i angazhar në një tjetër procedurë në Bashkinë Prrenjas. Konkretisht punonjësit si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Drejtuesi Teknik A.D rezulton të jetë i angazhuar në rolin e Drejtuesit Teknik në procedurën me objekt "Rikonstruksion i palestrës së shkollës 9-vjeçare "Qybra Sokoli", Qyteti Prrenjas"</li> <li>2. A.S Automakiniist rezulton të jetë i angazhuar në rolin e Shoferit të kamionit në procedurën me objekt "Rikonstruksion i palestrës së shkollës 9-vjeçare "Qybra Sokoli", Qyteti Prrenjas"</li> <li>3. I. Z Hekurthyes rezulton të jetë i angazhuar në rolin e Shoferit në procedurën me objekt "Rikonstruksion i palestrës së shkollës 9-vjeçare "Qybra Sokoli", Qyteti Prrenjas"</li> <li>4. K.Z Z Karpentier rezulton të jetë i angazhuar në rolin e Shoferit në procedurën me objekt "Rikonstruksion i palestrës së shkollës 9-vjeçare "Qybra Sokoli", Qyteti Prrenjas"</li> </ol> <p>Makineritë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kamioncinë me targa AA...CB</li> <li>2. Kamion veteshkarkues mbi 15 ton me targa AA...EL</li> </ol> <p>rezultojnë të jenë të angazhuara në procedurën me objekt "Rikonstruksion i palestrës së shkollës 9-vjeçare "Qybra Sokoli", Qyteti Prrenjas"</p>
4.OE"N" shpk	<p>S'kualifikuar</p> <p>Arsyet e mëposhtme:</p> <p>-Oferta e paraqitur nga OE "N" shpk Rezultoi të ishte anomalisht e ulët.</p> <p>Operatori ekonomik "N" shpk nuk paraqiti dokumentacionin përkatës për argumentim të ofertës anomalisht të ulët.</p>
5.OE"S" shpk	<p>Skualifikuar</p> <p>Arsyet e mëposhtme:</p> <p>Operatori Ekonomik "S" shpk nuk ka arritur të përmbushë kriterin nr.2.3.1 të Kapacitetit Teknik të DT, përvojën e mëparshme.</p> <p>Përsa i përket përvojes së mëparshme me një ent publik OE "S" shpk, ka deklaruar si punë të ngjashme kontratat e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kontrata me objekt "Sistemim Asfaltim rruga e Rrahit Bashkia Krujë" prane objektit të kultit Arremerras Fushë-Krujë" të lidhur me Bashkinë Krujë, dokumentacioni i kësaj kontrate nuk është paraqitur i plotë pasi mungon Formulari i Vlerësimit.</li> <li>2. Kontrata me objekt "Shpenzime për riparime me asfaltobeton" të lidhur me Bashkinë Elbasan, dokumentacioni i kësaj kontrate është i plotë, por vlera e kësaj kontrate është më e vogël se 40 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.</li> <li>3. Kontrata me objekt "Sistemim Asfaltim rruga e gështenjave Rrenc, Guri i Zi" të lidhur me Bashkinë Shkodër, dokumentacioni i kësaj kontrate nuk është paraqitur i plotë pasi mungon Formulari i Vlerësimit.</li> <li>4. Kontrata me objekt "Rikonstruksion i rrugëve të brendshme në Bashkinë Prrenjas, Rruga 1 Qershori / Rruga 5 Maji" të lidhur me Bashkinë Prrenjas, dokumentacioni i kësaj kontrate nuk është paraqitur i plotë pasi mungon Formulari i Vlerësimit.</li> <li>5. Kontrata me objekt "Sistemim Asfaltim i rrugës nga rruga e tregut Pallati i Kultures Kruje" të lidhur me Bashkinë Krujë, dokumentacioni i kësaj kontrate nuk është paraqitur i plotë pasi mungon Formulari i Vlerësimit.</li> </ol>

## Ankesa

Në lidhje me vlerësimin e ofertave të dorëzuara, nga KVO është mbajtur procesverbali nr. prot., s'ka datë 04.08.2023, për shpalljen e ofertës së OE "Rr U A Nr.2 E" Shpk, si ofertë anomalisht e ulët, sipas formulës së përcaktuar në DST. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE "Rr U A Nr.2 E" Shpk, u konstatua se oferta e OE nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilësuar si ofertë të pavlefshme.

Me shkresën nr.2201 prot., datë 14.08.2023 është bërë ankesë nga OE "Rr U A Nr.2 E" ShPK, për vlerësimin e ofertës.

Me shkresën nr. prot., s'ka datë 16.08.2023, nga KVO është mbajtur proceverbali për rivlerësimin e ofertave.

-Në kushtet e mësipërme është përzgjedhur fitues OE "Rr U A Nr.2 E" Sh.P.K, me ofertën ekonomike me vlerë 10,442,808 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 3,945,596 lekë/27.4% më pak. Pra është përzgjedhur e vlefshme, oferta më e ulët ekonomike, në krahasim me ofertat e tjera të vlefshme, të cilat gjatë vlerësimit të ofertave janë klasifikuar si të vlefshme.

-S'kualifikimi i ofertave nga KVO qëndron.

## **Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht<sup>10</sup>, nga OE shpallur fitues, konstatohet se:**

-Nuk administrohet certifikata e kualifikimit për drejtuesin e autobitumatrices<sup>11</sup>;

-Dokumentacioni mbi mjetin teknologjik, si grejderi nuk është i pajisur me targë njohje<sup>12</sup>, i cili përmban të dhënat e regjistrimit të tyre. Gjithashtu nuk administrohet certifikata e

<sup>10</sup> Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

<sup>11</sup> Neni 35 dhe 38 në Ligjin nr. 118/2012 "Për transportin e mallrave të rrezikshme".

<sup>12</sup> Neni 113, pika 4 në Kodin Rrugor dhe neni 248 shkronjat "g" dhe "gj" në rregulloren për zbatimin e Kodit Rrugor miratuar me VKM nr.153, datë 07.04.2000, e ndryshuar.

regjistrimit të tij me qëllim verifikimin dhe vërtetimin e pronësisë mbi mjetin, si dhe policia e sigurimit;

-Veç sa më sipër në asnjë rast nuk është dorëzuar dokumentacion, dëshmi e aftësisë profesionale me titull “Buldozerist” për drejtimin e grejderit.

Buldozer gjurmimi, shtyrje, nivelimi e ngjeshje dherash apo shpim toke: të gjithë llojet e traktorëve me thikë (ruspë), ose që tërheqin skreper, grejder apo nivelues, rul vibrues, shtruese asfalto-betoni, skreperët, grejderët dhe niveluesit kur janë vetëlëvizës, të gjithë llojet e traktorëve, me pajisje shtesë për ngritjen e peshave, shpimin e puseve etj, Manovratorëve u jepet dëshmi për BULDOZERIST.

### **Konkluzion.**

OE “Rr U A Nr.2 E”, nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte në zbatim të nenit 98 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, KVO duhet të kishte vazhduar me OE e rradhës ose anuluar procedurën e prokurimit.

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje si vijon, znj. M R, Kryetar, znj. A K dhe znj. M H, Anëtar.

*Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1508-1508/13 datë 24.05.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 189/16 datë 29.05.2024 nga KVO, znj. M R, znj. A K dhe znj. M H janë shprehur objeksionet për procedurat si më poshtë:*

**Pretendimi i Subjektit:** Sqarojmë se për sa i përket -1 (një) manovratorë, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme, dëshmitë e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga DPSHTRR;

-1 (një) shofer shoqëruar me kontratë pune të vlefshme, dëshmitë e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga DPSHTRR;

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në vlerësimin e dokumentacionit të kërkuar i është referuar kriterit të mësipërm dhe ka quajtur të vlefshme dëshminë e aftësisë profesionale për “Manovrator”.

Përsa i përket dokumentacionit të njohjes mbi mjetin teknologjik grejder është parë dokumentacioni nga KVO dhe për këtë mjet OE ka paraqitur Vërtetim zhdoganimi me nr. 2008/2165 datë 29.05.2008 vërtetim në të cilin përcaktohet se Mjeti “grejder” është blerë nga subjekti “Rr U A nr.2 sha.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se, në observacionin e dërguar nga ju, nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve. Nuk vërehen pretendime, prova, fakte apo referenca ligjore të reja, nga ato çka janë përmendur në dokumentat e paraqitura nga Bashkia Prrenjas, gjatë fazës së auditimit në terren. Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

## **4- Tenderi me objekt: “Blerje materiale për riparime, sistemime dhe mirembajtje të rrjetit ujtës dhe kullues” me këto të dhëna:**

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje materiale për riparime, sistemime dhe mirembajtje të rrjetit ujtës dhe kullues”.</b>			
<b>1.Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> REF-.....-02-16-2022 Urdhri nr. 12 prot., datë 13.02.2023	<b>2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit</b> Urdhri nr. 79, datë 09.02.2023 1.M A - Kryetar 2.Sh H - Anëtar 3.G Ç - Anëtar	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 12, datë 13.02.2023 1.Z Ç- Juriste 2.M A- Ekonomist 3.N G -Juriste	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 84 prot., datë 13.02.2023/ ndryshuar me Urdhër nr.112 datë 28.02.2023. 1.M Z - Kryetar 2.M P - Anëtar 3.R D - Anëtar
<b>5. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 2,333,333 lekë	<b>6. Oferta fituese, vlera fituese:</b> OE F R R PF me vlerë 1,704,100 lekë pa tvsh.	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 629,233 lekë pa tvsh	
<b>8. Data e hapjes së tenderit:</b> Data 28.02.2023	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti i Bashkisë.	<b>10. Operoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender, <b>3 OE</b> b) S’kualifikuar <b>Nuk ka,</b> c) Kualifikuar <b>3 OE</b>	

<b>11. Ankimime</b> AK-s'ka APP-s'ka KPP-s'ka	<b>12. Përgjigje</b> Ankesës nga AK S'ka	<b>13. Përgjigje</b> Ankesës nga APP apo <b>KKP:</b> S'ka
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr.922 prot, datë 28.03.2023	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSH):</b> 2,044,920	<b>16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës:</b> 2,044,920 lekë
<b>17. Situacioni Përfundimtar</b>	<b>18. Afati i kontratës në ditë</b> 3 muaj	<b>19. Zgjatja e kontratës me ditë</b> S'ka

*Sa më sipër u konstatua:*

Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se përlllogaritja e fondit limit nuk është argumentuar dhe dokumentuar plotësisht, si dhe në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar plotësisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Konkretisht si më poshtë vijon:

### **Preventivi**

Fondi limit, afati i lëvrimit dhe specifikimet teknike, janë hartuar nga komisioni i ngritur me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Prrenjas nr.79, me nr.448 prot., datë 09.02.2023, me përbërje si vijon: z. M A, z. Sh H, dhe z. G Ç.

Nga komisioni i përlllogaritjes së fondit limit është mbajtur procesverbali pa nr. prot., datë 10.02.2023, mbi evidentimin e sasisë, përlllogaritjen e fondit limit (çmim për njësi produkti) është bërë mesatarizimi i 3 ofertave nga 3 subjekte, përkatësisht: OE R K Shpk, OE L R Shpk dhe OE D H Shpk, si dhe për materialet me analizë teknike, komisioni është bazuar në VKM nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, i ndryshuar, është përcaktuar fondi limit me vlerë totale 2,333,333 lekë pa TVSH ose 2,800,000 lekë me TVSH.

### **Nga auditimi i veprimtarisë së komisionit të mësipërm konstatohet se:**

-Nuk administrohen kërkesat/informimi drejtuar subjekteve për dhënien e ofertave, me qëllim dokumentimin e mënyrës së përzgjedhur për përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e mësipërme.

-Nuk administrohet kërkesa nga Drejtoria e Bujqësisë për materialet që duhen për mirëmbajtjen e rrjetit ujitës dhe kullues, me qëllim që nga grupi i punës të bëhej përlllogaritja e sasisë së materialeve për procedurën e prokurimit.

-Ofertat nga 3 subjektet e mësipërme, nuk janë protokolluar.

-Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 1, shkronjën “ç” në pikën 2 të nenit 2, pikën 1 të nenit 13, pikën 2 në nenin 76 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

*Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi, z. M A, z. Sh H dhe z. G Ç.*

### **Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s'ka, datë 16.02.2023, nga NJP.**

**Pika 2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet. - Për këtë kërkesë nga NJP (përgjatuar specialistin e fushës) është pasqyruar vetëm baza ligjore, pa dhënë argumentimin se si ndikon ky marzh në përmbushjen e kontratës së prokurimit. Gjithashtu përcaktimi në pikën 2.2.1 nuk është në përputhje shkronjën pikën 4 në nenin 55 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Konkretisht sipas referencës ligjore, vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, në procedurat e prokurimit e hapur e thjeshtuar (për kontrata nën kufirin e ulët monetar);

Për më tepër që edhe në shkresën e APP nr. 3872, datë 10.06.2021 (bashkëlidhur procesverbali për argumentimin e kriterëve, sipas procedurës përkatëse) ka një shënim për kriterin e



mësipërm: “Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohe, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi”, pra VKM përcakton kufirin maksimal, nga 0-40%, ndërkohë proceverbali tip, e përcakton qartë, zgjidh një marzh brenda këtij intervali, si p.sh jo më pak se 30% e fondit limit dhe ky marzh duhet argumentuar. Sjellim në vëmendje këtu edhe rekomandimin e APP me shkresën nr.1797/1 prot., datë 10.03.2022, pika 3.

**Pika 2.3.1.** Për të provuar përvojën e mëparshme të suksesshme, kërkohe dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

Ndërkohë sipas përcaktimit në shkronjën “b” të në pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për më tepër që edhe në rekomandimin e APP nr. 3872, datë 10.06.2021 (bashkëlidhur procesverbali për argumentimin e kriterëve, sipas procedurës përkatëse) ka një shënim për kriterin e mësipërm: “Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohe, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi”, pra VKM përcakton kufirin maksimal, nga 0-20%, ndërkohë proceverbali tip, e përcakton qartë, zgjidh një marzh brenda këtij intervali, si p.sh jo më pak se 15% e fondit limit dhe ky marzh duhet argumentuar. Sjellim në vëmendje këtu edhe rekomandimin e APP me shkresën nr.1797/1 prot., datë 10.03.2022, pika 3, si dhe pikën 8 në rekomandimin e APP nr.7998 prot., datë 24.12.2021.

*-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: znj. Z Ç, z. M A dhe znj. N G.*

### ***Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Nga KVO është mbajtur procesverbali nr. s’ka, datë 28.02.2023 për hapjen e tenderit, procesverbali nr.s’ka, datë 09.03.2023 për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim. Nëpërmjet SPE, KVO më datë 09.03.2023 i është drejtuar OE të shpallur fitues për dorëzimin e dokumentacionit provues të formularit 8.

Me shkresën nr. 808 prot., datë 15.03.2023 nga OE shpallur fitues është dorëzuar dokumentacioni pranë Bashkisë Prrrenjas. Gjithashtu nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s’ka, datë 15.03.2023 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

*Në këtë tender ka marrë pjesë 3 OE, përkatësisht:*

- 1.OE “F R” Sh.K.P, me ofertë ekonomike në shumën prej 1,704,100 lekë pa TVSH.
- 2.OE “A-D” Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 1,911,400 lekë pa TVSH.
- 3.OE “A 2018” Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 2,097,100 lekë pa TVSH.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 23.03.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 3operatorë pjesëmarrës nuk ka OE të s’kualifikuar, janë kualifikuar 3 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 23.03.2023 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë OE “F R R PF” Sh.P.K me ofertën ekonomike me vlerë 1,704,100 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 629,233 lekë/27% më pak. Është përzgjedhur e vlefshme, oferta më e ulët ekonomike, në krahasim me ofertat e tjera të vlefshme, të cilat gjatë vlerësimit të ofertave janë klasifikuar si të vlefshme.

### ***Konkluzion***

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht<sup>13</sup>, nga OE “F R” shpallur fitues, konstatohet se OE plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit.

*Për sa më sipër për këtë pjesë është paraqitur observacion me nr. 1508-1508/13 prot., datë 24.05.2024, nga subjekti i audituar Bashkia Prrenjas, administruar në KLSH me praktikën nr. 189/16 prot., datë 29.05.2024, nga Komisioni i përllogaritjes së fondit limit i përbërë nga: z. M A, z. Sh H dhe z. G C.*

**Pretendimi i Subjektit:** Lidhur me përllogaritjen e fondit limit për procedurën e mësipërme sqarojmë se, komisioni duke mos pasur manual për të përcaktuar vlerën bëri studimin e tregut duke marrë në konsideratë cmimin në tre subjektë të ndryshme ku është marrë në konsideratë oferta me vlerën më të ulët.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH-së:** Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se, në observacionin e dërguar nga ju, nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve. Nuk vërehen pretendime, prova, fakte apo referenca ligjore të reja, nga ato çka janë përmendur në dokumentat e paraqitura nga Bashkia Prrenjas, gjatë fazës së auditimit në terren. Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

### 5. Tenderi me objekt: “Blerje materiale për mirmbajtjen e rrugëve, trotuareve dhe materiale për shtrimin e rrugicave midis pallateve” me këto të dhëna:

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje materiale për mirmbajtjen e rrugëve, trotuareve dhe materiale për shtrimin e rrugicave midis pallateve”.</b>			
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> REF-.....-06-13-2023 Urdhri nr. 44 prot., datë 06.06.2023	<b>2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit</b> Urdhri nr. 19, datë 19.01.2023 1. O A -Kryetar 2. E V -Anëtar 3. M K -Anëtar	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 44, datë 06.06.2023  1. M R - Juriste 2. R D -Ekonomi 3. M Z - Juriste	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 273 prot., datë 08.06.2023.  1. Z Ç -Kryetar 2. A K -Anëtar 3. M V -Anëtar
<b>5. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 5,661,850 lekë	<b>6. Oferta fituese, vlera fituese:</b> OE A 2018 shpk me vlerë 4,958,750 lekë pa tvsh.	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 703,100 lekë pa tvsh	
<b>8. Data e hapjes së tenderit:</b> Data 26.06.2023	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti i Bashkisë.	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender, <b>3 OE</b> b) S’kualifikuar <b>1 OE</b> , c) Kualifikuar <b>2 OE</b>	
<b>11. Ankimime</b> AK-s’ka APP-s’ka KPP-s’ka	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> S’ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP:</b> S’ka	
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</b>			
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr.2073 prot, datë 27.07.2023	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSH)</b> 5,950,500 lekë	<b>16. Likuiduar:</b> 5,950,500 lekë	
<b>17. Situacioni Përfundimtar</b>	<b>18. Afati i kontratës në ditë</b> 1 muaj	<b>19. Zgjatja e kontratës me ditë:</b> S’ka	

*Sa më sipër u konstatua:*

Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se përllogaritja e fondit limit nuk është argumentuar dhe dokumentuar plotësisht, si dhe në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar plotësisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Konkretisht si më poshtë vijon:

### **Preventivi**

Fondi limit, afati i lëvrimit dhe specifikimet teknike, janë hartuar nga komisioni i ngritur me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Prrenjas nr.19, nr.178 prot., datë 19.01.2023, me përbërje si vijon: z. O A, z. E V, dhe znj. M K.

<sup>13</sup> Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

Nga komisioni i përllogaritjes së fondit limit është mbajtur procesverbali pa nr. prot., datë 19.01.2023, mbi evidentimin e sasisë, përllogaritjen e fondit limit (çmim për njësi produkti) është bërë mesatarizimi i 3 ofertave nga 3 subjekte, përkatësisht: OE A Z Shpk, OE R K Shpk dhe OE L R Shpk, dhe është përcaktuar fondi limit me vlerë totale 5,661,850 lekë pa TVSH ose 6,794,220 lekë me TVSH.

**Nga auditimi i veprimtarisë së komisionit të mësipërm konstatohet se:**

-Nuk administrohen kërkesat/informimi drejtuar subjekteve për dhënien e ofertave, me qëllim dokumentimin e mënyrës së përzgjedhur për përllogaritjen e fondit limit për procedurën e mësipërme.

-Nuk administrohet kërkesa nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, me qëllim që nga grupi i punës të bëhej përllogaritja e sasisë së materialeve për procedurën e prokurimit.

-Ofertat nga 3 subjektet e mësipërme, nuk janë protokolluar.

-Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 1, shkronjën “ç” në pikën 2 të nenit 2, pikën 1 të nenit 13, pikën 2 në nenin 76 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

*Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi, z. O A, z. E V dhe znj. M K.*

**Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s’ka, datë 13.06.2023, nga NJP.**

**Pika 2.2.1,** OE ofertues duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të tre viteve të fundit financiare (2019, 2020, 2021), lëshuar nga Administrata Tatimore, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet - Për këtë kërkesë nga NJP (përfshijtur specialistin e fushës) është pasqyruar vetëm baza ligjore, pa dhënë argumentimin se si ndikon ky marzh në përmbushjen e kontratës së prokurimit. Gjithashtu përcaktimi në pikën 2.2.1 nuk është në përputhje me pikën 4 në nenin 55 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Konkretisht sipas referencës ligjore, vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, në procedurat e prokurimit e hapur e thjeshtuar (për kontrata nën kufirin e ulët monetar);

Për më tepër që edhe në shkresën e APP nr. 3872, datë 10.06.2021 (bashkëlidhur procesverbali për argumentimin e kriterëve, sipas procedurës përkatëse) ka një shënim për kriterin e mësipërm: “*Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi*”, pra VKM përcakton kufirin maksimal, nga 0-40%, ndërkohë proceverbali tip, e përcakton qartë, zgjidh një marzh brenda këtij intervali, si p.sh jo më pak se 30% e fondit limit dhe ky marzh duhet argumentuar. Sjellim në vëmendje këtu edhe rekomandimin e APP me shkresën nr.1797/1 prot., datë 10.03.2022, pika 3.

**Pika 2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme të suksesshme, kërkohen dëshmi për shërbime të mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet - Ndërkohë sipas përcaktimit në shkronjën “b” të pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për më tepër që edhe në rekomandimin e APP nr. 3872, datë 10.06.2021 (bashkëlidhur procesverbali për argumentimin e kriterëve, sipas procedurës përkatëse) ka një shënim për kriterin e mësipërm: “*Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi*”, pra VKM përcakton kufirin maksimal, nga 0-20%, ndërkohë proceverbali tip, e përcakton qartë, zgjidh një marzh brenda këtij intervali, si p.sh jo më pak se 15% e fondit limit dhe ky marzh duhet argumentuar. Sjellim në vëmendje këtu edhe

rekomandimin e APP me shkresën nr.1797/1 prot., datë 10.03.2022, pika 3, si dhe pikën 8 në rekomandimin e APP nr.7998 prot., datë 24.12.2021.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: znj. M R, znj. R D dhe znj. M Z.

### ***Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Nga KVO është mbajtur procesverbali nr. s'ka, datë 26.06.2023 për hapjen e tenderit, procesverbali nr.s'ka, datë 03.07.2023 për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim. Nëpërmjet SPE, KVO më datë 03.07.2023 i është drejtuar OE të shpallur fitues për dorëzimin e dokumentacionit provues të formularit 8.

Me shkresën nr. s'ka datë 07.07.2023 nga OE shpallur fitues është dorëzuar dokumentacioni pranë Bashkisë Prrrenjas. Gjithashtu nga KVO është mbajtur procesverbali nr. s'ka, datë 07.07.2023 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

*Në këtë tender kanë marrë pjesë 3 OE, përkatësisht:*

1.OE "A 2018" Sh.K.P, me ofertë ekonomike në shumën prej 4,958,750 lekë pa TVSH.

2.OE "G 001" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 5,174,850 lekë pa TVSH.

3.OE "L B" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 5,352,350 lekë pa TVSH.

-Nga OE të mësipërm, janë s'kualifikuar 1 OE/BOE, si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomik	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	OE "L L" shpk	S'kualifikuar për shkak se OE nuk ka dorëzuar mostrat për artikujt, ditën e hapjes së tenderit përpara KVO në magazinën e Bashkisë Prrrenjas, me qëllim verifikimin nëse këto produkte plotësojnë kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Dorëzimi i mostrave do të bëhet ditën e hapjes së procedurës. Mostrat duhet të jenë të mbyllura në një zarf/kuti jo transparente të vulosur dhe së bashku me mostrat, ofertuesi duhet të bejë shoqërimin e mostrave me një shkresë të firmosur nga përfaqësuesi ligjor dhe vulosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti. Mosparaqitja e të gjitha mostrave është kusht për skualifikim. OE nuk plotëson pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta të DST.

-S'kualifikimi i ofertave nga KVO qëndron.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 17.07.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 3 operatorë pjesëmarrës është 1 OE i s'kualifikuar, dhe 2 OE janë kualifikuar. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 17.07.2023 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë OE "A 2018" Sh.P.K, me ofertën ekonomike me vlerë 4,958,750 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 703,100 lekë/12% më pak. Është përzgjedhur e vlefshme, oferta më e ulët ekonomike, në krahasim me ofertat e tjera të vlefshme, të cilat gjatë vlerësimit të ofertave janë klasifikuar si të vlefshme.

### ***Konkluzion***

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht<sup>14</sup>, nga OE A 2018 shpallur fitues, konstatohet se OE plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit.

### **6. Tenderi me objekt: "Blerje dru zjarri për shkollat, kopshtet, çerdhet dhe institucionet e Bashkisë Prrrenjas" me këto të dhëna:**

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:</b> " Blerje dru zjarri për shkollat, kopshtet, çerdhet dhe institucionet e Bashkisë Prrrenjas".
---

<sup>14</sup> Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

<b>1.Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit:</b> REF-81961-10-02-2023 Urdhri nr. 67 prot., datë 29.09.2023	<b>2.Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit:</b> Urdhri nr. 416, datë 19.09.2023 1. L L-Kryetar 2. A R - Anëtar 3. Xh Xh- Anëtar	<b>3. Njësia e Prokurimit:</b> Urdhri nr. 67, datë 29.09.2023. 1.A K-Juriste 2.L L-Ing.Pyjesh 3.Xh Xh-Ing.Pyjesh	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave:</b> Urdhri nr. 430 prot., datë 02.10.2023. 1.M Z - Kryetar 2.S H - Anëtar 3.R D - Anëtar
<b>1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Procedura e Hapur e thjeshtuar-Mall”			
<b>5. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 4.998.000 lekë	<b>6. Oferta fituese, vlera fituese:</b> OE K shpk me vlerë 4.923.030 lekë pa tvsh	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 74,970 lekë pa tvsh	
<b>8. Data e hapjes së tenderit:</b> Data 13.10.2023	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti i Bashkisë Prrrenjas	<b>10. Operatoret Ekonomike</b> a) Kopaçi shpk	
<b>11. Ankimime</b> AK-s’ka APP-s’ka KPP-s’ka	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> S’ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP:</b> S’ka	
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</b>			
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 2995, datë 03.11.2023	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSH)</b> 4.923.030 lekë pa tvsh	<b>16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës. Po</b>	
<b>17.Situacioni Përfundimtar</b> marrja në dorëzim e mallit datë 14.12.2023	<b>18.Afati i kontratës në ditë –</b> 31.12.2023	<b>19. Zgjatja e kontratës me – ditë</b> S’ka	

Sa më sipër u konstatua:

### **Hartimi i fondit limit dhe përcaktimi i kërkesave për lëndë djegëse (dru zjarri).**

-Burimi i financimit është nga buxheti i bashkisë. Preventivi në vlerën 4,998,000 lekë me TVSH<sup>15</sup>,

Me urdhrin nr. nr. 416, me nr.2509 prot., datë 19.09.2023, të kryetarit të Bashkisë Prrrenjas është ngritur komisioni i përlogaritjes së fondit limit, i përbërë nga L L, Kryetar, A R dhe Xh Xh, Anëtarë, të cilët mbi bazën e kërkesave për sasi dru zjarri, nga 30 struktura (shkolla, kopshte, çerdhe, qendra kulturore), si dhe dokumentuar me procesverbalin nr.s’ka datë 14.09.2023 të mbajtur nga znj. A R, Drejtore e Arsimit, Sportit dhe kulturës, pasqyruar në tabelën nr.2, si më poshtë vijon:

Nr	Subjekti	Lënda	Njësia	Sasia	Çmimi/m3	Vlera
1	Shkolla e mesme “Halit Berzeshta”	Dru	m3	50	6,000	300,000
2	Shkolla 9 vjecare “Qybra Sokoli”	Dru	m3	57	6,000	342,000
3	Shkolla 9 vjecare “Zihni Golemi”	Dru	m3	40	6,000	240,000
4	Shkolla 9 vjecare “Rashtan”	Dru	m3	20	6,000	120,000
5	Kopështi Prrrenjas	Dru	m3	40	6,000	240,000
6	Cerdhja Prrrenjas	Dru	m3	40	6,000	240,000
7	Shkolla e mesme “Sali Halili”	Dru	m3	40	6,000	240,000
8	Cikli i ulët Sutaj	Dru	m3	25	6,000	150,000
9	Shkolla 9 vjecare Bardhaj	Dru	m3	15	6,000	90,000
10	Shkolla 9 vjecare Skëndërbe	Dru	m3	15	6,000	90,000
11	Shkolla 9 vjecare Rrajcë Fushë	Dru	m3	40	6,000	240,000
12	Cikli i ulët tek Liqeni	Dru	m3	15	6,000	90,000
13	Shkolla 9 vjecare “Ruhi Alko”	Dru	m3	40	6,000	240,000
14	Shkolla e mesme “Dalip Tocka”	Dru	m3	35	6,000	210,000
15	Cikli i ulët Urakë	Dru	m3	15	6,000	90,000
16	Njësia Administrative Rrajcë	Dru	m3	5	6,000	30,000
17	Shkolla e mesme “Arif Kuka”	Dru	m3	50	6,000	300,000
18	Shkolla e mesme “Q-Shkumbin”	Dru	m3	50	6,000	300,000
19	Shkolla 9 vjecare “Naim Frashri”	Dru	m3	30	6,000	180,000
20	Shkolla 9 vjecare Dritaj	Dru	m3	30	6,000	180,000
21	Shkolla 9 vjecare Bërzeshtë	Dru	m3	25	6,000	150,000
22	Shkolla 9 vjecare Skroskë	Dru	m3	30	6,000	180,000
23	Shkolla 9 vjecare Qukës-Skënderbe	Dru	m3	30	6,000	180,000
24	NJA Qukës	Dru	m3	5	6,000	30,000
25	Shkolla Stranik	Dru	m3	15	6,000	90,000
26	Shkolla 9 vjecare Farret	Dru	m3	10	6,000	60,000
27	Shkolla e mesme Farret	Dru	m3	45	6,000	270,000
28	Shkolla 9 vjecare Sharrë	Dru	m3	8	6,000	48,000

<sup>15</sup> Në zbatim të ligjit 82/2022, për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014 për tatimin në vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar neni 1, pika “q”, furnizimi i artikujve të përfshirë në kreun 4401 të Nomenklaturës së kombinuar të mallrave, me efekt deri më 31.12.2023.

Nr	Subjekti	Lënda	Njësia	Sasia	Çmimi/m3	Vlera
29	Shkolla 9 vjecare Stravaj	Dru	m3	8	6,000	48,000
30	NJA Stravaj	Dru	m3	5	6,000	30,000
	<b>Total pa TVSH</b>			833	6,000	<b>4,998,000</b>
					TVSH	-
	<b>Total</b>					<b>4,998,000</b>

Në preventiv është përcaktuar produkti djegës, dru. Në procesverbalin për dokumentimin e përlllogaritjes së fondit limit, komisioni ka përcaktuar çmimin 6,000 lekë m3 për drutë, transportin si dhe të jenë të prera dhe mos të ketë dru të kalbura.

Sipas procesverbalit të datës 21.09.2023, të mbajtur për efekt të pasqyrimin të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për përlllogaritjen e fondit limit ka përdorur mënyrën e “studimit të tregut”, pasi janë përgatitur specifikimet teknike në lidhje me objektin e prokurimit, ka studiuar ofertat e tregut nga 3 OE të ndryshëm (S Shpk, K Shpk dhe D 2006 Shpk) duke përlllogaritur si fond limit vlerën mesatare të këtyre të fundit e cila rezulton të jetë 4,998,000 lekë.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar plotësisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Konkretisht si më poshtë vijon:

### **Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s’ka, datë 02.10.2023, nga NJP.**

**Në pikën 2.2.1** nga AK kërkohet që operatori ekonomik duhet të paraqes kopje të deklarimit të xhiros vjetore për 3 (tre) vitet financiare (2020, 2021, 2022), ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël 40% e fondit limit të kontratës që po prokurohet – Ndërkohë sipas përcaktimit në shkronjën “c” të pikës 2 në nenin 43 dhe pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së parashikuar të kontratës.

**Në pikën 2.3.1** nga AK kërkohet që OE të ketë kryer furnizime të ngjashme në masën jo më pak se 20% të vlerës së objektit që prokurohet të realizuar gjatë 3 viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës – Ndërkohë sipas sipas përcaktimit në shkronjën ”b” të në pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, vlera e furnizimeve të ngjashme duhet të kërkohet në masën jo më të madhe se 20%.

-Në DST është kërkuar mjet transporti por nuk është përcaktuar kapaciteti mbajtës i tij, me qëllim garantimin e transportit të lëndës djegëse sipas nevojës së institucionit, si dhe disponimin e një shoferi.

-Nuk është përcaktuar që OE shpallur fitues duhet të dorëzojë çertifikatën për të vërtetuar origjinën e lëndës drusore<sup>16</sup>.

-Nuk është përcaktuar grafik lëvrimi i mallit, pra deri në datën kur do të përfundojë zbatimi i kontratës, vëndet ku do të dërgohet lënda djegëse.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “b” të pikës 3 në nenin 15, pikën 1 të nenit 40, shkronjën “c” të pikës 2 në nenin 43 dhe pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

*-Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga, znj. A K, z. L L dhe z. Xh Xh.*

### ***Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Prrenjas me nr. 430 datë 02.10.2023 është ngritur KVO e cili përbëhet nga, znj. M Z, Kryetar, z. S H dhe znj. R D, Anëtar.

<sup>16</sup> Shkronja “a” në pikën 8 në nenin 27 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”.

Në këtë tender ka marrë pjesë 1 OE, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “K” ShPK me ofertë në vlerën 4,923,030 lekë pa TVSH me diferencë nga fondi limit në vlerën 74,970 lekë.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 18.10.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 1 operatorë pjesëmarrës, të s’kualifikuar nuk ka, është kualifikuar 1 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 18.10.2023 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë OE “K” Shpk, me ofertën ekonomike me vlerë 4,998,000 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 74,970 lekë/1.5% më pak.

### **Konkluzion**

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht<sup>17</sup>, nga OE “K” Shpk shpallur fitues, konstatohet se OE plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit.

### **7. Tenderi me objekt: “Blerje karburanti me lote: Loti 1 Blerje Naftë, Loti 2 Blerje Benzine, Loti 3 Blerje Gazi”, me këto të dhëna:**

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje karburanti me lote: Loti 1 Blerje Naftë, Loti 2 Blerje Benzine, Loti 3 Blerje Gazi”.</b>		
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës/lotit (eve) së Prokurimit</b> Urdhri nr. 3, datë 27.01.2023.	<b>2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit:</b> Urdhri nr. 14, datë 18.01.2023 1.E V-Kryetar 2.M K-Anëtar 3.L A-Anëtar	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 3, datë 27.01.2023. 1.Z Ç-Juriste 2.N G-Juriste 3.M K-Ekonom
<b>1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “Procedurë e hapur e thjeshtuar - Mall”.		<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 48 prot., datë 27.01.2023. 1.M R - Kryetar 2.R D - Anëtar 3.M Z - Anëtar
<b>5. Fondi Limit total:</b> (Pa TVSH): 8,183,330 lekë Loti 1 Blerje Naftë: 7,874,998 lekë Loti 2 Blerje Benzine: 249,999 lekë Loti 3 Blerje Gazi: 58,333 lekë	<b>6. Oferta fituese, vlera fituese:</b> Loti 1 Blerje Naftë: OE G C GKG - normë fitimi 15 lekë, vlera 7.874.998 lekë pa tvsh. Loti 2 Blerje Benzine: OE G C GKG- normë fitimi 19 lekë, vlera 249.999 lekë pa tvsh Loti 3 Blerje Gazi: Nuk është paraqitur asnjë ofertë.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)</b> Loti 1 Blerje Naftë: 0 lekë Loti 2 Blerje Benzine: 0 lekë Loti 3 Blerje Gazi: Ska
<b>8. Data e hapjes së tenderit:</b> Data 10.02.2023	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti i Bashkisë.	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender, Loti 1 Blerje Naftë: 2 OE Loti 2 Blerje Benzine: 1 OE Loti 3 Blerje Gazi: Ska b) S’kualifikuar - ska c) Kualifikuar Loti 1 Blerje Naftë: 1 OE Loti 2 Blerje Benzine: 1 OE Loti 3 Blerje Gazi: ska
<b>11. Ankimime</b> AK-s’ka/ka; ka APP-s’ka/ka; KPP-s’ka/ka	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> S’ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP:</b> S’ka
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 644, datë 01.03.2023	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSH)</b> Loti 1 Blerje Naftë: normë fitimi 15 lekë, vlera 7,874,998 lekë pa tvsh Loti 2 Blerje Benzine: normë fitimi 19 lekë, vlera 249.999 lekë pa tvsh Loti 3 Blerje Gazi: Nuk është paraqitur asnjë ofertë	<b>16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës.</b> 6,650,924
<b>17. Situacioni Përfundimtar</b> Urdhri nr. 123, datë 03.03.2023 “Për marrjen në dorëzim të mallit”.	<b>18. Afati i kontratës në ditë</b> - 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.	<b>19. Zgjatja e kontratës me – ditë:</b> Ska

*Sa më sipër u konstatua:*

<sup>17</sup> Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se, nuk është argumentuar plotësisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Konkretisht si më poshtë vijon:

### **Hartimi i fondit limit dhe përcaktimi i kërkesave për karburant.**

Me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr.14, nr.168 prot., datë 18.01.2023 është ngritur komisioni i përllogaritjes së fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike, përcaktimin e nevojave sasiore dhe afatin e lëvrimit me përbërje z. E V, Kryetar, znj. M K dhe z. L A, Anëtar. Procesverbali me nr.s'ka datë 23.01.2023 është përllogaritur fondi limiti në total në vlerën 8,183,330 lekë pa TVSH, e ndarë në lote si më poshtë vijon:

-Loti 1: Gazoil 10 ppm është përllogaritur në vlerën 7,874,998 lekë pa TVSH.

-Loti 2: Benzinë është përllogaritur në vlerën 249,999 lekë pa TVSH.

-Loti 3: Gaz i lëngshëm natyror është përllogaritur në vlerën 58,333 lekë pa TVSH.

Në procesverbalin e mësipërm pasqyrohet informacioni nga komisioni i cili i është referuar vendimit të Bordit të Transparencës në faqen e MFE të datës 17.01.2023 i cili rezulton të jetë për lotin e 1 Gazoil 10 ppm në çmimin 208 lekë/litër me TVSH, për lotin e 2 Benzinë në çmimin 189 lekë/litër me TVSH si dhe për lotin e 3 Gaz i lëngshëm natyror me çmimin 71 lekë/litër me TVSH.

-Sasia totale e nevojshme për konsum për vitin 2023 është bërë sipas kërkesave nga 8 sektorë, përkatësisht: Sektori i MZSH, Sektori i Mirëmbajtjes së Rrugëve, Policia Bashkiake, Sektori i Mbetjeve, Drejtoria e Arsimit, Sektori i Shërbimeve Publike, Bordi i Kullimit dhe Drejtoria e Pyjeve.

-Referuar sa më sipër, çmimi për litër është përllogaritur në vlerën 208 lekë/litër me TVSH, me marzh fitimi 15 lekë/litër dhe sasia 42.376 litra, pra vlera totale 94,500,000 lekë me TVSH për Lotin e parë Blerje Naftë.

Për Lotin e dytë Blerje Benzine, çmimi për litër është përllogaritur në vlerën 189 lekë/litër me TVSH, me marzh fitimi 19 lekë/litër dhe sasia 1.442 litra, pra vlera totale 300,000 lekë me TVSH.

### **Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s'ka, datë 31.01.2023, nga NJP.**

**Pika 2.3.1** - Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore duke filluar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet – Ndërkohë sipas përcaktimit në shkronjën “b” të në pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë **jo më të madhe se 20%** të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për më tepër që edhe në rekomandimin e APP nr. 3872, datë 10.06.2021 (bashkëlidhur procesverbali për argumentimin e kriterëve, sipas procedurës përkatëse) ka një shënim për kriterin e mësipërm: “*Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi*”, pra VKM përcakton kufirin maksimal, nga 0-20%, ndërkohë proceverbali tip, e përcakton qartë, zgjidh një marzh brenda këtij intervali, si p.sh jo më pak se 15% e fondit limit dhe ky marzh duhet argumentuar. Sjellim në vëmendje këtu edhe rekomandimin e APP me shkresën nr.1797/1 prot., datë 10.03.2022, pika 3, si dhe pikën 8 në rekomandimin e APP nr.7998 prot., datë 24.12.2021.

-Në kriteret e mësipërme nuk është vendosur si kriter dorëzimi nga OE pjesmarrës i cili duhet të jetë i pajisur me vërtetim të lëshuar nga ISHTI (Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial), që subjekti ofertues ka importuar ose tregtuar karburante sipas standarteve të legjislationit Shqiptar, dhe nuk ka pasur penalitete për shkelje të cilësisë. - Ky kriter bazohet në nenin 36 dhe nenin 77, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 44, të



VKM-se Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

-Në kriteret për aftësitë teknike nuk është vendosur si kriter dorëzimi nga OE i cili duhet të jetë i pajisur me raport analize nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI) për mallin objekt prokurimi, ku vlerat e treguesve të analizuar të përputhen me vlerat në specifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor. - Ky kriter bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6/c, të nenit 40, të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

-Në kriteret për kapacitetet teknik nuk është vendosur si kriter dorëzimi nga OE i protokoll-matjeve/verifikimi metrologjik për saktësinë e sasisë së hedhjes së karburantit për instrumentat matës (pistoletat e shpërndarjes së karburantit) detyrim ligjor për subjektet që përdorin instrumente matës<sup>18</sup> me qëllim mbrojtjen e interesave të AK në sasinë e karburantit në furnizimin pranë stacionit të shitjes.

-Sa më sipër kriteret e kualifikimit janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 2, 3, 4, gërma “c” në pikën 6 në nenin 40, nenin 44, dhe pikën 2 në nenin 78 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP me përbërje si vijon, znj. Z Ç, znj. N G dhe znj. M K.

### ***Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s’ka, datë 10.02.2023 për hapjen e tenderit, procesverbali nr.s’ka, datë 14.02.2023 për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim. Nëpërmjet SPE, KVO më datë 14.02.2023 i është drejtuar OE të shpallur fitues për dorëzimin e dokumentacionit provues të formularit 8.

Me shkresën nr.s’ka datë 16.02.2023 nga OE shpallur fitues është dorëzuar dokumentacioni pranë Bashkisë Prrenjas. Gjithashtu nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s’ka, datë s’ka për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 27.02.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, kanë marrë pjesë: Loti 1 Blerje Naftë: 2 OE, Loti 2 Blerje Benzine 1 OE, Loti 3 Blerje Gazi nuk është paraqitur asnjë ofertë. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 27.02.2023 ka shpallur fituese: Loti 1 Blerje Naftë: OE G C GKG - normë fitimi 15 lekë, vlera 7.874.998 lekë pa TVSH, Loti 2 Blerje Benzinë: OE G C GKG- me normë fitimi 19 lekë, vlera 249.999 lekë pa TVSH, Loti 3 Blerje Gazi: nuk është paraqitur asnjë ofertë, për të cilën është lidhur kontrata nr.644 prot, datë 01.03.2023 për vlerën: Loti 1 Blerje Naftë: me normë fitimi 15 lekë, vlera 7,874,998 lekë pa TVSH ose 9,450,000 lekë me TVSH, Loti 2 Blerje Benzine: me normë fitimi 19 lekë, vlera 249,999 lekë pa TVSH ose 300,000 lekë me TVSH. Është përzgjedhur e vlefshme, oferta më e ulët ekonomike, në krahasim me ofertat e tjera të vlefshme, të cilat gjatë vlerësimit të ofertave janë klasifikuar si të vlefshme.

### **Konkluzion.**

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht<sup>19</sup>, nga OE G C GKG Shpk shpallur fitues, konstatohet se OE plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit.

*Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1508-1508/13 datë 24.05.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr.*

<sup>18</sup> Neni 19 dhe 20 në Ligjin nr. 126/2020 “Për Metrologjinë”, i ndryshuar, në fuqi për periudhën kur janë hartuar dhe miratuar kriteret e veçanta të kualifikimit.

<sup>19</sup> Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

189/16 datë 29.05.2024 nga Komisioni i Përlllogaritjes së Fondit Limit, znj. G K, znj. R H, z. O A, znj. R D, znj. N G janë shprehur objeksionet për procedurat si më poshtë:  
**Pretendimi i Subjektit:** Lidhur me përlllogaritjen e fondit limit sqarojmë se komisioni i përlllogaritjes e fondit limit ka marrë në konsideratë cmimin e konteniereve në tre subjekte të ndryshme ku është marrë në konsideratë oferta me vlerën më të ulët bahkëlidhur  
**Oëndrimi i Grupit të Auditimit:** Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se, në observacionin e dërguar nga ju, nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve. Nuk vërehen pretendime, prova, fakte apo referenca ligjore të reja, nga ato çka janë përmendur në dokumentat e paraqitura nga Bashkia Prrenjas, gjatë fazës së auditimit në terren. Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

**8. Tenderi me objekt: “Blerje kontenier mbetjesh për zonën shtesë” me këto të dhëna:**

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje kontenier mbetjesh për zonën shtesë”.			
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> REF-.....-02-13-2023 Urdhri nr. 07, datë 07.02.2023	<b>2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit:</b> Urdhri nr. 21, datë 19.01.2023 1.G K-Kryetar 2.R H-Anëtar 3.O A-Anëtar 4.R D-Anëtar 5.N G-Anëtar	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 07, datë 07.02.2023 1.Z Ç - Juriste 2.G K-Ing.Mjedisi 3.R D-Ekonomist	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 69 prot., datë 07.02.2023, ndryshuar me urdhrin nr. 69/1 datë 23.02.2023 1.M Z - Kryetar 2.A B - Anëtar 3.A O - Anëtar
<b>5. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 3,000,000 lekë	<b>6. Oferta fituese, vlera fituese:</b> OE “N.N.Z.K.Sh” shpk me vlerë 2,887,500 lekë pa tvsh.	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 112,500 lekë pa tvsh	
<b>8. Data e hapjes së tenderit:</b> Data 24.02.2023	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti i Bashkisë	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender, 2 OE b) S’kualifikuar S’ka c) Kualifikuar 2 OE	
<b>11. Ankimime</b> AK-s’ka/ka; ka APP-s’ka/ka; KPP-s’ka/ka	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> S’ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP:</b> S’ka	
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave			
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr.859 datë 21.03.2023	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSH)</b> 3.465.000 lekë	<b>16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës. PO</b>	
<b>17. Situacioni Përfundimtar Marrje në dorëzim</b> Urdhër nr. 868 prot, datë 21.03.2023	<b>18. Afati i kontratës në ditë</b> - 1 muaj	<b>19. Zgjatja e kontratës me – ditë</b> S’ka	

*Sa më sipër u konstatua:*

Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua përlllogaritja e fondit limit nuk është argumentuar dhe dokumentuar plotësisht, si dhe në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar plotësisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Konkretisht si më poshtë vijon:

**Preventivi**

-Nga ana e titullarit të AK, me urdhrin nr. 21, datë 19.01.2023 është ngritur grupi i punës “Përlllogaritjen e fondit limit”, i përbërë nga znj. G K, (Kryetar), znj. R H, z. O A, znj. R D dhe znj. N G, (Anëtar).

Sipas procesverbalit të datës 01.02.2023, të mbajtur për efekt të pasqyrimin të veprimtarisë, konstatohet se komisioni përlllogaritjen e fondit limit ka përdorur mënyrën e “studimit të tregut”, pasi janë përgatitur specifikimet teknike në lidhje me objektin e prokurimit, ka studiuar ofertat e tregut nga 3 OE të ndryshëm, përkatësisht: (L 2007 Sh.P.K; S A Sh.P.K dhe R Sh.P.K), duke përlllogaritur si fond limit vlerën mesatare të këtyre të fundit e cila rezultoi të jetë 3,000,000 lekë pa tvsh.

**Nga auditimi i veprimtarisë së komisionit të mësipërm konstatohet se:**

-Nuk administrohen kërkesat/informimi drejtuar subjekteve për dhënien e ofertave, me qëllim dokumentimin e mënyrës së përzgjedhur për përllogaritjen e fondit limit për procedurën e mësipërme.

-Ofertat nga 3 subjektet e mësipërme, nuk janë protokolluar.

-Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 1, shkronjën “ç” në pikën 2 të nenit 2, pikën 1 të nenit 13, pikën 2 në nenin 76 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Urdhri nr.57, datë 12.06.2014 të MFE “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimet me vlerë më të madhe se 400,000 lekë pa TVSH dhe më të vogël se 400,000 lekë pa TVSH.

*Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi, znj. G K, Kryetar, znj. R H, z. O A, R D dhe znj. N G, Anëtar.*

### **Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s’ka, datë 13.02.2023, nga NJP.**

**Pika 2.2.1**, OE ofertues duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të tre viteve të fundit financiare (2019, 2020, 2021), lëshuar nga Administrata Tatimore, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet - Për këtë kërkesë nga NJP është pasqyruar vetëm baza ligjore, pa dhënë argumentimin se si ndikon ky marzh në përmbushjen e kontratës së prokurimit. Gjithashtu përcaktimi në pikën 2.2.1 nuk është në përputhje shkronjën pikën 4 në nenin 55 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Konkretisht sipas referencës ligjore, vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, në procedurat e prokurimit e hapur e thjeshtuar (për kontrata nën kufirin e ulët monetar);

Për më tepër që edhe në shkresën e APP nr. 3872, datë 10.06.2021 (bashkëlidhur procesverbali për argumentimin e kriterëve, sipas procedurës përkatëse) ka një shënim për kriterin e mësipërm: *“Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi”*, pra VKM përcakton kufirin maksimal, nga 0-40%, ndërkohë proceverbali tip, e përcakton qartë, zgjidh një marzh brenda këtij intervali, si p.sh jo më pak se 30% e fondit limit dhe ky marzh duhet argumentuar. Sjellim në vëmendje këtu edhe rekomandimin e APP me shkresën nr.1797/1 prot., datë 10.03.2022, pika 3.

**Pika 2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme të suksesshme, kërkohen dëshmi për shërbime të mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet - Ndërkohë sipas përcaktimit në shkronjën “b” të në pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë **jo më të madhe se 20%** të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për më tepër që edhe në rekomandimin e APP nr. 3872, datë 10.06.2021 (bashkëlidhur procesverbali për argumentimin e kriterëve, sipas procedurës përkatëse) ka një shënim për kriterin e mësipërm: *“Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi”*, pra VKM përcakton kufirin maksimal, nga 0-20%, ndërkohë proceverbali tip, e përcakton qartë, zgjidh një marzh brenda këtij intervali, si p.sh jo më pak se 15% e fondit limit dhe ky marzh duhet argumentuar. Sjellim në vëmendje këtu edhe rekomandimin e APP me shkresën nr.1797/1 prot., datë 10.03.2022, pika 3, si dhe pikën 8 në rekomandimin e APP nr.7998 prot., datë 24.12.2021.

*Për sa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga, znj. Z Ç, znj. G K dhe znj. R D.*

***Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 24.02.2023 për hapjen e tenderit, procesverbali nr.s'ka, datë 01.03.2023 për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim. Nëpërmjet SPE, KVO më datë 04.10.2022 i është drejtuar OE të shpallur fitues për dorëzimin e dokumentacionit provues të formularit 8.

Me shkresën nr. 4901 prot., datë 28.02.2023 nga OE shpallur fitues është dorëzuar dokumentacioni pranë Bashkisë Prrenjas. Gjithashtu nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 03.03.2023 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

*Në këtë tender kanë marrë pjesë 2 OE, përkatësisht:*

1.OE “M.N.Z.K” Sh.K.P, me ofertë ekonomike në shumën prej 2,887,500 lekë pa TVSH.

2.OE “F R” Sh.K.P, me ofertë ekonomike në shumën prej 2,947,500 lekë pa TVSH.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 13.03.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 2 operatorë pjesëmarrës, të s'kualifikuar nuk ka, janë kualifikuar 2 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 13.03.2023, ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë OE N.N.Z.K. Sh shpk, me ofertën ekonomike me vlerë 2,887,500 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 112,500 lekë/4% më pak. Pra është përzgjedhur e vlefshme, oferta më e ulët ekonomike, në krahasim me ofertat e tjera të vlefshme, të cilat gjatë vlerësimit të ofertave janë klasifikuar si të vlefshme.

### **Konkluzion**

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht<sup>20</sup>, nga OE “M.N.Z.K Sh” Shpk shpallur fitues, konstatohet se OE plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit.

*Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1508-1508/13 datë 24.05.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 189/16 datë 29.05.2024 nga Komisioni i Përllogaritjes së Fondit Limit, znj. G K, znj. R H, z. O A, znj. R D, znj. N G janë shprehur objeksionet për procedurat si më poshtë:*

**Pretendimi i Subjektit:** Lidhur me përllogaritjen e fondit limit sqarojmë se komisioni i përllogaritjes e fondit limit ka marrë në konsideratë cmimin e konteniereve në tre subjekte të ndryshme ku është marrë në konsideratë oferta me vlerën më të ulët bahkëlidhur.

**Oëndrimi i Grupit të Auditimit:** Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se, në observacionin e dërguar nga ju, nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve. Nuk vërehen pretendime, prova, fakte apo referenca ligjore të reja, nga ato çka janë përmendur në dokumentat e paraqitura nga Bashkia Prrenjas, gjatë fazës së auditimit në terren. Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

**9. Tenderi me objekt: “Blerje Ushqime për kopshtin dhe çerdhen” viti 2023 me këto të dhëna:**

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Ushqime për kopshtin dhe çerdhen”.</b>			
<b>1.Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit:</b> REF-.....-02-22-2023. Urdhri nr. 1, datë 25.01.2023	<b>2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit</b> Urdhri nr. 629, datë 06.12.2022 1.G B-Kryetar 2.E C-Anëtar 3.B K-Anëtar	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 1, datë 25.01.2023 1.M R-Juriste 2.R D–Ekonomiste 3.N K-Veterinere	<b>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 43 prot., datë 25.01.2023. 1.Z Ç - Kryetar 2.N G - Anëtar 3.E S - Anëtar
<b>1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “E hapur e thjeshtuar-Mall”			
<b>5. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 4,148,895 lekë pa tvsh	<b>6. Oferta fituese, vlera fituese:</b> OE “N” shpk me vlerë 4,097,730 lekë pa tvsh.		<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 51,165 lekë pa tvsh

<sup>20</sup> Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

<b>8.Data e hapjes së tenderit:</b> Data 06.03.2023	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti i Bashkisë	<b>10. Operoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender, 5 OE b) S'kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 3 OE
<b>11. Ankimime</b> AK-s'ka/ka; APP-s'ka/ka; KPP-s'ka/ka	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> S'ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP:</b> S'ka
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 951, datë 29.03.2023	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSH)</b> 4,917,276 lekë	<b>16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës.</b> 3,062,789 lekë
<b>17. Situacioni Përfundimtar</b> Marrje në dorëzim Urdhëri nr. 172, datë 29.03.2023	<b>18. Afati i kontratës në ditë</b> 12 muaj	<b>19. Zgjatja e kontratës me ditë</b> S'ka

*Sa më sipër u konstatua:*

### **Hartimi i fondit limit**

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Prrenjas me nr. 629 datë 06.12.2022 është ngritur Komisioni për llogaritjen e fondit limit i përbërë nga z. G B, Kryetar, znj. E C dhe znj. B K, Anëtar. Sipas procesverbalit të mbajtur për efekt të pasqyrimin të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për përlllogaritjen e fondit limit ka përdorur mënyrën e “studimit të tregut”, pasi janë përgatitur specifikimet teknike në lidhje me objektin e prokurimit, ka studiuar ofertat e tregut nga 3 OE të ndryshëm, OE (F, M-P dhe A B) shpk, duke përlllogaritur si fond limit vlerën mesatare e cila rezultoi të jetë 4,148,895 lekë pa tvsh.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar plotësisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Konkretisht si më poshtë vijon:

### **Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s'ka, datë 22.02.2023, nga NJP.**

**Pika 2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit - Kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me pikën 4 në nenin 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Konkretisht sipas referencës ligjore, përcaktohet se për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për më tepër që edhe në rekomandimin e APP nr. 3872, datë 10.06.2021 (bashkëlidhur procesverbali për argumentimin e kriterëve, sipas procedurës përkatëse) ka një shënim për kriterin e mësipërm: “*Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi*”, pra VKM përcakton kufirin maksimal, nga 0-40%, ndërkohë proceverbali tip, e përcakton qartë, zgjidh një marzh brenda këtij intervali, si p.sh jo më pak se 30% e fondit limit dhe ky marzh duhet argumentuar. Sjellim në vëmendje këtu edhe rekomandimin e APP me shkresën nr.7998 prot., datë 24.12.2021, pika 8, paragrafi 3.

*-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: znj. M R, znj. R D dhe znj. N K.*

### **Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.**

Me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë me nr. 43, nr.258 prot., datë 25.01.2023, është ngritur “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, i përbërë nga znj. Z Ç, Kryetar, znj. N G dhe znj. E S, Anëtarë. Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 5 OE, për të cilët, referuar

procesverbalit të datës 09.03.2023, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

*Në këtë tender kanë marrë pjesë 5 OE, përkatësisht:*

- 1.OE “N” Sh.K.P, me ofertë ekonomike në shumën prej 4,097,730 lekë pa TVSH.
- 2.OE “M.C.C” Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 4,113,495 lekë pa TVSH.
- 3.OE “GEA” Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 4,126,960 lekë pa TVSH.
- 4.OE “E B” Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 4,144,845 lekë pa TVSH.
- 4.OE “M–P” Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 4,148,455 lekë pa TVSH.

-Nga BOE dhe OE të mësipërm, janë s’kualifikuar 2 OE/BOE, si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Kualifikuar/S’kualifikuar																								
1	M.C.C Shpk	S’kualifikuar; Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se: -Nuk plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim. Në preventivin e dorëzuar mungon njësia matëse e secilit artikull, duke bërë të pamundur vlerësimin e ofertës së paraqitur me mangësi në formular.																								
2	E B Shpk	S’kualifikuar; Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se: -Nuk plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim. Konkretisht OE Enxhi Balla shpk, në formularin e ofertës dhe lista e cmimeve sipas shtojcës 1 dhe 2, nga verifikimi i formularit të ofertës rezultoi se është ndryshuar sasia e disa prej zërave të preventivit.  <i>Sipas preventivit të OE është:</i> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Artikulli</th> <th>Pershkrimi i mallit</th> <th>Njësia</th> <th>Sasia</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>30</td> <td>Zarzavate (spinaq,brokoli)</td> <td>Kg</td> <td>688</td> </tr> <tr> <td>31</td> <td>Banane</td> <td>Kg</td> <td>780</td> </tr> </tbody> </table> <i>Sipas preventivit të AK është kërkuar:</i> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Artikulli</th> <th>Pershkrimi i mallit</th> <th>Njësia</th> <th>Sasia</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>30</td> <td>Zarzavate (spinaq,brokoli)</td> <td>Kg</td> <td>728</td> </tr> <tr> <td>31</td> <td>Banane</td> <td>Kg</td> <td>688</td> </tr> </tbody> </table>	Artikulli	Pershkrimi i mallit	Njësia	Sasia	30	Zarzavate (spinaq,brokoli)	Kg	688	31	Banane	Kg	780	Artikulli	Pershkrimi i mallit	Njësia	Sasia	30	Zarzavate (spinaq,brokoli)	Kg	728	31	Banane	Kg	688
Artikulli	Pershkrimi i mallit	Njësia	Sasia																							
30	Zarzavate (spinaq,brokoli)	Kg	688																							
31	Banane	Kg	780																							
Artikulli	Pershkrimi i mallit	Njësia	Sasia																							
30	Zarzavate (spinaq,brokoli)	Kg	728																							
31	Banane	Kg	688																							

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbljedhës më datë 24.03.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbljedhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 5 operatorë pjesëmarrës janë s’kualifikuar 2 OE, janë kualifikuar 3 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbljedhës, Titullari i AK më datë 24.03.2023 ka shpallur fituese OE “N” SHPK, me ofertën ekonomike me vlerë 4,097,730 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 51,165 lekë/1% më pak. Pra është përzgjedhur e vlefshme, oferta më e ulët ekonomike, në krahasim me ofertat e tjera të vlefshme, të cilat gjatë vlerësimit të ofertave janë klasifikuar si të vlefshme.

### **Konkluzion:**

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht<sup>21</sup>, nga OE “N” Shpk shpallur fitues, konstatohet se OE plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit.

10.Tenderi me objekt: **“Rikonstruksion i kanalit kryesor përroi i Lingajcës nga rruga e fushës deri tek lagjia Hallidri, fshati Rrajcë, Njësia Administrative Rrajcë, Bashkia Prrenjas”**, me këto të dhëna:

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:</b> “Rikonstruksion i kanalit kryesor përroi i Lingajcës nga rruga e fushës deri tek lagjia Hallidri, fshati Rrajcë, Njësia Administrative Rrajcë, Bashkia Prrenjas”.			
<b>1.Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> REF-.....-06-29-2023 Urdhri nr.52 prot., datë 22.06.2023	<b>2.Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit</b> Urdhri nr. 287, datë 20.06.2023 1.M P - Kryetar	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. nr.52 prot., datë 22.06.2023 1.Z Ç- Juriste 2.M P – Ing. Topograf 3.R D-Ekonomist	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 300 prot., datë 29.06.2023 1.M R - Kryetar 2.M V- Anëtar

<sup>21</sup> Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

<b>1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur - Punë”	2.R B- Anëtar 3.H K-Anëtar	4.R B–Ing. Miniere 5.A K - Juriste	3.M H - Anëtar
<b>5. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 8,333,596 lekë	<b>6. Oferta fituese, vlera fituese:</b> OE “B N.” Shpk me vlerë 6,236,631 lekë pa tvsh.		<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 2,096,965 lekë pa tvsh
<b>8. Data e hapjes së tenderit:</b> Data 11.07.2023	<b>9. Burimi Financimit</b> Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombetare e Mbrojtjes Civile		<b>10. Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender, <b>12 OE</b> b) S’kualifikuar <b>4 B/OE</b> , c) Kualifikuar <b>8 B/OE</b>
<b>11. Ankimime</b> AK-s’ka APP-s’ka KPP-s’ka	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> S’ka		<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP:</b> S’ka
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</b>			
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr.2347 prot., datë 04.09.2023	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSH)</b> 7,483,957 lekë		<b>16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës.</b> 7,109,705 lekë
<b>17. Situacioni Përfundimtar:</b> Po	<b>18. Afati i kontratës në ditë</b> 3 muaj		<b>19. Zgjatja e kontratës me ditë:</b> S’ka

*Sa më sipër u konstatua:*

Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar plotësisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

**Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s’ka, datë 29.06.2023, nga NJP.**

**Pika 2.3.3** AK ka kërkuar që OE duhet të ketë një punësim mesatar prej të paktën 22 (njëzet e dy) punonjës të siguruar, për periudhën e fundit e deklaruar nga data e hapjes së ofertave – Në kërkesën e mësipërme nuk përcaktohet lloji i formimit profesional për punonjësit e kërkuar, pasi OE mund të ketë 22 të punësuar me formimin profesional teknik hidraulik, karpentier, ndërkohë këta punonjës nuk duhen për zbatimin e kontratës përkatëse, ç’ka e bën një kriter jo konkret dhe jo në përputhje me qëllimin që kërkohet “*Kapacitetet teknike dhe profesionale për të realizuar projektin*”.

-Për numrin e mësipërm të punonjësve, në procesverbalin e hartimit dhe argumentimit të kriterëve, nuk pasqyrohet analiza teknike, e cila shërben për vlerësimin e numrit minimal të punonjësve. Për më tepër që në kërkesën **2.3.4** është përcaktuar përsëri numri i punonjësve dhe formimi profesional që kërkohet për zbatimin e kontratës. Në pikën 2.3.4 kërkohen gjithësej 5 punonjës dhe në këto kushte kur është përcaktuar numri dhe profesioni për zbatimin e kontratës, atëherë s’ka arsye të kërkohen edhe 17 punonjës të tjerë.

**Pika 2.3.4.** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf të kualifikuar, i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave, minimalisht:

- 1 (një) Inxhinier topograf për shfaqet e nevojshme për kryerjen e punimeve të rlevimeve topografike dhe punime topogjeodezike, për kryerjen e punimeve topografike për nxjerrjen e kuotave të punimeve të germimit etj.
- 1 (një) Teknik ndërtimi, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”;
- 1 (një) Manovratorë, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme, dëshmitë e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga DPSHTRR;
- 2 (dy) Shofer për përdorimin e kamionit dhe kamiocinën.

**Pika 2.3.5** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Eskavator me goma	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Kamion	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Kamiocinë	copë	1	Në pronësi ose me qera

Në procesverbalin përkatës nuk argumentohet numri dhe lloji i mjeteve që kërkohet, në përputhje me punën që do të kryejnë, volumin dhe grafikun e punimeve.

*Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP me përbërje si vijon: znj. Z Ç, znj. M P, znj. R D, z. R B dhe znj. A K.*

### ***Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 11.07.2023 për hapjen e tenderit, procesverbali nr.s'ka, datë 01.08.2023 për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim. Nëpërmjet kërkesës në SPE, datë 01.08.2023, KVO i është drejtuar OE B N Shpk për dorëzimin e dokumentacionit. Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 03.08.2023 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

*Në këtë tender kanë marrë pjesë 12 OE, përkatësisht:*

- 1.OE "N" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 6,074,760 lekë pa TVSH.
- 2.OE "B N" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 6,236,631 lekë pa TVSH.
- 3.OE "B" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 6,739,090 lekë pa TVSH.
- 4.OE "I.C.C G" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 6,734,300 lekë pa TVSH.
- 5.OE "O" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 6,748,880 lekë pa TVSH.
- 6.OE "A – 2A C" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 6,799,950 lekë pa TVSH.
- 7.OE "A I" & "K" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 7,085,960 lekë pa TVSH.
- 8.OE "K B" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 7,517,900 lekë pa TVSH.
- 9.OE "2Z K" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 7,554,660 lekë pa TVSH.
- 10.OE "I" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 7,571,320 lekë pa TVSH.
- 11.OE "A" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 7,827,050 lekë pa TVSH.
- 12.OE "R G - K" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 8,098,600 lekë pa TVSH.

**-Nga BOE dhe OE të mësipërm, janë s'kualifikuar 4 OE/BOE, si më poshtë:**

OE/BOE	Arsye e s'kualifikimit
1.OE "N" shpk	<b>S'kualifikuar;</b> 1.Me formularin përmbledhës të vetedeklarimit Operatori Ekonomik ka deklaruar se ka paguar të gjitha detyrimet për taksat, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i ka kërkuar informacion Drejtorisë se të Ardhurave dhe Licencave Bashkia Prenjas nëse OE "N" shpk i ka shlyer detyrimet e taksave dhe tarifave vendore . Nga verifikimi i listës së debitorëve në Bashkinë Prenjas, rezultoi se Operatori ekonomik nuk ka shlyer taksat dhe tarifat vendore për punimet e realizuara në Bashkinë Prenjas. OE "N" shpk ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së ku ndër të tjera thuhet shprehimisht se: 2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, 2.Për punonjesin T.K nga një verifikim i kryer në sistemin e tatimeve kodi i deklaruar tek listpagesa nuk është për pozicionin "shofer", por për pozicionin "punëtor krahu".
2.OE "K B" Shpk	<b>S'kualifikuar;</b> -Operatori ekonomik "K B" shpk nuk ka arritur të përmbushë kriterin e kërkuar sipas pikës 2.3.1 Kapaciteti Teknik. Konkretisht ka paraqitur kontratë për punë të ngjashme me Ministrinë e Industrisë dhe Energjisë nga ku rezultoi se kontrata e hedhur në SPE nuk është origjinale, mungon Akti i kolaudimit të punimeve dhe Certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve.
3.OE "2z K" Shpk	<b>S'kualifikuar;</b> -Operatori ekonomik "2Z K" shpk nuk ka arritur të përmbushë kriterin e kërkuar sipas pikës 1 KRITERET E PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT -Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetedeklarimi sipas shtojcës 8 duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës. -Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.



	Në pikën B të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit operatori ekonomik ka deklaruar se do të mbështetet në kapacitetet e subjektit “V H” Person fizik me nr.Nipt L.....L për kapacitetin “Shofer” dhe në kapacitetet e subjektit “K H” Person fizik me nr.Nipt L.....O për kapacitetin “Automakinist/Manovrator”. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se asnjë nga subjektet e mësipërme nuk ka paraqitur formularin përkatës.										
4. BOE “A I” Shpk dhe “K” Shpk	<p><b>S’kualifikuar;</b> Në pikën 2.3.5 të KRITEREVE TË VECANTA TË KUALIFIKIMIT është kërkuar: - Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nr</th> <th>Emri i mjetit</th> <th>Njesi</th> <th>Sasi</th> <th>Statusi</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Eskavator me goma</td> <td>Copë</td> <td>1</td> <td>Në pronësi ose me qera</td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga verifikimi i formulareve të vetëdeklarimit të paraqitur nga operatorët ekonomike rezulton se asnjë prej anetareve të bashkimit nuk ka deklaruar se disponon mjetin Eskavator me goma.</p>	Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi	1	Eskavator me goma	Copë	1	Në pronësi ose me qera
Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi							
1	Eskavator me goma	Copë	1	Në pronësi ose me qera							

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 29.08.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit.

-Në kushtet e mësipërme është përzgjedhur fitues OE Bajrami N Sh.P.K, me ofertën ekonomike me vlerë 6,236,631 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 2,096,965 lekë/25% më pak. Pra është përzgjedhur e vlefshme, oferta më e ulët ekonomike, në krahasim me ofertat e tjera të vlefshme, të cilat gjatë vlerësimit të ofertave janë klasifikuar si të vlefshme.

-S’kualifikimi i ofertave nga KVO qëndron.

### **Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht<sup>22</sup>, nga OE shpallur fitues, konstatohet se:**

-Nuk është plotësuar pika **2.3 e DST**, dorëzimi i vërtetimit për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për aktivitetet e kryera në Bashkinë Vorë dhe Bashkinë Librazhd përgjatë periudhës 2022-2023.

### **Konkluzion.**

OE “B N” Shpk, nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte në zbatim të nenit 98 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, KVO duhet të kishte vazhduar me OE e radhës ose anuluar procedurën e prokurimit.

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje si vijon, znj. M R, Kryetar, znj. M V dhe znj. M H, Anëtar.

*Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1508-1508/13 datë 24.05.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 189/16 datë 29.05.2024 nga KVO, znj. M R, z. A O dhe znj. M H janë shprehur objeksionet për procedurat si më poshtë:*

**Pretendimi i Subjektit:** Sqarojmë se në lidhje me sa më sipër, KVO bashkëngjitur ju dërgojmë dokumentacionin si vijon:

1. Vërtetim për pagesën e taksave dhe tarifave vendore Bashkia Elbasan dhe Bashkia Tiranë.

Për sa më sipër kërkojmë marrje në konsideratë të observimeve.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Për sa trajtuar më sipër observacioni juaj në lidhje me vërtetimet për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan dhe Bashkinë Tiranë merret në konsideratë, si dhe do reflektohen në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

### **11. Tenderi me objekt: “Rikonstruksion i palestrës së shkollës 9-vjeçare Qybra Sokoli qyteti Prrenjas”, me këto të dhëna:**

**a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i palestrës së shkollës 9-vjeçare Qybra Sokoli qyteti Prrenjas”.**

<sup>22</sup> Për përbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

<b>1.Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> REF-.....-03-29-2023 Urdhri nr. 25 prot., datë 23.03.2023	<b>2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit</b> Urdhri nr. 20, datë 19.01.2023 1.M P - Kryetar 2.B K-Anëtar 3.H K-Anëtar	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 25, datë 23.03.2023 1.A K – Juriste 2.M P - Inxhinier 3.R D -Ekonom	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 154 prot., datë 23.03.2023.  1.M R - Kryetar 2.A O - Anëtar 3.M H- Anëtar
<b>1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur e thjeshtuar”			
<b>5. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 8,651,922.8 lekë	<b>6. Oferta fituese, vlera fituese:</b> OE I Shpk me vlerë 7,283,716 lekë pa tvsh.		<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 1,368,206 lekë pa tvsh
<b>8.Data e hapjes së tenderit:</b> Data 11.04.2023	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti i Bashkisë.		<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender, 8 OE b) S’kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 6 OE
<b>11. Ankimime</b> AK-s’ka APP-s’ka KPP-s’ka	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> S’ka		<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP:</b> S’ka
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</b>			
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 1598, datë 13.06.2023	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSH)</b> 8,740,459 lekë		<b>16.Likuiduar plotësisht sipas kontratës:</b> Jo
<b>17.Situacioni Përfundimtar</b>	<b>18.Afati i kontratës në ditë</b> 2 muaj		<b>19. Zgjatja e kontratës me – ditë:</b> ska

*Sa më sipër u konstatua:*

Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar plotësisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

**Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s’ka, datë 28.03.2023, nga NJP, i ndryshuar.**

**Pika 2.3.2** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë, **drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

1. Inxhinier ndërtimi 1 (një) (Drejtues teknik)

Gjithashtu ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin mbështetës të përbërë nga :

- 2. Arkitekt 1 (një)**
- 3.Elektriçist 1 (një)
- 4.Hidroteknik 1 (një)
- 5.Automakinist 1 (një) (Është i domosdoshëm për përdorimin e makinerisë: vinçin).
6. Shoferë 2 (dy) (Për përdorimin e kamionit dhe kamioçinës)

Ekspertiza profesionale e Arkitektit është ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit, relacioneve teknike. Në lidhje me kërkesën për Arkitekt duke marrë shkas nga tipologjia e punimeve konkrete që do të realizohen (të përfshira në preventivin e punimeve), nuk është parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme ekspertiza profesionale e arkitektit. Ky kriter nuk është i domosdoshëm për zbatimin e kontratës, për sa kohë që në preventiv nuk ka zëra punimesh që mbulohen nga arkitekti. Vendosja e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

**Pika 2.3.3.** AK ka kërkuar që OE duhet të ketë fuqi puntore një punësim minimalisht prej të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës të siguruar, për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave – Në kërkesën e mësipërme nuk përcaktohet lloji i formimit profesional për punonjësit e kërkuar, pasi OE mund të ketë 15 të punësuar me formimin profesional teknik bojaxhi, karpentier, ndërkohë këta punonjës nuk duhen për zbatimin e kontratës përkatëse, ç’ka e bën një kriter jo konkret dhe jo në përputhje me qëllimin që kërkohet “*Kapacitetet teknike dhe profesionale për të realizuar projektin*”.

-Për numrin e mësipërm të punonjësve, në procesverbalin e hartimit dhe argumentimit të kriterëve, nuk pasqyrohet analiza teknike, e cila shërben për vlerësimin e numrit minimal të punonjësve. Për më tepër që në kërkesën **2.3.2** është përcaktuar përsëri numri i punonjësve dhe formimi profesional që kërkohet për zbatimin e kontratës. Në pikën 2.3.2 kërkohen gjithësej 7 punonjës dhe në këto kushte kur është përcaktuar numri dhe profesioni për zbatimin e kontratës, atëherë s'ka arsye të kërkohen edhe 8 punonjës të tjerë.

**Pika 2.3.4.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i mjetit/pajisjes teknike	Statusi	Njësia	Sasia
1	Kamion	Në pronësi ose me qira	Copë	1
2	Kamionçinë	Në pronësi ose me qira	Copë	1
3	Vinç Kullë	Në pronësi ose me qira	Copë	1
4	Skela	Në pronësi ose me qira	M2	200

Në procesverbalin përkatës nuk argumentohet numri dhe lloji i mjeteve që kërkohet, në përputhje me punën që do të kryejnë, volumin dhe grafikun e punimeve.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: znj. A K, znj. M P dhe znj. R D.

#### ***Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Prrenjas me nr. 154, nr.880 prot., datë 23.03.2023 është ngritur KVO i cili përbëhet nga znj. M R (Kryetar), z. A O dhe znj. M H (Anëtar). Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 11.04.2023 për hapjen e tenderit, procesverbali nr.s'ka, datë 20.04.2023 për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim. Nëpërmjet kërkesës në SPE, datë 28.04.2023, KVO i është drejtuar OE I Shpk për dorëzimin e dokumentacionit. Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë s'ka për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

*Në këtë tender kanë marrë pjesë 8 OE, përkatësisht:*

- 1.OE "Z" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 6,778,705 lekë pa TVSH.
- 2.OE "I" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 7,283,716 lekë pa TVSH.
- 3.BOE "O" & "Sh A" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 7,525,978 lekë pa TVSH.
- 4.OE "V K" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 7,588,807 lekë pa TVSH.
- 5.OE "S" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 7,864,171 lekë pa TVSH.
- 6.OE "Delia Impex" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 7,987,797 lekë pa TVSH.
- 7.OE "A-2<sup>a</sup> C" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 8,078,034 lekë pa TVSH.
- 8.OE "M" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 8,437,854 lekë pa TVSH.

-Nga BOE dhe OE të mësipërm, janë s'kualifikuar 2 OE/BOE, si më poshtë:

OE/BOE	Arsye e s'kualifikimit
1.OE "Z" shpk	Skualifikuar Operatori ekonomik "Z" shpk L.....O Arsyet e mëposhtme : Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar sipas pikës 2.1 të Kriterëve të veçanta të kualifikimit përkatësisht për punonjësin me profesion Automaknist dhe punonjësin me profesion Shofer nuk i ka të përfshirë në listepagesat e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar.
2.OE "D I" shpk	S'kualifikuar Operatori ekonomik "D I" shpk K.....R Arsyet e mëposhtme : -Operatori ekonomik nuk ka arritur të përmbushë pikën 2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit "Kapaciteti teknik "ku shprehimisht thuhet: Operatori ekonomik pjesmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë personelin si më poshtë : Hidroteknik (një) Për sa më sipër OE "D I" shpk nuk ka arritur të paraqesë 1 punonjës hidroteknik

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 29.05.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit.

-Në kushtet e mësipërme është përzgjedhur fitues OE "I" Sh.P.K, me ofertën ekonomike me vlerë 7,283,716 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 1,368,206 lekë/16%

më pak. Pra është përzgjedhur e vlefshme, oferta më e ulët ekonomike, në krahasim me ofertat e tjera të vlefshme, të cilat gjatë vlerësimit të ofertave janë klasifikuar si të vlefshme.  
-S'kualifikimi i ofertave nga KVO qëndron.

**Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht<sup>23</sup>, nga OE shpallur fitues, konstatohet se:**

-Nga OE I Shpk nuk është dorëzuar vërtetimi për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për vendet ku OE ka ushtruar veprimtari, konkretisht në territorin në Bashkisë Prrenjas, Maliq, Vlorë, Shijak, Dropull, për vitin 2022-2023  
Nuk plotësohet pika 2.3.2 OE I nuk ka dorëzuar dokumentacion për puntorin me profesion Hidroteknik.

**Konkluzion.**

OE "I" Shpk, nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte në zbatim të nenit 98 të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", KVO duhet të kishte vazhduar me OE e rradhës ose anuluar procedurën e prokurimit.

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje si vijon, znj. M R, Kryetar, z. A O dhe znj. M H, Anëtar.

*Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1508-1508/13 datë 24.05.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 189/16 datë 29.05.2024 nga KVO, znj. M R, z. A O dhe znj. M H, znj. A K, znj. M P dhe znj R D janë shprehur objeksionet për procedurat si më poshtë:*

**Pretendimi i Subjektit:** Sqarojmë se në lidhje me sa më sipër, KVO bashkëngjitur ju dërgojmë dokumentacionin si vijon:

1. Certifikate për transport mallrash për të tretë për mjetin AA...EL.
2. Certifikata e aftësisë profesionale për punonjës të K Z.
3. Dokumentacion për punonjës të M Sh (Hidroteknik). Përsa më sipër kërkojmë marrje në konsideratë të observimeve.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Për sa trajtuar më sipër observacioni juaj lidhur me këtë pikë merret pjesërisht në konsideratë, si dhe do reflektohet në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**12. Tenderi me objekt: "Rikonstrukcion i rrugëve të brendshme Bashkia Prrenjas 18.04.2023", me këto të dhëna:**

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstrukcion i rrugëve të brendshme Bashkia Prrenjas"</b>			
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> REF-.....-04-04-2023 Urdhri nr. 33 prot., datë 03.04.2023	<b>2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit</b> Urdhri nr. 179, datë 31.03.2023	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 33, datë 03.04.2023  1. Z Ç - Juriste 2. M P - Ing. Topograf 3. R D - Ekonomist	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 182 prot., datë 03.04.2023.  1. M R - Kryetar 2. A K - Anëtar 3. M H - Anëtar
<b>1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> "Kërkesë për Propozim"	1. M P - Kryetar 2. D C - Anëtar 3. E B - Anëtar		
<b>5. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 2,097,261 lekë	<b>6. Oferta fituese, vlera fituese:</b> OE "ZZ K" shpk me vlerë 2,087,200 lekë pa tvsh.		<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 10,061 lekë pa tvsh
<b>8. Data e hapjes së tenderit:</b> Data 18.04.2023	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti i Bashkisë.		<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender, <b>1 OE</b> b) S'kualifikuar <b>0 B/OE</b> , c) Kualifikuar <b>1 OE</b>
<b>11. Ankimime</b> AK-s'ka APP-s'ka KPP-s'ka	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> S'ka		<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP:</b> S'ka
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</b>			
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 1247, datë 02.05.2023	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSH)</b> 2,504,640 lekë		<b>16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës:</b> 2,379,328 lekë

<sup>23</sup> Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

17.Situacioni Përfundimtar	18.Afati i kontratës në ditë 40 ditë	19. Zgjatja e kontratës me ditë
----------------------------	---	---------------------------------

*Sa më sipër u konstatua:*

Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar plotësisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

**Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s'ka, datë 04.04.2023, nga NJP.**

**Pika 2.3.3** AK ka kërkuar që OE duhet të ketë një punësim mesatar prej të paktën 9 (nëntë) punonjës të siguruar, për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave – Në kërkesën e mësipërme nuk përcaktohet lloji i formimit profesional për punonjësit e kërkuar, pasi OE mund të ketë 9 të punësuar me formimin profesional hidraulik, karpentier, ndërkohë këta punonjës nuk duhen për zbatimin e kontratës përkatëse, ç'ka e bën një kriter jo konkret dhe jo në përputhje me qëllimin që kërkohet “*Kapacitetet teknike dhe profesionale për të realizuar projektin*”.

-Për numrin e mësipërm të punonjësve, në procesverbalin e hartimit dhe argumentimit të kriterëve, nuk pasqyrohet analiza teknike, e cila shërben për vlerësimin e numrit minimal të punonjësve. Për më tepër që në kërkesën **2.3.4** është përcaktuar përsëri numri i punonjësve dhe formimi profesional që kërkohet për zbatimin e kontratës. Në pikën 2.3.4 kërkohen gjithësej 3 punonjës dhe në këto kushte kur është përcaktuar numri dhe profesioni për zbatimin e kontratës, atëherë s'ka arsye të kërkohen edhe 6 punonjës të tjerë.

**Pika 2.3.4.** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf të kualifikuar, i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave, minimalisht:

- 1 (një) teknik ndërtimi, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”;
- 2 (dy) manovratorë, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme, dëshmitë e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga DPSHTRR;

**Pika 2.3.5.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Eskavator me goma	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Kamion	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Kamioncin	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Rrul	copë	1	Në pronësi ose me qera

Në procesverbalin përkatës nuk argumentohet numri dhe lloji i mjeteve që kërkohet, në përputhje me punën që do të kryejnë, volumin dhe grafikun e punimeve.

Veç sa më sipër janë kërkuar 2 mjete, por në asnjë rast nuk është kërkuar edhe disponimi i shoferëve. Mungesa e shoferëve sjellë pamundësinë e përdorimit të mjeteve dhe realizimin e punimeve.

*-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: znj. Z Ç, znj. M P dhe znj. R D.*

***Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 18.04.2023 për hapjen e tenderit, procesverbali nr.s'ka, datë 19.04.2023 për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim. Nëpërmjet kërkesës në SPE, datë 19.04.2023, KVO i është drejtuar OE 2Z K Shpk për dorëzimin e

dokumentacionit. Me shkresën nr.s'ka datë 24.04.2023 nga OE 2Z K Shpk është dorëzuar dokumentacioni pranë Bashkisë Prrenjas. Gjithashtu nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 24.04.2023 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

*Në këtë tender ka marrë pjesë 1 OE/BOE, përkatësisht:*

OE "2Z K" Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 2,087,200 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 10,061 lekë/0.5% më pak.

### **Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht<sup>24</sup>, nga OE shpallur fitues, konstatohet se:**

-Nuk është plotësuar pika **2.2 e DST**, dorëzimi i vërtetimit për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për aktivitetet e kryera në Bashkinë Tiranë, Lezhë dhe Bashkia Librazhd përgjatë periudhës 2022-2023.

-Sa i përket mjeteve të transportit/ndërtimit, të deklaruar në shtojcën 8, si dhe për vërtetimin e disponimit të tyre ka dorëzuar dokumentacionin fizik, ku një pjesë e zotëron nëpërmjet qiramarrjes dhe një pjesë të tyre e ka në pronësi, konstatohet se OE nuk plotëson pikën 2.3.4 për:

-Kamionin me targë AA...DJ, nëpërmjet kontratës së qirasë Nr.Rep:317, Nr.Kol:114 me subjektin "V H", por ky subjekt nuk disponon certifikatë për transport mallrash për dhënie me qira të mjeteve për të tretë.

-Nuk plotësohet pika 2.3.4, për disponimin e 2 manovratorëve. Nga OE 2Z K janë dorëzuar dokumentet për 1 manovrator, konkretisht z. M Q dhe nga verifikimi i dokumentacionit dhe listëpagesave konstatohet se manovratori M Q nuk figuron në listëpagesën e shoqërisë për muajin e fundit.

### **Konkluzion.**

OE "2Z K" Shpk, nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte në zbatim të nenit 98 të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", KVO duhet të kishte vazhduar me OE e radhës ose anuluar procedurën e prokurimit.

*-Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje si vijon, znj. M R, Kryetar, znj. A K dhe znj. M H, Anëtar.*

*Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1508-1508/13 datë 24.05.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 189/16 datë 29.05.2024 nga KVO, znj. M R, znj. A K dhe znj. M H janë shprehur objeksionet për procedurat si më poshtë:*

**Pretendimi i Subjektit:** *Sqarojmë se në lidhje me sa më sipër, KVO bashkëngjitur ju dërgojmë dokumentacionin si vijon:*

*1.Vërtetim për pagim të taksave Bashkia Rroskovec.*

*2.Dokumentacion për punonjës të K H Manovrator*

*Përsa më sipër kërkojmë marrje në konsideratë të observimeve.*

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** *Për sa trajtuar më sipër observacioni juaj lidhur me këtë pikë merret pjesërisht në konsideratë, si dhe do reflektohet në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

### **13. Tenderi me objekt: "Transporti i mbetjeve urbane nga Qyteti Prrenjas në incenerator Elbasan", me këto të dhëna:**

**a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Transporti i mbetjeve të grumbulluara (urbane) për në Incenerator Elbasan".**

<sup>24</sup> Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

<b>1.Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> REF-.....02-20-2023 Urdhri nr. 15 prot., datë 15.02.2023 <b>1.1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur e thjeshtuar”	<b>2. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit:</b> Urdhri nr. 16, datë 19.01.2023 1.G K - Kryetar 2.R H - Anëtar 3.O A - Anëtar 4.M V - Anëtar 5.N G - Anëtar	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 15, datë 15.02.2023 1.Z Ç - Juriste 2.G K –Ing.Mjedisi 3.R D-Ekonomiste	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave:</b> Urdhri nr. 85 prot., datë 15.02.2023 i ndryshuar me urdhër nr.136 datë 13.03.2023 1.M R - Kryetar 2.M P - Anëtar 3.A K - Anëtar
<b>5. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 8,332,847 lekë	<b>6. Oferta fituese, vlera fituese:</b> OE “P S” shpk me vlerë 7,738,000 lekë pa tvsh.		<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 594,847 lekë pa tvsh
<b>8. Data e hapjes së tenderit:</b> Data 03.03.2023	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti i Bashkisë		<b>10. Operoret Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender, 2 OE b) S’kualifikuar S’ka, c) Kualifikuar 2 OE
<b>11. Ankimime</b> AK-(Pastrime Silvio shpk) <b>Nr.888 prot datë 24.03.2023</b> APP–s’ka/ KPP-(Pastrime Silvio shpk) 23.03.2023	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> Vendimi nr.928 prot., datë 28.03.2023		<b>13. Përgjigje Ankesës nga apo KKP:</b> Vendimi nr.338/2023 datë 03.05.2023
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</b>			
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 1772 prot., datë 30.06.2023	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSH)</b> 9,285,600 lekë		<b>16. Likuiduar:</b> 3,515,535 lekë
<b>17.Situacioni Përfundimtar</b> JO	<b>18.Afati i kontratës në ditë</b> 12 muaj		<b>19. Zgjatja e kontratës me ditë:</b> s’ka

*Sa më sipër u konstatua:*

Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar plotësisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Konkretisht si më poshtë vijon:

**Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.s’ka, datë 20.02.2023, nga NJP.**

**Pika 2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme të suksesshme, kërkohen dëshmi për shërbime të mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet – Ky kriter është hartuar i gabuar dhe është në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikën 3 të nenit 41 në VKM nr. 285, datë 19.05.2021” Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku thuhet: “*Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit*” nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

**Pika 2.3.2.** Një punësim mesatar i të paktën 2 (dy) punonjës për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit e vertetuar kjo me:

-Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

-Listë pagesat e punonjësve të plotësuar rregullisht sipas formatit të përcaktimeve që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

-Kriteri i mësipërm nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht se çfarë profesioni duhet të jenë dy punonjësit e kërkuar.

**Pika 2.3.3.** Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me Licence të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit për transportin e mbetjeve jo të rrezikshme (kodi III.2.B).

**Pika 2.3.4.** Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës së shërbimit:

-Makinë teknologjike transportuese me ngarkim fundor ose anësor me kapacitet mbajtës 10 ton, raport kompaktimi 1:4-1:6 2 copë (*mjeti duhet të jetë të paktën i standard Euro 4*)

-Eskavator me zinxhir 0.5 m<sup>3</sup> 1 copë

Në kriterin e mësipërm janë kërkuar 1 makinë teknologjike me kapacitet mbajtës 10 ton, dhe 1 eskavator me zinxhir 0.5m<sup>3</sup> por në asnjë rast nuk është kërkuar edhe disponimi i shoferit/manovratorit. Mungesa e Shoferit/manovratorit sjellë pamundësinë e përdorimit të mjeteve të ndërtimit dhe realizimin e ngarkimit të mbetje me eskavator dhe transportimin e mbetjeve në inceneratorin e Elbasanit.

**Pika 2.3.5.** Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontratë, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

-Çertifikatë ISO 14001-2015 (Standart për sistemin e menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalente dhe e vlefshme.

Kërkesa për këtë certifikatë nuk argumentohet teknikisht dhe ligjërisht nga AK. Sqarojmë se ISO 14001:2015 specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit mjedisor që një organizatë mund të përdorë për të përmirësuar performancën e saj mjedisore.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: znj. Z Ç, znj. G K dhe znj. R D.

### ***Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Me urdhrin nr. 85 datë 15.02.2023, të titullarit të AK, nr.496 prot., datë 15.02.2023, i ndryshuar me urdhrin nr.136, nr. 794 prot., datë 13.03.2023, është ngritur “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, i përbërë nga znj. M R, Kryetar, znj. M P dhe znj. A K, Anëtar.

Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s’ka, datë 03.03.2023 për hapjen e tenderit, procesverbali nr.s’ka, datë 15.03.2023 për vlerësimin e ofertave, si dhe në datën 09.06.2023 është mbajtur raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim. Nëpërmjet kërkesës në SPE, datë 15.03.2023, KVO i është drejtuar OE “R” Shpk për dorëzimin e dokumentacionit. Gjithashtu nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s’ka, datë 20.03.2023 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

*Në këtë tender kanë marrë pjesë 2 OE/BOE, përkatësisht:*

OE “P S” Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 7,738,000 lekë pa TVSH.

OE “R” Sh.P.K, me ofertë ekonomike në shumën prej 7,847,500 lekë pa TVSH.

### **Ankesa**

Në lidhje me klasifikimin dhe vlerësimin e OE për procedurën e sipërcituar, ndër të tjera, rezulton se është paraqitur 1 ankesë nga OE “P S” Shpk, duke kundërshtuar s’kualifikimin dhe pretendimet e AK.

Titullari i AK, përkatësisht për ankimin, ka marrë vendimin (urdhër pezullimi nr.158 datë 24.03.2023) me të cilin ka vendosur pezullimin e vazhdimin të procedurës dhe caktimin e një Komisioni për Shqyrtimin e Ankesës të përbërë nga z. M A, znj. M Z znj. M B.

1. Ankesë nga OE -P S shpk me Nr.888 prot., datë 24.03.2023.

2. Urdhër pezullimi nr.158 datë 24.03.2023.

3. Urdhër shqyrtimi i ankesës nr.159 datë 24.03.2023.

4. Vendimi (përgjigja e ankesës nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës) nr. 928 prot., datë 28.03.2023.

5. Vendimi përfundimtar i KPP nr.338/2023 datë 03.05.2023, i cili ka vendosur të pranojë ankesën e OE P S Sh.p.k për procedurën e prokurimit si dhe Ak të anulojë vendimin e KVO-së për s’kualifikimin e OE dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara.

Nëpërmjet kërkesës në SPE, datë 15.05.2023, KVO i është drejtuar OE “P S” Shpk për dorëzimin e dokumentacionit. Gjithashtu nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s’ka, datë



25.05.2023 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 09.06.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit.

-Në kushtet e mësipërme është përzgjedhur fitues OE “P S” Sh.P.K, me ofertën ekonomike me vlerë 7,738,000 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 594,847 lekë/7% më pak. Pra është përzgjedhur e vlefshme, oferta më e ulët ekonomike, në krahasim me ofertat e tjera të vlefshme, të cilat gjatë vlerësimit të ofertave janë klasifikuar si të vlefshme.

### **Konkluzion:**

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht<sup>25</sup>, nga OE “P S” Shpk shpallur fitues, konstatohet se OE plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit.

**14. Tenderi me objekt: “Asfaltim i rrugës së Lagjes së re “Degëzimi i Toromanit”, me këto të dhëna:**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Asfaltim i rrugës së Lagjes së re “Degëzimi i Toromanit”, Preenjas Fshat.</b>		
<b>1.</b> Urdhër Prokurimi: Nr. 74, datë 10.10.2023	<b>2.</b> Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: 1. Z C, Kryetar; 2. Me P, Anëtar;	<b>3.</b> Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 447, datë 12.10.2023 1. M R, Kryetar; 2. M Z, Anëtar; 3. M H, Anëtar;
<b>4.</b> Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e thjeshtuar-punë”	<b>3.</b> E B, Anëtar; <b>4.</b> A K, Anëtar <b>5.</b> R D, Anëtar	
<b>5.</b> Fondi Limit (pa Tvsh) 2.666.665 lekë	<b>6.</b> Oferta fituese: “Rr U A nr.2 sha, 2,533,334,62 lekë pa tvsh.	<b>7.</b> Diferenca me fondin limit: 133,330 lekë pa tvsh
<b>8.</b> Data e hapjes së tenderit: 12.12.2023	<b>9.</b> Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë Preenjas	<b>10.</b> Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
<b>11.</b> Ankimime AK: Jo	<b>12.</b> Përgjigje ankesës nga AK: Jo	<b>13.</b> Përgjigje Ankesës nga KPP: Jo

*Sa më sipër u konstatua:*

Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar plotësisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Konkretisht si më poshtë vijon:

### **Hartimi i kriterëve:**

Në vijim është mbajtur procesverbali, datë 30.11.2023 për argumentimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të kualifikimit. Për kriteret e veçanta të kualifikimit, njësia është bazuar në relacionin e hartuar nga Njësia e prokurimit, në të cilin konstatohet se për përlllogaritjen e numrit të punonjësve që duhet të përmbushi operatori ekonomik, konkretisht në procesverbal thuhet se nga ana teknike argumentohet se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 5 punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatim të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda 2 muajve nga data e nënshkrimit të kontratës. Nga auditimi konstatohet se në procesverabl nuk është e argumentuar konkretisht se si është kryer përlllogaritja për nevojën së kësaj fuqie punëtore sipas zërave, volumeve, orëve të punës së nevojshme, si dhe grafikut të punimeve. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

*Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi Njësia e prokurimit me përbërje znj. Z Ç, znj. M P, z. E B, znj. A K dhe znj R D.*

### **Vlerësimi i ofertave**

<sup>25</sup> Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

Me urdhër nr. 447, datë 12.10.2023 është ngritur Komisioni i Vlerësimit të ofertave i përbërë nga znj. M R, znj. M H dhe znj. M Z.

Konstatohet se për këtë procedurë kanë marrë pjesë 2 operatorë ekonomik, si më poshtë:

1. A I me vlerë oferte 2,524,860 lekë
2. Rr U A nr.2 E me vlerë oferte 2,533,334 lekë

KVO më datë 12.12.2023 ka mbajtur proces verbalin për hapjen e procedurës së prokurimit me objekt “Asfaltim i rrugës së Lagjes së re “Degëzimi i Toromanit”, Prrenjas Fshat.

KVO me shkresën e datës 04.01.2024, është hartuar Raporti përmbledhës drejtuar titullarit të AK. Në vijim, është finalizuar procedura me lidhjen e kontratës nr. 546, datë 12.02.2024.

### **Konkluzion:**

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht<sup>26</sup>, nga OE “Rr U A nr.2 E” Shpk shpallur fitues, konstatohet se OE plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit.

*Përsa është trajtuar në Projekt Raport, nga znj. M Z, znj. M R, M H është paraqitur observacioni me nr. 1508-1508/13 datë 24.05.2024, i administruar në KLSH me nr. 189/16 prot., datë 29.05.2024, si më poshtë:*

**Pretendimi i subjektit:** Për mjetet me targa AA...DA, AB...GK dhe AA...ZT konstatohet se OE Rr U A nr.2 E nuk ka paraqitur dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë). Mjeti AA...DA është i pajisur me certifikatë pronësie, dokument i cili është pjesë e dokumentacionit fizik të paraqitur nga OE. Përsa i përket mjetit me targa AB...GK, theksojmë se operatori ekonomik ka paraqitur disa mjete (më tepër nga sa janë kërkuar në DT) dhe komisioni ka vlerësuar si të vlefshëm dokumentacionin e paraqitur për mjetin AA...MA. Për mjetin me targa AA...ZT theksojmë se është i pajisur me leje e qarkullimi e cila është e barasvlefshme me certifikatën e pronësisë. Për sa i përket certifikatës së pronësisë të mjetit me targa AB...IX sqarojmë se Leja e re e qarkullimit të mjetit zëvendëson certifikatën e pronësisë se mjetit, kjo referuar pikës 2 të Urdhërit nr. 284 datë 07.10.2020 “Për miratimin e lejes së re të qarkullimit të mjetit” të nxjerrë nga Ministria re Infrastrukturës, ku përcaktohet se: 2. Leja e re e qarkullimit të jetë e barasvlefshme me certifikatën e pronësisë. **Bashkëngjitur:** Leja e qarkullimit e re e cila është e barasvlefshme me certifikatën e pronësisë së mjetit.

**Oëndrimi i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër observacioni juaj lidhur me këtë pikë merret në konsideratë, si dhe do reflektohet në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**15. Tenderi me objekt: “Rikonstruksion i kalçetos pranë shkollës 9- vjeçare”, me këto të dhëna:**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i kalçetos pranë shkollës 9-vjeçare Prrenjas Fshat</b>		
<b>1.</b> Urdhër Prokurimi: Nr. 66, datë 20.09.2023	<b>2.</b> Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: 1. M R, Kryetar; 2. M H, Anëtar; 3. R D, Anëtar	<b>3.</b> Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 425, datë 26.09.2023 1. A K, Kryetar; 2. M Z, Anëtar; 3. M P, Anëtar;
<b>4.</b> Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e thjeshtuar-punë”		
<b>5.</b> Fondi Limit (pa Tvsh) 1,570,832 lekë	<b>6.</b> Oferta fituese: “E P P, 1,351,383 lekë pa tvsh.	<b>7.</b> Diferenca me fondin limit: 219,449 lekë pa tvsh
<b>8.</b> Data e hapjes së tenderit: 09.11.0.2023	<b>9.</b> Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë Prrenjas	<b>10.</b> Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
<b>11.</b> Ankimime AK: Jo	<b>12.</b> Përgjigje ankesës nga AK: Jo	<b>13.</b> Përgjigje Ankesës nga KPP: Jo

*Sa më sipër u konstatua:*

<sup>26</sup> Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

### **Vlerësimi i ofertave**

Me urdhër nr. 425, datë 26.09.2023 është ngritur Komisioni i Vlerësimit të ofertave i përbërë nga A K, M P dhe M Z.

Konstatohet se për këtë procedurë kanë marrë pjesë 2 operatorë ekonomik, si më poshtë:

1. OE EC P P me vlerë oferte 1,351,383 lekë.

2. OE S vlerë oferte 1,407,466 lekë.

KVO më datë 09.10.2023 ka mbajtur procesverbalin për hapjen e procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksion i kalçetos pranë shkollës 9 - vjeçare Prrenjas Fshat.

KVO me shkresën e datës 26.10.2023, është hartuar Raporti përmbledhës drejtuar titullarit të AK. Në vijim, është finalizuar procedura me lidhjen e kontratës nr. 3158, datë 16.11.2023.

### **Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se:**

-Sipas kriterëve të veçanta në DST pika 2.3.4 për mjetet me targa AB...BX, AA...VC, dhe AB...BX çertifikata për transport mallrash specifikohet vetëm për llogari të vet dhe jo për palë të treta dhe qiradhënie. Këto mjete janë marrë me qira nga operatori.

### **Konkluzion.**

OE “E P P” Shpk, nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte në zbatim të nenit 98 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, KVO duhet të kishte vazhduar me OE e radhës ose anuluar procedurën e prokurimit.

*-Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje si vijon, znj. A K dhe znj. M Z dhe M P, Anëtar.*

Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me Nenin 2, pikën 2 në nenin 3, nenin 77 dhe nenin 98 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”;

Shkronjën “c” të pikës 2 në nenin 2, pikën 4 në nenin 39, shkronjën “c” të pikës 2 në nenin 43, pikën 1 të nenit 44 dhe pikën 4 në nenin 55, pikën 2 të nenit 82, shkronja “b” në pikën 2 në nenin 93 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

*Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1508-1508/13 datë 24.05.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 189/16 datë 29.05.2024 nga KVO, znj. M P, znj. A K dhe znj. M Z janë shprehur objeksionet për procedurat si më poshtë:*

**Pretendimi i Subjektit:** *Sqarojmë se për sa i përket çertikatës së pronësisë të mjetit me targa AB...IX sqarojmë se Leja e re e qarkullimit të mjetit zëvendëson çertikatën e pronësisë së mjetit, kjo referuar pikës 2 të Urdhërit nr. 284 datë 07.10.2020 “Për miratimin e lejes së re të qarkullimit të mjetit” të nxjerrë nga Ministria re Infrastrukturës, ku përcaktohet se: 2. Leja e re e qarkullimit të jetë e barasvlershme me çertifikatën e pronësisë. Bashkëngjitur: Leja e qarkullimit e re e cila është e barasvlefshme me çertifikatën e pronësisë së mjetit. Përsa më sipër kërkojmë marrje në konsideratë të observimeve.*

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** *Për sa trajtuar më sipër observacioni juaj lidhur me këtë pikë merret në konsideratë, si dhe do reflektohet në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**Pretendimi i Subjektit:** *Njësia e Prokurimit ka dërguar të njëjtat komente që ka dërguar edhe në fazën e Projekt Raportit të Auditimit.*

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** *Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se, në observacionin e dërguar nga ju, nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve. Nuk vërehen pretendime, prova, fakte apo referenca ligjore të reja, nga ato çka janë përmendur në dokumentat e paraqitura nga Bashkia Prrenjas, gjatë fazës së auditimit në terren. Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.*

**16. Tenderi me objekt: “Hartimi i planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore “Sopot”, me këto të dhëna:**

**Me urdhrin e prokurimit nr. 40 datë 24. 05.2023** është miratuar realizimi i procedurës së prokurimit e llojit “shërbim konsulence” me objekt “Për hartimin e planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore Sopot” Bashkia Prrenjas.

<b>Hartimi i planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore “Sopot”</b>		
<b>1. UrdhërProkurimi:</b> Nr. 40 datë 24.05.2023	<b>2.Komisioni i Përlllogaritjes së Fondit Limit</b> 1. Xh Xh 2. S H 3. A A <b>3. Njësia e prokurimit</b> 1.Xh Xh 2.S H 3.Z Ç 4. M R 5. A K	<b>4.Komisioni Vlerësimit Ofertave:</b> 1.L L 2.L K 3.M M
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “Shërbim konsulence”		
<b>5.Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 4,145,202	<b>6.Oferta fituese:</b> “L” sh.p.k me ofertë 3,688,000 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit:</b> 457,202 lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit:</b> - Data e zhvillimit: 16.06.2023	<b>9.Burimi Financimit:</b> Fondet e veta	<b>10.Operatorët Ekonomikë:</b> a) Pjesëmarrës fazën II 1. “L” sh.p.k 2. BOE “D C”& “I G”
<b>11.Ankimime AK:</b> Nuk ka	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK:</b> Nuk ka	<b>13.Përgjigje Ankesës nga KPP:</b>

## **VLERËSIMI I OFERTAVE, FAZA I**

Rezultoi nga procesverbali i hapjes faza I në datë 17.07.2023 se në këtë procedure prokurimi u paraqiten dhe ofertuan OE, si më poshtë:

1. Operatori ekonomik “C” sh.p.k (skualifikuar)
2. Operatori ekonomik “D” shpk, (skualifikuar)
3. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “D C” shpk & “I G” shpk (kualifikuar)
4. Operatori ekonomik “L” shpk (kualifikuar)

1.1. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka skualifikuar OE “C” me arsyetimin se “kontratat e premtim/angazhimit me stafin teknik nuk janë me afat 12-muaj e për rrjedhojë nuk janë të vlefshme për gjatë gjithë kohës së hartimit të planit të mbarështimit.

Nga auditimi rezultoi se:

-Kontrata e premtim/angazhimi të datës 16.07.2023 mes “C” sh.p.k dhe z. D H si inxhinier pyjesh përcakton se afati do të jetë 10 muaj, nga koha për zbatimin e projektit (puna në terren)

-Kontrata e premtim/angazhimi të datës 16.07.2023 mes “C” sh.p.k dhe z. S O si inxhinier pyjesh përcakton se afati do të jetë 6 muaj, nga koha për zbatimin e projektit (puna në terren”

-Kontrata e premtim/angazhimi të datës 16.07.2023 mes “C” sh.p.k dhe z. V M si inxhinier/specialist pyjesh përcakton se afati do të jetë 6 muaj, nga koha për zbatimin e projektit (për punimet e zyrës).

-Kontrata e premtim/angazhimi të datës 16.07.2023 mes “C” sh.p.k dhe z. F A si inxhinier gjeodet përcakton se afati do të jetë 10 muaj, nga koha për zbatimin e projektit (për punime terreni dhe punimet e zyrës).

Sikurse konstatohet, vlerësimi i KVO-së ka ndjekur një interpretim të ngushtë të zbatimit të kriterit 2.3.3 të DST, për arsyen se nga ana e operatorit ekonomik afatet e përcaktuar në kontratat e premtimit/angazhimit lidhen me grafikun e punimeve dhe janë përcaktuar në bazë të rolit/funksionit që do të kryejnë punonjësit sipas intervaleve të grafikut të punimeve.

Konstatohet se punonjësit e mësipërm kanë dorëzuar edhe deklaratat e disponueshmërisë, ku shprehen se janë të disponueshëm brenda afatit të objektit të kontratës.

Si konkluzion, duke iu referuar edhe nenit 41, pika 4 të VKM nr.285/2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, për kriteret e veçanta në rastin e shërbimit të konsulencës përcaktohet se

*“stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë”, OE “C” duhej kualifikuar në fazën e parë.*

2.1. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka skualifikuar OE “D” shpk për mospërbushje të kriterit 2.3.1. “Përvojë e suksesshme” me argumentimet se:

-Kontrata me objekt “Rishikim/Hartim të planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore “Fushë Kuqe –Zavalinë” e lidhur me Bashkinë Elbasan datë 06.11.2017, nuk është realizuar gjatë 3 viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

-Kontrata me objekt “Hartim plane mbarështimi pyje e kullota“ të lidhur me Bashkinë Elbasan ka mungesë të vërtetimit të realizimit të shërbimit.

-Kontrata me objekt “Hartime të planit të mbarështimit të fondit pyjor dhe kullor për ekonominë pyjore Pezë, Shesh, Krrabe-Gurre” të lidhur me Bashkinë Tiranë ka mungesë të vërtetimit të realizimit të shërbimit.

-Kontrata me objekt “Hartim i planit të mbarështimit për ekonominë pyjore Kushe-2” të lidhur me Bashkinë Elbasan ka mungesë të vërtetimit të realizimit të shërbimit.

-Kontrata me objekt “Hartim plane mbarështimi pyje e kullota për ekonominë pyjore Shmil” të lidhur me Bashkinë Elbasan, ka mungesë të vërtetimit të realizimit të shërbimit.

Nga auditimi rezultoi se:

Operatori “D” sh.p.k ka lidhur kontratën nr.4441/20 datë 30.12.2020 me Bashkinë e Elbasanit për hartimin e planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore Shmil”, me vlerë 6,263,240 lekë. Si vërtetim për realizimin e shërbimit, operatori ka dorëzuar Urdhrin e Ministrit nr.18 datë 18.10.2022 që miraton planet e mbarështimit për ekonominë pyjore Shmil dhe ekonominë pyjore Kushe-2” çka provon realizimin e shërbimit. Si rrjedhojë, vetëm me këtë kontratë, subjekti e plotëson kriterin 2.3.1 të DST lidhur me përvojën e mëparshme, në një vlerë jo me të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë 3 viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

3.1. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar bashkimin e operatorëve ekonomikë “D C” shpk & “I G” shpk, por nga auditimi rezultoi se:

Njëri prej anëtarëve të BOE konkretisht OE “I G” shpk nuk ka paraqitur vërtetim realizimi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, referuar kriterit 2.3.1 “Kapaciteti Teknik” të dokumenteve Standarde të Tenderit. Kjo mospërbushje kriteri është konstatuar nga KVO në Fazën e II të vlerësimit të ofertave.

4.1. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar Operatori ekonomik “L” shpk me arsyetimin se oferta përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të nenit 82 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.

## **VLERËSIMI I OFERTAVE, FAZA II**

Në fazën e dytë të procedurës së prokurimit “shërbim konsulence” kanë garuar dy operatorë ekonomikë:

- Operatori ekonomik “L” shpk, i shpallur fitues me ofertë 3,688,000 lekë
- Bashkimi i Operatorëve “D C” shpk & “I G” shpk, i s’kualifikuar me ofertë 3,871,581 lekë

BOE është skualifikuar me arsyen se nuk ka dorëzuar propozimet ekonomike dhe teknike (nuk e ka ngarkuar në sistem sipas Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) si dhe për shkakun që s’është konstatuar në fazën e I, se njëri prej anëtarëve të BOE konkretisht OE “I G” shpk nuk ka paraqitur vërtetim realizimi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, referuar kriterit 2.3.1”.

### **Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël.**

Në zbatim të programit të auditimit, janë audituar 8 procedura prokurimi të llojit “blerje e vogël” në një vlerë totale të fondit limit prej 7,166,245 lekë, nga totali prej 18,186,860 lekë. Procedurat e përzgjedhura kanë një fond limit në vlerat 750,000 lekë deri në 1,000,000 lekë.

<b>Procedura</b>	<b>Fondi limit në lekë</b>
Rikonstruksion kanale ujitëse	832,913
Rikonstruksion i rrugëve të fshatit Karkavec, Njësia Administrative Qukes, Bashkia Prrenjas	750,000
Mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi për mjetet	1,000,000
Dekorimi i qytetit për Vitin e Ri	916,666
"Punime rikonstruksioni në ambientet private që do të përdoren për shkollën e mesme “Sali Halili Rrajce”	1,000,000
Blerje karrige për zyrën e këshillit dhe administratën	1,000,000
Shpenzime interneti	833,333
Shpenzime pr lyerje, meremetime, ambientesh në varësi të Bashkisë Prrenjas	833,333
<b>Totali</b>	<b>7,166,245</b>

### ***Nga auditimi i procedurave ka rezultuar se:***

**1.** Bashkia Prrenjas ka realizuar 4 procedura me blerje të vogla për objekt/shërbim të ngjashëm, konkretisht:

- Festa 28-29 nëntor zhvilluar në datë 07.11.2023 me fond limit 166,666 lekë
- Festa e Berzeshtës zhvilluar në datë 14.07.2023 me fond limit 333,000 lekë
- Festa e Rrajcës zhvilluar në datë 14.08.2023 me fond limit 300,000
- Loti i dytë “Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit” me fond limit 916,666 lekë i tenderuar si blerje e vogël me urdhrin nr. 77 datë 18.10.2023

Në rastin konkret, duhet të realizonte një procedurë “të hapur të thjeshtuar”, duke qenë se vlera totale e procedurave përkatëse është 1,716,665 lekë. E njëjta gjë konstatohet edhe me realizimin e dy procedurave të tjera (i) “blerje karburant për raste emergjencash” me vlerë 478,132 lekë zhvilluar datë 28.12.2023 dhe (ii) “blerje karburant për qendrën komunitare” me vlerë 831,600 lekë zhvilluar date 17.02.2023, pasi vlera e përlogaritur në total e këtyre procedurave për të njëjtin mall/shërbim/punë ose grup mallrash/shërbimesh/punësh është më e madhe se 1000,000 lekë në vit, niveli maksimal i përcaktuar në kuadrin rregullator për procedurat e llojit blerje e vogël, pika 5 e udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

**2.** Në 7 raste, komisioni i blerjeve të vogla nuk ka përfshirë si kriter vërtetimin se subjekti ka paguar sigurimet shoqërore të punonjësve, konkretisht në procedurat si mëposhtë:

- “Blerje materiale për objektin punime rikonstruksioni që do të përdoren për shkollën e mesme Sali Halili”, me fond limit 978,516 lekë;
- “Rikonstruksion i rrugëve të fshatit Karkavec, njësia administrative Qukës”, me fond limit 749,998.5 lekë;
- “Blerje karrige për zyrën e këshillit dhe administratën” në vlerën 1,000,000 lekë;
- “Mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi për mjetet”, me fond limit 1,000,000 lekë;
- “Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit” me fond limit 916,666 lekë;
- “Shpenzime për lyerje, meremetim ambientesh” me fond limit 833,000 lekë;
- “Shpenzime interneti” me fond limit 832,000 lekë.

**3.** Në 3 raste, operatorët ekonomikë të shpallur fitues nuk kanë përmbushur kriteret kualifikuese:

- **Në 2 procedura**, (i) “Blerje materiale për objektin punime për shkollën e mesme Sali Halili”, me fond limit 978,516 lekë dhe (ii) “Rikonstruksion i rrugëve të fshatit Karkavec” me fond limit 749,998 lekë sipas vërtetimit nr. T07797131 datë 16.02.2023, operatori ekonomik i

shpallur fitues “L-B” sh.p.k ka për të paguar gjithsej 2,151,736 lekë detyrime, nga të cilat 2,096,351 lekë kontribute, 7,969 lekë kamatëvonesa dhe 47,416 lekë gjoba.

-**Në 1 procedurë**, “Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit” me fond limit 916,666 lekë, subjekti i shpallur fitues nuk ka sjellë vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të energjisë, sipas kritereve të përcaktuara, por ka sjellë vetëm një deklaratë se nuk është debitor.

4.Nga auditimi u konstatua se:

-**Në 1 rast**, në procedurën e prokurimit me objekt “*Rikonstruksion i rrugëve të fshatit Karkavec*” me fond limit 749,998.5 lekë pa TVSH sipas preventivit të miratuar nga Bashkia Prrenjas, rikonstruksionet e rrugëve përfshijnë mbulesë vetëm me çakull, duke mos përfshirë punime me asfaltim. Si pasojë, kjo procedurë përbën një investim afatshkurtër, të paqëndrueshëm dhe jo efektiv.

-**Në 1 rast**, në procedurën “Rikonstruksion i kanaleve ujitëse” me fond limit 832,913 lekë, në lidhje me preventivin e punimeve rezultoi se në “Rikonstruksionin e kanalit ujitës Rrajcë-Sutaj” janë përfshirë 6 zëra punimesh ndërsa për të njëjtën objekt punimi “Rikonstruksion i kanalit ujitës Rrajcë-fushë” janë përfshirë 3 zëra, duke mos argumentuar nga ana teknike pse mungojnë zërat për transport materiale dhe mur guri. Po ashtu, për ndërtimin e kanalit ujitës Reshtan-Katjel janë përfshirë zërat “2.262/4 Shtresë betoni” dhe 2.558 “F.V tuba b/a 100 mm”, pa përfshirë zërat si gërmime dheu dhe transport materiale.

**Më hollësisht, procedurat janë trajtuar si mëposhtë:**

**1-Me urdhër prokurimi nr.64 datë 18.09.2023** është miratuar procedura “blerje e vogël” me objekt “*Rikonstruksion i kanaleve ujitëse*” me fond limit 832,913 lekë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi:

- Në lidhje me fondin limit, nga Komisioni i përbërë nga z. M H Kryetar, z. M H dhe z. H K anëtarë janë përzgjedhur çmimet e VKM nr.629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Preventivi i punimeve përfshin (i) “Rikonstruksionin e kanalit ujitës Rrajcë-Sutaj”, (ii) “Rikonstruksion i kanalit ujitës Rrajcë-fushë”, (iii) “Kanal Ujitës Rashtan-Katjel”.
- Me procesverbalin nr. 1 datë 19.09.2023 u është dërguar ftesa për ofertë në sistem katër operatorëve ekonomikë: “Rr U A Nr.2” sh.p.k; “L-B” sh.p.k; “M” P.F; “R G-K” sh.p.k; “B N” sh.p.k.
- Me procesverbalin nr. 2 datë 20.09.2023 nga anëtarët e komisionit të blerjeve të vogla rezultoi se janë dorëzuar 14 oferta të vlefshme dhe janë skualifikuar 4 oferta ekonomike.
- Me procesverbalin nr.3 datë 20.09.2023, është konstatuar se operatori ekonomik “L-B” ka paraqitur ofertën më të ulët me vlerë 678,433 lekë.
- Me datë 21.09.2023 është mbajtur procesverbali për kalimin te operatori i radhës, OE “A-D” me ofertë 758,280 lekë, pasi sipas Komisionit të Blerjeve të Vogla, operatori “L-B” nuk u paraqit brenda afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë.

Nga auditimi u konstatua se:

- Në lidhje me preventivin e punimeve rezultoi se në “Rikonstruksionin e kanalit ujitës Rrajcë-Sutaj” janë përfshirë 6 zëra punimesh ndërsa për të njëjtën objekt punimi “Rikonstruksion i kanalit ujitës Rrajcë-fushë” janë përfshirë 3 zëra, duke mos argumentuar nga ana teknike pse mungojnë zërat për transport materiale dhe mur guri. Po ashtu, për ndërtimin e kanalit ujitës Reshtan-Katjel janë përfshirë zërat “2.262/4 Shtresë betoni” dhe 2.558 “F.V tuba b/a 100 mm”, pa përfshirë zërat si gërmime dheu dhe transport materiale.

**2-Me urdhër prokurimi nr.23 datë 17.03.2023** është miratuar procedura “blerje e vogël” me objekt “Blerje materiale për objektin punime rikonstruksioni që do të përdoren për shkollën e mesme Sali Halili”, Rrajcë me fond limit 978,516 lekë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se:

- Me procesverbalin e datës 16.03.2023, nga Komisioni i Blerjeve të Vogla i përbërë nga znj. M P, Kryetar, znj. M H dhe z. H K anëtarë janë përzgjedhur çmimet e VKM nr.629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” si dhe janë marrë 3 oferta nga tregu, duke përcaktuar fondin limit në vlerën 978,516 lekë.
- Me procesverbalin nr. 1 datë 17.03.2023 u hodh Ftesa për Ofertë në sistem dhe iu dërgua pesë operatorëve ekonomikë: “G D”; “B F”; “P D”; “O L”, “E K”.
- Me procesverbalin nr. 2 datë 20.03.2023 nga anëtarët e komisionit të blerjeve të vogla rezultoi se janë dorëzuar 17 oferta të vlefshme. Në përfundim, me vendimin nr.54 datë 05.04.2023 është shpallur fitues operatori i renditur i gjashtë për nga oferta me vlerë 889,753 lekë, subjekti “L-B” sh.p.k, pasi operatori i parë me ofertën e ulët 637,000 lekë “A B” P.F është tërhequr, operatori i dytë “Sh M” P.F me ofertë 698,000 lekë nuk është paraqitur, operatori i tretë me ofertë 700,000 lekë “T&J C” sh.p.k nuk është paraqitur, operatori i katërt me ofertë 748,000 “4 A C” sh.p.k nuk është paraqitur dhe operatori i pestë “N H” P.F me ofertë 824,000 lekë është tërhequr nga gara.

Nga auditimi i konstatua se;

- Në procesverbalin për argumentimin e kriterëve të tenderit, komisioni i blerjeve të vogla nuk ka përfshirë si kriter vërtetimin se subjekti ka paguar sigurimet shoqërore të punonjësve.
- Sipas vërtetimit nr. T07797131 datë 16.02.2023, operatori ekonomik i shpallur fitues L-B” sh.p.k ka për të paguar gjithësej 2,151,736 lekë detyrime, nga të cilat 2,096,351 lekë kontribute, 7,969 lekë kamatëvonesa dhe 47,416 lekë gjoba. Sipas nenit 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” pika 2 përcaktohet se “Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkëlur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore”.

**3-Me urdhër prokurimi nr. 14 datë 15.02.2023** është miratuar procedura e prokurimit blerje e vogël me objekt “Rikonstruksion i rrugëve të fshatit Karkavec, njësia administrative Qukës”, Bashkia Prenjas me fond limit 749,998 lekë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se:

-Projekti i zbatimit është hartuar nga inxhinier z. K B (I kontraktuar nga bashkia, me licensë) dhe miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfshin rikonstruksionin e rrugëve në lagjen “Kryeziu”, lagjen “Alliu”, lagjen “Xhamia” lagjen “Kala” dhe lagjen “Skura”.

Rikonstruksioni i rrugës së lagjes Kryeziu	<b>Gërmim themele e planta, 025 m<sup>3</sup></b>
	Çakull mbeturinë për mbushje
	Transport materiale ndërtimi dheu, me auto deri në 2km
	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri në 2 km(çakull për mbushje)
Rikonstruksioni i rrugës së lagjes “Alliu”	Çakull mbeturinë për mbushje(Manuali nr.3)
	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto 2.0 km
Rikonstruksioni i rrugës së lagjes “Xhamia”	Çakull mbeturinë për mbushje(Manuali nr.3)
	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto 2.0 km
Rikonstruksioni i rrugës së lagjes “Xhamia”	Çakull mbeturinë për mbushje(Manuali nr.3)
	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto 2.0 km
5. Rikonstruksioni i rrugës së lagjes “Skura”	Çakull mbeturinë për mbushje(Manuali nr.3)
	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto 2.0 km

-Me procesverbalin nr. 1 të datës 15.02.2023, nga Komisioni i Blerjeve të Vogla i përbërë nga znj. M R, Kryetar, znj. M V dhe znj. R D anëtarë u hodh Ftesa për Ofertë në sistem dhe iu dërgua pesë operatorëve ekonomikë: “K B” sh.p.k; “HB G-C” sh.p.k; “K”; “A H” P.F; “Gj P” P.F.

-Me procesverbalin nr. 2 datë 20.03.2023 nga anëtarët e komisionit të blerjeve të vogla rezultoi se janë dorëzuar 4 oferta të vlefshme. Në përfundim, është shpallur fitues operatori i renditur i pari për nga oferta “L-B” me vlerë 689,552 lekë.

Nga auditimi u konstatua se;



-Në procesverbalin për argumentimin e kritereve të tenderit, komisioni i blerjeve të vogla nuk ka përfshirë si kriter vërtetimin se subjekti ka paguar sigurimet shoqërore të punonjësve.

-Sipas vërtetimit nr. T07797131 datë 16.02.2023, Operatori ekonomik i shpallur fitues “L-B” sh.p.k ka për të paguar gjithsej 2,151,736 lekë detyrime, nga të cilat 2,096,351 lekë kontribute, 7,969 lekë kamatëvonesa dhe 47,416 lekë gjoba. Sipas nenit 76 “Kriteret detyruese për s’kualifikim” pika 2, përcaktohet se “Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore”.

-Duke qenë se sipas preventivit të miratuar nga Bashkia Prrenjas, rikonstruksionet e rrugëve përfshijnë mbulesë vetëm me çakull, duke mos përfshirë asfaltim, vlera e likuiduar prej 786,054 lekë përbën një investim afatshkurtër, të paqëndrueshëm dhe jo efektiv.

-Në lidhje me afatin e zbatimit, në kontratë përcaktohet se afati do të jetë 15 ditë nga nënshkrimi i kontratës (datë 16.03.2023) ndërsa në procesverbalin e kolaudimit, kohëzgjatja datë 23.06.2023 është përcaktuar brenda 15 ditëve kalendarike nga data e fillimit të punimeve. Sipas këtij procesverbali, fillimi i punimeve është bërë në datë 28.03.2023 dhe ka përfunduar në datë 11.04.2023.

**4-Me urdhrin e prokurimit nr.90 datë 21.11.2023** është miratuar procedura e llojit blerje e vogël me objekt “Blerje karrige për zyrën e këshillit dhe administratën” në vlerën 1,000,000 lekë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se:

-Në lidhje me përcaktimin e fondit limit, vlera është përcaktuar duke marrë tre oferta nga operatorë që ushtrojnë aktivitetin objekt prokurimi. Konkretisht, “B B” sh.p.k në vlerë 1,021,950 lekë; “M M” në vlerë 1,037,500 lekë; “M” sh.p.k në vlerën 1,000,000 lekë.

-Me procesverbalin nr. 1 datë 21.11.2023 u hodh ftesa për Ofertë në sistem dhe iu dërgua pesë operatorëve ekonomikë: “B”; “B sh.p.k”; “Sh”; “O L”, “A”.

-Me procesverbalin nr. 2 datë 22.11.2023 nga anëtarët e komisionit të blerjeve të vogla rezultoi se janë dorëzuar 24 oferta të vlefshme. Në përfundim, është shpallur fitues operatori i renditur i katërti për nga oferta, “N H” me vlerë 788,800 lekë, pasi operatori i renditur i pari, “J & Sh” me vlerë 595,000 lekë ka njoftuar se tërhiqet për arsye mungesë transporti, operatori i renditur i dyti “S Rr” me vlerë 797,300 lekë nuk është paraqitur, operatori i renditur i treti “HB-G” me vlerë 780,000 lekë është tërhequr për mos realizimin në kohë.

Nga auditimi u konstatua se:

-Në procesverbalin për argumentimin e kritereve të tenderit, komisioni i blerjeve të vogla nuk ka përfshirë si kriter vërtetimin se subjekti ka paguar sigurimet shoqërore të punonjësve.

**5-Me urdhrin e prokurimit nr. 69 datë 03.10.2023** është miratuar realizimi i procedurës blerje e vogël me objekt “Mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi për mjetet”, me fond limit 1,000,000 lekë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi:

-Me procesverbalin e datës 26.09.2023 është përcaktuar fondi limit, i bazuar në tre oferta ekonomike të marra nga “J A” me ofertë 1,000,000 lekë, “R K” me ofertë 1,025,000 lekë dhe “D H” me ofertë 1,061,000 lekë.

-Me procesverbalin nr.1 datë 03.10.2023 u është dërguan ftesë për ofertë pesë subjekteve: “A O”, “D L”; “M K”; Y D”; A M S.

-Në procesverbalin nr.2 datë 06.10.2023, Komisioni i Blerjeve të Vogla ka konstatuar se është dorëzuar 1 ofertë e vlefshme, konkretisht subjekti F Rr me ofertë 930,000 lekë ndërsa 18 oferta janë s’kualifikuar për arsyen se nuk plotësojnë kriterin 6/3 se “operatori ekonomik duhet të dëshmojë se disponon të paktën një pikë servisi brenda territorit të bashkisë Prrenjas, e pasqyruar kjo në të dhënat e QKB dhe NIP-tet sekondare, shoqëruar me certifikatë pronësie dhe kontratë qiraje.

Nga auditimi u konstatua se;

-Në procesverbalin për argumentimin e kritereve të tenderit, komisioni i blerjeve të vogla nuk ka përfshirë si kriter vërtetimin se subjekti ka paguar sigurimet shoqërore të punonjësve.

**6-Me urdhrin e prokurimit nr. 56 datë 26.07.2023** është miratuar realizimi i procedurës “e hapur e thjeshtuar” me objekt “Organizimi i aktiviteteve”, me fond limit 1,716,665 e ndarë në dy lote:

-Loti i parë “organizimi i aktiviteteve” me fond limit 799,999 lekë dhe është prokuruar duke përdorur tre procedura me blerje të vogla:

-Festa 28-29 nëntor zhvilluar në datë 07.11.2023 me fond limit 166,666 lekë

-Festa e Berzeshtës zhvilluar në datë 14.07.2023 me fond limit 333,000 lekë

-Festa e Rrajcës zhvilluar në datë 14.08.2023 me fond limit 300,000

-Loti i dytë “Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit” me fond limit 916,666 lekë i tenderuar si blerje e vogël me urdhrin nr. 77 datë 18.10.2023

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi:

-Me procesverbalin e datës 11.10.2023 është përcaktuar fondi limit në vlerën 916,666 lekë duke marrë tre oferta nga OE “E T” P.F. me vlerë 881,666 lekë, OE “A 2018” sh.p.k me vlerë 925,833 lekë dhe OE “Sh” sh.p.k me vlerë 942,500 lekë .

-Me procesverbalin nr.1 datë 18.10.2023 u dërgua ftesa për ofertë pesë subjekteve: “S A”; “O H”; B”; A 2018”.

-Me procesverbalin nr. 2 datë 19.10.2023, Komisioni i Blerjeve të Vogla konstatoi se janë dorëzuar 14 oferta të vlefshme.

-Fitues është shpallur subjekti i renditur i dyti, “V C” me ofertë 699,000 lekë pasi ofertuesi i renditur i pari , B C ka shprehur tërheqjen.

Nga auditimi u konstatua se:

-Në lidhjen me procedurën, Bashkia Prrenjas nuk duhet ta ndante në lote, duke kryer procedura me blerje të vogla, por duhet të kryente një procedurë “të hapur të thjeshtuar”, duke qenë se vlera totale e procedurave përkatëse është 1,716,665 lekë. E njëjta gjë konstatohet edhe me realizimin e dy procedurave të tjera (i) “blerje karburant për raste emergjencash” me vlerë 478,132 lekë zhvilluar 28.12.2023 dhe (ii) “blerje karburant për qendrën komunitare” me vlerë 831,600 lekë zhvilluar 17.02.2023.

Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” pika 5 e cila përcakton se “*Autoriteti kontraktor planifikon natyrën, sasinë dhe llojet e mallrave, shërbimeve dhe zërat e punëve që do të prokurohen në këtë mënyrë dhe i përfshin ato në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit publik. Autoriteti kontraktor nuk është i detyruar të prokurojë njëherësh të gjithë sasinë e mallrave, shërbimeve apo të punëve për plotësimin e nevojave të veta. Autoriteti kontraktor mund të realizojë disa procedura prokurimi me vlerë të vogël gjatë vitit kalendarik, në varësi të nevojave dhe mundësive të tij, por vlera e përlogaritur në total e këtyre procedurave për të njëjtin mall/shërbim/punë ose grup mallrash/shërbimesh/punësh, nuk duhet të jetë më e madhe se 1,000,000 lekë në vit.*

-Subjekti i shpallur fitues nuk ka sjellë vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të energjisë, sipas kriterëve të përcaktuar, por ka sjellë vetëm një deklaratë se nuk është debitor.

-Në procesverbalin për argumentimin e kriterëve të tenderit, komisioni i blerjeve të vogla nuk ka përfshirë si kriter vërtetimin se subjekti ka paguar sigurime shoqërore të punonjësve.

**7-Me urdhrin e prokurimit nr.50 datë 15.06.2023** është miratuar procedura e prokurimit e llojit blerje e vogël me objekt “Shpenzime për lyerje, meremetim ambientesh në varësi të Bashkisë Prrenjas” me fond limit 833,000 lekë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se:

-Me procesverbalin e datës 13.02.2023 limit është përcaktuar fondi limit në vlerën 833,200 lekë duke marrë si bazë tre oferta ekonomike; “L R” me vlerë 833,000 lekë; “A Z” me vlerë 895,000 lekë dhe “R K” me vlerë 950,300 lekë.

-Me procesverbalin nr. 1 datë 08.08.2023 u është dërguar ftesa për ofertë pesë operatorëve ekonomikë: “M-D”; L R”; “E L”; “R K”: “G 001”.

-Me procesverbalin nr.2 datë 09.08.2023, Komisioni i Blerjeve të Vogla ka konstatuar se janë dorëzuar 29 oferta të vlefshme.

-Fitues është shpallur operatori “M -M” me ofertë 682,000 lekë i renditur i shtati për nga oferta, pasi operatori i renditur i parë “E L” me ofertë 416,66 ka shprehur tërheqjen për pamundësi realizimi; operatori i renditur i dyti “A K” me ofertë 458,900 lekë ka shprehur tërheqjen për pamundësi realizimi; operatori i renditur i treti “5 Xh G” me ofertë 540,000 lekë ka shprehur tërheqjen për pamundësi realizimi; operatori i renditur i katërti “E&E” me ofertë 548,000 lekë është tërhequr për arsye objektive; operatori i renditur i pesti “H Xh” me ofertë 620,000 lekë nuk është paraqitur brenda afatit; operatori i renditur i gjashti “B B” 634,560 lekë ka shprehur tërheqjen për arsye shëndetësore;

Nga auditimi rezultoi se:

-Në procesverbalin për argumentimin e kriterëve të tenderit, komisioni i blerjeve të vogla nuk ka përfshirë si kriter vërtetimin se subjekti ka paguar sigurimet shoqërore të punonjësve.

**8-Me urdhrin e prokurimit nr. 2 datë 25.01.2023** është miratuar realizimi i procedurës e llojit blerje e vogël me objekt “Shpenzime interneti”, për 10 godina, me fond limit 832,000 lekë

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se:

-Me procesverbalin e datës 23.01.2023 është përcaktuar fondi limit në vlerën 832,800 lekë bazuar në tre oferta ekonomike: “A” sh.p.k me ofertë 861,600 lekë; “Fast-net” sh.p.k me vlerë 852,000 lekë; I G” me vlerë 832,800 lekë.

-Me procesverbalin nr. 1 datë 25.01.2023 u është dërgua ftesa për ofertë; M K; F.al; I and C; I C; F;.

-Me procesverbalin nr.2 datë 26.01.2023, Komisioni i Blerjeve të Vogla ka konstatuar se janë dorëzuar 4 oferta të vlefshme.

-Fitues është shpallur operatori ekonomik “I” i renditur i katërti me vlerë 831,600 lekë, pasi operatori i renditur i pari “M” me vlerë 548,900 lekë nuk u paraqit sipas afatit; operatori i renditur i dyti “A”, me vlerë 550,000 lekë ka shprehur tërheqjen për arsye objektive; operatori i renditur i treti “E L”, me ofertë ekonomike 689,000 lekë nuk u paraqit brenda afatit.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se:

-Në procesverbalin për argumentimin e kriterëve të tenderit, komisioni i blerjeve të vogla nuk ka përfshirë si kriter vërtetimin se subjekti ka paguar sigurimet shoqërore të punonjësve.

#### **2.4.4 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomik fitues.**

**Shënim:** Gjatë auditimit të ushtruar në Bashkinë Prrenjas, nga ana e grupit të auditimit të KLSH nuk janë kontrolluar procedurat mbi zbatimin e kontratave për investime publike, mbi planifikimin, kontrollin dhe zhvillimin e territorit, të cilat do të jenë objekt i auditimit në auditimin e radhës.

#### **2.5. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.**

*Në zbatim të pikës 5 të Programit të Auditimit, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:*

*Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Prrenjas;*

*Aplikimet për lejet ndërtimi për vitin 2023;*

*Përlllogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas paketave fiskale të miratuara në Këshillin Bashkiak.*

*Në lidhje me riskun konstatohet se për vitin 2023 në Bashkinë Prrenjas nuk rezultojnë leje ndërtimi me risk të lartë, në bazë të kriterëve si mëposhtë:*

*Nuk ka leje ndërtimi me sipërfaqe mbi 250 m<sup>2</sup>*

*Nuk ka leje ndërtimi për objekt pallate, hoteleri, agrobiznese*

*Lejet e ndërtimit të kategorisë së funksionit “shërbime” janë shtesa anësore në objekte ekzistuese me sipërfaqe 40-50 m<sup>2</sup>*

Nga auditimi është konstatuar se:

-Në 1 rast, me lejen nr. 1756/1 prot., datë 27.07.2023 për zhvilluesin z.Bashkim Hamid Hana me objekt “Prishje ndërtimi ekzistues dhe ndërtim banese të re, podrum 1 kat+banesë”, me sipërfaqe ndërtimi 120 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe e përgjithshme ndërtimi 249.70 m<sup>2</sup>, me lartësi maksimale 6.5 m është konstatuar se në prokurën e posaçme me nr. 564 repertori dhe nr.321 koleksioni datë 28.02.2023 mungon pëlqimi i dy prej bashkëpronarëve për kryerjen e veprimeve juridike dhe administrative për lejen e ndërtimit.

-Në 1 rast, me lejen nr.1851 prot., datë 19.09.2023 për zhvilluesin z.Bashkim dhe Violeta Cura me objekt “Prishje objekti ekzistues “lokal 1 kat dhe ndërtim objekti të ri 1 kat socio-ekonomik”, zhvilluesi disponon certifikatë pronësie për pasurinë nr. 2/707, e llojit “njësi” me sipërfaqe 40 m<sup>2</sup> por mungon dokumenti provues i pronësisë që rregullon marrëdhënien me truallin.

-Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se në 5 raste nuk është respektuar lartësia maksimale e kateve, konkretisht:

- Leja e ndërtimit nr.1391 prot., datë 24.05.2023 për zhvilluesin z. F N me objekt “Prishje ndërtimi ekzistues dhe ndërtim banese të re, podrum 1 kat+banesë, lartësia maksimale e lejuar në njësinë strukturore 2/384 është 6 m, ndërsa në lejen e ndërtimit është përcaktuar 7 m.
- Leja e ndërtimit nr.1161 prot., datë 29.05.2023 për zhvilluesin z. K B me objekt “Ngritje kati (me mbulesë çati) në objektin ekzistues”, lartësia maksimale e lejuar në njësinë strukturore 4/315 është 6 m, ndërsa në lejen e ndërtimit është përcaktuar 8.12 m.
- Leja e ndërtimit nr.557 prot., datë 20.04.2023 për zhvilluesin z. Xh dhe znj. D O me objekt “Shtesë anësore në objektin ekzistues Podrum 1 kat + ngritje 2 kat”.
- Lartësia maksimale e lejuar në njësinë strukturore 1/20 është 6 m, ndërsa në lejen e ndërtimit është përcaktuar 9.22 m.
- Leja e ndërtimit nr. 2211 prot., datë 14.12.2023 për zhvilluesin z. P H për objektin “Banesë e re individuale 2 kat + çati”, lartësia maksimale e lejuar në njësinë strukturore 4/95 është 6 m, ndërsa në lejen e ndërtimit është përcaktuar 8.2m
- Leja e ndërtimit 1755 Prot., datë 27.07.2023 për zhvilluesin z. Xh B me objekt “Ngritje kati (me mbulesë çati) në objektin ekzistues 1 kat”, lartësia maksimale e lejuar në njësinë strukturore 1/20 është 6 m, ndërsa në lejen e ndërtimit është përcaktuar 8.3m.

-Në 2 raste, përkatësisht për lejet me nr. 1756/1 prot., datë 27.07.2023 dhe nr.1391 prot., datë 24.05.2023, leja për prishje nuk është shënuar në kushtet e dokumentit të lejes si dhe mungon akti teknik i shembjes. Në rubrikën përkatëse të kushteve nuk është specifikuar se njoftimi për fillimin e punimeve duhet shoqëruar me aktin teknik të shembjes së objektit ekzistues.

-Në 1 rast, nga shqyrtimi i projektit arkitektonik rezultoi se leja e ndërtimit duhet të kishte si objekt një ndërtim të ri dhe jo shtesë. Ndonëse në certifikatën e pronësisë ka një objekt ekzistues me sipërfaqe 47 m<sup>2</sup>, në terren rezultoi se është një podrum nëntokësor, çka nuk është shoqëruar me një akt ekspertize për të argumentuar sesi ky podrum mund të shërbejë si një bazë të qëndrueshme për ngritjen e një banese 2 kate me lartësi 9.22 m.

-Në 1 rast, për lejen nr. 798 prot., datë 15.05.2023, në bazë të dokumentacionit të lejes së ndërtimit, plani i rilevimit bën një paraqitje të papërditësuar të situatës faktike në terren, pasi në bazë të ortofotove nga aplikacioni “Google Earth” rezultoi se ka objekt ekzistues.

*Në funksion të realizimit të auditimit, në mënyrë të detajuar u shqyrtuan lejet e ndërtimit si mëposhtë:*

***Me nr. 1756/1 prot., datë 27.07.2023 është miratuar leja e ndërtimit për zhvilluesin z. Bashkim Hamid Hana me objekt “Prishje ndërtimi ekzistues dhe ndërtim banese të re,***

podrum 1 kat+banesë”, me sipërfaqe ndërtimi 120 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe e përgjithshme ndërtimi 249.70 m<sup>2</sup>, me lartësi maksimale 6.5 m. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se subjekti ka dorëzuar:

Projektin dhe relacionin teknik

Projektin dhe relacionin konstruktiv

Preventivin e punimeve

Certifikatën e pronësisë

Vlera e investimit është përlllogaritur sipas kostos mesatare të Entit Kombëtar të Banesave, për qytetin e Prrrenjasit, në vlerën 32,393 lekë/m<sup>2</sup>.

Vlera e investimit	249.7 m <sup>2</sup> x 32 393 lekë/m <sup>2</sup>	8, 088, 532
Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë <sup>27</sup>	8 088 532 * 1%	80, 885
Tarifë për mure të jashtme <sup>28</sup>	135 m <sup>2</sup> x 15 lekë/m <sup>2</sup>	2, 025
Tarifë për akt piketimi <sup>29</sup>	165 m <sup>2</sup> x 50 lekë/m <sup>2</sup>	8, 250
Totali i paguar		91, 160

Duke qenë se vlera e investimit sipas preventivit është 5,411,900 lekë, me e vogël se çmimi i referencës, si bazë për llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë është marrë referenca e Entit Kombëtar të Banesave në vlerën 8,088,532 lekë.

Nga auditimi u konstatua se:

Në lidhje me aplikimin për lejen e ndërtimit rezulton se në prokurën e posaçme me nr. 564 repertori dhe nr.321 koleksioni datë 28.02.2023 kanë dhënë pëlqimin për kryerjen e veprimeve për lejen e ndërtimi, duke emëruar përfaqësues z. K B, vetëm 5 bashkëpronarë. Ndërsa, në certifikatën e pronësisë rezulton se pasuria me nr.210/6, zona kadastrale 3203, me sipërfaqe totale 1261 m<sup>2</sup>, nga të cilat 300 m<sup>2</sup> truall dhe 120m<sup>2</sup> ndërtesë është në pronësi të 6 bashkëpronarëve, nga ku rezulton se mungon pëlqimi i bashkëpronares, znj. H H. Po ashtu, njëri nga bashkëpronarët, z. B H ka nënshkruar prokurën për kryerjen e veprimeve për lejen e ndërtimit edhe në emër të bashkëpronares znj. T Ç, pa patur tagër përfaqësimi për veprime të tilla, sipas prokurës së posaçme nr. 1519, nr.1069 koleksioni datë 07.08.2021.

Në bazë të nenit 11, pika 1, germa (ç) të VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, në rastet kur prishja shoqërohet me ndërtim të ri, leja për prishje është pjesë e lejes së ndërtimit dhe shënohet në kushtet e dokumentit të lejes. Në rastin konkret, prishja nuk është shënuar në rubrikën e kushteve të lejes si dhe mungon akti i prishjes. Në rubrikën përkatëse duhet të specifikohet se njoftimi për fillimin e punimeve të shoqërohet me aktin teknik të shembjes së objektit ekzistues.

*Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1150/1 datë 27.05.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 189/13 datë 29.05.2024 nga z. E B, znj. M H dhe znj. M P janë shprehur objeksionet për procedurat si më poshtë:*

**Pretendimi i Subjektit:** Sqarojmë se “mbas miratimit të lejes me nr 58, datë 16/08/2023, znj. H H nuk ka patur asnjë ankesë dhe leja është dhënë në emër të B H etj”. Ndërkohë me shkresën nr.189/13 datë 29.05.2024, observacione për projekt-raportin, Bashkia Prrrenjas ka sjellë bashkëlidhur një prokurë nr. 1522 repertori dhe nr.1071 koleksione datë 09.08.2021 të znj. H H ku nuk përmendet tagri i përfaqësimit për aplikimin për leje ndërtimi.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Observacioni nuk do merret në konsideratë pasi të gjithë bashkëpronarët duhet të shprehin pëlqimin, në bazë të nenit 15 të VKM nr.408/2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.

<sup>27</sup> Në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.11, dt.26/12/2022 “Për miratimin e paketës fiskale të Bashkisë Prrrenjas për vitin 2023 dhe planin e të ardhurave 2023” taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet familjare është 1 % dhe për ndërtimet me efekt biznesi është 2%.

<sup>28</sup> TarifA për mure të jashtme ndërtimi në zbatim të VKB nr.11, dt.26/12/2022 “Për miratimin e paketës fiskale të Bashkisë Prrrenjas për vitin 2023 dhe planin e të ardhurave 2023” është 15 lekë/m

<sup>29</sup> TarifA për akt piketimi është 50 lekë/m<sup>2</sup>

**Me nr.1391 prot., datë 24.05.2023 është miratuar leja e ndërtimit për zhvilluesin z. Fatmir Nezha** me objekt “Prishje ndërtimi ekzistues dhe ndërtim banese të re, podrum 1 kat+banesë”, me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi 238.70 m<sup>2</sup>, me lartësi maksimale 7m. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se subjekti ka dorëzuar:

Projektin dhe relacionin teknik

Projektin dhe relacionin konstruktiv

Preventivin e punimeve

Certifikatën e pronësisë

Etj.

Vlera e investimit është përlllogaritur sipas kostos mesatare të Entit Kombëtar të Banesave, për qytetin e Prrenjasit, në vlerën 32,393 lekë/m<sup>2</sup>.

Taksa +tarifa	Përlllogaritja	Vlera
Vlera e investimit	238.70m <sup>2</sup> x32393 lekë/m <sup>2</sup>	7, 732, 209
Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë	7 732 209 * 1%	77, 322
Tarifë për mure të jashtme	140 m <sup>2</sup> x 15 lekë/m <sup>2</sup>	2100
Tarifë për akt piketimi	99 m <sup>2</sup> x 50 lekë/m <sup>2</sup>	4, 950
<b>Totali i paguar</b>		<b>84,372</b>

Duke qenë se vlera e investimit sipas preventivit është 7,116,685 lekë, me e vogël se çmimi i referencës, si bazë për llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë është marrë referenca e Entit Kombëtar të Banesave në vlerën 7,732,209 lekë.

Nga auditimi u konstatua se:

Në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor, lartësia maksimale e lejuar në njësinë strukturore 2/384 është 6 m, ndërsa në lejen e ndërtimit është përcaktuar 7 m.

Në bazë të nenit 11, pika 1, germa (ç) të VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, në rastet kur prishja shoqërohet me ndërtim të ri, leja për prishje është pjesë e lejes së ndërtimit dhe shënohet në kushtet e dokumentit të lejes. Në rastin konkret, prishja nuk është shënuar në rubrikën e kushteve të lejes si dhe mungon akti i prishjes. Në rubrikën përkatëse duhet të specifikohet se njoftimi për fillimin e punimeve duhet shoqëruar me aktin teknik të shembjes së objektit ekzistues.

*Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1150/1 datë 27.05.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 189/13 datë 29.05.2024 nga z. E B, znj. M H dhe znj. M P janë shprehur objeksionet për procedurat si më poshtë:*

**Pretendimi i Subjektit:** Sqarojmë se aktin e prishjes e kërkon në momentin që zhvilluesi aplikon për certifikatë përdorimi, së bashku me deklaratën e subjektit ndërtues që ka kryer punimet sipas projekt-preventivit të miratuar (ku faktohet edhe prishja e objektit) dhe me një akt noterial nga zhvilluesi që është bërë prishja e objektit ekzistues. Gjithashtu specialistët e drejtorisë së planifikimit, zhvillimit të territorit dhe aplikimit të projekteve dhe inspektorët e IVMT-së Prrenjas, pasi zhvilluesi ka bërë njoftimin që do të fillojë punime, bëjnë kontrolle për çdo fazë të ndërtimit të objektit, në zbatim të ligjit 8402, datë 10/09/1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar. Me shkresën nr.189/13 datë 29.05.2024, observacione për projekt-raportin, Bashkia Prrenjas ka paraqitur të njëjtat komente.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Akti teknik i prishjes së objektit duhet t’i bashkëngjitet aplikimin për fillimin e punimeve, pra në fazën e parë të lejes dhe jo në fazën e fundit të lëshimit të certifikatës së përdorimit.

**Me nr.1161 prot., datë 29.05.2023 është miratuar leja e ndërtimit në emër të zhvilluesit z.Kodhel Bogdani** me objekt “Ngritje kati (me mbulesë çatie) në objektin ekzistues” me sipërfaqe ndërtimi 120 m<sup>2</sup>, me lartësi maksimale 8.12 m. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se subjekti ka dorëzuar:

Projektin dhe relacionin teknik

Projektin dhe relacionin konstruktiv

Preventivin e punimeve

Certifikatën e pronësisë

Etj.

Vlera e investimit është përlogaritur sipas kostos mesatare të Entit Kombëtar të Banesave, për qytetin e Prrenjasit në vlerën 32,393 lekë/m<sup>2</sup>.

Taksa +tarifa	Përlogaritja	Vlera
Vlera e investimit	120 m <sup>2</sup> x 32 393 lekë/m <sup>2</sup>	3, 887, 160
Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë	3 887 160* 1%	38, 872
Tarifë për mure të jashtme	98 m <sup>2</sup> x 15 lekë/m <sup>2</sup>	1, 470
<b>Totali i paguar</b>		<b>40 342</b>

Duke qenë se vlera e investimit sipas preventivit është 2,891,527 lekë, me e vogël se çmimi i referencës, si bazë për llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë është marrë referenca e Entit Kombëtar të Banesave në vlerën 3,887,160 lekë.

Nga auditimi u konstatua se:

Në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor, lartësia maksimale e lejuar në njësinë strukturore 4/315 është 6 m, ndërsa në lejen e ndërtimit është përcaktuar 8.12 m.

**Me nr.557 prot., datë 20.04.2023 është miratuar leja e ndërtimit në emër të zhvilluesit z. Xhevat dhe znj. Drita Onuzi** me objekt “Shtesë anësore në objektin ekzistues Podrum 1 kat + ngritje 2 kat (me mbulesë çati)” me sipërfaqe totale ndërtimi të ri 238.3 m<sup>2</sup>, me lartësi maksimale kati 9.22 m.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se subjekti ka dorëzuar:

Projektin dhe relacionin teknik

Projektin dhe relacionin konstruktiv

Preventivin e punimeve

Certifikatën e pronësisë

Etj.

Vlera e investimit është përlogaritur sipas kostos mesatare të Entit Kombëtar të Banesave, për qytetin e Prrenjasit në vlerën 32,393 lekë/m<sup>2</sup>.

Taksa +tarifa	Përlogaritja	Vlera
Vlera e investimit	238.3 m <sup>2</sup> x 32 393 lekë/m <sup>2</sup> =	7, 719, 252
Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë	7 719 252* 1%	77, 193
Tarifë për mure të jashtme	180 m <sup>2</sup> x 15 lekë/m <sup>2</sup>	2,700
Tarifa për akt piketimi	115.1 m <sup>2</sup> x 50 lekë/m <sup>2</sup>	5,755
<b>Totali i paguar</b>		<b>85, 648</b>

Duke qenë se vlera e investimit sipas preventivit është 6,137,534 lekë, me e vogël se çmimi i referencës, si bazë për llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë është marrë referenca e Entit Kombëtar të Banesave në vlerën 7,719,252 lekë.

Nga auditimi u konstatua se:

Në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor, lartësia maksimale e lejuar në njësinë strukturore 1/20 është 6 m, ndërsa në lejen e ndërtimit është përcaktuar 9.22 m.

Nga shqyrtimi i projektit arkitektonik rezulton se leja e ndërtimit duhet të kishte si objekt një ndërtim të ri dhe jo shtesë. Ndonëse në certifikatën e pronësisë ka një objekt ekzistues me sipërfaqe 47 m<sup>2</sup>, në terren rezulton se është një podrum nëntokësor, çka nuk është shoqëruar me një akt ekspertize për të argumentuar sesi ky podrum mund të shërbejë si një bazë të qëndrueshme për ngritjen e një banese 2 kate me lartësi 9.22 m.

*Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1150/1 datë 27.05.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 189/13 datë 29.05.2024 nga z. E B, znj. M H dhe znj. M P janë shprehur objeksionet për procedurat si më poshtë:*

**Prendimi i Subjektit:** Sqarojmë se nga aplikanti, inxhinieri konstruktor në projektin konstruktiv, relacionin konstruktiv, në specifikimet teknike dhe preventivin e punimeve rezulton që në kuotën -2.4m ka kolona. Nga analiza dhe dokumentet e paraqitura ky objekt është një bazë e qëndrueshme për të ndërtuar objektin "Shtesë anësore në objektin ekzistues "Podrum 1 kat + ngritje 2 kat (me mbulesë

çati)". Gjithashtu është dorëzuar deklarata e përgjegjësisë profesionale të inxhinierit konstruktor, z. K B, që ka hartuar projektin konstruktiv në përputhje me legjislacionin në fuqi. Me shkresën nr.189/13 datë 29.05.2024, observacione për projekt-raportin, Bashkia Prrenjas ka sjellë të njëjtat komente. **Qëndrimi i grupit të auditimit:** Obseravioni do të merret pjesërisht në konsideratë, pasi do të rekomandohet që për raste të tilla të bashkëngjitet një akt qëndrueshmërie për objektin.

**Me nr.1851 prot., datë 19.09.2023 është miratuar leja e ndërtimit në emër të zhvilluesit z.Bashkim dhe Violeta Cura** me objekt “Prishje objekti ekzistues “lokal 1 kat dhe ndërtim objekti të ri 1 kat socio-ekonomik”, me sipërfaqe 40 m<sup>2</sup>.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se subjekti ka dorëzuar:

Projektin dhe relacionin teknik

Projektin dhe relacionin konstruktiv

Preventivin e punimeve

Certifikata pronësie

Etj.

Vlera e investimit është përlogaritur sipas kostos mesatare të Entit Kombëtar të Banesave, për qytetin e Prrenjasit në vlerën 32,393 lekë/m<sup>2</sup>.

Taksa +tarifa	Përlogaritja	Vlera
Vlera e investimit	40 m <sup>2</sup> x 32 393 lekë/m <sup>2</sup>	1 295 720
Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë	1 640 296 * 2%	32 850
Tarifë për mure të jashtme	8 m <sup>2</sup> x 15 lekë/m <sup>2</sup>	120
Tarifë për akt piktimi	40 m <sup>2</sup> x 50 lekë/m <sup>2</sup>	2000
Totali i paguar		34925

Si bazë për përlogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë është marrë vlera e investimit sipas preventivit 1,640,296 lekë, duke qenë se është më e madhe se çmimi i referencës së Entit Kombëtar të Banesave në vlerën 1,295,720 lekë.

Nga auditimi u konstatua se:

Zhvilluesi disponon certifikatë pronësie për pasurinë nr. 2/707, e llojit “njësi” me sipërfaqe 40 m<sup>2</sup> e cila rezulton se nuk ka marrëdhënie me truallin. Nga dokumentacioni i aksesuar në e- leje konstatohet se në kartelën pronësore ka përshkrim “regjistruar me dokument nr.5501, blerë truall me VKM me sipërfaqe 40 m<sup>2</sup>”, por mungon dokumenti provues mbi pronësinë e truallit.

*Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1150/1 datë 27.05.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 189/13 datë 29.05.2024 nga z. E B, znj. M H dhe znj. M P janë shprehur objeksionet për procedurat si më poshtë:*

**Prendimi i Subjektit:** Sqarojmë se “Në hartën treguese lëshuar më datë 16/06/2023 dhe kartelën e pasurisë lëshuar më datë 21/06/2023, nga ASHK, Drejtoria Vendore Librazhd, është shënuar që z.B C është pronar i një objekti 40m<sup>2</sup>, të llojit njësi dhe sipërfaqe të truallit 40m<sup>2</sup>. Ku te pika E- Informacione të tjera të pronës në kartelë shkruhet shprehimisht: "Regjistruar me dokument nr.5501 bashkim pasurie, blerë truall me VKM me sipërfaqe 40 m<sup>2</sup>. Harta dhe kartela janë dokumentacion që lëshohen nga institucion zyrtar si ASHK, Librazhd, ku çdo shënim konsiderohet si dokumentacion provues apo vërtetues mbi pronësinë. Me shkresën nr.189/13 datë 29.05.2024, observacione për projekt-raportin, Bashkia Prrenjas ka sjellë të njëjtat komente.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në certifikatën e pronësisë administruar në E- leje mungon marrëdhënia me truallin, por në seksionin e pronësisë ka të shënuar vetëm 40 m<sup>2</sup> njësi, çka nënkupton se trualli rezulton si sipërfaqe funksionale bashkëpronësie e objektit bazë.

**Me nr. 798 prot., datë 15.05.2023 është miratuar leja e ndërtimit në emër të zhvilluesit z.Ditjon Alisufi** për objektin “Podrum 1 kat + banesë 1 kat + çati” me sipërfaqe totale ndërtimi 175.50 m<sup>2</sup> me lartësi maksimale 5.05 m<sup>2</sup>.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se subjekti ka dorëzuar:

Projektin dhe relacionin teknik

Projektin dhe relacionin konstruktiv



Preventivin e punimeve

Certifikata pronësie

Etj.

Vlera e investimit është përlogaritur sipas kostos mesatare të Entit Kombëtar të Banesave, për qytetin e Prrenjasit në vlerën 32,393 lekë/m<sup>2</sup>.

Taksa +tarifa	Përlogaritja	Vlera
Vlera e investimit	175.70 m <sup>2</sup> x 32 393 lekë/m <sup>2</sup>	5,691,450
Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë	5 691 450 * 1%	=6,915
Tarifë për mure të jashtme	138 m <sup>2</sup> x 15 lekë/m <sup>2</sup>	2,070
Tarifa për akt piketimi	122.20 m <sup>2</sup> x 50 lekë/m <sup>2</sup> =	6,110
Totali i paguar		65,095

Duke qenë se vlera e investimit sipas preventivit është 4,659,195 lekë, më e vogël se çmimi i referencës, si bazë për llogaritjen e vlerës së investimeve është marrë referenca e Entit Kombëtar të Banesave në vlerën 5,691,450 lekë.

Nga auditimi u konstatua se :

Në bazë të dokumentacionit të lejes së ndërtimit, plani i rilevimit bën një paraqitje të papërditësuar të situatës faktike në terren, pasi në bazë të ortofotove nga aplikacioni “Google Earth” rezulton se ka objekt ekzistues.

**Me nr. 2211 prot., datë 14.12.2023 është miratuar leja e ndërtimit në emër të zhvilluesit z. P H** për objektin “Banesë e re individuale 2 kat + çati” me sipërfaqe totale ndërtimi 154.5 m<sup>2</sup> me lartësi maksimale 8.2 m.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se subjekti ka dorëzuar:

Projektin dhe relacionin teknik

Projektin dhe relacionin konstruktiv

Preventivin e punimeve

Certifikata pronësie

Etj.

Vlera e investimit është përlogaritur sipas kostos mesatare të Entit Kombëtar të Banesave, për qytetin e Prrenjasit në vlerën 32,393 lekë/m<sup>2</sup>.

Taksa +tarifa	Përlogaritja	Vlera
Vlera e investimit	154.50 m <sup>2</sup> x 32 393 lekë/m <sup>2</sup>	5, 004, 718.5
A.Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë	5 091 531 * 1%	50, 915
B.Tarifë për mure të jashtme	142 m <sup>2</sup> x 15 lekë/m <sup>2</sup>	2, 130
C.Tarifa për akt piketimi	66.80 m <sup>2</sup> x 50 lekë/m <sup>2</sup>	3 ,340
Totali i paguar		56, 385

Si bazë për përlogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë është marrë vlera e investimit sipas preventivit 5,091,531 lekë, duke qenë se është më e madhe se çmimi i referencës së Entit Kombëtar të Banesave në vlerën 5,004,718 lekë.

Nga auditimi u konstatua se:

Në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor, lartësia maksimale e lejuar në njësinë strukturore 4/95 është 6 m, ndërsa në lejen e ndërtimit është përcaktuar 8.2 m.

**Me nr. 1755 Prot., datë 27.07.2023 është miratuar leja e ndërtimit në emër zhvilluesit z. Xh B** me objekt “Ngritje kati (me mbulesë çati) në objektin ekzistues 1 kat”, me sipërfaqe totale të ndërtimit të ri prej 107.5 m<sup>2</sup>, me lartësi maksimale 8.3 m.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se subjekti ka dorëzuar:

Projektin dhe relacionin teknik

Projektin dhe relacionin konstruktiv

Preventivin e punimeve

Certifikatën e pronësisë

Etj.

Vlera e investimit është përllogaritur sipas kostos mesatare të Entit Kombëtar të Banesave, për qytetin e Prrenjasit në vlerën 32,393 lekë/m<sup>2</sup>.

Taksa +tarifa	Përllogaritja	Vlera
Vlera e investimit	107.50 m <sup>2</sup> x 32 393 lekë/m <sup>2</sup>	3 482 247
A.Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë	3 482 247 * 1%	34 822
B.Tarifë për mure të jashtme	81 m <sup>2</sup> x 15 lekë/m <sup>2</sup>	1215
Totali i paguar		36 037

Duke qenë se vlera e investimit sipas preventivit është 2,859,103 lekë, më e vogël se çmimi i referencës, si bazë për llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë është marrë referenca e Entit Kombëtar të Banesave në vlerën 3,482,247 lekë.

Nga auditimi u konstatua se:

Në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor, lartësia maksimale e lejuar në njësinë strukturore 1/20 është 6 m, ndërsa në lejen e ndërtimit është përcaktuar 8.3 m.

*Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1150/1 datë 27.05.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 189/13 datë 29.05.2024 nga z. E B, znj. M H dhe znj. M P janë shprehur objeksionet për procedurat si më poshtë:*

**Pretendimi i Subjektit:** Sqarojmë se “Mbushja urbane nënkupton zhvillimin e parcelave bosh të pandërtuara me ndërtime të reja, me tregues zhvillimi të ngjashëm me ato të gjithë zonës, që do të thotë se treguesit në nivel parcele ngelen të njëjtë me treguesit që mbizotërojnë në zonë, ndërsa treguesit në nivel njësie do të rriten si pasojë e dendësimit. Në njësitë strukturore janë objekte të formës 2 kat të mbuluara me çati, të cilat variojnë me lartësi 7 m deri në 9 m. Pra është respektuar nr. i kateve sipas PPV-së, leja është dhënë për një objekt të formës 2kat, me lartësi 6m (Lartësia dysheme–dysheme për katet banim është minimumi 3.00 m, ku thuhet në VKM 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar). Ndërsa pjesa tjetër është lartësia e çatisë (ku konsiderohen ndërtim që ndërtohet edhe me deklaratë paraprake punimesh). Me shkresën nr.189/13 datë 29.05.2024, observacione për projekt-raportin, Bashkia Prrenjas ka sjellë të njëjtat komente.

**Oëndrimi i grupit të auditimit.** Përcaktimet e pasaportave të njërive strukturore të Planit të Përgjithshëm Vendor janë detyruese për t’u zbatuar sipas nenit 32 në referencë të kushteve bazë të zhvillimit. Përllogaritjet e nenit 37 vlejnë vetëm kur nuk ka rregullore, pra PPV të miratuar, sipas nenit 37 pika 3 e VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se:

Në 1 rast, me lejen nr. 1756/1 prot., datë 27.07.2023 për zhvilluesin z.B H H me objekt “Prishje ndërtimi ekzistues dhe ndërtim banese të re, podrum 1 kat+banesë”, me sipërfaqe ndërtimi 120 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe e përgjithshme ndërtimi 249.70 m<sup>2</sup>, me lartësi maksimale 6.5 m është konstatuar se në prokurën e posaçme me nr. 564 repertori dhe nr. 321 koleksioni datë 28.02.2023 mungon pëlqimi i dy prej bashkëpronarëve për kryerjen e veprimeve juridike dhe administrative për lejen e ndërtimit.

Në 1 rast, me lejen nr.1851 prot., datë 19.09.2023 për zhvilluesin z. B dhe znj. V C me objekt “Prishje objekti ekzistues “lokal 1 kat dhe ndërtim objekti të ri 1 kat socio-ekonomik”, zhvilluesi disponon certifikatë pronësie për pasurinë nr. 2/707, e llojit “njësi” me sipërfaqe 40 m<sup>2</sup> por mungon dokumenti provues i pronësisë që rregullon marrëdhënien me truallin. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin e territorit”. VKM nr. 408/2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se në 5 raste nuk është respektuar lartësia maksimale e kateve, konkretisht:

Leja e ndërtimit nr.1391 prot., datë 24.05.2023 për zhvilluesin z.F N me objekt “Prishje ndërtimi ekzistues dhe ndërtim banese të re, podrum 1 kat+banesë, lartësia maksimale e lejuar në njësinë strukturore 2/384 është 6 m, ndërsa në lejen e ndërtimit është përcaktuar 7 m.

Leja e ndërtimit nr.1161 prot., datë 29.05.2023 për zhvilluesin z.K B me objekt “Ngritje kati (me mbulesë çati) në objektin ekzistues”, lartësia maksimale e lejuar në njësinë strukturore 4/315 është 6 m, ndërsa në lejen e ndërtimit është përcaktuar 8.12 m.

Leja e ndërtimit nr.557 prot., datë 20.04.2023 për zhvilluesin z.Xh dhe znj.D O me objekt “Shtesë anësore në objektin ekzistues Podrum 1 kat + ngritje 2 kat”, lartësia maksimale e lejuar në njësinë strukturore 1/20 është 6 m, ndërsa në lejen e ndërtimit është përcaktuar 9.22 m

Leja e ndërtimit nr. 2211 prot., datë 14.12.2023 për zhvilluesin z.P H për objektin “Banesë e re individuale 2 kat + çati”, lartësia maksimale e lejuar në njësinë strukturore 4/95 është 6 m, ndërsa në lejen e ndërtimit është përcaktuar 8.2m

Leja e ndërtimit 1755 Prot., datë 27.07.2023 për zhvilluesin z.Xh B me objekt “Ngritje kati (me mbulesë çati) në objektin ekzistues 1 kat”, lartësia maksimale e lejuar në njësinë strukturore 1/20 është 6 m, ndërsa në lejen e ndërtimit është përcaktuar 8.3m.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin e territorit”. VKM nr. 408/2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Prenjas.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se:

Në 2 raste, përkatësisht për lejet me nr. 1756/1 prot., datë 27.07.2023 dhe nr.1391 prot., datë 24.05.2023, leja për prishje nuk është shënuar në kushtet e dokumentit të lejes si dhe mungon akti teknik i shembjes. Në rubrikën përkatëse të kushteve nuk është specifikuar se njoftimi për fillimin e punimeve duhet shoqëruar me aktin teknik të shembjes së objektit ekzistues.

Në 1 rast, nga shqyrtimi i projektit arkitektonik rezulton se leja e ndërtimit duhet të kishte si objekt një ndërtim të ri dhe jo shtesë. Ndonëse në certifikatën e pronësisë ka një objekt ekzistues me sipërfaqe 47 m<sup>2</sup>, në terren rezulton se është një podrum nëntokësor, çka nuk është shoqëruar me një akt ekspertize për të argumentuar sesi ky podrum mund të shërbejë si një bazë të qëndrueshme për ngritjen e një banese 2 kate me lartësi 9.22 m.

Në 1 rast, për lejen nr. 798 prot., datë 15.05.2023, në bazë të dokumentacionit të lejes së ndërtimit, plani i rilevimit bën një paraqitje të papërditësuar të situatës faktike në terren, pasi në bazë të ortofotove nga aplikacioni “Google Earth” rezulton se ka objekt ekzistues.

Veprime në kundërshtim me Neni 11, pika 1, germa (ç) të VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.

## **2.6. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor. (IMTV).**

Në zbatim të pikës 6 të programit të auditimit, grupi i auditimit, për periudhën objekt auditimi 01.01.2023 – 31.12.2023, kërkoi vënien në dispozicion të dokumenteve të nevojshme siç janë, struktura e IMTV dhe formimi profesional i stafit të kësaj strukture, dosjet e procedurave të mbajtura nga IMTV, në të cilat duhet të përfshihen procesverbalet e konstatimit të mbajtura nga inspektorët, vendimet e gjobave, vendimet e pezullimit, vendimet e prishjeve dhe procesverbalet e ekzekutimit të këtyre prishjeve, kallëzimet penale, kërkesat drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv, informacioni periodik 3 mujor që dërgohet pranë IKMT, planet vjetore dhe planet mujore të punës të miratuara nga kryeinspektori.

Sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion në lidhje me organizimin e Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes Territorit, për periudhën 01.01.2022-31.12.2023, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IMTV, këtu e në vijim), është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 4, të Ligjit nr.9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”.

Për vitin 2022-2023, struktura e IMTV përbëhet nga 4 punonjës, nga të cilët 1 Kryeinspektor dhe 3 Inspektorë. IMTV është drejtuar për periudhën nën auditim nga Kryeinspektor G B nga data 23 Janar 2023 deri 12 Korrik 2023, me profesion Inxhinier Topograf dhe në vazhdim nga

data 22.11.2023 deri më datë 31.01.2024 nga J K. Për periudhën nën auditim, edhe punonjësit që kanë kryer detyrën e inspektorëve, kanë arsimimin për inxhinieri.

Sa më sipër, konstatohet se arsimimi i tyre është në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, i cili përcakton detyrimin për arsimimin e lartë të inspektorëve, dhe llojin e arsimit të kërkuar.

Struktura organizative e IMTV në Bashkinë Prrenjas, sipas viteve nga data 01.01.2023 deri në datën 31.12.2023.

NR	Emër, Mbiemër	Pozicioni sipas strukturës	Profesioni	Arsimi	Periudha e Punës
1	G Ç	Kryeinspektor	Inxhinier Gjeologjie	I Lartë	01.02.2022 - 23.01.2023
2	G B	Kryeinspektor	Inxhinier Topograf	I Lartë	23.01.2023-12.07.2023
3	A A	Inspektor	Inxhinier Burimet Natyrore	I Lartë	18.06.2020 - Vazhdim
4	J K	Inspektor Kryeinspektor Inspektor	Teknologji Informacioni, Informatike ekonomike	I Lartë	13.01.2023-21.11.2023 22.11.2023- 31.01.2024 01.02.2024 - vazhdim
5	S D	Inspektor Mjedisi	Teknik Mjedisi	I Lartë	08.08.2023-Vazhdim

Burimi: Bashkia Prrenjas

Në vijim, aktet e inspektimit të mbajtura nga Inspektorët për procedurat e IMTV në Bashkinë Prrenjas, për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.203 për personat fizik dhe juridik, si më poshtë vijon;

Nr.	Emri Subjektit	Lloj objektit	Vendimi	
			Nr.	Datë
1.	A e D H	Mosrespektimi i afatit të punimeve	167	16.01.2023
2.	R K	Ndërtim objekti 2 kat me kollona + kati dyte teknik vetem kollona + murature	168	27.01.2023
3.	R F	Shtese anesore 1 kat ne objekt ekzistues 1 kat	169	06.02.2023
4.	R K	Mosrespektimi i afatit të punimeve	170	18.04.2023
5.	V G	Ngritje kati ne objekt ekzistues 1 kat	171	18.04.2023
6.	Ç H	Ndertim objekt 1 kat banimi	172	18.04.2023
7.	S M	Ndertim objekt 1 kat banimi	173	24.05.2023
8.	A A	Punime shtrimi me pllake (kocke)	174	30.05.2023
9.	L R	Ndertim mur rrethues	175	31.05.2023
10.	H F	Ndertim objekt 1 kat banimi	176	02.06.2023
11.	A Z	Ndertim pa leje ngritje kati me çati	177	02.06.2023
12.	D O	Ndertim pa leje 1 kat + 1 kat nentoke	178	02.06.2023
13.	A R	Ndertim pa leje me mur guri + mur me beton arme + kollona	179	08.06.2023
14.	K H	Rrethim prone publike pa leje perkatese	180	15.06.2023
15.	B R	Ndertim objekt 1 kat banimi	181	19.06.2023
16.	S H	Ndertim objekt 1 kat banimi	182	01.08.2023
17.	A A	Mbyllja e deres pa leje perkatese	183	01.08.2023
18.	N B	Shkelja e projektit te miratuar	184	01.08.2023
19.	Sh”S P”	Shkelja e projektit te miratuar	185	29.08.2023
20.	M V	Shkelja e projektit te miratuar	186	30.08.2023
21.	E K	Shkelja e projektit te miratuar	187	04.09.2023
22.	S R	Ngritje kati ne objekt ekzistues 1 kat	188	04.09.2023
23.	A L	Godine 2 kat pa leje ndertimi	189	04.09.2023
24.	S Q	Shtese anesore ne objekt ekzistues + mure mbajtes	190	04.09.2023
25.	H M	Mur mbajtes +kollona pa leje	191	06.09.2023
26.	S B	Prishje objekti te vjeter, ndertim xokel + kollona	192	06.09.2023
27.	B K	Shtese anesore + ngritje kati, kollona + solete	193	19.09.2023
28.	R B	Ngritje kati ne objekt ekzistues	194	25.09.2023
29.	Sh R	Ndertim objekti 2 kat	195	27.09.2023
30.	M H	Ndertim objekti 2 kat	196	05.10.2023
31.	F M	Ndertim I 2 xokelave pa leje	197	06.10.2023
32.	L V	Mosrespektimi i afatit të punimeve	198	09.10.2023
33.	E, B K	Hapje rruge dhe ndertim muri mbajtes pa leje	199	18.10.2023
34.	E SBS R K	Mosrespektimi i afatit të punimeve	200	19.10.2023
35.	Sh H T SH.P.K	Punime germimi, krijim toke per aktivitet, vendosje peshore, kioska	201	07.11.2023
36.	I B	Shkelja e projektit te miratuar	202	17.11.2023

Burimi: Bashkia Prrenjas

Në zbatim të pikës 6.1.2. të programit të auditimit, mbi vendimet e marra nga IMTV dhe procedurat e ndjekur në lidhje me vendimet për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV, u konstatua se:

-Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 nga Inspektorët e Inspektoriatit të Mbrojtjes të Territorin në Bashkinë Prrenjas, kanë mbajtur gjithsej 36 akte konstatimi, për ndërtime informale pa leje ndërtimi dhe për objekte për mosrespektim të afatit të punimeve. Nga këto, për 7 subjekte është marrë vendim për pezullim të punimeve, për 7 prej tyre është nxjerrë vendim për prishjen e objektit, për 10 prej tyre është marrë vendim gjobe dhe për 7 prej tyre është vijuar me kallëzim penal.

Nga 7 vendime të marra për prishjen e objektit, nga IMTV-ja nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm dhe për këto objekte, në praktikat përkatëse të mbajtuara nga inspektorët, ndërtimet e konstatuara nuk janë shoqëruar me fotot përkatëse, nuk disponohet dokumentacion justifikues, në lidhje me nxjerrjen e vendimeve ekzekutive nga gjykata administrative, në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u shqyrtua dokumentacioni me përzgjedhje për procedurat e ndjekura nga IMTV-ja për ndërtimet informale të ndërtuara pa leje ndërtimi dhe për objektet në shkelje të lejes së ndërtimit.

#### R K

Nga inspektimi i bërë në terren me datë 27.01.2023, nga Inspektorët e Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Prrenjas, A A dhe J K, kanë ushtruar kontroll me adresë në zonën Prrenjas Fshat, Bashkia Prrenjas.

Gjatë kontrollit inspektorët e terrenit të IMTV-së më datë 27.01.2023 kanë mbajtur procesverbal për konstatimin e kundërvatjes, ndërtim objekti 2 kat me kollona + kati i dytë teknik vetëm kollona + muraturë të sapofilluar.

Në vazhdim të procedurës, inspektorët e terrenit kanë përgatitur relacion për vazhdimin e procedurës ligjore dhe marrjen e vendimit për dënimin me gjobë nga Kryeinspektori.

Në dosje mungon procesverbali për pezullimin e punimeve nga Kryeinspektori dhe vazhdimin e procedurës së mëtejshme për dënimin me gjobë.

#### **Konkluzion:**

-Nga Kryeinspektori i IMTV-së nuk është respektuar afati ligjor për nxjerrjen e masës administrative vendim për pezullimin e punimeve, jo në përputhje me kërkesat e nenit 13 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar, i cili përcakton se: *brenda 10 ditëve nga marrja e kopjes së procesverbalit ose e njoftimit për rezultatin e kontrollit, inspektorët e inspektoriatit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut/kombëtar nxjerrin vendimin për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, i cili nënshkruhet nga kryeinspektori.*

-Nuk është respektuar procedura për të vijuar me nxjerrjen e Urdhërit të Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm jo në përputhje me kërkesat e nenit 5,12 të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011, ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", nenit 51 të ligjit 8402, datë 10.09.1998 dhe VKM 408, datë 13.05.2015, si dhe nenit 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

- Në dosje mungon vendimi për dënimin me gjobë dhe nxjerrjen e urdhërit të ekzekutimit, sipas neneve 20, 22 dhe 30 të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

-Nga IMTV-ja e Bashkisë Prrenjas është konstatuar se subjekti ka kryer ndërtim të paligjshëm, duke konsumuar elementet e vepres penale të parashikuar në nenin 199/a i Kodit Penal dhe në vijim nuk është përgatitur dosja për të vijuar me kallëzim penal në ngarkim të subjektit ndërtues, për veprën penale "Ndërtimi i paligjshëm" parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal.

#### R K, subjekti ndërtues "E SBS"

Nga inspektimi i bërë në terren me datë 18.04.2023, nga Inspektoret e Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Prrenjas, A A dhe J K, kanë ushtruar kontroll me adresë në zonën Bashkia Prrenjas, në subjektin fizik z. R K, "E SBS".

Gjatë kontrollit inspektoret e terrenit të IMTV-së me procesverbalin nr. 170, datë 18.04.2023 kanë mbajtur proces-verbal për konstatimin e kundërvatjes nuk është respektuar afati i përfundimit të punimeve.

Në vazhdim të procedurës, inspektoret e terrenit kanë përgatitur relacion, sipas parashikimit ligjor për vazhdimin e procedurës ligjore dhe marrjen e vendimit për dënimin me gjobë nga Kryeinspektori.

Me vendimin nr. 23, datë 22.11.2023 është vijuar praktika për dënimin e kundërvajtësit z. R K me gjobë në masën 100,000 (njëqind mijë) lekë.

Me mandatin e arkëtimit nr.2818, datë 22.11.2023, me nr. Serisë 12232, gjoba është arkëtuar nga subjekti fizik.

#### **Konkluzion:**

-Nga Kryeinspektori i IMTV-së nuk është vijuar procedura ligjore për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit dhe vendimeve ekzekutive nga gjykata për dënimin me gjobë, si akt që përbën titull ekzekutiv, jo në përputhje me kërkesat e nenit 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

-Nuk është bërë kërkesa për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, drejtuar Gjykatës Administrative për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit.

-Nuk është respektuar afati ligjor për nxjerrjen e masës administrative, i cili përcakton se: *brenda 10 ditëve nga mbajtja e procesverbalit të konstatimit të kundërvajtjes, Inspektoriatit Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore nxjerrin vendimin për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, të cilat nënshkruhen nga kryeinspektori*, jo në përputhje me kërkesat e nenit 13 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

#### S M

Nga inspektimi i bërë në terren me datë 24.05.2023, nga Inspektoret e Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Prrenjas, A A dhe J K, kanë ushtruar kontroll me adresë në zonën fshati Katodesh, Bashkia Prrenjas, në banesën e shtetasit S M.

Gjatë kontrollit inspektoret e terrenit të IMTV-së me procesverbalin nr. 173, datë 24.05.2023 kanë mbajtur proces-verbal për konstatimin e kundërvatjes ndërtim objekti 1 kat me muraturë tulle + soletë.

Në vazhdim të procedurës, inspektoret e terrenit kanë përgatitur relacion për vazhdimin e procedurës ligjore dhe marrjen e vendimit për dënimin me gjobë nga Kryeinspektori.

Me vendimin nr. 32, datë 24.05.2023 nga Kryeinspektori është vendosur me pezullimin e punimeve të ndërtimit të objektit 1 kat me muraturë tulle dhe soletë, në adresën fshati Katodesh, njësia Administrative Rrajcë, Bashkia Prrenjas.

Me vendimin nr. 16, datë 24.05.2023 është vijuar praktika për dënimin e kundërvajtësit z. S M me gjobë në masën 500.000 (pesëqind mijë) lekë.

Me vendimin nr. 4, datë 24.05.2023 është vijuar për prishje e objektit të kundërligjshëm 1 kat me muratur tulle të objektit të paligjshëm të z. S M.

#### **Konkluzion:**

-Nga Kryeinspektori i IMTV-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e Urdhërit të Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm dhe dënimin me gjobë, si akt që përbën titull ekzekutiv, jo në përputhje me kërkesat e nenit 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

-Në dosje mungon praktika për nxjerrjen e urdhërit të ekzekutimit, sipas neneve 20, 22 dhe 30 të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

-Nga IMTV-ja e Bashkisë Prrenjas është konstatuar se subjekti ka kryer ndërtim të paligjshëm, duke konsumuar elementet e vepres penale të parashikuar në nenin 199/a të kodit penal dhe në vijim nga IMTV-ja është përgatitur dosja për të vijuar me kallëzim penal në ngarkim të subjektit ndërtues, për veprën penale "Ndërtimi i paligjshëm" parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

-Në dosje mungon korrespondenca, kërkesë për mbështetje me Policinë e Shtetit, Policinë Bashkiake dhe IKMT, për veprimet e mëtejshme në funksion të dokumentimit dhe çfarë veprimesh janë marrë për objektin në fjalë. Gjoha rezulton e pa arkëtuar.

### A Z

Nga inspektimi i bërë në terren me datë 02.06.2023, nga Inspektoret e Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Prrenjas, A A dhe J K, kanë ushtruar kontroll me adresë në zonën fshati Katodesh, Bashkia Prrenjas, në subjektin fizik A Z.

Gjatë kontrollit inspektoret e terrenit të IMTV-së me procesverbalin nr. 177, datë 02.06.2023 kanë mbajtur proces-verbal për konstatimin e kundërvajtjes ndërtim pa leje, ngritje kati me çati.

Në vazhdim të procedurës, inspektoret e terrenit kanë përgatitur relacion për vazhdimin e procedurës ligjore dhe marrjen e vendimit për dënimin me gjobë nga Kryeinspektori.

Me vendimin nr. 36, datë 02.06.2023 nga Kryeinspektori është vendosur me pezullimin e punimeve të ndërtimit, në adresën fshati Katodesh, njësia Administrative Rrajcë, Bashkia Prrenjas.

Me vendimin nr. 20, datë 02.06.2023 është vijuar praktika për dënimin e kundërvajtësit z. A Z me gjobë në masën 500.000 (pesëqind mijë) lekë.

Me vendimin nr. 8, datë 02.06.2023 është nxjerrë vendim për prishje e objektit të paligjshëm të z.A Z.

### **Konkluzion:**

-Nga Kryeinspektori i IMTV-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e Urdhërit të Ekzekutimit për dënimin me gjobë, si akt që përbën titull ekzekutiv, jo në përputhje me kërkesat e nenit 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

-Nga IMTV-ja e Bashkisë Prrenjas është konstatuar se subjekti ka kryer ndërtim të paligjshëm, duke konsumuar elementet e vepres penale të parashikuar në nenin 199/a të kodit penal dhe në vijim nga IMTV-ja është përgatitur dosja për të vijuar me kallëzim penal në ngarkim të subjektit ndërtues, për veprën penale "Ndërtimi i paligjshëm" parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

-Në dosje mungon korrespondenca, kërkesë për mbështetje me Policinë e Shtetit, Policinë Bashkiake dhe IKMT, për veprimet e mëtejshme në funksion të dokumentimit dhe çfarë veprimesh janë marrë për objektin në fjalë.

### D O

Nga inspektimi i bërë në terren me datë 02.06.2023, nga Inspektorët e Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Prrenjas, A A dhe J K, kanë ushtruar kontroll me adresë në zonën Prrenjas, Bashkia Prrenjas, në subjektin fizik D O.

Gjatë kontrollit inspektoret e terrenit të IMTV-së me procesverbalin nr. 178, datë 02.06.2023 kanë mbajtur proces-verbal për konstatimin e kundërvajtjes ndërtim pa leje 1 kat + 1 kat nën tokë.

Në vazhdim të procedurës, inspektoret e terrenit kanë përgatitur relacion, sipas parashikimit ligjor për vazhdimin e procedurës ligjore dhe marrjen e vendimit për dënimin me gjobë nga Kryeinspektori.

Me vendimin nr. 37, datë 02.06.2023 nga Kryeinspektori është vendosur me pezullimin e punimeve të ndërtimit, në adresën fshati Prrenjas, njësia Administrative Prrenjas, Bashkia Prrenjas.

Me vendimin nr. 21, datë 02.06.2023 është vijuar praktika për dënimin e kundërvajtësit z. D O me gjobë në masën 500,000 (pesëqind mijë) lekë.

Me vendimin nr. 9, datë 02.06.2023 është nxjerrë vendim për prishje e objektit të paligjshëm të z. D O.

### **Konkluzion:**

-Nga Kryeinspektori i IMTV-së nuk është vijuar procedura ligjore për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit për dënimin me gjobë dhe prishjen e objektit të kundërligjshëm, si akt që përbën titull ekzekutiv, jo në përputhje me kërkesat e nenit 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar dhe neneve 20, 21, 22 dhe 30 të ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 për kundërvajtjet administrative.

-Nga IMTV-ja e Bashkisë Prrenjas është konstatuar se subjekti ka kryer ndërtim të paligjshëm, duke konsumuar elementet e veprës penale të parashikuar në nenin 199/a të kodit penal dhe në vijim nga IMTV-ja është përgatitur dosja për të vijuar me kallëzim penal në ngarkim të subjektit fizik ndërtues, për veprën penale "Ndërtimi i paligjshëm" parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

-Në dosje mungon korrespondenca, kërkesë për mbështetje me Policinë e Shtetit, Policinë Bashkiake dhe IKMT, për veprimet e mëtejshme në funksion të dokumentimit dhe çfarë veprimesh janë marrë për objektin në fjalë. Nuk administrohet foto e objektit.

### H F

Nga inspektimi i bërë në terren me datë 02.06.2023, nga Inspektoret e Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Prrenjas, A A dhe J K, kanë ushtruar kontroll me adresë në zonën Prrenjas, Bashkia Prrenjas, në subjektin fizik znj.H F.

Gjatë kontrollit inspektoret e terrenit të IMTV-së me procesverbalin nr. 176, datë 02.06.2023 kanë mbajtur proces-verbal për konstatimin e kundërvajtjes ndërtim pa leje 1 kat banesë.

Në vazhdim të procedurës, inspektoret e terrenit kanë përgatitur relacion, sipas parashikimit ligjor për vazhdimin e procedurës ligjore dhe marrjen e vendimit për dënimin me gjobë nga Kryeinspektori.

Me vendimin nr. 35, datë 02.06.2023 nga Kryeinspektori është vendosur me pezullimin e punimeve të ndërtimit, në adresën fshati Urakë, njësia Administrative Prrenjas, Bashkia Prrenjas.

Me vendimin nr. 19, datë 02.06.2023 është vijuar praktika për dënimin e kundërvajtësit znj. H F me gjobë në masën 500,000 (pesëqind mijë) lekë.

Me vendimin nr. 7, datë 02.06.2023 është nxjerrë vendim për prishjen e objektit të paligjshëm të znj. H F.

### **Konkluzion:**

-Nga Kryeinspektori i IMTV-së nuk është vijuar procedura ligjore për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit për dënimin me gjobë dhe prishjen e objektit të kundërligjshëm, si akt që përbën titull ekzekutiv, jo në përputhje me kërkesat e nenit 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.



-Nga IVMT-ja e Bashkisë Prrenjas është konstatuar se subjekti ka kryer ndërtim të paligjshëm, duke konsumuar elementet e veprës penale të parashikuar në nenin 199/a të kodit penal dhe në vijim nga IMTV-ja është përgatitur dosja për të vijuar me kallëzim penal në ngarkim të subjektit fizik ndërtues, për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm“ parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

-Në dosje mungon korrespondenca, kërkesë për mbështetje me Policinë e Shtetit, Policinë Bashkiake dhe IKMT, për veprimet e mëtejshme në funksion të dokumentimit dhe çfarë veprimesh janë marrë për objektin në fjalë. Gjoha ndodhet e pa arkëtuar.

## A R

Nga inspektimi i bërë në terren me datë 08.06.2023, nga Inspektoret e Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Prrenjas, A A dhe J K, kanë ushtruar kontroll me adresë në zonën fshati Karkavec, Bashkia Prrenjas, në subjektin fizik A R.

Gjatë kontrollit inspektoret e terrenit të IMTV-së me procesverbalin nr. 179, datë 08.06.2023 kanë mbajtur proces-verbal për konstatimin e kundërvajtjes ndërtim pa leje mur me gur + mur me beton arme e kollona.

Në vazhdim të procedurës, inspektoret e terrenit kanë përgatitur relacion, sipas parashikimit ligjor për vazhdimin e procedurës ligjore dhe marrjen e vendimit për dënimin me gjobë nga Kryeinspektori.

Me vendimin nr. 38, datë 08.06.2023 nga Kryeinspektori është vendosur me pezullimin e punimeve të ndërtimit, në adresën fshati Prrenjas, njësia Administrative Prrenjas, Bashkia Prrenjas.

Me vendimin nr. 22, datë 08.06.2023 është vijuar praktika për dënimin e kundërvajtësit z. A R me gjobë në masën 500,000 (pesëqind mijë) lekë.

Me vendimin nr. 10, datë 08.06.2023 është nxjerrë vendim për prishje e objektit të paligjshëm të z. A R.

## **Konkluzion:**

-Nga Kryeinspektori i IMTV-së nuk është vijuar procedura ligjore për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit dhe vendimeve ekzekutive nga gjykata për dënimin me gjobë, si akt që përbën titull ekzekutiv, jo në përputhje me kërkesat e nenit 5 pika “d“ të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

-Nga IMTV-ja e Bashkisë Prrenjas është konstatuar se subjekti ka kryer ndërtim të paligjshëm, duke konsumuar elementet e veprës penale të parashikuar në nenin 199/a të kodit penal dhe në vijim nga IMTV-ja është përgatitur dosja për të vijuar me kallëzim penal në ngarkim të subjektit fizik ndërtues, për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm“ parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

-Në dosje mungon korrespondenca, kërkesë për mbështetje me Policinë e Shtetit, Policinë Bashkiake, shërbimin përmbartimor dhe IKMT, për veprimet e mëtejshme në funksion të dokumentimit dhe çfarë veprimesh janë marrë për objektin në fjalë. Gjoha është e pa arkëtuar. Procedura e mbajtur nga IMTV, pranë Bashkisë Prrenjas për personat fizik dhe juridik, nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023 po i paraqesim në formatin e tabelave si më poshtë, vijon: “Vendim për pezullimin e punimeve” dhe “Vendim për prishjen e objektit”.

Nr.	Emri Subjektit	Lloj objektit	Vendimi	
			Nr.	Datë
1.	S M	Banese	32	24.05.2023
2.	A A	Njesi+Banese	33	30.05.2023
3.	L R	Njesi+Banese(Pallat)	34	31.05.2023
4.	H F	Banese	35	02.06.2023
5.	A Z	Banese	36	02.06.2023
6.	D O	Banese	37	02.06.2023

7.	A R	Banese	38	08.06.2023
----	-----	--------	----	------------

Burimi: Bashkia Prrenjas

Procedurat e mbajtura nga I.V.M.T, pranë Bashkisë Prrenjas për personat fizik dhe juridik, nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023 “Vendim për dënim me gjobë”, vijon;

Nr.	Emri i Subjektit	Lloji objektit	Vendimi		
			Nr.	Datë	Lekë
1.	Ae D H	Njësi+Banese	14	17.01.2023	100.000
2.	E SBS	Njësi	15	18.04.2023	100.000
3.	S M	Banese	16	24.05.2023	500.000
4.	A A	Njesi+Banese	17	30.05.2023	20.000
5.	L R	Njesi+Banese(Pallat)	18	31.05.2023	500.000
6.	H F	Banese	19	02.06.2023	500.000
7.	A Z	Banese	20	02.06.2023	500.000
8.	D O	Banese	21	02.06.2023	500.000
9.	A R	Banese	22	08.06.2023	500.000
10.	E SBS	Njësi	15	18.04.2023	100.000

Burimi: Bashkia Prrenjas

Pasqyra e gjobave të aplikuara sipas personave për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, konkretisht, vijon;

Nr.	Emër Mbiemër	Lloj objektit	Arsyeja e gjobës
1.	A e D H	Njësi + Banese	Mosrespektimi i afatit të punimeve
2.	E SBS	Njësi	Mosrespektimi i afatit të punimeve
3.	S M	Banese	Ndertim objekt 1 kat banimi
4.	A A	Njesi+Banese	Punime shtrimi me pllake (kocke)
5.	L R	Njesi+Banese(Pallat)	Ndertim mur rrethues
6.	H F	Banese	Ndertim objekt 1 kat banimi
7.	A Z	Banese	Ndertim pa leje ngritje kati me çati
8.	D O	Banese	Ndertim pa leje 1 kat + 1 kat nentoke
9.	A R	Banese	Ndertim pa leje me mur guri + mur me beton arme + kollona
10.	E SBS	Njësi	Mosrespektimi i afatit të punimeve

Burimi: Bashkia Prrenjas

Pasqyra e gjobave të arkëtuara për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, konkretisht:

Nr.	Emri Subjektit	Detyrimi	Arkëtimi	Pa arkëtuar	Shënim
1.	A e D H	100.000	100.000		Kryeinspektor Gazment Çuku
2.	E SBS	100.000	100.000		Kryeinspektor Gëzim Bitri
3.	S M	500.000	-----	Pa arkëtuar	Kryeinspektor Gëzim Bitri
4.	A A	20.000	20.000		Kryeinspektor Gëzim Bitri
5.	L R	500.000	-----	Pa arkëtuar	Kryeinspektor Gëzim Bitri
6.	H F	500.000	-----	Pa arkëtuar	Kryeinspektor Gëzim Bitri
7.	A Z	500.000	-----	Pa arkëtuar	Kryeinspektor Gëzim Bitri
8.	D O	500.000	-----	Pa arkëtuar	Kryeinspektor Gëzim Bitri
9.	A R	500.000	-----	Pa arkëtuar	Kryeinspektor Gëzim Bitri
10.	E SBS	100.000	100.000		Kryeinspektor Jani Kllogjri

Burimi: Bashkia Prrenjas

Pasqyra mbi kallëzimet penale të IMTV, periudha 01.01.2023 – 31.12.2023.

Nr.	Emër Mbiemër	Lloji i objektit	Kallëzim penal	
			Nr.	datë
1.	S M	Banese	1789	03.07.2023
2.	A A	Njesi+Banese	1786	03.07.2023
3.	L R	Njesi+Banese(Pallat)	1791	03.07.2023
4.	H F	Banese	1790	03.07.2023
5.	A Z	Banese	1788	03.07.2023
6.	D O	Banese	1787	03.07.2023
7.	A R	Banese	1785	03.07.2023

Burimi: Bashkia Prrenjas

Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 nga Inspektoret e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Prrenjas, kanë mbajtur gjithsej 36 akte konstatimi, për ndërtime informale pa leje

ndërtimi dhe për objekte për mosrespektim të afatit të punimeve. Nga këto, për 7 subjekte është marrë vendim për pezullim të punimeve, për 7 prej tyre është nxjerrë vendim për prishjen e objektit, për 10 prej tyre është marrë vendim gjobe dhe për 7 prej tyre është vijuar me kallëzim penal.

Veprime në kundërshtim me ligjin 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 4, neni 5 geramat a, b, ç, d, f; dhe Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” Nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

## **2.7. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.**

Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka kryer auditim në Bashkinë Prrenjas “Mbi auditimin financiar dhe përputhshmërisë”, rezultoi si më poshtë, vijon;

Janë lënë 14 *masa organizative*, 7 masa janë zbatuar plotësisht, 1 masë është zbatuar pjesërisht, 6 masa janë në proces zbatimi.

Janë lënë 5 *masa për shpërblim dëmi*, 5 janë zbatuar plotësisht, 0 janë zbatuar pjesërisht, është në proces zbatimi dhe nuk janë zbatuar 0, nuk janë pranuar 0.

Janë lënë 6 *masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore*, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara): 1 masë është zbatuar plotësisht, 3 janë zbatuar pjesërisht, 2 janë në proces zbatimi dhe mbeten për t’u zbatuar nga Bashkia Prrenjas për periudhën në vijim, 0 nuk janë zbatuar, 0 nuk janë pranuar.

### **7.1.Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.**

Bashkia Prrenjas, në zbatim të shkresës Nr. 3368/1 prot., datë 11.12.2023 ka marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna dhe ka informuar Kontrollin e Lartë të Shtetit, mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, atë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit” të Titullarit dhe për çdo rekomandim të lënë, ka ngarkuar strukturat përkatëse të Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve.

Nga Bashkia Prrenjas, është respektuar afati 20 ditor për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH -së, në përputhje me nenin 15 gërma “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, nëpërmjet urdhrin të brendshëm me Nr.1678 prot, datë 20/06/2023, dërguar pranë KLSH me shkresë Nr. 3368/1 Prot., datë 11.12.2023.

### **7.2.Realizimi programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.**

Nga Bashkia Prrenjas, nuk është respektuar afati 6 mujor, për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve, në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

### **7.3.Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.**

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve, rezulton se:

Nga Bashkia Prrenjas janë masat e duhura për raportimin në lidhje me planin e veprimeve të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. 3368/1prot, datë 11.12.2023, duke respektuar afatin 20 ditor. Ndërsa nuk është raportuar dhe për ecurinë e tyre në afatin 6 mujor, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2.

**a.** Nga **14 masa organizative** të rekomanduara, janë pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar 7 masa janë zbatuar plotësisht, 1 masë është zbatuar pjesërisht dhe 6 masa janë në proces zbatimi.

**b. Nga 5 masa shpërblim dëmi** në vlerën **1,508,892.39 lekë** të cilat janë pranuar plotësisht, dhe janë zbatuar.

**c. Nga 6 masa** për të ardhura të munguara në vlerën **104,299,191 lekë** të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat 3 masa janë në proces zbatimi dhe **3 masa janë zbatuar pjesërisht**.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, gërma “j”; Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

**Nga sa më sipër, grupi i auditimit të KLSH-së, rikërkon si më poshtë vijon:**

#### **A. Masa Organizative**

Për **14** masa organizative të mbetura në proces zbatimi nga Bashkia Prrenjas, konstatohet se **7** masa janë zbatuar plotësisht, **1** masë është zbatuar pjesërisht, dhe **6** masa janë në proces zbatimi.

*Trajtuar më hollësisht, si vijon:*

**2.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Prrenjas, të marrë masa për plotësimin e Njesisë së auditimit të brendshëm me 3 auditues, sipas standarteve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me ligjin, VKM-ve dhe Manualeve, për të përmbushur misionin e saj në arritjen e objektivave.

*2.1 Bashkia Prrenjas ka percaktuar në strukturën e saj 3 pozicione pune për njësinë e auditimit të brendshëm. 1 (një) pozicion në Sektorin e Auditit është vakant. Me shkresën nr. 3097 prot., datë 10/11/2023 është bërë shpallja për pozicionin vakant.*

**Rekomandimi është zbatuar pjesërisht**

**3.1. Rekomandimi:** Nga Nëpunësi zbatues të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrave të aktiveve të njesisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: data e hyrjes ose e marrjes në dorëzim. Përshkrimi i aktivitetit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, data e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhja, personi përgjegjës, vlera e akumuluar e amortizimit, koha e shërbimeve të mrëmbajtjes, data e daljes nga pronësia.

**3.2. Rekomandimi:** Nga Nëpunësi zbatues të merren masa për nxjerrje e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizimin e menjhershëm të Aktiveve Afatgjata material të painventarizuara deri më sot, si dhe saktësimin e asetëve të painventarizuara, përkatësisht për zerat: 210 “Toka troje terrene”, 211 “Pyje plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjetje, vepra ujore” 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” 215 “Mjete transporti”.

Në llogaritjen e vlerës së këtyre aktiveve të merret në konsidëratë vlera fillestare dhe kryerja e vlersimeve të mëpasshme të aktiveve afatgjata material dhe shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e tyre, të cilat nuk janë shtuar në vlerën historike të aktivitetit përkatës, sipas rastit.

**3.3. Rekomandimi:** Nga Bashkia Prrenjas, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të merren masa për të sistemuar lloagaritë 210 “Toka troje terrene”, 211 “Pyje plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjetje, vepra ujore ”214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, 215 “Mjete transporti”, sipas vlerave të specifikuara më sipër.

*3.1 Drejtoria e Finances dhe Buxhetit është në proces sistemimi pasi problemet janë të trashëguara nga ish komunitat. **Rekomandimi është proces zbatimi.***

*3.2. Drejtoria e Finances dhe Buxhetit është në proces sistemimi pasi problemet janë të trashëguara nga ish komunitat. **Rekomandimi është proces zbatimi.***

*3.3. Drejtoria e Finances dhe Buxhetit është në proces sistemimi pasi problemet janë të trashëguara nga ish komunitat. **Rekomandimi është proces zbatimi.***

**4.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Prrenjas, nëpërmjet Nënpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të shoqërive:1. Ujësjetës Kanalizime Librazhd-Prrenjas sh.a, me NUIS J68122606V, për 42.08% të aksioneve, gjithsej 174,947 aksione me vlerën 174,947,000 lekë, 2. U K P sh.a, me NUIS: M.....U, për 12.9% të aksioneve, gjithsej 12,900 aksione, me vlerë 1,290,000 lekë. 3. E-A-sh.a, me NUIS M....., për 8% të aksioneve, gjithsej 1 aksion, me vlerë 500,000 lekë. Si dhe regjistrimin e kapitalit aksionar të këtyre shoqërive në shumën totale 176,737,000 lekë në debit të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2023

**4.1 Bashkia Prrenjas po merr masa për sistemimet në kontabilitet të shoqërive:1.U K L-P sh.a. Sistemimi do të bëhet me mbylljen e pasqyrave financiare. Rekomandimi është proces zbatimi.**

**5.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike dhe Financës në Bashkinë Prrenjas, në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, ta mbajë në konsideratë që pagesat e vlerave pjesore të AQT, duhet ti evidentojë në llogarinë 230-231 “Shpenzime në në proces për rritjen e AQT”, deri në vlerën e plotë dhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave, ti kontabilizojë ato në llogaritë e klasave 20-21, sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

**5.1 Drejtoria e Finances dhe Buxhetit është në proces zbatimi, sistemimi do behet me mbylljen e pasqyrave financiare. Rekomandimi është proces zbatimi.**

**6.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Prrenjas në cilësinë e Nënpunësit Autorizues të marrë masa për ngritjen në kohë të komisioneve me specialist të fushës për marrjen në dorëzim të objekteve të përfunduara dhe të mos lejojë likuidimin e situacionit përfundimtarë, pa verifikuar cilësinë e punimeve në cdo objekt sipas likuidimit/preventivit të miratuar nga AK. Pas përfundimit të këtyre veprimeve, në rastet ku nuk konstatohen problem, të vijohet me zhbllokimin e fondeve të ngurtësuara.

**6.1 Drejtoria e Finances dhe Buxhetit është në proces zbatimi, sistemimi do behet me mbylljen e pasqyrave financiare. Rekomandimi është në proces zbatimi.**

**7.1. Rekomandimi:** Me celjen e fondeve /mbërritjen e shkresës së dërguar nga MFE për alokimin e fondit pjesor të vitit ushtrimor të detajuar sipas projekteve të investimeve, të kryhet veprimi kontabël për shumën përkatëse në debit të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për tu përdorur”. Me konstatimin e shpenzimit, (mbërritja e faturës shoqëruar me situacion) të bëhet veprimi përkatës në debit të llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” dhe në kredi të llogarisë 404 “Furnitorë për investime”.

Në momentin e pagesave të faturave, të kryhet kontabilizimi për cdo pagesë në debit të llogarisë 404 “Furnitorë për investime” dhe në kredi të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”.

Në fund të vitit ushtrimor, për fondet e përdorura për investimet e papërfunduara/ në proces, të kryhet veprimi kontabël në debit të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për tu përdorur” në kredi të llogarisë 720 “Grant korrent i brendshëm” dhe në kredi të llogarisë 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)” për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor, për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues.

Me përfundimin e investimit do të bëhet kapitalizimi i aktivitetit, duhet prerë artikulli kontabël në debit të llogarisë 21 dhe në kredi të llogarisë 231.

Me kapitalizimin e aktivitetit, të kryhen veprimet kontabël në debit të llogarisë 476 në kredi të llogarisë 105 për fondet buxhetore të përdorura për investime në kredi të llogarisë 1011 dhe në debit të llogarisë 105, për vlerën e aktiveve të blera.

**7.1 Drejtoria e Finances dhe Buxhetit është në proces zbatimi, sistemimi do behet me mbylljen e pasqyrave financiare. Rekomandimi është proces zbatimi.**

**8.1 Rekomandimi:** Kryeinspektori i IMTV Bashkia Prrenjas, të marrë masa që në të ardhmen, të nxjerrë vendimet e gjobave për të gjitha rastet e konstatimit të ndërtimeve pa leje ose në shkelje të lejes, të kryet pezullimi i punimeve në aktin përkatës si dhe të nxirren vendimet për prishjen e tyre.

**8.10 IMTV pranë Bashkisë Prrenjas ka marrë masa për nxjerrjen e vendimeve të gjobave për të gjitha rastet e konstatimit të ndërtimeve pa leje ose në shkelje të lejes (gjithsej 10 gjoba), ka kryer pezullimin e punimeve në aktin përkatës, si dhe ka nxjerrë vendime për prishjen e tyre, I.M.T.V pranë Bashkisë Prrenjas ka dërguar në Prokurori 7 kallzime penale për ndërtime të paligjshme (shkresa nr. 3006 prot., datë 03.11.2023). **Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.****

**14.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Prrenjas duhet të kontabilizohet detyrimi ndaj subjektit "D B/M 2012" person fizik, me NUTS L.....K, si dhe të vazhdohet me shlyerjen e plotë të tij, sipas mundësiv financiare të Bashkisë Prrenjas.

**14.1 Bashkia Prrenjas ka planifikuar detyrimin ndaj subjektit "D B/M 2012" person fizik, me NUTS L.....K, në buxhetin e vitit 2024 të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr.6 datë 27.12.2023 "Për miratimin Përfundimtar të Programit Buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe Buxheti vitit 2024", të konfirmuar me shkresën me nr. 69/1 Prot., datë 12.01.2024 "Konfirmim i aktit" Prefektit Qarkut Elbasan, prot., me tonën nr. 63/2 datë 12.01.2024. **Rekomandimi është në proces.****

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

**1.1 Rekomandim:** Bashkia Përrenjas të arkëtojë vlerën 184,133.17 lekë pa TVSh nga OE "C" ShPK për punime të pakryera, parashikuar në kontratën nr. 1075 prot, datë 19.03.2020, me objekt "Rikonstruksioni i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit Përrenjas".

**1.1 Bashkia Përrenjas me shkresën nr. 1686 prot, datë 21.06.2023 ka dërguar njoftim për marrjen e masave për shpërbllim dëmi në vlerën 184,133.17 lekë pa TVSh OE "C" ShPK, bashkëngjitur faturën nr. 168 datë 26.06.2023. Në datë 26.06.2023 nga Subjekti OE "C" ShPK është bërë likuidimi i faturës nr. 168 datë 26.06.2023 në vlerën 184,133.17 lekë pa TVSh. **Rekomandimi është zbatuar.****

**1.2 Rekomandime:** Bashkia Përrenjas të marrë masa për të ngritur një grup pune me specialist të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin, kolaudatorin e punimeve si dhe Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizimeve Përrenjas, në cilësinë e administratorit të investimit, për të vlerësuar dhe analizuar situatën, bazuar nga fakti i auditimit në terren ku rezultuan pajisje të pavendosura në objekt. Dalja e përgjegjësi, realizimi i zërave të punimeve sipas PZ dhe ST në shumën **363,171 lekë**, të konfirmohet zyrtarisht nga palët, AK bashkia Përrenjas, Ndërmarrja e U K sha P, sipërmarrësi i punimeve, Mbikëqyrësi i punimeve dhe Kolaudatori i punimeve të objektit brenda periudhës së garancisë më datë 25.07.2023 në rast të kundërt, mosvendosja e pajisjeve në objekt, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga personat përgjegjës.

**1.2 Bashkia Përrenjas me shkresën nr. 1686 prot, datë 21.06.2023 ka dërguar OE "C" ShPK njoftim për marrjen e masave për shpërbllim dëmi. Me shkresën nr. 1703 prot, datë 23.06.2023 Bashkia Përrenjas ka njoftuar për marrjen e masave referuar auditimit të zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt: "Rikonstruksioni i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit Përrenjas", Mbikëqyrësin e punimeve subjektin "Z & C" ShPK dhe Kolaudatori i punimeve subjektin "D" ShPK. Kryetari i Bashkisë ka ngritur urdhrin nr. 289, datë 22.06.2023, me nr. 1679 prot., datë 22.06.2023 "Për ngritjen e grupit të punës për të vlerësuar për të vlerësuar dhe analizuar situatën, bazuar nga fakti i auditimit të KLSH-së në terren ku rezultuan pajisje të pavendosura në objektin "Rikonstruksioni i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit Përrenjas". Grupi i punës ka mbajtur procesverbal për zbatimin e**

masave të lënë nga KLSH-ja dhe konstaton se janë vendosur zërat e punimeve sipas PZ dhe ST. Me shkresën nr.2500 prot, datë 18.09.2023, grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 289, datë 22.06.2023, ka njoftuar Kryetarin e Bashkisë për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve lënë nga KLSH-ja. **Rekomandimi është zbatuar.**

**2.1 Rekomandime:** Bashkia Përrenjas të arkëtojë vlerën **299.500 lekë** pa TVSh nga BOE “M” ShPK dhe “Sh” ShPK, për punime të pakryera, sipas kontratës nr. 3954 prot., datë 24.11.2020, me objekt “Rikonstruksion dhe riveshje me asfaltim i pjesëve të dëmtuara të rrugës Lapidar Qukës Shkumbin, Bulliri i Belbës, asfaltimi i rrugës në lagjen e Kryeziut, asfaltimi i rrugës në lagjen e Shtytit dhe rikonceptim i qendrës së Fshatit Qukës”.

**2.1 Bashkia Përrenjas me shkresën nr. 1688 prot, datë 21.06.2023 ka dërguar njoftim për marrjen e masave për shpërblim dëmi në vlerën 299,500 lekë pa TVSh nga BOE “M” ShPK dhe “Sh” ShPK, bashkangjitur faturën nr. 169 datë 26.06.2023. Në datë 09.08.2023 nga Subjekti “M” ShPK është bërë likujdimi i faturës nr. 169 datë 26.06.2023 në vlerën 299,500 lekë pa TVSh. Rekomandimi është zbatuar.**

**3.1. Rekomandimi:** Bashkia Përrenjas të arkëtojë vlerën 218,650 lekë pa TVSh nga BOE “M” ShPK dhe “Sh” ShPK, për punime të pakryera, sipas kontratës nr. 3954 prot., datë 24.11.2020, me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Qukës Shkumbin -Skroskë”.

**3.1 Bashkia Përrenjas me shkresën nr. 1687 prot, datë 21.06.2023 ka dërguar njoftim për marrjen e masave për shpërblim dëmi në vlerën 218,650 lekë pa TVSh BOE “M” ShPK dhe “Sh” ShPK, bashkangjitur faturën nr. 176 datë 26.06.2023. Në datë 09.08.2023 nga Subjekti “M” ShPK është bërë likujdimi i faturës nr. 176 datë 26.06.2023 në vlerën 218,650 lekë pa TVSh. Rekomandimi është zbatuar.**

**4.1. Rekomandimi:** Bashkia Përrenjas ti kërkojë sipërmarrësit të punimeve OE “Sh 07” ShPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative që në objekt të realizohen punimet të cilat i përkasin shumës 260,610 lekë pa TVSh, brenda periudhës së garancisë (datë 07.07.2023), për të garantuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e rrugës. Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga AK bashkia Përrenjas dhe Mbikëqyrësi i punimeve të objektit. Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve Teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve.

**4.1. Bashkia Përrenjas me shkresën nr. 1685 prot., datë 21.06.2023 ka dërguar njoftim për marrjen e masave për shpërblim dëmi OE “Sh 07” ShPK. Kryetari i Bashkisë ka ngritur urdhrin nr.302, datë 30.06.2023, me nr. 1769 prot, datë 30.06.2023 “Për ngritjen e komisionit për kontrollin dhe verifikimin e cilësisë së punimeve të riparimeve të kryera në objektin: “Rikonstruksion i Rrugës Qukës Skënderbe, Bashkia Përrenjas”. Në zbatim të urdhrin të Kryetarit të Bashkisë, Komisioni ka mbajtur akt-kontroll datë 07.07.2023 dhe ka konstatuar se nga OE “Sh” ShPK janë kryer ndërhyrjet e kërkuara si dhe janë riparuar dëmtimet në aksin rrugorë. Me shkresën 2500 prot, datë 18.09.2023, komisioni i ngritur me urdhrin nr. nr. 302, datë 30.06.2023, ka njoftuar Kryetarin e Bashkisë për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve lënë nga KLSH-ja. Rekomandimi është zbatuar.**

**5.1. Rekomandimi:** Bashkia Përrenjas të arkëtojë vlerën 182,828 lekë pa TVSh nga OE “E A” ShPK, për punime të pakryera, sipas kontratës nr. 3623 prot., datë 03.11.2020, me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Qukës Shkumbin -Skroskë”.

**5.1 Bashkia Përrenjas me shkresën nr. 1684 prot, datë 21.06.2023 ka dërguar njoftim për marrjen e masave për shpërblim dëmi në vlerën 182.828 lekë pa TVSh OE “E A” ShPK, bashkangjitur faturën nr. 170 datë 26.06.2023. Në datë 30.06.2023 nga OE “E A ShPK (subjekti ka ndryshuar emrin nga “E A ShPK, në L K ShPK ) është bërë likujdimi i faturës nr. 170 datë 26.06.2023 në vlerën 182.828 lekë pa TVSh. Rekomandimi është zbatuar.**

**C. Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara):**

Për 6 masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara): 1 masë është zbatuar plotësisht, 3 janë zbatuar pjesërisht, 2 janë në proces zbatimi dhe mbeten për t'u zbatuar nga Bashkia Prrenjas për periudhën në vijim, 0 nuk janë zbatuar, 0 nuk janë pranuar.

Trajtuar më hollësisht si vijon:

**1.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Prrenjas dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për arkëtimin e detyrimeve të palikujduara nga debitorët progresivë për vitin 2022, nga mospagesa e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara në paketën fiskale nga subjektet ekonomike që ushtrojnë aktivitetet për qëllime biznesi si dhe nga subjektet familjare në vlerën totale 63,391,576 lekë.

**1.1. Drejtoria e të Ardhurave ka dërguar “Kërkesë për Shlyerje detyrimesh”, me shkresën nr. 328 prot datë 30.01.2023.**

*-Për 116 subjekte Biznesi Vogël në qytetin Prrenjas ku vlera debitore deri në datë 31.12.2022 është 4,996,937 lekë. Nga kjo vlerë debitore është paguar vlera 1,496,407 lekë dhe vlera e mbetur nga debitorët rezulton të jetë 3,500,530 lekë.*

*-Për 83 subjekte Biznesi i vogël Njësia Administrative Rrajcë ku vlera debitore deri në datë 31.12.2022 është 1,007,637 lekë. Nga kjo vlerë debitore është bërë pagesë nga debitorët në vlerën 421,764 lekë dhe vlera e mbetur pa paguar është 585,873 lekë.*

*-Për 50 subjekte Biznesi i vogël Njësia Administrative Qukës vlera debitorë deri në datë 31.12.2022 është 661,538 lekë. Nga kjo vlerë debitore është paguar vlera 139,768 lekë dhe vlera e mbetur rezulton të jetë 521,770 lekë.*

*-Për detyrimet e prapambetura për Biznesin e madh i cili u mbyll me gjendje debitore më datë 31.12.2022 në vlerën 11,646,648 lekë ku nga këto deri më sot janë arkëtuar 3,692,649 lekë.*

*-Për biznesin e vogël, qyteti Prrenjas, vlera e debitore e arkëtuar është = 1,496,407 lekë*

*-Për biznesin e vogël, Njësia Qukës, vlera debitore e arkëtuar është = 139,768 lekë*

*-Për biznesin e vogël, Njësia Rrajcë, vlera debitore e arkëtuar është = 421,764 lekë*

*Pagesa totale nga gjendja debitore për bizneset është = 5,750,588 lekë.*

*Për taksat dhe tarifave vendore nga subjektet familjare të cilët rezultojnë debitor në 31.12.2022 janë bërë këto arkëtime:*

*-Për familjarët qyteti Prrenjas nga shuma debitore janë arkëtuar 1,379,156 lekë*

*-Për familjarët Njësia Administrative Rrajcë nga shuma debitore janë arkëtuar 2,795,276 lekë*

*-Për familjarët Njësia Administrative Stravaj nga shuma debitore janë arkëtuar 281,888 lekë*

*-Për familjarët Njësia Administrative Qukës nga shuma debitore janë arkëtuar 986,520 lekë*

*Pagesa totale nga gjendja debitore për subjektet familjare është 5,442,840 lekë.*

*Përsa i përket debitorëve të ujit të pijshëm janë njoftuar të gjithë personat të cilët rezultojnë debitore dhe janë bërë këto arkëtime:*

*-Për abonentët e qytetit Prrenjas janë arkëtuar tarifë uji 1,491,180 lekë*

*-Për abonentët e njësisë Rrajcë janë arkëtuar tarifë uji 2,285,883 lekë*

*-Për abonentët e njësisë Qukës janë arkëtuar tarifë uji 1,191,948 lekë*

*-Për abonentët e njësisë Stravaj janë arkëtuar tarifë uji 263,672 lekë*

*Pagesa totale nga gjendja debitore për ujin e pijshëm është 5,232,682 lekë.*

***Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.***

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Urbanistikës të përcjellë listën me subjektet debitore për taksën e ndikimit në infrastrukturë si dhe në vijim Bashkia Prrenjas të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore prej 2,526,900 lekë.

**2.1 Bashkia Prrenjas ka dërguar njoftime për pagesë detyrimesh me nr. 2194 Prot., datë 11.08.2023 dhe nga shuma totale prej 2,526,900 lekë, janë arkëtuar 957,230 lekë.**

***Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.***



**3.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Prrenjas, Drejtoria e të Ardhurave dhe Drejtoria e Financës të analizojë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të përllogaritur sa më saktë nivelin e detyrimit me penalitet për kontaktat e qirsë për të cilat nuk janë paguar deri në datë 31.12.2022, si dhe në mbledhjen e detyrimeve e konsideruar e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Prrenjas për vlerën 5,023,618 lekë.

**3.1 Drejtoria e të Ardhurave dhe Drejtoria e Financës është proces zbatimi për përllogaritjen e sakte të nivelit të detyrimit me penalitet për kontaktat e qirsë për të cilat nuk janë paguar deri në datë 31.12.2022. Rekomandimi është në proces zbatimi.**

**4.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Prrenjas, Sektori Juridik, Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave dhe Drejtoria e Taksave Vendore të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të kërkuar likuidimin nga subjektet të cilat ushtrojnë aktivitet për qëllime biznesi në fushën e mineraleve të pajisur me leje minerare brenda territorit të Bashkisë Prrenjas, për detyrimin e qirasë së papaguar nga kontratat e lidhura për sipërfaqen në përdorim nga fondi pyjor kullësor, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë në vlerën 20,488,050 lekë, si dhe të verifikojnë në terren dhe të administrojnë të gjithë sipërfaqen e e fondit pyjor /kullësor sipas të dhënave në regjistrin e AKBN-së.

**4.1. Nuk është pranuar nga Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave sepse Bashkia Prrenjas nuk ka kontrata të lidhura me 15 subjektet, që operojnë në shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullësore (karriera) të pasqyruara në tabelën e aneksit 2.6.5 “Tarifat e munguara nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në shfrytëzim karrierë” të shkresës Nr.515/18 Prot., datë 08.09.2022 “Dërgohet raporti përfundimtar i auditimit dhe rekomandimit” të Kontrollit të Lartë të Shtetit ku të pasqyrohen detyrimet që rrjedhin nga kontratat.**

*Në lidhje me konstatimin e subjekteve, që operojnë në shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullësore në veprimtari minerare janë hartuar dhe dërguar për miratim raportet dhe dokumentacioni për heqje nga fondi pyjor për subjektet. (Me shkresën nr. 1268 prot., 05.05.2023). Rekomandimi është në process zbatimi.*

**5.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Prrenjas dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për mbledhjen e detyrimeve të subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa paguar plotësisht tarifën për pajisjen me autorizimin e tregtimit të hidrokarbureve në vlerën totale 2,221,083 lekë e cila është e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Prrenjas.

**5.1 Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka dërguar njoftim për pagesë për subjektet që ushtrojnë aktivitet për tregtim lënde djegëse dhe janë pajisur me autorizim, janë bërë pagesa në shumën 321,083 lekë. Rekomandimi është në proces zbatimi.**

**6.1 Rekomandimi:** Nga ana e Drejtorisë së Urbanistikës, personit të ngarkuar për llogaritjen e TNI për objektet e reja që kanë tipologjinë e mësipërme, taksa të përllogaritet bazuar në cmimin e shitjes.

**6.1 Drejtoria Urbanistikës ka marrë masa që në të ardhmen taksa të përllogaritet bazuar në cmimin e shitjes. Për vitin 2023 Bashkia Prrenjas nuk ka patur asnjë praktike.**

**6.2 Rekomandimi:** Drejtoria e Urbanistikës dhe Drejtoria e Taksave Tarifave Vendore të marrin masa për arkëtimin e vlerës prej 10,047,964 lekë ndaj 2 subjekteve për llogaritje të gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga të cilat 4,170,770 lekë për subjektin L B dhe E B si dhe 5,877,194 lekë për subjektin M –P.

**6.2 Drejtoria e Urbanistikës me shkresën nr. 1847 Prot., datë 05.07.2023 ka njoftuar subjektin subjektin M –P shpk, për arkëtimin e vlerës 5,877,194 lekë për llogaritje të gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë. Më shkresën nr. 1847 Prot., datë 05.07.2023 është njoftuar subjekti L B dhe E B, për arkëtimin e vlerës 4,170,770 lekë. Drejtoria e të ardhurave në datë 07.02.2024 ka rinjoftuar subjektin L B dhe E B me shkresën nr.482 prot, datë 07.02.2024 për detyrimin tatimor në vlerë 4,170,770 lekë. Rekomandimi nuk është zbatuar.**

*Ndërmjet Bashkisë Prrenjas dhe subjektit M –P shpk është lidhur një marrveshje për pagesën me këstë të detyrimeve. Dhe më datë 15.02.2024 nga subjektit M –P shpk është bërë pagesa në shumën 1,200,000 lekë sipas faturës nr. 21, datë 15.02.2024. **Rekomandimi është në proces zbatimi.***

## **2.8.Të ndryshme të dala gjatë auditimit.**

-Gjatë auditimit nuk ka pasur çështje të tjera, veç çështjeve të programit të trajtuara më sipër.

## **IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:**

### **A. MASA ORGANIZATIVE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

Mjedisi i kontrollit”. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit, si dhe nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 64, pika h, Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe “Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Kapitulli III, pika 3.1.

Përsa i përket politikave që lidhen me burimet njerëzore, konstatohet se për 32 punonjësit e larguar, në disa raste nuk është vepruar sipas Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 13. - VKM nr. 360, datë 14.07.2000 “Për lirim nga shërbimi civil”, pikat 19, 20 dhe 21 “Dorëzimi i detyrës”;

“Menaxhimi i Riskut”. Nga auditimi, rezultoi se gjurmët standarde të auditimit nuk janë hartuar dhe miratuar nga titullari i njësisë, si një dokument i unifikuar për të gjitha proceset e Bashkisë Përrenjas, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 16, pika 2; “Manualin e menaxhimit financiar dhe kontrollit” kapitulli V; UMF nr. 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar, nenet 121 dhe 122; -Bashkia Përrenjas nuk ka hartuar listën (hartën)/manualin e proceseve të punës, në moszbatim të Ligjit nr. 10296 /2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe “Manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit”, Kapitulli III, pika 3.3; “Aktivitetet e Kontrollit”. Nuk është hartuar/miratuar një Plan i Kontrollit të Brendshëm periodik apo vjetor, në kundërshtim me nenin 22, pika 1 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, “Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

“Informimi dhe komunikimi” -Komunikimi i brendshëm, një prej kanaleve më të rëndësishme të komunikimit nuk është në nivelet e duhura, në një njësi është ai ndërmjet titullarit, menaxherëve dhe punonjësve të tij “komunikimi vertikal”. Punonjësit nuk njihen sa duhet me sistemin e komunikimit të brendshëm dhe të kuptojnë rolin e tyre, detyrimet dhe përgjegjësitë që çdonjëri ka në këtë sistem. Falë komunikimit ata bëhen më të ndërgjegjshëm për rolin dhe përgjegjësitë që kanë në lidhje me arritjen e qëllimeve dhe objektivave të njësisë. Kjo vjen në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e MF nr. 108, datë 17.11.2016. Kapitulli III. Komponentët E Menaxhimit Financiar Dhe Kontrollit pika 3.4.

“Monitorimi” - Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë

8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 24. Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 13-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1.Rekomandimi:** Nga Titullari i Bashkisë Përrenjas, me atributet e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për njohjen nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherët të programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

**Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2024**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi vlerësimin e aktivitetit të njësisë së auditimit të brendshëm të disa prej dosjeve të përzgjedhura u konstatua se:

- NJAB, e ushtron funksionin e vet me dy auditues (1 përgjegjës dhe 1 specialist) në strukturën organizative të saj dhe me një vend vakant, në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, “Mbi auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, pika 3, “Manualin e procedurave të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, VKM-në nr. 83 datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, pikat 3 dhe 6.

- Në disa dosje nuk ka gjurmë auditimi, nuk dokumentohet dhe nuk administrohet shkresa përcjellëse e kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar, si dhe mungon Memo e planifikimit, pra Projekt Drafti i programit të auditimit në fazën e hartimit të programit të angazhimit.

- Në fund të procesit të auditimit në disa dosje mungojnë letrat e punës për secilin auditues të cilat duhet të përfshijnë regjistrimin e punës së audituesit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemit. - Në programet e auditimit nuk është përfshirë si drejtim “vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si pasojë audituesit e brendshëm nuk kanë marrë në shqyrtim identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar.

Mungesa e planeve të veprimit ka sjellë mungesën e monitorimit nga NJAB për zbatimin e rekomandimeve nga ana e subjekteve të audituara brenda afateve të përcaktuara, në moszbatim të përcaktimeve të kreut 4.1.13.1 dhe 4.1.13.2 “Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit”, paragrafi 3, si dhe “Raportimi i ndjekjes së rekomandimeve”, paragrafi 4; mosraportimit të subjekteve të audituara në moszbatim të Kreut 4.1.13.3 “Përgjegjësitë e njësisë për të zbatuar rekomandimet e auditimit të brendshëm” të “Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.1, faqe 15-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Përrenjas, të marrë masa për plotësimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm me numrin e nevojshëm të audituesve të certifikuar, për të përmbushur misionin e saj në arritjen e objektivave.

*Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2024*

**2.2.Rekomandimi:** Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Përrenjas, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin risk të lart, të ndjekë me korrektësi çdo fazë të misionit auditues, duke e plotësuar me praktikën dokumentare përkatëse.

Të marrë masa për të arkivuar në arkivin e institucionit dosjet e auditimit dhe të aplikojë opinione auditimi sipas standardeve të auditimit dhe manualit për auditimin në sektorin e brendshëm publik.

## Menjëherë dhe në vijimësi

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare, rezulton se Llogaria nr. 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, në fillim të vitit 2023 është në vlerën 84,536,862 lekë dhe në fund të vitit 2023 është në vlerën 94.462.552 lekë, pra me një rritje të vlerës së debitorëve të Bashkisë Përrenjas në vlerën (9,925,690) lekë.

Nga verifikimi i listës analitike të debitorëve në fund të vitit 2023, konstatohet se nuk janë kontabilizuar të drejtat për arkëtim në vlerën 2,672,984 lekë, konkretisht për vlerën 2,400,000 lekë kamat-vonesë e papërlllogaritur për gjokat e IVMT dhe vlera 272,984 lekë kamat - vonesë e papërlllogaritur për kontratat e qerasë.

Në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet llogaria nr. 470 “*Llogari në pritje – të ardhura për t’u marrë*” (me kundërparti llogarinë nr.468), e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, shkronja “ë”, pika 3, neni 12; Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, rubrika 2.3, paragrafi 21, shkronja “c”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 37-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Përrenjas, të marrë masat e nevojshme për vlerësimin dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të drejtave të bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 “*Debitorë të ndryshëm*” me kundërparti llogarinë nr.470 “*Të ardhura për t’u marrë*”.

## Me mbylljen e pasqyrave financiare të viti 2024

**4.Gjetje nga auditimi:** Llogaria 4342 “*Operacione me shtetin (të drejta)*” në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 101,103,958 lekë dhe nuk kuadron me Llogarinë 7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*” e cila është pasqyruar në vlerën 117,077,498 lekë sipas Pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve.

Llogaria 4342, sipas Udhëzimit të MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, përbëhet nga gjendja e llogarive të klasës 4 llogaritë 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” në vlerën 81,703,882 lekë , 42 “*Detyrime ndaj personelit*” në vlerën 13,953,770 lekë, 431 “*Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa*” në vlerën 736,879 lekë, 435 “*Sigurime shoqërore*” në vlerën 4,074,938 lekë, 436 “*Sigurime shëndetësore*” në vlerën 565,189 lekë dhe llogaria 467 “*Kreditor të ndryshëm*” në vlerën 22,401,738 lekë.

Gjendja e llogarive të klasës 4 është paraqitur në vlerën 123,436,396 lekë. Llogaria 4342 është nënvlerësuar për vlerën 22,332,438 lekë ndërsa llogaria 7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*” është nënvlerësuar për vlerën 6,358,898 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, neni 10 dhe 11, Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 32. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 37-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Përrenjas, të marrë masat për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 4342 *Operacione me shtetin*” dhe kundër partisë 7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*”. Veprimet e sistemuese të bëhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2023.

## Me mbylljen e pasqyrave financiare të viti 2024

**5. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 467 në fund të vitit 2023 paraqitet me vlerën 22,401,738 lekë, nga auditimi i llogarisë analitike, konstatohet se nuk janë kontabilizuar detyrimet për vendime gjyqësore në vlerën 919,709 lekë, të cilat janë likuiduar gjatë vitit 2024 për llogari të vitit 2023. Këto veprime janë në kundërshtim me Funkcionimi kontabël i llogarive të klasës 4, në Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 37-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Përrenjas, të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i detyrimeve të bashkisë ndaj të tretëve, në llogarinë nr. 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Në përfundim të merren masa për raportimin e detyrimeve të prapambetura në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare të viti 2024**

**6. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën neto 11,899,243 lekë. Duke iu referuar të dhënave kontabël të paraqitura sipas kostos historike, dhe sipas inventarizimit kontabël kjo llogari është e analizuar në 11 raste në vlerën 11,899,243 lekë. Në analizë të llog. 202 llogari “Studime dhe Kërkime” konstatohet se vlera e mbetur në fund të vitit 2023 prej 11,899,243 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, për 11 projekt studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të objekteve sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qëndrueshme Patrupëzuar” Pika 1/b “Klasifikimi kontabël” e cila ndër të tjera përcakton se: “Shpenzimet e kërkimeve të aplikuara dhe të zhvillimi - Llogaria 202” “Studime dhe Kërkime”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 37-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1.Rekomandimi:** Drejtoria financës në Bashkinë Përrenjas të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës së studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura koresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare të viti 2024**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i ekstraktit historik të Shoqërisë Aksionare “E A Sh.A” me NIPT M.....T, u konstatua se Bashkia Përrenjas zotëron 8% të aksioneve të kësaj shoqërie ose 0.56 aksion me vlerë nominale 500,000 lekë secili, në total 280,000 lekë. Aktivet afatgjata Pjesëmarrje në kapitalin e vet rezultojnë në fund të vitit në vlerën 0 lekë. Pra sa më sipër llogaria nr.26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” është nënvlerësuar me 280,000 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Urdhri i Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”. VKM nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”. Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu 3.1, pika 31,

shkronja “b”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 37-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Përrenjas, të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare të viti 2024**

**8. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Përrenjas, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 36,630,270 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Vlera e mësipërme është e rakorduar me Degën e Thesarit Përrenjas. Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2023, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të Bashkisë ndaj subjekteve private, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466. Sistemimi i vlerës totale të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” duhet të bëhet duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Nga Drejtoria e Çështjeve Juridike Prokurimeve dhe Aseteve dhe Drejtoria e Financës nuk janë marrë masa për zhblokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e garancive të bllokuara. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, pika 3.2 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4) funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 37-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Përrenjas në bashkëpunim me Drejtorin e Planifikimit të Territorit, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, si dhe të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar vlerën e garancisë, të cilave i’u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe investimi për të cilën është mbajtur garancia është marrë në dorëzim.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare të viti 2024**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i **16** procedura prokurimi të zhvilluara në Bashkinë Përrenjas për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023, me fond limit 115,754 mijë lekë pa TVSh, u konstatuan parregullsi në përzgjedhjen e procedurës së auditimit, kritere jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DT, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, si më poshtë:

- Në **14** procedura nga 16 të audituara, me vlerë totale të fondit limit 110,038 mijë lekë pa TVSh ose 96% e fondit të procedurave të audituara, u konstatua se janë aplikuar kritere të paargumentuara dhe specifikime teknike të pa argumentuara, jo në lidhje të ngushtë me tipologjinë e procedurës që zhvillohet, e cila ndikon drejtpërdrejt në pjesëmarrjen e OE në procedurë për rritjen e konkurrencës, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të mesëm, si dhe ndikojnë indirekt në eliminimin e OE me oferta më të leverdishme dhe pengojnë në zbatimin e kontratës.

- Në **7** procedura nga 16 të audituara, me vlerë totale të fondit limit 72,284 mijë lekë pa TVSh, ose 63% e fondit të procedurave të audituara u konstatua se, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Përrenjas dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike në Bashkinë Përrenjas, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tyre u konstatuan mangësi dhe mosplotësim i kriterëve të vendosura në DT.

- Në procedurat me vlerë të vogël, u konstatua copëzim fondi dhe vlera e këtyre procedurave e tejkalonte shumë tavan prej 1 milion lekë, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi, ndërkohë

që kishin funksion të ngjashëm dhe duhet të grupoheshin duke u prokuruar në një procedurë të vetme.

Gjithashtu në **3 procedura** të llojit blerje e vogël u konstatua se vlerësimi i ofertave nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 39, “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike”; neni 34 “Përlllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit”, neni 40, “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, neni 41, “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, neni 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; neni 98, “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika 1, germa a) dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1 dhe 6; neni 36 “Specifikimet teknike”, neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 5; neni 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1; neni 67, “Klasifikimi i ofertave” neni 78, pika 4, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”; neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, paragrafi i fundit; neni 85 “Lidhja e kontratës”, pika 2, etj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 49-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1. Rekomandimi:** Titullari i Autoritetit Kontraktor (Kryetari i Bashkisë Përrenjas), të marrë të gjithë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve që përfshihen në procesin prokurues që të jenë specialistë të fushës, si dhe të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të tyre, me qëllim shmangien e mangësive të evidentuara në përlllogaritjen e vlerësimit të kontratës, dokumentimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike dhe në vlerësimin e ofertave.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka bërë një vlerësim të saktë të ofertave në procedurën e prokurimit “shërbim konsulence” me objekt “Për hartimin e planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore Sopot”, me fond limit 4,145,202 lekë. Konkretisht, u konstatua se në fazën e I të kualifikimit:

-KVO ka skualifikuar OE “D” ShPK për mos përmbushje të kriterit 2.3.1. “Përvojë e suksesshme”, ndonëse operatori ka dorëzuar Urdhrin e Ministrit nr.18 datë 18.10.2022 që miraton planet e mbarështimit për ekonominë pyjore Shmil dhe ekonominë pyjore Kushe-2, çka provon realizimin e shërbimit përkatës lidhur me përvojën e mëparshme, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë 3 viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

-KVO ka kualifikuar bashkimin e operatorëve ekonomikë “D C” ShPK & “I G” ShPK, ndonëse njëri prej anëtarëve të BOE, konkretisht OE “I G” ShPK nuk ka paraqitur vërtetim realizimi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, referuar kriterit 2.3.1 “Kapaciteti Teknik” të DST. Kjo mos përmbushje kriteri është konstatuar nga KVO në Fazën e II të vlerësimit të ofertave. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 49-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**10.1.Rekomandim:** Bashkia Përrenjas të marrë masa që për procedura të ndara me faza, me objekt hartimin e planeve të mbarështimit, vlerësimi i fazës së parë kualifikuese të jetë i tillë që të mundësojë konkurrimin e shumë operatorëve ekonomikë në fazën e dytë, duke i konsideruar urdhrat e ministrit për miratimin e planeve të mbarështimit si vërtetime që provojnë kryerjen e shërbimeve të ngjashme.

#### **Në vijimësi**

**11. Gjetje nga auditimi:** Në 2 raste u konstatuan investime të paqëndrueshme për rikonstruksionin e rrugëve dhe mosargumentim të ndryshimeve në zëra të punimeve për procedura me objekt të ngjashëm prokurimi, konkretisht:

-Në 1 rast, në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rrugëve të fshatit Karkavec” me fond limit 749,998.5 lekë, sipas preventivit të miratuar nga Bashkia Përrenjas, rikonstruksionet e rrugëve përfshijnë mbulesë vetëm me çakull, duke mos përfshirë punime me asfaltim. Si pasojë, kjo procedurë përbën një investim afatshkurtër, të paqëndrueshëm dhe jo efektiv.

-Në 1 rast, në procedurën “Rikonstruksion i kanaleve ujitëse” me fond limit 832,913 lekë, në lidhje me preventivin e punimeve rezulton se në “Rikonstruksionin e kanalit ujitës Rrajcë Sutaj” janë përfshirë 6 zëra punimesh ndërsa për të njëjtën objekt punimi “Rikonstruksion i kanalit ujitës Rrajcë-fushë” janë përfshirë 3 zëra, duke mos argumentuar nga ana teknike pse mungojnë zërat për transport materiale dhe mur guri. Po ashtu, për ndërtimin e kanalit ujitës Reshtan-Katjel janë përfshirë zërat “2.262/4 Shtresë betoni” dhe 2.558 “F.V tuba b/a 100 mm”, pa përfshirë zërat si gërmime dhe dhe transport materiale. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe ligjin nr. 840/1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 49-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**11.1.Rekomandimi:** Bashkia Përrenjas të marrë masa që në punimet për rikonstruksione të rrugëve të përfshijë zërat për asfaltim dhe punime të tjera, me qëllim realizimin e investimeve në mënyrë të plotë dhe të qëndrueshme si dhe të argumentojë përmes një relacioni teknik arsyet e ndryshimeve të zërave të punimeve për procedura me objekt të ngjashëm prokurimi.

**Në vijimësi**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi aktivitet e Drejtorisë së Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Përrenjas, mbi lejet e ndërtimit/ zhvillimit të lëshuara për periudhën objekt auditimi, rezulton se:

- Në 2 raste, ka mangësi në dokumentacionin ligjor të aplikimit për leje ndërtimi;  
- Në 5 raste, nuk është respektuar lartësia maksimale e kateve të pasaportave të njërive strukturore.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe ligjin nr. 840/1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.

- Në 4 raste, ka mungesë të dokumentacionit teknik për leje ndërtimi që shoqërohen me prishje të objektit ekzistues dhe shtesa kati.

Veprim në kundërshtim me nenin 11, pika 1, germa (ç) të VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 100-108, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**12.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikim, Kontroll Zhvillim Territorit Bashkia Përrenjas, në dhënien e lejeve të ndërtimit/zhvillimit të ketë konsideratë :

- T’u kërkojë subjekteve përkatëse përcjelljen e një deklarate noteriale për shprehjen e pëlqimit nga bashkëpronarët, duke refuzuar dhënien e certifikatës së përdorimit deri në plotësimin e dokumentacionit.

- Në miratimin e lejeve të ndërtimit të respektojë lartësitë e kateve të përcaktuara për njësitë strukturore sipas Planit të Përgjithshëm Vendor.

- Në rubrikën e kushteve të lejeve, në rastet kur ndërtimi i ri kërkon prishjen e objektit të vjetër, të përcaktojë që njoftimi i fillimit të punimeve të shoqërohet me aktin teknik të shembjes së objektit. Për leje ndërtimi të llojit shtesa në objekt ekzistues, sipas rastit, të kërkojë si dokumentacion aktin e ekspertizës për të argumentuar qëndrueshmërinë e objektit të ri.

**Në vijimësi**

**13.Gjetje nga auditimi:** Në 1 rast u konstatua mospërputhje e planvendosjeve për dhënien me qira të fondit pyjorë për HEC-et “G 1 & G 2”.

Nga auditimi ka rezultuar se planvendosja që shoqëron lejen e ndërtimit miratuar me Vendimin nr. 5 datë 05.05.2015 të Këshillit Kombëtar të Territorit nuk përputhet me



planvendosjen e administruar në dosjen e kontratës së qirasë. Planvendosja e miratuar nga KKT përfshin linja të shtrirjes së tubacioneve nëntokësore dhe linjave të derivacionit që nuk janë pasqyruar në planvendosjen e administruar në dosje, e për pasojë krijon rrisje për mos përlllogaritjen e saktë të sipërfaqeve që jepen në përdorim për aktivitetin e HEC-it. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1, datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 100-108, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**13.1.Rekomandimi:** Bashkia Përrenjas të marrë masa për të verifikuar në terren shtrirjen e tubacioneve, sipas planvendosjes së lejes së ndërtimit miratuar me Vendimin nr. 5 datë 05.05.2015 të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe të plotësojë dosjen me dokumentacionin e lejes përkatëse të ndërtimit.

**Menjëherë**

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i asetëve rezulton se, nga 899 prona që i janë transferuar me listë përfundimtare Bashkisë Përrenjas, përfshirë ish-komunën Rrajcë, vetëm 19 pasuri që i përkasin inventarit të pasurive të paluajtshme janë regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Në veçanti, konstatohet se nuk janë regjistruar pasuritë e shërbimeve arsimore, ndonëse për to janë realizuar investime përgjatë viteve. Inventarët e pasurive të paluajtshme nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se Bashkia Përrenjas nuk ka ngritur një strukturë të posaçme bashkëpunimi me Zyrën Vendore të ASHK-së për të verifikuar statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Veprimet apo mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 37, të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM nr.28 datë 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishtme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3.4, faqe 37-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**14.1.Rekomandimi:** Bashkia Përrenjas të marrë masa për ngritjen e një strukture të posaçme për të koordinuar me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës në funksion të përditësimit të inventarit dhe regjistrimit të pasurive të paluajtshme, përmes verifikimit juridik dhe faktik (evidentim në terren) të gjendjes së pronave. Në veçanti, të përcaktojë si prioritet regjistrimin e pasurive të paluajtshme të shërbimeve arsimore, si shkolla, kopshte dhe çerdhe.

**Menjëherë**

**15. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Përrenjas ka në administrim një fond pyjor dhe kullor prej 18399.9 ha, i ndarë në 7 ekonomi pyjore dhe 2 ekonomi kullorë dhe ka hartuar plane mbarështimi për 2 ekonomi pyjore, nga 7 gjithsej, ndërsa një i tretë është në proces. Në lidhje me sipërfaqet pyjore, Bashkisë Përrenjas i janë transferuar 1028 ngastra gjithsej dhe janë regjistruar 21 pasuri të llojit “pyll”, “kullota” dhe “shkëmbore”. Nga këto, 10 pasuri të janë regjistruar në ASHK gjatë vitit 2023. Në zbatim të detyrimeve ligjore, numri i punonjësve të strukturës përgjegjëse për pyjet përcaktohet në përpjesëtim me sipërfaqen e fondit pyjor si më poshtë: një specialist pyjesh për 750 – 1000 ha për pyjet e larta. Për bashkinë Përrenjas, me një fond pyjor 18399 ha numri i punonjësve duhet të ishte 18 ndërkohë që numëron vetëm 10 inspektorë, përfshirë kryeinspektorin. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me ligjin nr.57/2020 “Për pyjet” dhe VKM nr.433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish komunave/bashkive”, të ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 37-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**15.1.Rekomandimi:** Bashkia Përrenjas të marrë masa që të parashikojë fonde për miratimin e planeve të mbarështimit për ekonomitë pyjore, regjistrimin e sipërfaqeve pyjore si dhe për

plotësimin e numrit të inspektorëve në pyje në raport me sipërfaqet në hektarë që i janë transferuar.

## Në vijimësi

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi të dhënat e buxhetit të vitit 2023, rezulton se është realizuar në masën 82%, ku nga vlera e parashikuar me gjithë shtesa prej 1,101,092 mijë lekë është realizuar vlera 901,708 mijë lekë. Ky mos realizim vjen për faktin se parashikimi i shpenzimeve nuk është bërë mbi bazën e të ardhurave faktike të një vitit më parë, por është planifikuar mbi planin e të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore, i cili për asnjë vit nuk realizohet.

Zëri kryesorë i shpenzimeve, investimet është zëri që ka përqindjen më të ulët, ku nga vlera e parashikuar prej 221,665 mijë lekë është realizuar në masën 116,943 mijë lekë ose 53%, që do të thotë se nga Bashkia Përrenjas në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.

Në lidhje me faturat e palikujduara në fund të vitit 2023, konstatohet se janë në vlerën 47,371,178 lekë, nga e cila me të ardhurat e veta 1,320,672 lekë dhe me fondet nga Ministrinë e linjës për vlerën 46,050,506 lekë. Në raport me totalin e shpenzimeve të vitit 901,708 mijë lekë, kjo njësi vendore nuk është në vështirësi financiare, pasi zë 5.2% të totalit

Në lidhje me detyrimet e vitit, konstatohet se detyrimi në vlerën **20,551,726 lekë** për kryerjen e punimeve në objektin “Pyllëzim me drurë frutorë (Arra dhe Lajthi)”, me vlerë kontrate 20,856,661 lekë, ka mbetur për likuidim në vlerën **13,087,846 lekë**, Referuar shkresës nr. 2521/1 prot, datë 21.08.2020 rezulton se për këtë objekt është regjistruar procedimi penal nr.327/2020 dhe është në hetim nga Prokuroria.

Gjithashtu, referuar Vendimit nr. 859, date 14.11.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, Bashkia Përrenjas është në Proces gjyqësor me Subjektin Ergi SHPK si dhe për kryerjen e punimeve në objektin “Gjelbërimi nëpërmjet pyllëzimeve i Kurorës së Qytetit Përrenjas”, me vlerë kontrate 10,584,173 lekë, ka mbetur për likuidim vlera **7,463,880 lekë**, referuar shkresës nr. 3459 prot, datë 20.12.2023, rezulton se për këtë objekt është regjistruar procedimi penal nr. 1566/2022 dhe është në hetim nga Prokuroria.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me germën (a) të nenin 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe pikën 24 dhe 25 në nenin 3, nenin 47 në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 18-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**16.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Përrenjas dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për likuidimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, si dhe të bëjë grafikun e likuidimit të detyrimeve të prapambetura, respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

**16.2.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t’u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

## Përgjatë vitit buxhetor 2024 dhe në vijim

**17. Gjetje nga auditimi:** Sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion në lidhje me organizimin e Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes Territorit, për periudhën 01.01.2022-

31.12.2023, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IMTV, këtu e në vijim), është ngritur dhe funksionon në bazë të neneve 4 dhe 11, të Ligjit nr.9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”.

Nga auditimi rezulton se:

- Nga Kryeinspektori i IMTV-së nuk është respektuar afati ligjor për nxjerrjen e masës administrative vendim për pezullimin e punimeve, në kundërshtim me nenin 13 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

- Në dosje mungon vendimi për dënimin me gjobë dhe nxjerrjen e urdhrin të ekzekutimit, sipas neneve 20, 22 dhe 30 të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

- Nga IMTV-ja e Bashkisë Përrenjas është konstatuar se subjekti ka kryer ndërtim të paligjshëm, duke konsumuar elementet e veprës penale të parashikuar në nenin 199/a i Kodit Penal dhe në vijim nuk është përgatitur dosja për të vijuar me kallëzim penal në ngarkim të subjektit ndërtues, për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm“ parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal.

- Nga Kryeinspektori i IMTV-së nuk është vijuar procedura ligjore për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit dhe vendimeve ekzekutive nga gjykata për dënimin me gjobë, si akt që përbën titull ekzekutiv, jo në përputhje me kërkesat e nenit 5 pika “d“ të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

- Nuk është bërë kërkesa për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, drejtuar Gjykatës Administrative për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit.

- Në dosje mungon korrespondenca, kërkesë për mbështetje me Policinë e Shtetit, Policinë Bashkiake dhe IKMT, për veprimet e mëtejshme në funksion të dokumentimit dhe çfarë veprimesh janë marrë për objektin në fjalë. Nuk administrohet foto e objektit.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 nga Inspektoret e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Përrenjas, kanë mbajtur gjithsej 36 akte konstatimi, për ndërtime informale pa leje ndërtimi dhe për objekte për mosrespektim të afatit të punimeve. Nga këto, për 7 subjekte është marrë vendim për pezullim të punimeve, për 7 prej tyre është nxjerrë vendim për prishjen e objektit, për 10 prej tyre është marrë vendim gjobe dhe për 7 prej tyre është vijuar me kallëzim penal. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 108-116, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**17.1. Rekomandimi:** Kryeinspektori i IMT-së Bashkia Përrenjas, të vijojë procedurën për nxjerrjen e Vendimit për “Prishje Objekti të Kundërligjshëm”, që janë me procesverbal konstatimi për objektet e ndërtuara pa leje ndërtimi dhe të nxjerrë “Urdhër Ekzekutimi" për prishjen e objekteve të kundërligjshëm për subjekte që janë me Vendim për “Prishje Objekti të Kundërligjshëm”.

**17.2. Rekomandimi:** Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Përrenjas, të marrë masa si vijon:

-Mbajtjen e aktkontrolleve për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe planifikimit, kontrollit dhe zhvillimit të territorit.

-Moslejimin e zhvillimit të ndërtimit në kushtet e mungesës së lejes së zhvillimit dhe të ndërtimit të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

-Në çdo rast që konstatohet shmangie nga projekti i miratuar, përveç ndëshkimit me masë administrative, heqjen e licencës profesionale për personat përgjegjës, sipas parashikimeve ligjore, me qëllim forcimin e masave për kontrollin e territorit dhe mbrojtjen e tij nga ndërhyrjet abuzive.

-Rritjen e bashkëpunimit me Drejtorinë e Politikave Urbane, për shkëmbimin e informacionit midis tyre. Realizimin e kontrolleve periodike mbi objektet në zhvillim, të pajisur me leje ndërtimi, për të verifikuar nëse zbatimi i punimeve kryhet sipas projektit të miratuar.

-Përgatitjen e planeve vjetore dhe mujore të punës dhe informacionin periodik tre mujor ndaj Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) mbi aktivitetin e saj, procedurat e mbajtura gjatë kësaj kohe dhe vendimet e marra.

## Menjëherë dhe në vijimësi

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve, rezulton se:

Nga Bashkia Rrogozhinë janë masat e duhura për raportimin në lidhje me planin e veprimeve të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. 3368/1prot, datë 11.12.2023, duke respektuar afatin 20 ditor. Ndërsa nuk është raportuar dhe për ecurinë e tyre në afatin 6 mujorë, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2.

**a.** Nga **14 masa organizative** të rekomanduara, janë pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar 11 masa janë në proces zbatimi, **3 janë zbatuar pjesërisht.**

**b. c.** Nga **6 masa** për të ardhura të munguara pranuar plotësisht. Nga të pranuarat 3 masa janë në proces zbatimi 1 (një) masë është zbatuar pjesërisht, dhe **2 masa janë zbatuar pjesërisht.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 120-126, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**18.1. Rekomandim:** Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përsheptimin e atyre në proces si më poshtë:

### **A. Masa Organizative**

**2.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Përrenjas, të marrë masa për plotësimin e Njesisë së auditimit të brendshëm me 3 auditues, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me ligjin, VKM-ve dhe Manualeve, për të përmbushur misionin e saj në arritjen e objektivave.

**3.1. Rekomandimi:** Nga Njësia zbatues të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrave të aktiveve të njesisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: data e hyrjes ose e marrjes në dorëzim. Përshkrimi i aktivitet, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, data e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëposhme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivitet, vendndodhja, personi përgjegjës, vlera e akumuluar e amortizimit, koha e shërbimeve të mrëmbajtjes, data e daljes nga pronësia.

**8.1 Rekomandimi:** Kryeinspektori i IMTV Bashkia Përrenjas, të marrë masa që në të ardhmen, të nxjerrë vendimet e gjobave për të gjitha rastet e konstatimit të ndërtimeve pa leje ose në shkelje të lejes, të kryet pezullimi i punimeve në aktin përkatës si dhe të nxirren vendimet për prishjen e tyre.

### **B. Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara)**

1.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Përrenjas dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për arkëtimin e detyrimeve të palikujduara nga debitorët progresivë për vitin 2022, nga mospagesa e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara në paketën fiskale nga subjektet ekonomike që ushtrojnë aktivitetet për qëllime biznesi si dhe nga subjektet familjare në vlerën totale 63,391,576 lekë.

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Urbanistikës të përcjellë listën me subjektet debitorë për taksën e ndikimit në infrastrukturë si dhe në vijim Bashkia Përrenjas të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë prej 2,526,900 lekë.

6.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Urbanistikës, personit të ngarkuar për llogaritjen e TNI për objektet e reja që kanë tipologjinë e mësipërme, taksa të përlllogarit bazuar në çmimin e shitjes.

6.2 Rekomandimi: Drejtoria e Urbanistikës dhe Drejtoria e Taksave Tarifave Vendore të marrin masa për arkëtimin e vlerës prej 10,047,964 lekë ndaj 2 subjekteve për llogaritje të gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga të cilat 4,170,770 lekë për subjektin L B dhe E B si dhe 5,877,194 lekë për subjektin M –P.

Menjëherë

## **B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË TYRE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura, rezulton se Bashkia Përrenjas për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2023 ka shpenzuar vlerën **1,634,429 lekë**, për 4 raste, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomicitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Në urdhrin e Titullarit të institucionit për likuidimin e vendimeve gjyqësore të mësipërme, nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij (largimit nga puna) ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Përrenjas. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore dhe si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 18-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Përrenjas të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet (argumentimin dhe propozimin nga njësia e burimeve njerëzore për largimet nga puna, si dhe mbrojtjen juridike nga sektori juridik të çështjeve përkatëse pranë gjykatës), me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

**Përgjatë zbatimit të buxhetit të vitit 2024 dhe në vijimësi**

## **C. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit, u konstatua se në Bashkinë Përrenjas operojnë gjithsej 22 subjekte të cilat kanë lidhur kontrata qiraje për HEC, gurorë, objekte, veprimtari ekonomike, telefoni, duke përllogaritur një detyrim me 31.12.2022 në vlerën 4,566,925 lekë, ndërsa detyrimi vjetor për vitin 2023 është 11,913,677 lekë, gjithsej në shumën 16,480,602 lekë. Janë likujduar gjatë vitit 2023 vlera 13,750,767 lekë, duke mbetur për likuidim vlera **2,729,835 lekë**.

Nga auditimi, u konstatua se referuar nenit 5, pika 5.5 e kontratave, për subjektet të cilat janë debitorë nga Bashkia Përrenjas (personat përgjegjës), nuk janë llogaritur penalitetet në masën 0.1%, por jo më shumë se 10%, detyrim i cili deri në datën 31.12.2023 rezulton në vlerën **2,831,729 lekë**.

Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfi-teozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar; VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”. nenit 5, pika 5.5 e kontratës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 18-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

**1.1.Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Përrenjas, Drejtoria e të Ardhurave dhe Licencave, dhe Drejtoria e Financës të analizojnë situatën dhe të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve kontraktuale në vlerën **2,729,835 lekë**, si dhe kamatvonesa deri më 31.12.2023 në vlerën **2,831,729 lekë**.

**D. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi administrimin e TNI nga ndërtimet informale, rezultoi se:

Sipas të dhënave të marra nga DPKZHT Bashkia Përrenjas, deri në fund të vitit 2023 janë legalizuar gjithsej 108 subjekte për vlerën 3,118,638 lekë, nga e cila likuiduar vlera 1,080,846 lekë, duke mbetur për detyrim vlera 2,037,792 lekë, si e ardhur e munguar në buxhet, pasi nuk rezultoi e kontabilizuar. Për vitin 2023 kemi 6 leje me vlerë 194,563 lekë të shtuar.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5; etj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 18-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar me vlerë **2,037,791 lekë**.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi administrimin e taksës së tokës bujqësore, rezultoi se kjo taksë për vitin 2023 është realizuar në vlerën 3,182 mijë lekë nga vlera 4,700 mijë lekë të planifikuara ose në masën 67.7 %. Referuar të dhënave të vëna në dispozicion nga Bashkia Përrenjas rezultoi se vlera debitorë për taksën e tokës bujqësore, deri në fillim të vitit 2023 është 16,272,478 lekë, përsa i përket debitorëve të cilët janë krijuar gjatë vitit 2023 rezultoi vlera debitorë prej 2,757,315 lekë, **si rrjedhojë detyrimi deri më 31.12.2023 rezultoi në vlerën 16,865,439 lekë** vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Përrenjas, pasi është e pakontabilizuar.

Theksojmë se, sipërfaqe e tokës bujqësore e taksuar, është bërë mbi bazën e vetëdeklarimeve të familjeve që përdorin tokë bujqësore, si dhe jo të jenë bërë verifikime me qëllim sigurimin e të dhënave dhe krijimin e kadastrës vendore të tokës bujqësore.

Mangësi konstatohen edhe në organizimin e strukturave për ndjekjen e kësaj takse, mos përditësimi i regjistrave të familjeve fermerë që disponojnë toke si dhe niveli i ulët i realizimit të taksës së tokës bujqësore, duke u evidentuar një numri i madh i familjeve debitorë në vlera të konsiderueshme debitorë. Regjistrat nuk janë të përditësuar sipas ndryshimeve të bëra vit pas viti në kadastrë për tokat në disponim dhe përdorim.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 dhe 24. ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10. VKB nr. 11 prot., datë 26.12.2022 pika A.2/b Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 18-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave dhe Licensave, në bashkëpunim Njësitë Administrative të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës, për hartimin e regjistrat të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, duke verifikuar në terren si dhe marrjen zyrtare e të dhënave nga institucionet përkatëse. Pas identifikimit dhe evidentimit me të gjithë treguesit të parcelave të tokës që disponon çdo fermer, të rishikohet planifikimi i të ardhurave për këtë taksë, të ndiqet arkëtimi i saj nëpërmjet njoftim-vlerësimeve për detyrimet për gjithë kohën e papaguar për familjet fermerë dhe për mos pagesat të ndiqen procedurat e tjera

administrative e ligjore në strukturat e tjera kompetente, sipas rastit. Gjithashtu të ndiqen të gjitha rrugët ligjore deri në arkëtimin e vlerës 16,865,439 lekë vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Përrenjas.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit që administron IMTV-ja në Bashkinë Përrenjas u konstatua se në fund të vitit 2022 si rrjedhojë e gjobave të vendosura është krijuar detyrimi në vlerën 1,000,000 lekë për 2 gjoba të vendosura, detyrimi i krijuar brenda vitit 2023 është në vlerën 3,000,000 lekë për 6 gjoba të vendosura, në total detyrimi i krijuar në datën 31.12.2023 është për 8 gjoba në vlerën 4,000,000 lekë vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Përrenjas. Nga auditimi konstatohet se, Drejtoria e IMTV nuk ka ndjekur hapat e nevojshëm në çdo rast për të dërguar në gjykatë vendimet për të nxjerrë Urdhrin e Ekzekutimit për të gjithë gjobat e vendosura të këtij viti, sipas kërkesave të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, pika 4. Gjobat analitike janë të pasqyruara në kapitullin Anekse-Aneksi nr.3, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 18-39, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1.Rekomandimi:** IMTV dhe Drejtoria e të Ardhurave dhe Licencave në Bashkisë Përrenjas të ndjekin të gjitha masat ligjore me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtime e pa ligjshme për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave në vlerën **4,000,000 lekë**.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Bashkia Përrenjas lidhur me gjendjen e debitorëve progresiv për subjektet fizik/juridik, në fund të vitit 2022 rezulton në një numër debitorësh prej **212 subjekte në vlerën 18,312,760 lekë**. Detyrim i krijuar gjatë vitit 2023 rezulton për 87 subjekte në vlerën 9,481,250 lekë, duke rezultuar në fund të vitit 2023 (progresiv), prej 245 subjektesh me vlerë debitorë prej **21,694,048 lekë**.

Përsa i përket taksave dhe tarifave vendore për abonentët familjarë në Bashkinë Përrenjas konstatohet se, familjarët ngarkohen me taksa dhe tarifa për Tokën, Banesën, Ndriçimin dhe Shërbimet Publike nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Licencave Bashkia Përrenjas.

Nga auditimi deri në fillim të vitit 2023 gjendja e debitorëve nga abonentët familjarë është në vlerën 28,806,338 lekë. Janë krijuar brenda viti 2023 në vlerën 9,368,038 lekë për 4842 familje, duke mbetur debitorë progresiv deri më 31.12.2023 në një numër prej **5,275 familje debitorë në vlerën 33,783,018 lekë**.

Përsa i përket debitorëve familjarë të cilët tarifohen për tarifën e ujit të pijshëm deri më 31.12.2023 kemi të bëjmë me një vlerë debitorë **prej 13,138,092 lekë**.

Në fund të vitit 2023 borxhi tatimor në Bashkinë Përrenjas është në vlerën 68,615,158 lekë vlerë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Përrenjas.

Gjithashtu nga auditimi konstatohet se, pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet e vitit 2023, nuk janë nxjerrë urdhrat përkatës për të ndërmarrë hapa të tjera bazuar në masat e parashikuara në kuadrin ligjor të fushës ndaj debitorëve të Bashkisë Përrenjas. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 18-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1.Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave dhe Licencave Bashkia Përrenjas në bashkëpunim me sektorët e tjerë të Bashkisë Përrenjas, si, Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit, Drejtorinë Juridike, Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë Financës, të marrin masat administrative e ligjore duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve në vlerën **87,518,388 lekë** kjo për subjekte/abonent familjare, për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit që mund të krijohet nga mos ndjekja e tyre.

**Menjëherë**

**5. Gjetje nga auditimi:** Në territorin e Bashkisë Përrenjas për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 6 subjekte. Grupi i auditimit auditori dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe pagesën e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore për vitet 2023, duke rezultuar se 2 subjekte nuk ka paguar detyrimin për autorizim në vlerën 1,600,000 lekë, respektivisht:

- Subjekti “L B” ShPK për vlerën 1,000,000 lekë.

- Subjekti “K” ShPK për vlerë 600,000 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” VKM nr. 344, Datë 19.4.2017 Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 970, Datë 2.12.2015 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 18-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**5.1.Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve bashkia Përrenjas, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur prej **1,600,000** lekë nga 2 subjektet, respektivisht;

-Vlera 1,000,000 lekë nga subjekti “L B” SHPK.

-Vlera 600,000 lekë nga subjekti “K” SHPK.

## Menjëherë

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin lidhur me tarifën e pastrimit dhe tarifën e mjedisit, tarifa këto të përcaktuara në VKB-në nr.11 prot., datë 26.12.2022 për miratimin e paketës fiskale të Bashkisë Përrenjas për vitin 2023 ku specifikohet se subjektet të cilët do të tarifohen me tarifën e “Mjedisit” dhe tarifën e “Pastrimit” sipas veprimtarisë së tyre janë si më poshtë vijon:

-Subjektet Hece deri në 2 Mega për një nivel tarife 300,000 lekë .

-Subjekte Hece nga 3 - 4 Mega për një nivel tarife 350,000 lekë.

-Subjektet Hece deri në 5 Mega për një nivel tarife 400,000 lekë.

-Subjektet persona juridik që ushtrojnë aktivitet të tillë si, Karrierë guri (gurore) Shfrytëzim karrierash lumore dhe malore, prodhim Insertesh, shfrytëzim minierash, hekur nikeli, shfrytëzim pyjesh dhe industri të tjera të cilat ndikojnë në mjedis, për një nivel tarife 250,000 lekë.

Nga auditimi konstatohet se, nga ana e Drejtorisë e të Ardhurave dhe Licencave dhe inspektorati i mjedisit pranë Bashkisë Përrenjas nuk janë tarifuar për tarifën e mjedisit 9 subjekte për llojin e aktivitetit si, Karrierë Guri, Inerte, shfrytëzim pyjesh etj, për vlerën 2,250,000 lekë. Për subjektet me aktivitet HEC nuk janë tarifuar 2 subjekte në vlerën 700,000 lekë. Përsa i përket tarifës së Pastrimit rezultojnë 14 subjekte me veprimtari Hec, Gurore, Minierat dhe Nyje betoni të cilët nuk janë tarifuar me tarifën e pastrimit duke sjellë një vlerë debitorë prej 1,540,000 lekë. Në total nga mos tarifimi i tarifës së “Mjedisit” dhe tarifës së “Pastrimit” rezulton vlera debitorë prej 4,490,000 lekë vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Përrenjas. Këto veprime janë në kundërshtim me VKB nr.11 prot., datë 26.12.2022 për miratimin e paketës fiskale të Bashkisë Përrenjas Kapitulli III pika 1 dhe pika 15. Struktura e ngarkuar për përllogaritjen dhe vjeljen e tarifës së Mjedisit, VKB-së nr. 11, datë 26.12.2022 “Mbi caktimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023”. Kapitulli III pika 15. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 18-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1.Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve Bashkia Përrenjas, të marrë të gjitha masat duke zbatuar të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për nxjerrjen dhe kontabilizimin e detyrimeve për tarifën e “Mjedisit” dhe tarifën e “Pastrimit” për 25 subjektet në vlerën **4,490,000** lekë, respektivisht:

-Vlera 700,000 lekë për 2 subjekte HECE.

-Vlera 2,250,000 lekë për 9 subjekte me lloj aktiviteti si, Karrierë Guri, inerte etj.

-Vlera 1,540,000 për 14 subjekte me veprimtari Hec, Gurore, Minierat dhe Nyje betoni etj.



**6.2.Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve Bashkia Përrenjas të ushtrojë kontrolle pranë aktiviteteve të subjekteve të cituar më sipër, me qëllim identifikimin nëse, ushtrohet ose jo veprimtaria prej tyre.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

## **E. MASA DISIPLINORE.**

Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil: Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në V.K.M-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Përrenjas**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

### **a. “Vërejtje” në zbatim të pikës “a” të nenit 58, për 9 punonjës:**

**1. Znj. M P**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Aplikimit të Projekteve, për mangësi në dokumentacionin ligjor dhe mosrespektimin e lartësive maksimale të kateve, veprime në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Përrenjas, si dhe në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për 7 raste (procedura prokurimi) ka aplikuar kritere të paargumentuara, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (*Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 49-100*).

**2. Znj. Z Ç**, me detyrë Drejtor Juridike, Prokurimeve Publike dhe Burimeve Njerëzore, për mangësi në realizimin e procedurave me blerje të vogël, veprime në kundërshtim me pikën 5 të udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, si dhe në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për 10 raste (procedura prokurimi) ka aplikuar kritereve të paargumentuara, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. (*Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 49-100*).

**3. Znj. M R**, me detyrë përgjegjëse sektori, sektori juridik dhe prokurimeve, për mangësi në realizimin e procedurave me blerje të vogël, në cilësinë e anëtares së komisionit të blerjeve të vogla, veprime në kundërshtim me ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, si dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, për 5 raste (procedura prokurimi) ka shpallur fitues OE të cilët nuk janë në kushtet plotësimit të të gjitha kritereve të DST të miratuara nga AK në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82. (*Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 51-104*).

**4. Z. L L**, me detyrë Drejtor i Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, për mangësi në vlerësimin e procedurës “shërbim konsulence” me objekt “Për hartimin e planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore Sopot”, në cilësinë e Kryetarit të KVO, veprime në kundërshtim me VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. (*Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 49-100*).

**5. Znj.A K**, me detyrë specialiste, për mangësi në realizimin e procedurave me blerje të vogël, në cilësinë e anëtares së komisionit të blerjeve të vogla, veprime në kundërshtim me ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, si dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, për 4 raste (procedura prokurimi) ka shpallur fitues OE të cilët nuk janë në kushtet plotësimit të të gjitha kritereve të DST të miratuara nga AK në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82. (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 49-100).

**6. Znj. R D**, me detyrë specialiste, për mangësi në realizimin e procedurave me blerje të vogël, në cilësinë e anëtares së komisionit të blerjeve të vogla, veprime në kundërshtim me ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, si dhe në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për 10 raste (procedura prokurimi) ka aplikuar kriterëve të paargumentuara dhe/ose jo të lidhura ngushtë me tipologjinë e procedurës, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 49-100).

**7. Znj. M H**, me detyrë specialiste, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, për 6 raste (procedura prokurimi) ka shpallur fitues OE të cilët nuk janë në kushtet plotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82. (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 49-100).

**8. Znj. M V**, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e të Ardhurave, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, për 2 raste (procedura prokurimi) ka shpallur fitues OE të cilët nuk janë në kushtet plotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82. (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 49-100).

**9. Z. A O**, me detyrë specialist në Drejtorinë e të Ardhurave, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, për 1 rast (procedura prokurimi) ka shpallur fitues OE të cilët nuk janë në kushtet plotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82. (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 49-100).

## **F. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL.**

Për punonjësit që janë rekomanduar masat disiplinore, Bashkia Përrenjas pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë: a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar. b. Të njoftojë Komisionerin për Mbiqëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

**Shënim:** Gjatë auditimit të ushtruar në Bashkinë Përrenjas, nga ana e grupit të auditimit të KLSH nuk janë kontrolluar procedurat mbi zbatimin e kontratave për investime publike, mbi planifikimin, kontrollin dhe zhvillimin e territorit, të cilat do të jenë objekt i auditimit në auditimin e radhës.

## V.ANEKSE

**Aneksi nr.1 – Mbi hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare trajtuar nga faqja nr.50 deri në faqen nr.63 të projekt raportit të auditimit.**

Formati nr.1

Nr.	Reshti	Referenca e	EMERTIMI	Ushtrimi I	Ushtrimi Paraardhes
		<b>Logarive</b>		<b>Mbyllur</b>	
1		<b>A</b>	<b>A K T I V E T</b>	<b>1,764,404,822</b>	<b>2,175,308,277</b>
2			<b>I.Aktivitet Afat shkurtër</b>	<b>424,389,382</b>	<b>366,977,224</b>
3			<b>1.Mjete monetare dhe ekujvalent të tyre</b>	<b>190,710,648</b>	<b>161,716,608</b>
4	531		Mjete monetare në Arke	0	0
5	512,56		Mjete monetare në Banke		
6	520		Disponibilitete në Thesar	190,338,038	161,445,108
7	50		Letra me vlerë		
8	532		Vlera të tjera	372,610	271,500
9	54		Akreditiva dhe paradhenie		
10	59		Provizgjone zhvlersimi letra me vlerë (-)		
11			<b>2.Gjendje Inventari qarkullues</b>	<b>36,791,552</b>	<b>40,080,928</b>
12	31		Materiale	10,968,007	13,463,338
13	32		Inventar i imet	24,074,419	25,967,007
14	33		Prodhim nre proces		
15	34		Produkte		
16	35		Mallra	1,749,126	650,583
17	36		Kafshe në rritje e majmeri		
18	37		Gjendje të pa mbritura, ose prane të tretteve		
19	38		Diferenca nga cmimet e magazinimit		
20	39		Provizgjone përzhvlersimin e inventarit (-)		
21			<b>3.Llogari të Arketushme</b>	<b>195,566,510</b>	<b>140,351,263</b>
22	411		Kliente e llogari të ngjashme		
23	423,429		Personeli, paradhenie, deficite, gjoba		
24	431		Tatim e Taksa		
25	432		Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
26	433		Fatkeqsi natyrore që mbulohe në shteti		
27	435		Sigurime Shoqerore		
28	436		Sigurime Shendetore		
29	437,438,		Organizma të tjere shtetore		
30	44		Institucione të tjera publike		
31	465		Efekte për tu arketuar nga shitja e letrave me vlerë		
32	468		Debitore të ndryshem	94,462,552	84,536,862
33	4342		Operacione me shtetin(Te drejta)	101,103,958	55,814,401
34	45		Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
35	49		Shuma të parashikuara për xhvlresim(-)		
36			<b>4.Te tjera aktive afatshkurtra</b>	<b>1,320,672</b>	<b>24,828,425</b>
37	409		Parapagime		
38	473		Llogari e pritjes të mardhenieve me thesarin		
39	477		Diferenca konvertimi aktive		
40	481		Shpenzime për t'u shperndare në disa ushtrime		
41	486		Shpenzime të periudhave të ardhshme	1,320,672	24,828,425
42			<b>II.Aktivitet Afat gjata</b>	<b>1,340,015,440</b>	<b>1,808,331,053</b>
43	<b>20</b>		<b>1.Aktive Afatgjata jo materiale</b>	<b>11,899,243</b>	<b>11,899,243</b>
44	201		Prime të emisionit dhe Rimbursimit të huave		
45	202		Studime dhe kerkime	11,899,243	11,899,243
46	203		Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme		
47	<b>21</b>		<b>2.Aktive Afatgjata materiale</b>	<b>1,195,497,819</b>	<b>1,605,689,007</b>
48	210		Toke, T,roje, Terene	4,918,360	4,918,360
49	211		Pyje, Plantacione	24,118,659	24,118,659
50	212		Ndertesat e Konstruksione	618,437,942	599,864,043
51	213		Rruge, rrjete, vepra ujore	501,633,730	916,482,044
52	214		Instalime teknike, makineri e paisje	8,203,353	10,168,721
53	215		Mjete Transporti	19,127,590	21,813,454
54	216		Rezerva Shtetore	0	
55	217		Kafshe pune e prodhimi	0	
56	218		Inventar ekonomik	19,058,185	28,323,726
57	24		Aktive afatgjata të demtuara		
58	28		Caktime të Aktiveve Afatgjata		
59	25-26		<b>3.Aktive Afatgjata Financiare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
60	25		Huadhenie e Nenhuadhenie		
61	26		Pjesmarrje në kapitalin e vet		
62			<b>4.Investime</b>	<b>132,618,378</b>	<b>190,742,803</b>
63	230		Per Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231		Per Aktive Afatgjata materiale	132,618,378	190,742,803

65	<b>B</b>	<b>PASIVET(DETYRIMET)</b>	<b>160,066,666</b>	<b>132,022,317</b>
66		<b>I.Pasivet Afat shkurtra</b>	<b>160,066,666</b>	<b>132,022,317</b>
67		<b>1. Llogari te Pagushme</b>	<b>160,066,666</b>	<b>132,022,317</b>
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	81,703,882	37,880,065
69	42	Detyrime ndaj personelit	13,953,770	13,007,747
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	736,879	581,377
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqerore	4,074,938	3,820,372
76	436	Sigurime Shendetsore	565,189	524,840
77	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	36,630,270	45,539,778
82	467	Kreditore te ndryshem	22,401,738	30,668,138
83	4341	Operacione me shtetin( detyrime		
84	49	Shuma te parashikuara per xhvlresim(-)		
85		<b>2.Te tjera pasive afatshkurtra</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
86	419	Kreditore, Parapagime		
87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se titullit		
91		<b>II.Pasivet Afat Gjata</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
92	Klase 4	Llogari te pagushme		
93	16.17,18	Huate Afat gjata		
94		Provigjonet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	<b>C</b>	<b>AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)</b>	<b>1,604,338,156</b>	<b>2,043,285,960</b>
97	<b>D</b>	<b>FONDI I KONSOLIDUAR :</b>	<b>1,604,338,156</b>	<b>2,043,285,960</b>
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	1,450,630,388	1,927,380,630
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	153,707,768	115,905,330
101	111	Rezerva		
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve		
	15	Shuma te parashikuara per rreziqe e Zhvlresime	0	0
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshmne		
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		
105	107	Vlera e mjeëteve te caktuara ne perdorim	0	0
106	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata	0	0
107		Te Tjera	0	0
108	<b>E</b>	<b>TOTALI I PASIVEVE(B+C)</b>	<b>1,764,404,822</b>	<b>2,175,308,277</b>

Burimi: Bashki Prrenjas, Drejtoria e financës

Formati nr.3

Nr. Reshti	Nr Rubrike	PERMBAJTJA	Periudha Raportuse	Periudha Paraardhese
(a)	(b)	(c)	(1)	(2)
1	1	<b>VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT</b>	<b>926,436,671</b>	<b>892,023,287</b>
2	1	<b>Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime korente (+)</b>	<b>814,046,851</b>	<b>797,968,437</b>
3	2	<b>Arketime e te hyra(Cash), gjate vitit ushtrimor</b>	<b>84,847,087</b>	<b>69,292,326</b>
4		Te Hyra nga Tatimet e Doganat tatimore e Doganore(+)	0	0
5		Te hyra nga Kontributet e Sig. shoq. e shendets(+)	0	0
6		Te hyra nga ardhurat jotatimore (+)	27,542,733	24,762,524
7		Te hyra, Sponsorizime nga te trete,(+)		
8		Te hyra, nga kredi e huamarrje afatshkurter(+)		
9		Te hyra nga Mjetet ne ruajtje(+)		
10		Te tjera, arketuar(+)		
11	3	<b>Pagesa per Detyrime e Shpenzime korente</b>		
12		Per detyrime e Shpenzime nga vitet e kaluara(-)		
13		Per detyrime e Shpenzime te viti ushtrimor(-)		
14		Pagesat per mjetet ne ruajtje(-)		
15		Interesi I paguar(-)		
16		Tatime te paguara(-)		
17		Te tjera te paguara (-)		
18	II	<b>VEPRIMTARITE E INVESTIMEVE</b>	<b>132,618,378</b>	<b>190,161,059</b>
19		Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime Kapitale (+)	132,618,378	190,161,059
20		Te hyra nga Kredi dhe e huamarrje afatgjata (+)		
21		Te hyra nga shitja e Aktiveve Afatgjata (+)		
22		Te hyra nga interesat e huadhenies dhe nenhuadhenies(+)		
23		Pagesa per detyrime e Investime nga vitet e kaluara(-)		
24		Per detyrime e Investime te viti ushtrimor(-)		
25		Huadhenie e Nenhuadhenie(-)		
26		Pjesmarrje ne kapitalin e vet(-)		

27		Dividente te paguar(-)		
28	III	<b>TRANSFERTA E TE TJERA</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
29		Derdhje e Transferime te te Ardhurave ne Buxhet(-)		
30		Transferime ne buxhet te Fondeteve pa perdorura(-)		
31		Levizje e brendshme e transferata te tjera(+)		
32	IV	<b>Rritja /Renia neto e Mjeteve monetare</b>	<b>28,994,040</b>	<b>14,863,788</b>
33	V	<b>Teprica ne fillim te vitit ushtrimor</b>	<b>161,716,608</b>	<b>146,832,820</b>
34	VI	<b>Teprica e Likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimor</b>	<b>190,710,648</b>	<b>161,716,608</b>

*Burimi: Bashki Prrerjas, Drejtoria e financës.*

NR	Pershkrimi I Projektit	Garanci qe trashegohen 2024
1	Likujdim Meremetime Per Ambientet E Bashkise	4.307
2	Likujdim Situacion Perfundimtar "Nderim Trotuari"(Pjesa Mbetur) 06220	32.246
3	Shtrese Cakulli T=10cm Perhapur E Ngjeshur Me Makineri "Kopaci"	16.593
4	Hapje Rruges Per Tek Varrezat Nga Arra E Cukut Mona Shpk	7.821
5	Grumbullim I Vendburimeve Ujore Per Funiz. Me Uje Te F. Berzeshte Zdravo Shpk	185.421
6	Grumbullim I Vendburimeve Ujore Per Funiz. Me Uje Te F. Berzeshte Zdravo Sit 2	211.885
7	Grumbullim I Vendburimeve Ujore Per Funiz. Me Uje Te F. Berzeshte Zdravo Sit 2	84.579
8	Rikonstruksion Kopshti , Lagja Liqeni Prrerjas	11.328
9	Riparim Tualetesh Shkolla Urake,Pishkash Dhe Rrajce Shkelqim Kurti	19.794
10	Grumbullim I Vendburimeve Ujore Per Funizimin Me Uje Te Pishem F. Berzesht	124.379
11	Rikos. I Qendres Multifunkionale Bashkia Prrerjas Kinemaja E Qytetit	329.761
12	Rikonstruksion I Rruges Se Brendshme Nga Rruga Minatori Deri Te Rruga Blerimi	96.174
13	Rehabilitim Perforcim Banesash Ekzistuse	817.816
14	Rikonstruksion I Urave Ekzistuse Fanje Dhe Gurre , Qukes Jodjon- Po Shpk	13.578
15	Rikonstruksioni I Rruges Se Brendshme Nga Rruga Minatori Deri Te Rrg.. Blerimi	23.869
16	Rikons. Dhe Riveshje Me Asfaltim I Pjeseve Te Demtuara Te Rruges Lapidari Qukes Shkumbin, Mulliri I Belbes, Asfaltim I Rruges Ne Lagjen E Kryeziut,Asfaltim Rruges Ne Lagjen E Shytit Dhe Rikonceptimi I Qendres Se Fshatit Qukes Nj. Adm. Qukes,B. Prrerjas	750.000
17	Nderim I Kanalizimeve Te Ujerave Te Zeza Ne Qukes Qender Njesia Administrative Qukes,Bashkia Prrerjas	120.959
18	Rikonstruksion I Rrugeve Muhamet Kadia Lagjia E Spitalit , Bashkia Prrerjas	120.623
19	Rikons. Dhe Riveshje Me Asfaltim I Pjeseve Te Demtuara Te Rruges Lapidari Qukes Shkumbin, Mulliri I Belbes, Asfaltim I Rruges Ne Lagjen E Kryeziut,Asfaltim Rruges Ne Lagjen E Shytit Dhe Rikonceptimi I Qendres Se Fshatit Qukes Nj. Adm. Qukes,B. Prrerjas Sit Nr 2 Nga 01	950.241
20	Rikons. Dhe Riveshje Me Asfaltim I Pjeseve Te Demtuara Te Rruges Lapidari Qukes Shkumbin, Mulliri I Belbes, Asfaltim I Rruges Ne Lagjen E Kryeziut,Asfaltim Rruges Ne Lagjen E Shytit Dhe Rikonceptimi I Qendres Se Fshatit Qukes Nj. Adm. Qukes,B. Prrerjas Sit 2 Nga 05	949.759
21	Rikons. Dhe Riveshje Me Asfaltim I Pjeseve Te Demtuara Te Rruges Lapidari Qukes Shkumbin, Mulliri I Belbes, Asfaltim I Rruges Ne Lagjen E Kryeziut,Asfaltim Rruges Ne Lagjen E Shytit Dhe Rikonceptimi I Qendres Se Fshatit Qukes Nj. Adm. Qukes,B. Prrerjas Situacion Nr 3. Dt 16.03.2021	589.255
22	"Rikonstruksion Shkolle Katjel", Bashkia Prrerjas Sit Nr 1 Date 22.04.2021	223.133
23	Rikons. Dhe Riveshje Me Asfaltim I Pjeseve Te Demtuara Te Rruges Lapidari Qukes Shkumbin, Mulliri I Belbes, Asfaltim I Rruges Ne Lagjen E Kryeziut,Asfaltim Rruges Ne Lagjen E Shytit Dhe Rikonceptimi I Qendres Se Fshatit Qukes Nj. Adm. Qukes,B. Prrerjas	437.749
24	Rikonstruksion I Shkolles Katjel, Bashkia Prrerjas Situac Nr. 2	235.428
25	Rikonstruksion I Shkolles Katjel Situacion Perfundimtar	115.461
26	Nderim I Nje Kendi Lojrash Per Femijet Dhe Vendosje Dere E Brendshme Shkolla Katjel,Vendosje Ulluqesh,Veshje Shkallësh,Me Mermer Hidroizolimtarace Nderim Muri Betoni Dhe Rrethim Me Rrjet Teli Shkolla E Mesme Karkavec Njesia Adm Qukes Bashkia Prrerjas	102.628
27	"Rehabilitim Skemes Ujitese Radigoz- Stranik-Berzeshte", Bashkia Prrerjas	687.222
28	"Rikonstruksion I Rruges Qukes Skenderbe,Bashkia Prrerjas	437.168
29	"Rikonstruksion I Rruges Qukes Skenderbe,Bashkia Prrerjas	801.056
30	"Permiresim I Banesave Ekzistuse Per Komunitete Te Varfera Dhe Te Pafavorizuar"	538.227
31	"Rikonstruksion I Rrugeve Te Brendshme Ne Bashkine Prrerjas : Rruga 1 Qershori/ Rruga 5 Maj "	201.889
32	Nderim I Kanalizimeve Te Ujerave Te Zeza Ne Qukes Qender Njesia Administrative Qukes,Bashkia Prrerjas	38.511
33	"Rikonstruksion I Rruges Qukes Skenderbe,Bashkia Prrerjas Sit Nr 2	447.084
34	Rikons. Dhe Riveshje Me Asfaltim I Pjeseve Te Demtuara Te Rruges Lapidari Qukes Shkumbin, Mulliri I Belbes, Asfaltim I Rruges Ne Lagjen E Kryeziut,Asfaltim Rruges Ne Lagjen E Shytit Dhe Rikonceptimi I Qendres Se Fshatit Qukes Nj. Adm. Qukes,B. Prrerjas	446.382
35	Rikons. Dhe Riveshje Me Asfaltim I Pjeseve Te Demtuara Te Rruges Lapidari Qukes Shkumbin, Mulliri I Belbes, Asfaltim I Rruges Ne Lagjen E Kryeziut,Asfaltim Rruges Ne Lagjen E Shytit Dhe Rikonceptimi I Qendres Se Fshatit Qukes Nj. Adm. Qukes,B. Prrerjas	653.221
36	Nderim Kendi I Ri Lojrash Qyteti Prrerjas, Bashkia Prrerjas"Sit Perfundimtar	67.269
37	"Rikonstruksion I Rruges Qukes Skenderbe,Bashkia Prrerjas	474.691
38	"Rikonstruksion I Rrugeve Te Brendshme Ne Bashkine Prrerjas : Rruga 1 Qershori/ Rruga 5 Maj " Sit Perfundimtar	278.569
39	"Permiresimin E Kushteve Te Banesave Per Komunitetet E Varfera Dhe Te Pafavorizuar"	557.516
40	" Rikonstruksion I Rruges Qukes Shkumbin- Skroske Bashkia Prrerjas " Sit Nr 1	600.000
41	"Ndertimi I Njës Këndi Lojrash Për Femijë Dhe Vendosje Dere E Brendshme Shkolla Katjel Nj Adm Rrajcë Bashkia Prrerjas ,Vendosje Ulluqe ,Veshje Shkallësh Me Mermer ,Hidroizolim Tarrace,Ndertimur Betoni Dhe Rrethim Me Rrjete Teli Shkolla Mesme Karkavec Njësia Adm Qukës Bashkia Prrerjas" Sit Perfundimtare	23.400
42	" Rikonstruksion I Rruges Qukes Shkumbin- Skroske Bashkia Prrerjas " Sit Nr 2	457.822
43	"Rehabilitim Skemes Ujitese Radigoz- Stranik-Berzeshte", Bashkia Prrerjas Situacion Perfundimtar	1.055.886
44	"Rikonstruksion I Shkolles Stravaj" Situacioni Nr 1	80.340
45	"Nderim Mur Guri Mbajtes Per Rrugen Lagjia Tarushi, Rikons. E Rruges Te Shkolla 9-Vjecare Rrajce,Ndertim Mur Guri Mbajtes Per Rrugen Lagjia Hana, Nderim Mur Guri Mbajtes Per Perroin+ Perforcim Themeli Te Xhamia Rrajce, Nderim Mur Guri Mbajtes Per Rrugen Lagjia Rira. Nderim Ur Guri Mbajtes Per Rrugen Te Banesa E Tefik Rira"	47.267
46	"Permiresimin E Kushteve Te Banesave Per Komunitetet E Varfera Dhe Te Pafavorizuar"	488.565
47	"Permiresim I Banesave Ekzistuse Per Komunitete Te Varfera Dhe Te Pafavorizuar"Sit Nr 2 Per Vitin 2021	252.455
	<b>Totali</b>	<b>15.209.327</b>

*Burimi: Bashki Prrerjas, Drejtoria e financës.*

**Aneksi nr.2 – Mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit trajtuar nga faqja nr.28 deri në faqen nr.40 të projekt raportit të auditimit.**

Tabela nr. 1, Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2023 për mallra dhe shërbime (Nga të ardhurat e veta + transfertën e pakushtëzuar)

Nr.	Emërtimi i i Objektivit	Emërtimi i Subjektit	Data e lidhjes së kontratës	Nr. i faturës	Data e Faturës	Vlera e detyrimit ne 31.12.2022	Shtesat gjate vitit 2023	Shlyerjet gjatë vitit 2023	Gjendja 31.12.2023
1	Detyrime Te Prapambetura Energji Elektrike Per Kontraten E10e200002100245	F I ShU Sh.A				1,582,615	0	1,582,615	
2	Organizim Aktiviteti Dhe Dekorim I Qytetit Per Vitin E Ri	D B	3287/3 prot dt.31.12.2018	50	15.01.2019	1,320,672	0	0	1,320,672
<b>Totali i detyrimit</b>						<b>2,903,287</b>		<b>1,582,615</b>	<b>1,320,672</b>

Burimi: Bashkia Prrrenjas

Tabela nr.2, Lista e vendimeve gjyqësore të ardhura në financë dhe likuidimet e kryera prej saj për dëmshpërblim page, për punonjësit e larguar nga puna.

Emri i kreditorit	Vendim Gjykatë nr./dt	Objekti i Vendimit	Vlera e detyrimit sipas Vendimit Gjykatës	Gjendja e palikujduar 31/12/2022	Vendime të ardhura gjatë vitit 2023		Likujduar gjate vitit 2023- janar -shukurt 2024	Mbetja date 31.12.2023
					Nr dhe dt. Gjykatës	Vlera e vendimit		
1	2	3	4	5	6	7	8	9=5+7-8
B Q	Vendim Nr. 405(86-203-580) Date18.05.2023 Gjykata Administrative E Apelit Tirane	Shpërblim page	394,820		Vendim Nr. 405(86-203-580) Date18.05.2023	394,820	394,820	
M A	Vendim Nr.210(13-2022-1418) Dt 11.04.2023 Te Gjykates Se Rrethit Gjyqesore Elbasan	Shpërblim page	919,709		Vendim Nr.210(13-2022-1418) Dt 11.04.2023	919,709	919,709	
Xh K	Vendim Nr.723 (13-2022-4315) Dt 27.09.2022 Gjykata E Rrethit Gjyqesor Elbasan	Shpërblim page	243,700		Vendim Nr.723 (13-2022-4315) Dt 27.09.2022	243,700	243,700	
A A	Vendim Nr.10-2022-1929/446 Dt 16.12.2022 Te Gjykates Se Apelit Durres	Shpërblim page	76,200		Vendim Nr.10-2022-1929/446 Dt 16.12.2022	76,200	76,200	
Total			1,634,429			1,634,429	1,634,429	0

Burimi: Bashkia Prrrenjas

Tabela nr.3, Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2023 për investimet (Nga transfertat të kushtëzuara, si investime nga Ministri të linjës, FSHZH)

Nr.	Emërtimi i i Objektivit	Emërtimi i Subjektit	Data e lidhjes së kontratës	Nri. i faturës	Data e Fatutës	Vlera e detyrimit ne 31.12.2022	Shtesat gjate vitit 2023	Shlyerjet gjatë vitit 2023	Gjendja 31.12.2023
1	Pyllezim Me Drure Frutor (Per Kulturen Arre Dhe Kulturen Lajthi, Ish Komuna Stravaj	E SHPK	03.09.2013	98	29.10.2013	43,8073	0	0	438,073
				39	01.07.2015	12,649,773			12,649,773
2	Rikonstrukcion Dhe Rrethim I Shkolles Se Mesme "Halit Berzeshta" Bashkia Prrrenjas	N SHPK	26.09.2014	42	25.02.2016	2,694,084	0	2,694,084	0
3	Gjelberim. Nepermjet Pyllez. I Kurores Se Qytetit Prrrenjas	A M E	17.10.2017	843	28.12.2017	5,405,630		0	5,405,630
				163	27.03.2020	2,058,250		0	2,058,250
<b>Totali i detyrimit</b>						<b>23,245,810</b>		<b>2,694,084</b>	<b>20,551,726</b>

Burimi: Bashkia Prrrenjas

### Aneksi nr.3 – Mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave trajtuar nga faqja nr.40 deri në faqen nr.50 të projekt raportit të auditimit.

#### Organizimi i Strukturës së Taksave

Nr.	Emri Mbiemri	Funksioni Sipas Strukturës	Lloji i shkollës	Larte ose i mesëm	Urdhri i emërimit		Pozicioni i punës
					Nr., datë	Urdhri largimit Nr., datë	
1	M.V	Drejtor	Publike	Lartë	Nr.364 dt. 29.08.2023		Drejtor në Drejtorinë e të Ardhurave
2	J. B	Drejtor	Publike	Lartë	Nr.238 dt 23.06.2020	Nr.363 Dt. 29.08.2023	Drejtor ne drejtorine e te ardhurave ,lejeve dhe licencave
3	L K	Përgjegjës	Publike	Lartë	Nr.1385 dt. 10.05.2022	Nr.42 dt 25.01.2023	Pergjegjes Sektori ne drejtorine e te Adhurave
4	Z C	Specialist	Publike	Lartë	Nr.240. dt.23.06.2020	Nr. 331 dt 21.07.2023	Specialiste ne Sektorin e Lejeve dhe Licencave
5	N A	Inspektor	Publike	Mesëm	Nr.297 date 01.02.2022		Inspektor taksash dhe tarifash vendore ne Njesine Administrative Rrajce
6	O M	Specialiste	Publike	Lartë	Nr.206 . dt. 22.09.2021		Speciasiste Biznesi
7	I Xh	Specialiste	Publike	Lartë	Nr. 199dt. 25.03.2022		Specialist ne NJ. Qukes
8	A O	Inspektor	Publike	Lartë	Nr.313 date 02.02.2022		Inspektor tatimor ne bashki
9	L T	Specialist( Licensimet/ ransporti)	Publike	Lartë	Nr.389.dt.11.09.2023		Specialiste ne Sektorin e Lejeve dhe Licencave

Burimi: Bashkia Prrrenjas

Parashikimi dhe Realizimi i të Ardhurave në Bashkinë Prrrenjas, Viti 2023

Lloji i takses, tarifës	000/tekë		
	PLAN	FAKT	%
	Janar-Dhjetor -2023	Realizim Janar- Dhjetor 2023	Realizimi ne % deri me 31 Dhjetor 2023
Tatim i thjesht.mbi biznesin e vogel	0	169	-
T .Biznesi I vogel	0	33	-
Taksa e regj.pervitsh automj.	8,000	10,492	131.2
Taksa nga tatimi mbi te ardhurat personale(2%)	7,200	9,498	131.9
Taksa mbi ndertesat	7,200	6,701	93.1
Taksa e ndikimit ne infrastrukt.	15,400	6,832	44.4
Takse tregu + Ambulante	1,500	1,140	76.0
Taksa e kalim te drejt.prones.	200		-
Te ardhura nga RENTA	1,200	57	5
Takse toke bujq.	4,700	3,182	67.7
Takse tablele /reklame / banderole	1,600	1,670	104.4
Takse mbi truallin shesh funksional	2,500	1,399	56.0
Takse e perkohshme arsim	1,700	856	50.4
Takse Hoteli	50	7	14.0
<b>TOTALI TAKSAVE VENDORE</b>	<b>51,250</b>	<b>42,036</b>	<b>82</b>
Te ardhura nga Tarife Uji Pijshem	20,000	4,386	22
Tarife pastrimi	18,271	10,140	55
Tarifa te tjera nga Urbanistika	1,800	1,059	59
Leje transporti+ Tarife parkim	600	392	65
Tarife vaditje	223	211	95
Tarife ndricimi	2,200	1,972	90
Tarife Kabellori	700	186	27
Tarife Gjelberimi	1,200	735	61
Tarifa ne sektorin e pyjeve dhe kullotave t. Drusore	1,000	312	31
<b>TOTALI I TARIFAVE VENDORE</b>	<b>45,994</b>	<b>19,393</b>	<b>42.2</b>
Takse per perdorimin e hapsirave publike			-
Te tjera TE PAPANIFIKUARA/ shitje mallrash nga ankandi		1,190	-
Sponsorizime nga individvet		15	-
Sponsor jo qeveritar		287	-
Grant nga nje nivel qeverisje		6,000	-
Sekuestro dhe zhdemtime nga ndihma ekonomike		7	-
<b>TOTALI TE ARDHURAVE TE PAPANIFIKUARA</b>	<b>-</b>	<b>7,499</b>	<b>-</b>
Pagesa e prinderve çerdhe	1,000	933	93
Pagesa e prinderve kopesht	2,500	2,616	105
Totali I kopesht/ Cerdhe	3,500	3,549	101
Qira Trualli + QIRA KULLOTASH	7,036	13,569	193
QIRA KULLOTASH	120	124	103
Tarife per akte ligj. dhe administrative	800	591	74
Te ardhura nga pullat e gjendjes civile	50	23	46
Te ardhura nga gjobat	500	1,317	263
MZSH Zjarri	500	285	57
Tarife e ndikimit ne mjedis	4,500	3,925	87
Tarife per mirembajtjen e rrugeve	1,000	1,181	118
TE Ardhurat nga Debitoret	16,000		-
Tarife Vendore Per shfrytezim Karburantesh	3,000	321	11
Tarife per mirembajtje varrezash	500	823	165
Tarife inertesh	250		-
Te Ardhura te tjera jo tatimore		10	-
Totali TE TJERA	34,256	22,169	65
<b>TOTALI TE ARDHURAVE 2023</b>	<b>135,000</b>	<b>94,646</b>	<b>70</b>

Burimi: Bashkia Prrrenjas

Tabela Analitike Gjobat e Policisë Bashkiake

Nr.	Subjekti	Nr.Serial, Date Vendim Gjobe	Vlera	Paguar	Debitor	Gjithësej
1	I K	105 Dt.30.01.2023	500	Po		500
2	F K	106 Dt.21.02.2023	3000	Po		3000
3	A H	107 Dt.31.05.2023	2000	Po		2000
4	F S	108 Dt.27.08.2023	500	Po		500
5	S G	109 Dt.11.09.2023	500	Po		500
6	F K	116 Dt.19.09.2023	2000	Po		2000
7	Aa..M	905dt 06.01.2023	500	Jo	500	0
8	U K	906 Dt 22.02.2023	1000	Jo	1000	0
9	Aa...pu	910 Dt 14.07.2023	1000	Jo	1000	0
10	I Z	912 Dt 10.09.2023	500	Jo	500	0
11	Aa..vh	915 Dt 28.12.2023	500	Jo	500	0
12	Aa...sa	155 Dt 23.01.2023	500	Jo	500	0
13	Aa...ev	156 Dt24.01.2023	500	Po		500
14	El.c	157 Dt 27.03.2023	500	Po		500
15	Aa...ul	158 Dt 14.08.2023	500	Jo	500	0
16	Aa...ev	159 Dt 15.11.2023	500	Po		500
17	Ab..bo	160 Dt 15.12.2023	500	Po		500
18	Aa..da	161 Dt 28.12.2023	500	Po		500
19	Aa..vd	162 Dt 28.12.2023	500	Jo	500	0
20	M K	014 Ft 11.09.2023	2000	Jo	2000	0
21	R M	015 Dt 22.10.2023	500	Po		500
22	E P	016 Dt 22.10.2023	500	Po		500
23	K S	017 Dt 22.10.2023	500	Po		500
24	A S	13 Dt 02.07.2023	500	Po		500
25	B H	907 Dt 27.03.2023	1000	Po		1000

26	A A	908 Dt 14.04.2023	500	Po	500
27	Aa.gi	909 Dt 12.06.2023	500	Po	500
28	A S	911 Dt 14.09.2023	1000	Po	1000
29	Rr S	913 Dt 01.11.2023	500	Po	500
30	A T	914 Dt 19.12.2023	500	Po	500
31	Aa. Hr	73 Dt 08.11.2023	500	Po	500
32	Ab . Aa	75 Dt 02.12.2023	500	Jo	500
<b>Totali</b>			<b>25,000</b>		<b>7,500 17,500</b>

Burimi: Bashkia Prrrenjas

### Debitorë Biznesi i Madh

Nr	Subjekti	AUTORIZIM tregtim me pakice nafte	NIPTI	ADRESA	GJENDJA E DETYRIMIT DERI ME 31.12.2023
1	2		3	4	
1	S E SHPK		L.A	bashkia Prrrenjas	- 0
2	H-I SHPK		K.I	bashkia Prrrenjas	0
3	G E SHPK		L.R	bashkia Prrrenjas	2,563,772
4	F-C A		L.Q	bashkia Prrrenjas	387,800
5	M E K K SHPK		K.U	bashkia Prrrenjas	-
6	M		L.F	bashkia Prrrenjas	370,184
7	(OSHE)		L.L	bashkia Prrrenjas	-
8	TMC		K.P	bashkia Prrrenjas	1,090,435
9	A SHPK		J.Q	bashkia Prrrenjas	- 0
10	G SHPK		K.G	bashkia Prrrenjas	-
11	N S.H.P.K		K.I	bashkia Prrrenjas	1,201,601
-	P 2010 SHPK		L.E	bashkia Prrrenjas	369,545
12	L B SHPK		J.M	bashkia Prrrenjas	974,920
13	E T M G SHPK		K.I	bashkia Prrrenjas	700,000
14	K-12 SHPK		K.C	bashkia Prrrenjas	635,000
15	B B & B S.H.P.K		K.F	bashkia Prrrenjas	-
16	B 2017		L.K	bashkia Prrrenjas	-
17	E		L.B	bashkia Prrrenjas	-
18	S P			bashkia Prrrenjas	-
19	F B		K.C	bashkia Prrrenjas	67,959
20	K SHPK	26.04.2018-25.04.2023	L.J	bashkia Prrrenjas	15,647
21	F I D N		K.C	Prrrenjas , Dega Prrrenjas, Qender Prrrenjas, Rruga e tregut, Pallati 17/7, Bashkia Prrrenjas	0
22	A P		J.N	bashkia Prrrenjas	7,739
23	R B		L.B	bashkia Prrrenjas	0
24	K SHPK		K.H	bashkia Prrrenjas	1,554,150
25	U-K P ,sha (qira ndertese )	NR.3559prot 22.12.22	M.U	bashkia Prrrenjas	0
26	D R E S E		K.V	bashkia Prrrenjas	-
27	B P		L.O	bashkia Prrrenjas	- 0
28	A M C		L.M	bashkia Prrrenjas	0
29	D E		L.O	bashkia Prrrenjas	- 0
30	M-P SHPK		L.A	bashkia Prrrenjas	- 0
31	M-P SHPK		L.A	bashkia Prrrenjas	0
32	L - I A		K.V	bashkia Prrrenjas	- 0
33	SHRSF M SH P K		K.A	bashkia Prrrenjas	90,000
34	M - F SHPK		J.B	bashkia Prrrenjas	210,844
35	K T S.H.P.K		K.U	bashkia Prrrenjas	0
36	M SHPK		K.I	bashkia Prrrenjas	65,000
37	GS.B E		L.A	bashkia Prrrenjas	-
38	K SHPK		J.P	bashkia Prrrenjas	1
39	E G		L.A	bashkia Prrrenjas	- 0
40	F "B" E		K.D	bashkia Prrrenjas	- 0
41	SH		K.K	bashkia Prrrenjas	0
42	B-G SHPK		L.H	bashkia Prrrenjas	0
43	F-A B A		K.V	bashkia Prrrenjas	- 0
44	A P P dergo postes librazhd	INSTITUCION	J.N	bashkia Prrrenjas	1
45	A P S		J.N	bashkia Prrrenjas	0
46	A P RR		J.N	bashkia Prrrenjas	- 0
47	A P Q		J.N	bashkia Prrrenjas	- 1
48	A P D Q TH		J.N	bashkia Prrrenjas	-
49	A S C T		K.I	bashkia Prrrenjas	- 0
50	T B L		J.V	bashkia Prrrenjas	-
51	O A SHA (A Q)		J.Ë	bashkia Prrrenjas	220,360
52	G C GKG		K.T	bashkia Prrrenjas	1
53	A RR		J.N	bashkia Prrrenjas	0
54	A Q		J.N	bashkia Prrrenjas	230,000
55	V A RR		K.L	bashkia Prrrenjas	-
56	F GJ		K.N	bashkia Prrrenjas	0
57	A SHPK		J.F	bashkia Prrrenjas	- 0
58	S I G Q,TH (N)		J.O	bashkia Prrrenjas	- 1
59	S I V P		J.O	bashkia Prrrenjas	0
60	I S.H.A		L.D	bashkia Prrrenjas	- 0
61	R shpk		K.V	bashkia Prrrenjas	- 1
62	K SHPK		L.A	bashkia Prrrenjas	0
63	G SHPK		M.K	bashkia Prrrenjas	-
64	L - T shpk		L.Q	bashkia Prrrenjas	-
65	T B 2002 SHPK		L.R	bashkia Prrrenjas	-
66	A - T shpk		L.U	bashkia Prrrenjas	65,092
67	S2 A		L.Q	bashkia Prrrenjas	427,180
68	K SHPK		K.E	bashkia Prrrenjas	- 0
69	R E shpk		L.N	bashkia Prrrenjas	1
70	E-F		L.I	bashkia Prrrenjas	131,725
	F M (I b)			bashkia Prrrenjas	-
71	Rr T		L.L	bashkia Prrrenjas	- 0
	F SHPK		M.U	Bashkia Prrrenjas NJ.A QUKES	-
72	R		J.Q	bashkia Prrrenjas	-
	N-2018 SHPK		L.G	bashkia Prrrenjas	174,954



73	L S		K.Q	bashkia Prrrenjas	-
74	S T		L.C	bashkia Prrrenjas	-
75	S		J.M	bashkia Prrrenjas	364,928
76	E SBS		L.F	bashkia Prrrenjas	0
77	K D		L.O	bashkia Prrrenjas	30,000
78	K B		K.A	bashkia Prrrenjas	-
79	B D C			bashkia Prrrenjas	0
80	M		L.R	bashkia Prrrenjas	330,000
	A E N SHPK kontrate qiraje me kuarcir blace		L.A	bashkia Prrrenjas	187,834
81	P TRANS SHPK		L.K	bashkia Prrrenjas	117,335
82	L SHPK		M.S	bashkia Prrrenjas	11,850
	I B		KONTRATE QERA 25.05.2021-25.5.2022	bashkia Prrrenjas	20,160
	S & D L		J.S	bashkia Prrrenjas	-
83	S U G A		J.H	bashkia Prrrenjas	-
84	AK I SHPK		rruga ded gio luli 2/3,tiranr 1001 albania	bashkia Prrrenjas	-
86	S& R		L.P	bashkia Prrrenjas	300,000
88	S A- A SHPK		K.M	bashkia Prrrenjas	-
89	U. SHPK	DOGAN	J.F	bashkia Prrrenjas	-
90	B. X SHPK		K.N	bashkia Prrrenjas	110,120
91	MGM P. SHPK		K.N	bashkia Prrrenjas	304,985
	S. P. H.		M.F		296,619
92	E. H SHPK	3 mega (300.000t.	L.M	AFATI DERI ME 25.03.2031	-
100	L CH D KALO BIZNES I VOGEL		M.A	bashkia Prrrenjas	36,507
93	E SHPK		K.C	bashkia Prrrenjas	-
94	OST		K.N	bashkia Prrrenjas	-
	OST sha		K.N	BASHKIA PRRENJAS	-
	R		J.U		21,726
95	F.I.C SHPK		L.I	BASHKIA PRRENJAS	0
96	S R E	ALTIN KODRA	M.V	bashkia Prrrenjas	-
97	E	LLOGARIT PER 5 MUAJ per vitin 2023	K.Ë	bashkia Prrrenjas	22,312
98	I V I E G	LLOGARIT PER 5 MUAJ per vitin 2024	K.T		22,312
102	B CH		L.A	bashkia Prrrenjas	-
	<b>TOTALI</b>				<b>13,730,596</b>

Burimi: Bashkia Prrrenjas

### Niptet Sekondare

Nr.	Kontratit 2023	
1	NDERTIME,RIKONSTRUKSIONE LERASH UJI PER BAGETTITE DHE SISTEMIME MALORE(PRITA MALORE) I NDARE NE LOTE: LOTI I PRITA ME MURE GURI TE THATE,LLAC,CIMENTO E BREZ	38000
2	Rikonstruksion I Kalcetos Prane Shkolles 9 Vjecare Prrrenjas-Fshat	5830
3	Ndertim Kend Lojrash Prane Shkolles 9 Vjecare Prrrenjas- Fshat, Bashkia Prrrenjas	4789
4	Permirsim I Banesave Ekzistuese Per Komunitete Te Varfera Dhe Te Pafavorizuara	38000
	<b>TOTALI</b>	<b>86,619</b>

Burimi: Bashkia Prrrenjas

### Debitorë Nga Karburantet

IDENTIFIKIMI I TATIPAGUESIT					Lloji i Aktivitetit (Kodi1-10) Sipas paketes fiskale 2021	DETYRIMI I LENE NGA KLSH	PAGESAT	DEBITORE 31.12.2022	Pagesa 2023	Debitore 31.12.2023
Nr	Subjekti	NIPTI	NJA. PRRJAS	ADMINISTRATORI						
1	L B SHPK	J.M	bashkia Prrrenjas	B L	KARBURANTI + nxjerrje minerali gurore	1,000,000	-	1,000,000		1,000,000
2	K SHPK	L.J	bashkia Prrrenjas	E M	TREGTIM NAFTE (GLN) 8*13500tabela	900,000		900,000	300,000	600,000
	<b>TOTALI</b>					<b>2,221,083</b>	-	<b>2,221,083</b>	<b>621,083</b>	<b>1,600,000</b>

Burimi: Bashkia Prrrenjas

### Debitorë Qukës Biznesi Vogël 2023

IDENTIFIKIMI I TATIPAGUESIT					DEBITORE VITI 2023
Nr	Subjekti	NIPTI	NJESIA QUKES		
			2	3	4
1	N D	L.D		NJ.Admn.Qukes	75,240
2	A L	K.H		NJ.Admn.Qukes	57,280
3	I K	L.H		NJ.Admn.Qukes	10,895
4	B L	L.U		NJ.Admn.Qukes	12,820
5	R K/F H	K.J		NJ.Admn.Qukes	6,840
6	Ra B	L.K		NJ.Admn.Qukes	71,436
7	L V	L.O		NJ.Admn.Qukes	33,720
8	S R	L.L		NJ.Admn.Qukes	65,509
9	K Y	L.M		NJ.Admn.Qukes	27,240
10	K R	L.G		NJ.Admn.Qukes	61,456
11	S K	K.H		NJ.Admn.Qukes	15,170
12	A V	L.H		NJ.Admn.Qukes	405
13	S Q	L.V		NJ.Admn.Qukes	19,866
14	F K	L.B		NJ.Admn.Qukes	36,610
15	E P	L.K		NJ.Admn.Qukes	16,310
16	I.K	L.D		NJ.Admn.Qukes	34,204
17	B.Z	L.B		NJ.Admn.Qukes	32,016
18	S.O	L.D		NJ.Admn.Qukes	6,000
19	L.H	L.D		NJ.Admn.Qukes	42,245
20	A.P	L.A		NJ.Admn.Qukes	34,516
21	A.Zh	L.T		NJ.Admn.Qukes	42,490
22	L B	L.S		NJ.Admn.Qukes	12,000
23	Xh C			NJ.Admn.Qukes	6,000
24	A K	L.R		NJ.Admn.Qukes	7,000

25	K K	M.A	NJ. Admn. Qukes	9,499
26	P Z	L.E	NJ. Admn. Qukes	58,140
27	A B	M.L	NJ. Admn. Qukes	9,388
28	S B	K.J	NJ. Admn. Qukes	31,826
29	E S nipti pezulluar	L.H	ushtro aktivitet	10,563
	<b>TOTALI</b>			<b>846,684</b>

Burimi: Bashkia Prrenjjas

### Debitorë Rrajce Biznesi Vogel 2023

IDENTIFIKIMI I TATIPAGUESIT				DEBITORE VITI 2023
Nr	Subjekti	NIPTI	NJA. PRRJAS	
1	2	3	4	
1	T.D	K.R	Nj. Admn. Rrajc	24,640
2	A K	L.D	Nj. Admn. Rrajc	29,940
3	M Z	L.Q	Nj. Admn. Rrajce	32,267
4	R V	L.V	Nj. Admn. Rrajce	68,538
5	B H	L.C	Nj. Admn. Rrajce	10,133
6	F D	L.F	Nj. Admn. Rrajce	8,545
7	G F	L.A	Nj. Admn. Rrajce	17,778
8	O Z	L.D	Nj. Admn. Rrajce	42,835
9	D H	K.V	Nj. Admn. Rrajce	22,489
10	Y D	K.R	Nj. Admn. Rrajce	46,539
11	S K	L.R	Nj. Admn. Rrajce	50,083
12	A B	K.D	Nj. Admn. Rrajce	70,878
13	Nj D	L.P	Nj. Admn. Rrajce	11,038
14	Sh L	L.Q	Nj. Admn. Rrajce	20,968
15	A L	L.I	Nj. Admn. Rrajce	9,765
16	S L	L.Q	Nj. Admn. Rrajce	8,473
17	A T	L.F	Nj. Admn. Rrajce	9,400
18	S C	L.R	Nj. Admn. Rrajce	7,833
19	B T	L.V	Nj. Admn. Rrajce	12,550
20	I H	L.G	Nj. Admn. Rrajce	18,516
21	L H	L.P	Nj. Admn. Rrajc	28,449
22	I B	L.R	Nj. Admn. Rrajc	13,569
23	A B	L.F	Nj. Admn. Rrajc	21,095
24	G L	L.H	Nj. Admn. Rrajc	14,738
25	D L	M.A	Nj. Admn. Rrajc	9,000
26	A B	L.E	Nj. Admn. Rrajc	8,688
27	Rr S	K.R	Nj. Admn. Rrajc	313,262
28	D A	L.F	Nj. Admn. Rrajc	9,360
29	O T	L.J	Nj. Admn. Rrajce	12,823
30	A L	L.T	Nj. Admn. Rrajce	9,120
31	Sh T	L.C	Nj. Admn. Rrajce	10,120
32	D L	L.M	Nj. Admn. Rrajce	15,464
33	E K	L.L	Nj. Admn. Rrajce	40,120
34	N B	M.H	Nj. Admn. Rrajce	23,808
35	A D	L.H	Nj. Admn. Rrajce	22,841
36	D B	L.O	Nj. Admn. Rrajce	14,965
37	A I K	K.R	Nj. Admn. Rrajce	12,970
38	R K		Nj. Admn. Rrajce	27,313
39	M H	L.L	Nj. Admn. Rrajce	8,830
40	Xh B	K.K	Nj. Admn. Rrajce	12,800
41	B C	L.K	Nj. Admn. Rrajce	10,100
42	Q Th	M.N	Nj. Admn. Rrajce	17,245
43	A C	M.C	Nj. Admn. Rrajce	17,245
	<b>TOTALI</b>			<b>1,197,133</b>

Burimi: Bashkia Prrenjjas

### Debitorë Biznesi i Vogël Prrenjjas

IDENTIFIKIMI I TATMIPAGUESIT				
Nr	Subjekti	NIPTI	NJA. PRRJAS	DEBITOR 31.12.2023
1	2	3	4	
1	MP	L.C	PRRENJAS	20,538
2	A Ç	K.T	PRRENJAS	16,879
3	A R	K.I	PRRENJAS	38,700
4	A A	L.F	PRRENJAS	37,986
5	A B	L.C	PRRENJAS	50,552
6	A P	L.N	PRRENJAS	120,504
7	A T	L.Q	PRRENJAS	19,251
8	A S	L.L	PRRENJAS	83,949
9	A K	L.I	PRRENJAS	32,499
10	A B	K.C	PRRENJAS	56,333
11	A Z	L.T	PRRENJAS	23,860
12	A Z	K.G	PRRENJAS	50,673
13	V Z	M.T	PRRENJAS	49,671
14	A C	K.V	PRRENJAS	12,120
15	A T	L.E	PRRENJAS	20,749
16	A Sh K	L.A	PRRENJAS	50,063
17	A C	K.N	PRRENJAS	22,785
18	A K	L.U	PRRENJAS	9,120
19	B K	L.D	PRRENJAS	148,102
20	B Zh	L.Q	PRRENJAS	17,564
21	B F	L.J	PRRENJAS	23,258
22	B D	K.E	PRRENJAS	16,879
23	D Z	L.L	PRRENJAS	149,294
24	D C	L.E	PRRENJAS	19,730

25	DO	LN	PRRENJAS	11,000
26	DD	LU	PRRENJAS	53,930
27	DB	LB	PRRENJAS	45,034
28	ED	KA	PRRENJAS	114,811
29	EÇ	KE	PRRENJAS	6,927
30	EK	LV	PRRENJAS	17,342
31	EG	LK	PRRENJAS	30,210
32	EO	LG	PRRENJAS	20,397
33	FM	LA	PRRENJAS	152,704
34	FK	KJ	PRRENJAS	24,007
35	FK	KT	PRRENJAS	17,194
36	FK	LR	PRRENJAS	77,093
37	EK	MM	PRRENJAS	5,997
38	EH	LD	PRRENJAS	21,045
39	FP	KH	PRRENJAS	65,235
40	FC	LG	PRRENJAS	17,786
41	FB	LC	PRRENJAS	39,952
42	FZh/E	KO	PRRENJAS	120,383
43	GSh	LG	PRRENJAS	20,638
44	EXh	LV	PRRENJAS	23,841
45	GK	LL	PRRENJAS	5,068
46	IM	LU	PRRENJAS	21,655
47	IB	LQ	PRRENJAS	25,208
48	JLI	LQ	PRRENJAS	22,378
49	JZ	LA	PRRENJAS	26,567
50	JA	KD	PRRENJAS	32,599
51	KR	KV	PRRENJAS	27,776
52	KRr	LM	PRRENJAS	34,758
53	LK	LP	PRRENJAS	28,785
54	KS	KM	PRRENJAS	14,654
55	LS	LK	PRRENJAS	167,091
56	MV	KF	PRRENJAS	134,293
57	MK	LO	PRRENJAS	18,194
58	ML	LC	PRRENJAS	40,276
59	LD	LR	PRRENJAS	20,138
60	MP	LR	PRRENJAS	19,008
61	MA	LB	PRRENJAS	58,650
62	ML	LN	PRRENJAS	16,675
63	MK	LI	PRRENJAS	33,889
64	AZ	LA	PRRENJAS	38,574
65	NS	KI	PRRENJAS	123,186
66	NK	MK	PRRENJAS	16,064
67	MKF	LM	PRRENJAS	19,120
68	PB	LD	PRRENJAS	24,211
69	PA	LO	PRRENJAS	23,804
70	QH	LM	PRRENJAS	31,498
71	RC	LR	PRRENJAS	10,240
72	RK	LO	PRRENJAS	8,578
73	RR	KF	PRRENJAS	61,676
74	RR	KF	PRRENJAS	32,939
75	SL	LI	PRRENJAS	31,240
76	SB	LP	PRRENJAS	17,694
77	SA	KT	PRRENJAS	20,272
78	ShB	KB	PRRENJAS	82,070
79	DÇ	LA	PRRENJAS	22,080
80	ShM	LO	PRRENJAS	20,164
81	ShA	KU	PRRENJAS	23,050
82	OK	LJ	PRRENJAS	19,730
83	BB	LD	PRRENJAS	41,538
84	TK	LI	PRRENJAS	12,371
85	TK	LM	PRRENJAS	180,196
86	VSh	LJ	PRRENJAS	147,007
87	VJ	KB	PRRENJAS	44,671
88	IA	LV	PRRENJAS	21,767
89	VB	KR	PRRENJAS	138,694
90	VR	LK	PRRENJAS	56,713
91	XhB	KG	PRRENJAS	98,331
92	NA	LG	PRRENJAS	16,206
93	FV	LN	PRRENJAS	34,488
94	EK	LA	PRRENJAS	71,320
95	IG	LI	PRRENJAS	19,064
96	MM	LD	PRRENJAS	17,194
97	MK	LF	PRRENJAS	125,565
98	SH	LR	PRRENJAS	23,313
99	KA	LG	PRRENJAS	144,166
100	RK	LL	PRRENJAS	45,895
101	ShN	LU	PRRENJAS	24,951
102	SK	LO	PRRENJAS	62,193
103	OL	LA	PRRENJAS	17,488
104	DM	LT	PRRENJAS	56,177
105	BK	LS	PRRENJAS	84,387
106	AM	LS	PRRENJAS	84,610
107	BZh	LF	PRRENJAS	14,935
108	DB	LH	PRRENJAS	21,767
109	EQ	LN	PRRENJAS	37,424
110	AP	LE	PRRENJAS	16,120

111	O K	M.O	PRRENJAS	37,738
112	K K	M.V	PRRENJAS	18,508
113	E Sh A B	M.G	PRRENJAS	20,749
114	Y H	M.I	PRRENJAS	27,063
115	Y H dyqan veshjesh	M.I	PRRENJAS	20,230
116	I B	M.O	PRRENJAS	67,476
117	E Zh	M.N	PRRENJAS	45,534
118	M P	L.K	PRRENJAS	55,681
119	F K	M.C	PRRENJAS	15,694
120	D S	M.A	PRRENJAS	25,942
121	M P	M.S	PRRENJAS	22,815
122	I B	L.O	PRRENJAS	17,288
123	D Korca (nder..H.K)	M.U	PRRENJAS	18,949
124	M R	L.D	PRRENJAS	22,640
125	E T	L.A	PRRENJAS	38,240
126	B K/E K	L.G	PRRENJAS	72,972
127	3 - B	M.L	PRRENJAS	19,176
128	F P	M.S	PRRENJAS	20,825
129	E E	L.O	FARRET	86,084
130	D C	K.O	FARRET	32,828
131	A V	L.C	FARRET	12,246
132	O Z	L.E	STRANIK	28,754
133	A A	M.A	PRRENJAS	9,120
134	A K	M.J	PRRENJAS	28,341
135	E K	L.C	PRRENJAS	53,074
136	V K	K.D	PRRENJAS	6,060
	<b>TOTALI</b>			<b>5,833,015</b>

*Burimi: Bashkia Prrenjas*

**Për sa më sipër paraqitet Raporti Përfundimtar i Auditimit.**

## **KONTROLLI I LARTË I SHITIT**

